



NDAL SHPËRFILLJES SË EDUKIMIT

Kritika e programeve arsimore

të partive politike shqiptare

Në prag të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, 11 maj 2025



PËRMBAJTJA



1. Disa mesazhe nga Naim dhe Sami Frashëri - faqe 3
2. Reagoni me votim kundër shpërfilljes së sistemit arsimor - faqe 5
3. Vota e pavlefshme është reagim i ligjshëm - faqe 6
4. Kushtet për anulim të protestës - faqe 7
5. Klasa politike që edukon keq popullin nuk mund të bëjë program për arsimin dhe edukimin - faqe 8
6. Shpërfillja e sistemit arsimor nga media shqiptare në bashkëpunim me kartelin e partive politike - faqe 9
7. Pse arsimit duhet të jetë prioriteti Nr.1 - faqe 10
8. Shpërfillja e arsimit provë e ekzistencës së kartelit të partive - faqe 13
9. Shthurja e mësimi dhe e frymëzimit prej Rilindjes Kombëtare është mekanizëm shpjegues i politikës së shthurjes kombëtare - faqe 14
10. Arsyet pse nuk do të votojmë më 11 maj 2025 - faqe 15
11. Anashkalimi i programit politik për çështjen fetare është pjesë e shpërfilljes së rëndësisë së sistemit të edukimit - faqe 19

KRIKUA E DETAJUAR E PROGRAMEVE ARSIMORE TË PARTIVE

12. Kritika e programit të partive - faqe 20
13. Programi i Partisë Socialiste dhe kritika ndaj programit - faqe 21-41
14. Shembull i provuar nihilizmi i Ministrisë së Arsimit ndaj shkollës “Udha e shkronjave” - faqe 31
15. Për Ministrinë e Arsimit nuk ka as shkolla të tjera model - faqe 33
16. Projekti ndërtimor i parealizuar shkollor (Udha e shkronjave) - faqe 34
17. Programi i Partisë Demokratike (*inexistente*) dhe kritika - faqe 35-42
18. Qëndrimi ndaj databazës së paligjshme SMIP dhe “Mësonjëtores” provon bashkëpunimin e Partisë Demokratike me Qeverinë - faqe 40
19. Programi i Partisë Mundësia dhe kritika e programit - faqe 43-65

20. Disa mundësi të çuara dëm nga partia “Mundësia” - faqe 47-65
21. Programi i Partisë së Lirisë (ish-LSI) dhe kritika - faqe 66 - 70
22. Programi i Lëvizjes Bashkë dhe kritika - faqe 71-93
23. Programi i Lëvizjes “Shqipëria bëhet” - faqe 94 -102
24. Programi i Koalicionit Euroatlantik - faqe 103 - 106
25. Programi i Aleancës Kombëtare Shqiptare - faqe 107- 108
26. Programi i Lëvizjes Atdheu - faqe 109-111
27. Programi i Partisë “Djathtas për Zhvillim” - faqe 112

ARTIKUJ TË RIBOTUAR

28. “Qeverive të Shqipërisë dhe të Kosovës për projektligjin e propozuar (Artur Shkurti, Udha e shkronjave) *për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë*” - faqe 113
29. Mesazh Kuvendit të Shqipërisë (për artikullin më sipër) - faqe 114
30. Reagimet e mësuesve, pedagogëve, intelektualëve për projektligjin e propozuar - faqe 115-116
31. Mungesa e reagimit nga deputetët, parlamenti, ministrat dhe qeveritë - faqe 117
32. Një krahasim me reagimin e diplomatëve të huaj ndaj të njëjtit propozim - faqe 117
33. Global Albania (ribotim i broshurës) - faqe 118-144

ARTIKUJ TË DATËS 10 MAJ 2025

34. Mos votoni, mos shenjtëroni partitë politike që shpërfillin arsimin
35. Elita politike dhe mediatike që i ka fëmijët në shkollat private (shqiptare, të huaja, fetare) shpërfillin arsimin publik
36. Kokëfortësia e partive në shpërfilljen e arsimit do ta shthurë kombin shqiptar ...



*Tregomu dhe shqipëtarëve
udhën' e punës së mbarë,
Bashkomi, bëmi vëllezër,
edhe fjeshtë shqipëtarë.*

Naim Frashëri

Korça



“Mësonjëtores së parë shqipe”, Korçë, 7 mars 1887
Vepër e Naim & Sami Frashërit dhe e Rilindjes Kombëtare

O vëllezër shqipëtarë,
Gëzohi që erth kjo ditë
Kaq' e mir'e kaq'e mbarë,
Që sjell gjithë mirësitë!

Kjo është një dit'e rezë,
Që bie vëllazërinë
E dëbon jetën e zezë
Dhe ndarjen e marrëzinë.

Ta lusimë këtë ditë,
Q'ë bekoi zot'i vërtetë
Dh'ë dërgoi me shumë dritë,
T'i mbes'emëri përjetë.

Sot e vumë gurr'e parë,
Sa'sht'e bekuar kjo ditë!
Zot'i math e pruftë mbarë
E na dhëntë urtësinë!

Hapu, hapu, errësirë!
Pa jakë tëhu, o dritë!
Se arriti koh'e mirë,
U gdhi nata, u bë ditë.

Sot niset një tjetër jetë,
Të rremenë posht'e shtije,
Mbretëron fjal'e vërtetë,
Dhe të mirat gjith'i bije.

Zot'i math qoft'i lëvduar,
Q'ë nxjer në shesht të vërtetën,
Se ajo sij ka buruar,
Pa e ndritur jetën.

Lumja ti, moj Korç'o lule,
Q'i le pas shoqet' e tua!
Si trimi në ball'u sule,
Ta paçim përjetë hua!

Kushdo që është sot burrë
Dhe shqipëtar i vërtetë,
Emëri s'i shuhet kurrë
Dhe nderi i rron përjetë.

Gjuha jonë sa e mirë!
Sa e ëmblë, sa e gjerë!
Sa e lehtë, sa e lirë!
Sa e bukur, sa e vlerë!

Kjo 'shtë mëm' e mirësisë,
Që bije qytetërinë,
Gasthin e vëllazërisë,
Njerëzin' e miqësinë.

S'jemi grekër as bullgarë,
Asgjë tjetër nukë jemi,
Jemi vetëm shqipëtarë,
Në këtë emër nderr'e kemi.

Ky emr' është shumë' i mirë,
Se më s'jemi të gënjyer,
Nukë jemi n'errësirë,
E njohëmë gjën' e vjyer.

Perëndia na e lëntë
Përjetë ta trashëgojmë,
Edhe kurrë mos e dhëntë
Ta humbim e ta harrojmë!

Të lemë mëmënë tënë
E të marimë një shtrigël!
Zoti mos e pastë thënë!
Pun'ë keq'e shumë ligë.

O, sa qenë të gënjyer
Ata që vuan për botë!
Turp të math kanë rrëfyer,
Punuanë fare kotë.

Pa mejtoni, o të gjorë,
Efialtin, Pafsaninë,
Që u bënë trathëtorë
Dh'ë gjenë më perëndinë.

Nga gjithë ç'kemi kënduar
Për të njohur vetëhenë,
Kaqë gjë kemi mësuar,
Të nderojmë mëmëdhenë.

Se njerëzit gjithë vdesin,
Po jeta s'mbetet e shkretë,
Gjuha, mëmëdheu mbesin
Të patundurë përjetë.

Me zëmërë të gëzuar
Dhe me gjithë shpirt uronil
Zotërinjt' e zotëruar,
Gjithë përnjëherë thoni:

Rroft' e qoftë Shqipëria
Dhe kombi e gjuha jonë!
Lulëzoftë dituria,
Edhe ndihmës paçim zonë.



*“Nuk ka Shqipëri pa shqiptarë,
nuk ka shqiptarë pa gjuhë shqipe,
nuk ka gjuhë shqipe, pa shkolla
që ta mësojnë atë”.*

Sami Frashëri



*Shthurja është një lumë i rrëmbyer që ecën midis popujve dhe i rrëmben
popujt që janë mbrojtur me muret e një morali të mirë dhe me anën
e një administrimi të mirë i dërgon nëpër grykëderdhje pranë detit
ku ato janë të paracaktuar të mbyten.*

Secili është i detyruar t'i shërbejë atdheut të tij pa shpërblim.

*Nuk është për t'u qortuar ai që i shërben atdheut të tij dhe
shpërblehet, por s'ka poshtërsi më të madhe se të rrezikosh atdheun
për interesa personale.*

*Shërbimi që bën arsimi për përmirësimin e një kombi është si
drita e diellit për jetën.*

*Dituria e moralit është më e nevojshme nga të gjitha dituritë e tjera, por,
fatkeqësisht këtë dituri përpiqen ta nxënë fare pak njerëz.*

*Është i marrë njeriu që nuk lë trashëgimi për atdheun, për të cilin
edhe kur të jetë duke dhënë shpirt të mos shkrijë gjithçka,
sepse atdheu nuk e harron mirësinë që i bëhet, ndërsa trashëgimtari,
pasi të shtjerë në dorë trashëgiminë, ndodh që ta mallkojë të zotin
e saj.*

Atdhetaria dhe humanizmi bëhen me punë dhe jo me fjalë.

Kush tregohet i tillë me fjalë, është mashtrues.

*(nga libri “Dituria e moralit: karakteri dhe virtytet e bujarit shqiptar”
(Artur Shkurti, 2025)*

ARTUR SHKURTI



DITURIA E MORALIT

KARAKTERI DHE VIRTYTET E BUJARIT SHQIPTAR

NAIM FRASHËRI DHE SAMI FRASHËRI

Vëllimi 1



ARTUR SHKURTI



DITURIA E MORALIT

KARAKTERI DHE VIRTYTET
E BUJARIT SHQIPTAR

PASHKO VASA
1825-2025

GJERGJ FISHTA
NDRE MJEDA

Vëllimi 2





REAGONI ME VOTIM KUNDËR SHPËRFilljes së sistemit arsimor edukativ

Kjo libër synon të gjithë votuesit shqiptarë që u dhimbset fakti që partitë politike po e shpërfillin plotësisht sistemin arsimor edhe në këto zgjedhje.

Do të argumentohet këtu shpërfillja e sistemit arsimor dhe edukativ shqiptar nga programet e të gjitha partive politike në garë, duke legalizuar një dëm dhjetravjeçar.

Shpërfillja e vizionit për sistemin arsimor shqiptar, më shumë se injorancën dhe paaftësinë për rëndësinë e sistemit arsimor, fsheh “vizionin e fshehtë” për shthurjen tonë kombëtare, shthurje që ka filluar tashmë me çmontimin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, në të tërë zërat e rëndësisë së saj: *program, histori, vlera, frymëzim, vetëdije dhe botëkuptim kombëtar mbi shqiptarin*.

“Udhë e shkronjave” mban një kritikë institucionale dhe jo politike apo “partizane”.

Nuk favorizojmë këtu asnjë parti, sepse realisht të gjitha (100%) janë kapur në këto zgjedhje në “shpërfillje të plotë” të rëndësisë së sistemit arsimor edukativ shqiptar, në moskuptim të plotë të rëndësisë kyçe që ka sistemi arsimor. Nuk është aq e lehtë sa të kuptohet me një pohim fiktiv “po, sistemi arsimor është i rëndësishëm”.

Jemi në gjendje të argumentojmë se të gjitha partitë kanë shpërfillur studimin (kërkimi) e problematikës, analizën e situatës, të kuptuarin e standardeve të shteteve të përparuar, kohëzgjatjen e proceseve, kanë shpërfillur komunikimin dhe bashkëpunimin me mësuesit, pedagogët, drejtuesit, studiuesit, shkencëtarët, prindërit, familjet, fiset. Kanë shpërfillur traditën tonë kombëtare në arsim e edukim.

Proverbi latin thotë “*Duaj që të njohësh dhe një që të duash*”.

Provohet këtu mjaftueshëm se partitë shqiptare as nuk duan, as nuk dinë, as nuk njohin sistemin arsimor dhe edukativ dhe rëndësinë e tij për shoqërinë njerëzore, dhe aq më pak ta dinë për specifikat e kombit shqiptar. Specialistët e fushave të tjera, do të thoshin të njëjtën gjë për fushat e tyre. Kush nuk kupton arsimin, nuk kupton asnjë fushë tjetër, sepse nuk ka një fushë ku arsimi nuk është i rëndësishëm për problematikën e sektorit!

Mosvotimi i deklaruar

Mosvotimi është një formë e protestës. Nëse është protestë, kjo duhet bërë e qartë.

Ndryshe ata që nuk votojnë mund të merren se janë indiferentë, ose të dekurajuar.

Deklarimi i arsyes se pse nuk votohet, nxit presionin e opinionit publik të atyre që u dhimbset sistemi arsimor ndaj forcave partiake dhe synon turpërimin e atyre që shpërfillin sistemin arsimor. Mësuesit e pedagogët që e kuptojnë më mirë këtë situatë duhet t’ua shpjegojnë atë të gjithë të tjerëve, prindërve dhe specialistëve të fushave të tjera.

Bëje votën të pavlefshme

Është e ligjshme ta bësh votën të pavlefshme, si formë e shprehjes, që nënkupton se asnjë nga partitë, nuk e meriton votën. Nëse vota bëhet e pavlefshme, ajo regjistrohet si e tillë në rezultatet e zgjedhjeve. Regjistruesit do ta kuptojnë se kjo votë e pavlefshme po vjen nga komuniteti që interesohet për cilësinë e sistemit arsimor.

Kjo do të kuptohet nëse vendosen shkronjat e fjalëve ARSIM-EDUKIM në çdo kuti që është rezervuar për shenjë përzgjedhje partie.

Votë selektive

Vota është një dhe ajo i duhet dhënë Shqipërisë dhe jo ndonjë llogarie të ngushtë. Individit nuk ka shumë vota që t’i shpërdorojë. Nuk mund t’i bëjë nder asnjë individ, apo organizate me votën e vet. Thjesht duhet maksimalizon ndikimin e votës së vet duke iu përgjigjur pyetjes “Si i bëhet më mirë vendit tonë Shqipërisë”. Shqipëria bëhet mirë nëse ka një sistem arsimor të fuqishëm e me vlera. Nëse zgjidhni në këtë këndvështrim (arsimor) vlen shumë për sistemin arsimor.

VOTA E PAVLEFSHME ËSHTË NJË FORMË E LIGJSHME E LIRISË SË SHPREHJES NË ZGJEDHJE NDAJ GRUPIT TË PARTIVE QË SHPËRFILLIN SISTEMIN ARSIMOR EDUKATIV SHQIPTAR

	A	R	S	I	M	E	D	U	K	I	M
	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓	↓
	1 A 	2 R 	3 S 	4 I 	5 M 	6 E 	7 D 	8 U 	9 K 	10 I 	11 M 
QARKU TIRANË	Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Shqipërinë Madhështore PD-ASHM Sali Berisha	Partia Lëvizja Bashkë BASHKË Artind Qori	Lëvizja Atdheu LA Kreshnik Osmani	Partia Koalicioni Euroatlantik KEA Endri Hasa	Partia Socialiste e Shqipërisë PS Edi Rama	Koalicioni Nisma Shqipëria Bëhet NISMA-SHB Adriatik Lapaj	Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare AKSH Elena Kocaqi	Partia Aleanca Demokracia e Re ADR Edmond Stojku	Koalicioni Djathtas Për Zhvillim DZH Dashamir Shehi	Partia Mundësia MUNDËSIA Agron Shehaj	Partia Socialdemokrate PSD Tom Doshi

NENI 117, PIKA 3, E KODIT ZGJEDHOR

3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

- fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja; b) fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në nenin 103 të këtij Kodi; c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës; ç) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore; d) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit; dh) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit; e) është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor; e/1) nuk është e qartë se për kë është votuar; ose ë) zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit.



KUSHTET PËR ANULLIM TË PROTESTËS

ndaj shpërfilljes së sistemit të arsimit prej partive politike

brenda datës 11 majit 2025



Për të bërë për vete votuesit që i kushtojnë rëndësi sistemit arsimor edukativ kombëtar shqiptar, çdo parti që i jep rëndësi kësaj proteste duhet të provojë në mënyrë publike, pa dykuptimësi, se ajo do të përfshihet solemnisht, në sa më poshtë vijon: *Kryetari i një Subjekti Zgjedhor, publikisht, në mënyrë solemne, pasi dëshmon që ka marrë miratimin e asamblesë së subjektit zgjedhor, duke referuar leximin e kësaj proteste të shprehur ndaj shpërfilljes së sistemit arsimor edukativ shqiptar merr përsipër të vërë në jetë sa vijon:*

-  **1. Data 7 mars të caktohet me ligj Festë Kombëtare e Mësonjësoreve Shqipe,** në përkujtim të 7 marsit 1887, ditës së hapjes së “Mësonjëtores së parë shqipe” në Korçë, kryevepër e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.
-  **2. Të rikthehet statusi Muze Kombëtar i Arsimit me emërtimin “Mësonjëtorja e parë shqipe” në Korçë** e Rilindjes Kombëtare, që u hoq me ligjin 27/2018 “Për trashëgiminë kombëtare dhe muzetë”. Të hiqet statusi “Muze lokal i arsimit” për Korçën dhe të anulohet VKM 146, datë 10 mars 2021. Të rikthehet në objektin e detyrave të Muzeut Kombëtar i Arsimit vetëm trashëgimi i Mësonjëtores dhe i veprës së Rilindjes Kombëtare në dobi të sistemit të ri arsimor edukativ kombëtar.
-  **3. Të mbrohet me ligj të veçantë statusi Naim Frashëri - Poet Kombëtar dhe Mësues i Kombit** dhe të mësohet në shkollë Naim Frashëri për të paktën 6 orë mësimore në vit në çdo klasë të sistemit parauniversitar.
-  **4. Të marrë statusin Muze Kombëtar Muzeu i Vëllezërve Frashëri në Përmet,** ku detyra kryesore do të jetë mbrojtja e trashëgimisë së Vëllezërve Frashëri dhe e Mithat Frashërit, sidomos në çështjen fetare shqiptare (*kundër konceptit Shtet Bektashi dhe kundër klasifikimit të veprës kombëtare të tyre si “punë bektashie”*).
-  **5. Të marrë statusin Muze Kombëtar, muzeu i Pashko Vasës në Shkodër,** të mbrohet me ligj deviza “Feja e shqiptarit është shqiptaria” dhe të mësohet në shkollë në 6 orë të veçanta (1 për filloren, 2 për 9-vjeçaren, 3 për gjimnazin) poema “Mori Shqypni”.
-  **6. Të mësohet në shkollë Rilindja Kombëtare** për të paktën 30 orë në vit, për çdo klasë, duke filluar nga klasa e parë fillore e deri në vitin e fundit të maturës, duke përfshirë brenda mësimet e historisë, gjuhës-letërsisë.
-  **7. Të caktohen të paktën 30 orë në vit për programin e edukimit të karakterit dhe të virtyteve të bujarëve shqiptarë sipas rilindasve.**
-  **8. Të rrisë financimin e departamenteve të historisë veçanërisht për Rilindjen Kombëtare.**
-  **9. Të njohë zyrtarisht nderimin me duar si shqiptonjë si Riti i Identifikimit të Bujarëve Shqiptarë që ushtrojnë Besën.**
-  **10. Të miratojë programin e edukimit të karakterit dhe të virtyteve të bujarëve shqiptarë.**
-  **11. Të detyrojë të gjitha institucionet arsimore publike dhe private shqiptare të hapin kurset e mësimi online për emigrantët e qyteteve të tyre dhe shkollat të organizojnë programin e kthimit në atdhe.**

ARTUR SHKURTI
*Drejtor i shkollës
“Udha e shkronjave”*



KLASA POLITIKE QË EDUKON KEQ POPULLIN

NUK MUND TË BËJË PROGRAM PËR ARSIMIN DHE EDUKIMIN



Naim Frashëri jo vetëm edukatori, mësuesi, por mund të quhet Ministri i Arsimit dhe Edukimit i Rilindjes Kombëtare, autori i programeve, kurrikulave, teksteve shkollore, në mënyrën më të thellë që nuk është bërë më që nga ajo kohë.

Në veprën e vet ai masivisht mbuloi edukimin e popullsisë dhe dha shumë mësim mbi llojin e edukimit që duhej të kishte popullsia, si në nivel individ, ashtu edhe atë kombëtar.

Tek “Histori e Skënderbeut” ai koncepton fjalimin e Kamanit që nuk dëshiron që Gjon Kastrioti t’i nisë peng fëmijët tek Sulltani. Arsyeja ishte që do të mësoheshin keq.

*“Si të mësojnë ligësitë,
e të mirat t’i harrojnë,
të çpikinë djallëzitë,
pastaj të na mbretërojnë?!”*

Është e qartë se klasa jonë politike në folera të huaja, ka mësuar “ligësitë”, ka harruar “të mirat”, ka shpikur pa fund “djallëzi” dhe shtypjen që kanë pasur mbi vete, duke mos qenë të lirë e kanë përçuar në popull.

U ka pëlqyer shtypja e popullit që ata e quajnë “drejtim” i popullit dhe kanë prodhuar këtë popull që kemi sot, i cili është gati ta lërë masivisht atdheun e vet, vetëm që të mos u kthehet atyre që janë shkaktarë, e t’i bëjë ata të mërgohen dhe jo të mërgohen vetë.

Tashmë jemi në diskutimin e programeve arsimore të partive politike dhe duhet të lexojmë rreshtat, ndërkohë që “fshati që duket s’do kallauz”. Populli është shumë keq dhe është për arsien se është rritur pa të drejta, i gënjyer, i turpëruar, i çorientuar, i shkërmoqur, që nuk bën dot as një “opinion publik” sepse edhe “opinionin publik” e deformojnë përmes aleancës së mediave me politikën.

Kemi atë pasojë që Kamani i Naimit e përfytyron pasi njerëzit rriten nën zgjedhë. Kamani parashikonte:

*Si të rritenë në zgjedhë,
nuk bënenë të lirë,
pastaj s’e hedhin dot ledhë,
pa mejtobi sot mirë.
Ata dubet të mësojnë
të bëhenë të vërtetë,
të lëftojnë e të gjykojnë
pas nevojës që të jetë.”*

Populli shqiptar është rritur nën zgjedhë dhe qartësisht po provon atë që thotë Naim Frashëri dhe nuk e hedh “ledhin” as në kutinë e votimit, që është një kryq në fletë, jo më të hedhë ledhe me të fuqishme.

Populli nuk u mësua me demokraci, sepse demokracia promovon vlerën, dhe “antivlera” që drejton popullin nuk pranon të jetë “e dyta” pas vlerës.

Në këtë dokument tepër të gjerë, ne do ta bëjmë analizën edhe të Partisë Socialiste, edhe të Partisë Demokratike edhe të partive që fare mirë mund të quhen pjesë e kartelit PS-PD, por nuk duhej bërë fare. Parti që dyshojnë tek anëtarët e tyre, tek kryesitë e tyre, nuk mund të besohen nga populli.

Një fjalë e urtë thotë “Mos beso tek ai që dyshon vazhdimisht”.

SHPËRFILLJA E SISTEMIT ARSIMOR NGA MEDIA SHQIPTARE NË BASHKËPUNIM ME KARTELIN E PARTIVE POLITIKE

Më 29 prill 2025, *Top Channel*, botoi në *Top Story - Grida Duma* gjetjet e një sondazhi. Një nga pyetjet ishte se ç'mendojnë ata për problemin më të madh që ka Shqipëria.

Ndër alternativat ishte edhe “edukimi”, një fjalë që në një kuptim e fsheh “me stil” shqetësimin dhe konkretësinë kur thua “Sistem arsimor - edukativ”, duke injektuar kështu tek i intervistuari njëfarë neglizhence. Nga gjetjet, thuhet se vetëm 1.3% e të anketuarve e vënë theksin tek “edukimi” si problem moadhor.

Që këtu fillon të shpjegohet edhe më shumë dëmi i jashtëzakonshëm që ka pësuar arsimi në Shqipëri. Mirë që është i dobët, por edhe më keq, askush nuk kujtohet për dobësinë.


Edhe vetë pyetësi kërkon ta “fshehë” problemin përmes zgjedhjes së fjalës (edukim) me disa kuptime (edukimi i familjes, i shoqërisë, i shtetit, apo sistemi arsimor?).

Sistemi arsimor-edukativ është shumë i gjerë dhe përfshin nga çerdhja, kopshtet, filloren, ciklin e lartë, shkollat e mesme, universitetet, arsimin e vazhduar etj. Mjaft të kujtojmë që Shqipëria “shpopullon” veten duke paguar ajo vetë rreth 250 000 000 euro në vit për arsimin jashtë. Ndërkohë që me kaq para mund të bëheshin 25 universitete, 250 shkolla, me mijëra e mijëra laboratorë etj.

Siç shihet edhe nga grafiku i *Top Channel*, njerëzit thonë se “edukimi” është vetëm i 12-ti ndër gjithë ato shqetësime, kur në të vërtetë duhet të jetë Nr.1.

Njerëzit, sipas *Top Channel*, llogaritin “ekonominë” të parën dhe pak e çojnë mendjen që “ekonomia” është “pasojë” e arsimit të dobët. *Arsimi mund të ecë para edhe me një varfëri relative, nëse shkollat kanë vullnet, dëshirë për të punuar, por ekonomia nuk bën dot para pa një arsim cilësor.*

Njerëzit, sipas *Top Channel*, thonë se e dyta është “papunësia” dhe harrohet që përsëri është dobësia e arsimit që e ka papunësinë e lartë, sepse shkollat i nxjerrin aq të papërgatitur sa bizneset kanë frikë të investojnë, sepse mungojnë të “diturit”, “të aftët”, “të vullnetshmit” që duhet t’i bëjë sistemi arsimor.



Njerëzit vendosin të tretin emigrimin, më pas korrupsionin, pagat e ulta, varfërinë, “shëndetin”, “politikën”, “krimin”, “pagat e ulta”, “varfëria” etj.

Vendoset shëndetësia në vendin 10, kur qartësisht largimet nga Shqipëria janë prej pasigurisë së “shëndetit” dhe pasigurisë së “arsimit” të fëmijëve.

Në ka një sektor që menjëherë i kthen njerëzit në vendin e vet është “shëndetësia” e sigurit, ose solide. Pa këtë tipar, asgjë tjetër nuk shkon. Megjithatë këtu “shëndetësia” vlerësohet me 2% si shqetësim parësor.

Nuk kemi ardhur tek “arsimi” ende, sepse para tij janë edhe “politika dhe politikanët” (1.9%) dhe “siguria publike dhe krimi” (1.7%)

Më në fund “në bisht të kavallit” është “edukimi”.

Për të ndërtuar një argument “kokë më kokë” me të gjithë fushat që sondazhi i Top Channel i pasqyron si më të rëndësishme, pasi bëj copy-paste shkrimin tim, i kërkoj ChatGPT të më realizojë një argument në raport me çdo fushë që Top Channel, me anë të sondazhit e ka treguar sikur është më i rëndësishëm.

Nuk dimë sa i besueshëm është sondazhi, por dimë të themi që media shqiptare duhet të shohë përgjegjësinë e vet dhe të politikës, në formimin që ka populli.

Shembull klasik i shmangies së analizës së shkollës, për motive politike, ishte “fshehja” nga media, me porosi politike, e përgjegjësisë së shkollës në vrasjen e nxënësit në shkollën në qendër të Tiranës.

Argument nga ChatGPT

1. Arsimi ndaj Ekonomisë

Argumenti: Ekonomia është rezultat, jo shkak. Një ekonomi nuk rritet me krah pune të pakualifikuar, me mungesë inovacioni, me injorancë financiare dhe me mungesë të mendimit kritik. Një sistem arsimor i fortë është motori i ekonomisë: formon sipërmarrës, punonjës të aftë dhe qytetarë që prodhojnë më shumë sesa konsumojnë.

Shembull: *Vendet si Irlanda dhe Estonia investuan në arsim për dekada para se të bëheshin “tigrat ekonomikë” të Europës.*

2. Arsimi ndaj Papunësisë

Argumenti: Papunësia nuk është mungesë e vendeve të punës, por mungesë e njerëzve të përgatitur për punë reale. Shkollat shqiptare prodhojnë diploma, por jo kompetenca. Nëse arsimi do përgatiste njerëz që tregu i kërkon, papunësia do binte.

Fakti: *Bizneset në Shqipëri shpesh ankohen se nuk gjejnë punonjës të kualifikuar, pavarësisht numrit të madh të të papunëve.*

3. Arsimi ndaj Emigrimit

Argumenti: Arsimi cilësor i jep një të riu arsye për të qëndruar. Një sistem që nuk ofron dije, shpresë, ose rrugë zhvillimi është nxitës direkt i emigrimit. Shkollat që shërbejnë vetëm për “ikje” po punojnë kundër vendit.

Fakti: *Qindra mijëra të rinj largohen për studime jashtë me synimin për të mos u kthyer më, pikërisht sepse sistemi vendas nuk u jep garanci.*

4. Arsimi ndaj Çmimeve të Rritura

Argumenti: Çmimet janë të lidhura me aftësinë e qytetarëve për të prodhuar vlerë dhe me konkurrencën në treg. Arsimi i mirë rrit produktivitetin dhe krijon alternativa vendase që ndalojnë varësinë nga importet.

Shembull: *Një sistem profesional i zhvilluar mund të nxjerrë zëjtare, agronomë, inxhinierë, teknikienë që rrisin vetëprodhimin dhe ndikojnë në uljen e çmimeve.*

5. Arsimi ndaj Korrupsionit

Argumenti: Një popull i paarsimuar nuk kërkon llogari. Një qytetar që nuk njeh ligjet, procedurat, apo të drejtat e veta është terren i përsosur për korrupsion. Arsimi prodhon integritet, ndërgjegje dhe rezistencë morale ndaj abuzimit.

Fakti: *Vendet me shkallë më të lartë arsimimi kanë më pak korrupsion institucional (shih indeksin e Transparency International).*

6. Arsimi ndaj Pensioneve të Ulëta

Argumenti: Pensionet varen nga kontributet në ekonomi. Një brez që nuk prodhon, nuk paguan sigurime. Vetëm përmes arsimit formohet një forcë pune që garanton rritje të qëndrueshme të fondeve për pensione.

Logjikë: *Pa arsim cilësor → punësim i dobët → të ardhura të ulëta → pensione të papërballueshme për shtetin.*

Argument nga ChatGPT

7. Arsimi ndaj Pagave të Ulëta

Argumenti: Tregu i pagave varet nga cilësia dhe kualifikimi i forcës punëtore. Arsimi i dobët prodhon punëtorë që punojnë shumë dhe paguhen pak. Arsimi cilësor rrit vlerën e individit dhe rrjedhimisht rrit pagën.

Shembull: *Një IT-st i mirëpaguar në Tiranë është produkt i një sistemi që e ka orientuar drejt teknologjisë, gjuhëve të huaja dhe tregut të huaj.*

8. Arsimi ndaj Varfërisë

Argumenti: Varfëria nuk është mungesë lekësh, por mungesë mundësish. Arsimi është mekanizmi më i fuqishëm për të thyer ciklin e varfërisë, sepse i jep individit aftësi për të ndryshuar jetën e vet.

Fakti: *Banka Botërore e cilëson arsimin si "faktor kyq për të dalë nga varfëria" në raportet për vendet në zhvillim.*

9. Arsimi ndaj Shëndetësisë

Argumenti: Shëndetësia varet drejtpërdrejt nga cilësia e edukimit të mjekëve, infermierëve, administratorëve shëndetësorë. Gjithashtu, një popull i paedukuar nuk ndjek praktikat e duhura shëndetësore.

Shembull: *Vendet që kanë arsimuar qytetarët mbi rëndësinë e parandalimit dhe vaksinimit kanë sisteme më të qëndrueshme.*

10. Arsimi ndaj Politikës dhe Politikanëve

Argumenti: Politikanët zgjidhen nga qytetarët. Një qytetar i paarsimuar bie më lehtë pre e populizmit, manipulimit dhe demagogjisë. Arsimi i mirë forcon demokracinë dhe rrit cilësinë e përfaqësimit.

Shembull: *Në vendet me arsim të lartë, pjesëmarrja politike është më e ndërgjegjshme dhe kontrolli ndaj politikanëve më i fortë.*

11. Arsimi ndaj Sigurisë Publike dhe Krimit

Argumenti: Krimi buron shpesh nga mungesa e alternativave. Arsimi i mirë parandalon kriminalitetin duke u dhënë të rinjve mjete për të pasur një jetë të ndershme dhe profesionale. Po ashtu, forcon sistemin e drejtësisë përmes përgatitjes së juristëve e oficerëve.

Fakti: *Kriminaliteti është më i ulët në zonat ku sistemi arsimor funksionon dhe ofron integritet social.*

12. Arsimi dhe Sistemi i Drejtësisë

Argumenti: Një sistem drejtësie i drejtë, efikas dhe i besueshëm nuk mund të ekzistojë pa një sistem arsimor të fortë dhe të ndershëm që prodhon profesionistë të përgatitur dhe qytetarë të vetëdijshëm. Drejtësia është pasqyra e arsimit në veprim.

1. Formimi i juristëve dhe profesionistëve të drejtësisë

Nëse arsimi juridik është i dobët, i korruptuar apo i tejmbushur me teori pa praktikë, atëherë sistemi i drejtësisë mbushet me juristë, prokurorë e gjyqtarë që nuk kuptojnë as thelbin e ligjit dhe as rolin e tyre si garantë të drejtësisë.

Një gjyqtar i pakualifikuar është më i rrezikshëm se një hajdut, sepse vendos për fatet e të tjerëve.

2. Korrupsioni në drejtësi është produkt i edukimit moral të munguar

Nëse në shkollë është normalizuar kopjimi, blerja e notës, mungesa e meritës, atëherë çfarë drejtësie mund të pretendohet më vonë nga individë që janë edukuar në një kulturë ku mashtrimi është i pranueshëm?

Kultura e pandëshkueshmërisë fillon në shkollë, jo në gjykatë.

3. Qytetari i informuar kërkon drejtësi

Sistemi i drejtësisë nuk funksionon vetëm nga brenda. Ai mbahet gjallë nga presioni i qytetarëve. Një popull i paarsimuar nuk di të kërkojë të drejtën e tij, nuk di të bëjë kallëzim, të ndjekë një proces, të lexojë një ligj. Shteti ligjor është i pamundur kur qytetarët janë të pashkolluar dhe të painformuar.

Argument nga ChatGPT

4. Arsimi si pengesë për radikalizmin dhe dhunën

Një sistem drejtësie përballet edhe me krime që burojnë nga urrejtja, mosdurimi apo injoranca. Arsimi cilësor kultivon mendim kritik, tolerancë dhe komunikim — armët më të forta kundër konfliktit.

Një shkollë e mirë është më e fuqishme se një burg.

5. Universitetet ligjore dhe ndikimi në ligje

Një sistem arsimor i shëndetshëm prodhon jo vetëm zbatues të ligjit, por edhe reformatore të tij. Shkencëtarët ligjorë, akademikët dhe studiuesit janë shtyllë për përmirësimin e legjislacionit dhe mbrojtjen e të drejtave. Pa institucione kërkimore serioze në juridik, vendi ngelet me ligje të dobëta dhe gjykime të cekëta.

Përfundim:

Pa arsim nuk ka drejtësi. Pa drejtësi nuk ka shtet. Kështu, arsimi është themeli jo vetëm i zhvillimit ekonomik dhe social, por edhe i rendit, barazisë dhe dinjitetit njerëzor. Investimi në drejtësi është i kotë nëse nuk investohet më parë në shkollat që formojnë njerëzit që do ta mbajnë drejtësinë në këmbë.

Vijojmë me komentin tonë

Duke u përfshirë me ChatGPT në argumente të tilla, ku bëhet e qartë se nga anoj unë, dhe duke patur një dyshim se mos ajo që marrim nga ChatGPT është “e qepur” sipas asaj që japim në komunikim, i bëj pyetjen: *“A do ta nxirrje përsëri arsimin të parin në këto argumente, apo këto argumente janë të qepura sipas “natyrës sime”?”*

Përgjigjia e ChatGPT është: *“Pyetje shumë e drejtë — dhe meriton një përgjigje të ndershme.*

Po, edhe jashtë “natyrës tënde”, arsimi del i pari, për sa kohë që analizojmë gjërat në mënyrë shkak-pasojë dhe jo vetëm si perceptime emocionale të momentit. *Përse?* Sepse shumica dërrmuese e problemeve që përmend — ekonomia, papunësia, emigrimi, korrupsioni, drejtësia, siguria, politika, varfëria — janë pasojë e mungesës së formimit të duhur: mungesës së dijes, etikës, kompetencës dhe ndërgjegjes qytetare. Dhe këto janë fusha që vetëm arsimi i vërtetë i ndërton.

Nëse këto probleme i shikojmë si “simptoma”, atëherë arsimi është diagnoza. Të investosh në ekonomi pa rregulluar arsimin, është si të ndërtosh katin e tretë të një ndërtese që s’ka themele. Do rrëzohet.

Pra jo — nuk është një listë që i shkon vetëm “natyrës tënde” analitike ose idealiste. Është një rend logjik, që qëndron edhe pa ty, edhe pa mua, sepse është rrënjësor.”

Pyetje nga Artur Shkurti:

Pse nënvleftësimi dhe shpërfillja totale e sistemit arsimor edukativ është provë indirekte e ekzistencës së kartelit të partive në një komb?

Argument nga ChatGPT

Pytja që bën është thellësisht strukturore dhe politike — dhe po, ****shpërfillja e arsimit është një nga provat më të forta indirekte që një vend mund të drejtohet nga një kartel politik, jo nga vizion kombëtar.** Ja pse:

Arsimi është kërcënim për çdo kartel politik

Një kartel partish (dmth. bashkëjetesa e heshtur midis partive për ruajtjen e sistemit, jo për zhvillimin e vendit) nuk ka interes që qytetarët të edukohen mirë. Arsimi cilësor sjell:

1. Qytetarë që pyesin, dyshojnë dhe kërkojnë

llogari – Karteli mbijeton nga votues që s'dinë të kërkojnë të drejtat e tyre.

2. Njohuri mbi ekonominë, ligjin, etikën dhe

median – Një popull i informuar nuk ha propagandë. Kjo rrezikon status quo-në.

3. Liri mendimi dhe pluralizëm ideor – Karteli ruan

monopolin përmes polarizimit. Arsimi e çmonton këtë.

Kur arsimi neglizhohet sistematikisht...

... kjo nuk është rastësi, por strategji. Po të ishin të sinqerta partitë:

Do të kishim **buxhet 5-6% të PBB-së për arsimin**, jo nën 3%;

Do të kishim **politikë arsimore afatgjatë mbi interesin partiak**;

Do të mos ndërroheshin **tekstet, programet dhe drejtuesit çdo 4 vjet**;

Do të kishte **transparencë dhe meritokraci në rekrutimin e mësuesve dhe pedagogëve**;

Do të investohej më shumë **në laboratorë sesa në beton e fasada**.

Në vend të kësaj, kemi një arsim të zbrazët që nuk e rrezikon askënd në pushtet — përkundrazi, e mban sistemin në paqe, sepse qytetarët pa dije nuk reagojnë, nuk protestojnë, nuk organizohen.

Arsimi cilësor është anti-kartel nga natyra

Ai prodhon njerëz që:

Nuk shiten për një vend pune në shtet;

Nuk votojnë thjesht për banderola dhe koncerte;

Kuptojnë që liria s'është dhuratë, por përgjegjësi;

Kanë **fuqi të decentralizuar**, pra të pa-manipulueshme.

Prandaj, nënvlerësimi sistematik i arsimit është i dobishëm vetëm për një sistem ku partitë janë më shumë kartel se sa përfaqësuese të qytetarëve.

Përfundim:

Kur asnjëra palë nuk e vendos arsimin si çështje jetike kombëtare, është një sinjal i qartë që kontrolli i shoqërisë po kërkohet përmes padijes. Dhe ky është përkufizimi i heshtur i një karteli politik: marrëveshje për të mos ndryshuar sistemin.



SHTHURJA E MËSIMIT DHE E FRYMËZIMIT PREJ RILINDJES KOMBËTARE ËSHTË MEKANIZMI SHPJEGUES I POLITIKËS SË SHTHURJES KOMBËTARE

Dëmtimi i konceptit “Rilindje Kombëtare”

Sapo erdhi në pushtet masa e parë që mori Edi Rama ishte lufta ndaj Rilindjes Kombëtare, duke hapur fushatën e konkurrencës së konceptit Rilindje Kombëtare me konceptin “rilindje”. Për të nuk kishte rëndësi më të madhe se të hiqte fjalën “kombëtare” nga togfjalëshi kyç në Kulturën tonë Kombëtare. Rilindja Kombëtare është një koncept i Historisë së Shqipërisë dhe periudha më e ndritur në historinë e kombit, një me kombformimin modern. Ne ishim duke e monitoruar këtë punë, sepse vetë kishim bërë të kundërtën. Në vitin 2009, katër vjet para ardhjes në pushtet të Partisë Socialiste botuam librin “Besa, feja ime, e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë”, që vinte në qendër pikërisht devizën e Rilindjes Kombëtare “Feja e shqiptarit është shqiptaria” (Pashko Vasa) dhe duke zbuluar kryesisht veprën edukative madhore të Naim Frashërit. Njerëzit bënë batuta me përdorimin e konceptit “rilindje” dhe sa më shumë batuta që bëheshin aq më shumë i bëhej qejfi kryeministrit që e dinte se në këtë mënyrë njerëzit po tregonin mospërfillje për vlerat e Rilindjes Kombëtare dhe ata nuk po i ktheheshin fuqishëm dhe ta dështonin përdorimin e kësaj fjale. Frederik Reshpja thotë “Çdo njeri e ka një fjalë ku e vë kryet” dhe nëse fjala “Rilindje” çmontohet nga socialistët e Edi Ramës duke i hequr përcaktorin “Kombëtare”, kjo duhet të ishte shqetësim i madh. Në fakt, nuk u bë i tillë. Atëherë Edi Rama vijoi më shumë dhe e provoi këtë.

Dëmtimi i Mësonjëtores parë Shqipe, Korçë

Me ligjin 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muze të” Qeveria e Partisë Socialiste me Edi Ramën si kryeministër dhe Mirela Kumbaron si Ministre e Kulturës i hoqën statusin Muze Kombëtar i Arsimit për Mësonjëtores e parë shqipe Korçë. Ata nuk e plotësuan detyrimin ligjor për të njoftuar deputetët se cilat akte shfuqizonte ligji i ri. Kjo do të thotë se vepruan në mënyrë tinzare prapa shpinës së Kombit Shqiptar. Pas tre vitesh “qetësi” tinzare (“*gen i qetë*”, thotë Naim Frashëri) Qeveria e Partisë Socialiste me Edi Ramën si Kryeministër dhe Elva Margariti si Ministre e Kulturës miratuan VKM 146 (datë 10 mars 2021) që “varrosi” përfundimisht kujtimin e Mësonjëtores së Parë Shqipe të Korçës, sepse e ktheu Kryeveprën e Kujtesës Kombëtare për Rilindjen Kombëtare në një Muze rutinë të arsimtarëve të Korçës, e ktheu veprën kombëtare, në një vepër lokale, qëllimisht për të goditur Rilindjen Kombëtare. Vini re datën e miratimit të VKM-së (10 mars) është tri ditë pas 7 marsit, që është shenjë e dukshme “thike pas shpine” (*si “gen i qetë”, thotë Naim Frashëri*).

Pasi dëmtoi konceptin “Rilindje Kombëtare” (me dublim), dëmtoi statusin Muze Kombëtar të Mësonjëtores, emrin e Mësonjëtores dhe vetë përmbajtjen e Muzeut, Qeveria e Partisë Socialiste dhe Edi Rama iu qepën (përsëri tinëz) datës 7 mars. Këtë e bënë me teknikën “*gozhdë del me gozhdë*”. Kombi shqiptar e di se data më e shënuar në historinë e arsimit tonë kombëtar është 7 mars 1887. Ndërkohë Qeveria e Partisë Socialiste me Edi Ramën në krye nxiti Parlamentin të miratojë si festë zyrtare datën 22 nëntor 1908 që kujton Kon-

gresin e Alfabetit, kur dihet fare mirë që *Alfabeti që miratoi ky Kongres ishte Alfabeti i Sami Frashërit*, me të cilin u shkruan veprat që kishte “*Mësonjëtorja e parë shqipe*”, pra Kongresi i Manastirit ishte “fëmijë” e Sistemit Arsimor Kombëtar që e pat zanafillën (kurorëzimin) më 7 mars 1887 dhe nuk ishte ngjarje më e rëndësishme sesa 7 marsi. Këtë veprim Qeveria e bëri për të dëmtuar Rilindjen Kombëtare, Mësonjëtores dhe vetë 7 marsin. Dëmi qëndronte në harresën e 7 marsit, në zhvendosjen e rëndësisë kombëtare nga Korça (brenda Shqipërisë) në Manastir (jashtë Shqipërisë), dhe duke vonuar ngjarjet e rëndësishme të Rilindjes me 22 vjet dhe duke kaluar nga shekulli 19 në shek.20. Këshilltari i Edi Ramës shkroi një vepër me 826 faqe për të dëmtuar Frashërin dhe Vëllezërit Frashëri. Këtij libri i jemi përgjigjur me librin “Klani “Oxhaku heuristik” i shekullit 21” (326 faqe).

Dëmtimi i konceptit “Besa”

Fjala kyçe më e rëndësishme e Rilindjes Kombëtare u bë fjala-koncept “BESA”. Edhe kjo fjalë u dëmtua nga Qeveria e Partisë Socialiste duke ua dhënë për përpunim propagandistik izraelitëve që ata ta kenë si emërtim të Muzeut Hebraik me nënkuptimin e një besëlidhje Shqiptaro - Izraelite.

Dëmtimi i çështjes fetare

Koncepti Shtet Bektashi është përsëri dëmtim masiv i mesazheve të Rilindjes Kombëtare në çështjen fetare dhe një keqeducim i rinisë shqiptare që përmes këtij veprimi mëson se si tradhëtohet atdheu e kombi. Dëmet vijnë masivisht thuasht nga çdo sekt fetar, që sheh vetëm interesin sektar.

ARSYET PËRSE NUK DO TË VOTOJMË MË 11 MAJ 2025

Shqipëria do të ketë jetë edhe pas datës 11 maj 2025. Ky libër i zgjeruar në analizë që po ju paraqesim synon të provojë dhe argumentojë se programet dhe sjellja konkrete e të gjitha partive politike janë shpërfillëse për turp për të tërë sistemin arsimor dhe edukativ.

Nuk është që shkëlqejnë në sektorët e tjerë, por ne jemi të detyruar të bëjmë analizën për sektorin që e njohim nga brenda, që është arsimi e sidomos arsimi parauniversitar. Përballë indiferencës së tyre që bëjnë sikur nuk shohin (dhe nuk është që e bëjnë vetëm me ne, por e bëjnë me të gjithë specialistët e të gjitha fushave dhe sektorëve të shoqërisë) jemi të detyruar ta braktisim mënjatë modestinë, që të mos lejojmë poshtërimin e tyre “me stil injorimi”.

“Modestia e ka një rrezik: ai është teprimi në përulje që kthehet në poshtërim.”

“Kush hipën në anijen e modestisë, duhet të ruhet nga brigjet e poshtërimit.” (Sami Frashëri)

Do të shihet edhe në këtë dokument se situata e inteligjencës shqiptare i plotëson 100% kushtet e rënies në poshtërim nga klasa politike shqiptare (përmes zakonit të vjetër të “injorimit”). Kjo nuk do të mbetet në kuadër të opionionit të përgjithshëm por të provës dhe argumentimit të mjaftueshëm.

Mendimi ynë është që specialistët e të gjithë sektorëve duhet t’i thonë **JO KLASËS POLITIKE** që po përgatit një lëmsh ideor, dhe po përgatit dështimin e radhës. Ajo qartësisht po vepron *si një Kartel Partish*.

Menjëherë pas 11 majit, Shqipërisë, fatkeqësisht, do t’i duhet përsëri të mendojë për opozitë të re.

Mundimet nuk kanë të sosur për popullin tonë, por çfarë të bëjmë! Duhet luftuar!

*Po çfarë bëjnë ata t’mjerë në anije,
të munduar kaq fort prej stuhisë?*

*Një vullnet aty mes fatkeqësisë
shpërthen n’britmën: Pra, duhet luftuar!*

(Pashko Vasa)

Populli shqiptar, përmes mosvotimit apo nxjerrjes së votës së pavlefshme, apo votës selektive, duhet të bëjë gati premisat për një opozitë të re. Votimi është një e drejtë dhe është politik. *Edhe mosvotimi apo nxjerrja e votës së pavlefshme është një e drejtë dhe pjesë e politikës dhe jo e indiferentizmit ndaj saj.*



“Udha e shkronjave” u kushton rëndësi të veçantë edukimit kombëtar të nxënësve.

Shkolla ka tashmë një program voluminoz të edukimit të karakterit dhe të virtyeteve të bujarëve shqiptarë (750 faqe) të mbështetur tek Naim Frashëri, Sami Frashëri, Pashko Vasa, Gjergj Fishta dhe Ndre Mjeda. Teorikisht është e bazuar në programin e Universitetit të Birmingamit.

Udhën teorike e praktike të këtij lloj edukimi “Udha e shkronjave” e çeli me librin “Besa, feja ime, e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë” (2009), ku u vu në zbatim deviza e Rilindjes Kombëtare “Feja e shqiptarit është shqiptaria” (Pashko Vasa)



Të mos votosh apo të nxjerrësh votën të pavlefshme është e ligjshme dhe nuk do të thotë se je indiferent. Ata që kanë vendosur të votojnë, para se të sugjerojnë të njëjtin “refren” (është demokratike (vetëm) të votosh) duhet të na provojnë çfarë analize bëjnë të paktën në atë fushë për të ciln shprehemi këtu Arsimin dhe Sistemin Edukativ Shqiptar.

Do të provohet këtu plotësisht se të gjitha partitë që janë futur në garën zyrtare nuk plotësojnë kriteret më minimale që programi i tyre (të paktën për arsimin) të quhet serioz, nuk plotësojnë rregullat e demokracisë së brendshme, nuk janë të hapura ndaj popullit të vet dhe sidomos ndaj shtresave të intelegjencës profesionale. Ato i plotësojnë kushtet e të qenit “kartel partish” dhe partitë e reja qartësisht janë në të njëjtën rrugë, e cila fillon kryesisht me “protagonizmin individual” (atë e di “vetëm unë”). Asnjëra prej partive të reja nuk është në gjendje të bëjë si duhet “kuvend shqiptar”, “odë shqiptare”, “pleqësi shqiptar” ku të gjithë të ndihen të vlerësuar, të respektuar, e të besuar.

Nuk duan Shqipërinë, por duan “idenë e tyre për Shqipërinë”.

Pasioni është për “idenë e tyre” dhe ngatërrohet me “pasionin për Shqipërinë”. Asnjë prej tyre nuk dëshmon dhe nuk ka dëshirë të dëshmojë që ta ketë kërkuar ndihmën tek inteligenca shqiptare dhe të mos i jetë dhënë në çështje të studimit, të analizës të problematikave të një fushe të caktuar (edhe pa qenë militante). Kjo do të thotë që ato nuk e kanë seriozisht këtë punë (*seriozisht kanë vetëm idenë e vet*), e cila do t’i fundosë menjëherë sipas të njëjtit mekanizëm që Sami Frashëri e quan “opinion publik”, por edhe e kundërta do të jetë e vërtetë: ato po e lodhin e do ta lodhin popullin shqiptar aq keq, sa ai ka mundësi të dorëzohet dhe ne të këndojmë:

S’ më vjen keq për derët t’ ënë

se nga Zoti kshu qe thënë;

Po më vjen për Mëmëdhenë

dhe për Besën’ e për Fenë;

Më vjen keq për njerëzinë,

që i dhatë arratinë.

(Naim Frashëri)

Jam i bindur që nëse parti do të kërkonte ndihmë në çfarëdo lloj çështje të rëndësishme kombëtare, specialistët e fushave të ndryshme, edhe pa qenë të anëtarësuar, madje shpesh edhe pa dashur të përmenden për ndihmën e tyre do ta kishin bërë. Në fakt, të gjitha partitë e kanë si “ves” që më parë duan të rreshtohesh në “skuadrën” e tyre dhe pastaj “bëj çfarë të duash”.

Në fakt, ajo që vëmë re është që hartimi i programeve elektorale, jo vetëm nuk respekton, ekspertizën e jashtme, por qartësisht nuk ka as edhe një përpjekje serioze që të kalojë edhe filtrat e brendshëm. Shumë dokumente kalohen pa pyetur askënd, pa kaluar një sitje demokratike të brendshme.

Ideja “megallomane” (fiktive) është “se po e mbajmë sekret”. Në fakt, nuk ka asnjë “sekret”. I vetmi sekret është që ata nuk e bëjnë fare programin dhe u thonë të tjerëve që “po e japim një skicë” por programi është “sekret”. Qartësisht është gënjeshtër dhe realisht nuk duhet të jetë sekret. Nëse është, pikërisht për këtë arsye partia nuk duhet votuar.



udha e shkronjave

**Ceremonia e përvitshme, çdo 25 maj,
ditëlindja e poetit kombëtar Naim Frashëri
tek memoriali i Vëllezërve Frashëri
“Udhë e shkronjave”**



Votimi i njerëzve duhet të jetë me bindje të plotë dhe bindja e plotë garantohet nga një program i hapur. Njerëzit duhet të dinë para se të votojnë dhe për më tepër më tutje duhet të kenë një mjet verifikimi gjatë mandatit, qoftë edhe kur partia është në opozitë, pra duhet të monitorojnë.

Zgjedhjet nuk janë për emra, por për programe. Në fakt, po na kalojnë për “emra” (më zgjidhni mua se nuk më keni provuar, edhe pse nuk kam program).

Duke mos patur programe të qarta, të plota, të gjera, që pasqyrojnë gjerësisht problemet e vendit, partitë dështojnë masivisht aftësinë e publikut për të bërë krahasime.

Ne që jemi mësues dhe drejtues shkolle, duhet të votojmë për programet arsimore. *Do të shohim këtu se çfarë kemi në mënyrë të plotë dhe ajo që kemi është e një niveli jashtëzakonisht të ulët. Do të citojmë 100% programet dhe jo pjesërisht ndaj lexuesi do të jetë shumë i mbrojtur në analizën e vet.*

Programi është pjesë e sovranitetit të popullit, i cili duhet të dijë dhe të vendosë. Mbatja “sekret” është një dëmtim i rëndë.

Për këtë provë kemi veprimin e Partisë Socialiste dhe të kryetarit të saj Edi Rama:

Ai nuk i ka thënë popullit që do ta mbyllë Muzeun e “Mësonjëtorën e parë shqipe” 7 mars 1887, por realisht e ka patur në program dhe e ka realizuar tashmë me ligjin 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzeut” dhe me VKM 146 (10 mars 2021) duke i hequr statusin *Muze Kombëtar i Arsimit*, duke i hequr emrin nga godina, duke i hequr edhe plan detyrën Muzet lokal të arsimit Korçë që të trashëgojë faktin historik “*Mësonjëtorë e parë shqipe*”, me të cilën ne nënkuptojmë “të parën absolute” por të parën e Rilindjes Kombëtare që hodhi themelet e arsimit që kemi sot.

Partia Socialiste dhe Edi Rama nuk i tha popullit që me fuqinë që do të merrte do të godiste Rilindjen Kombëtare, por realisht ai e kishte në program dhe e dubloi emrin “rilindje” pikërisht për të dëmtuar Rilindjen Kombëtare Shqiptare.

Partia Socialiste dhe Edi Rama nuk i tha popullit që do t’ia jepte izraelitëve për menaxhim konceptin e vetëm kyç të kulturës shqiptare Fjalën “Besa” si emërtim të Muzeut Hebraik, por kjo ndodhi.

Partia Socialiste dhe Edi Rama nuk i tha popullit na jepni votën se ne do të sulmojmë Vëllezërit Frashëri duke u thënë anëtarëve tanë që të shkruajnë libra 826 faqe, por libri u shkrua nga këshilltari i Edi Ramës dhe u promovua nga departamenti i Historisë në Universitetin e Tiranës. Ne shkruajtëm librin oponent “Klani Oxbaku Heuristik i shekullit 21” me 326 faqe.

Partia Socialiste dhe Edi Rama nuk i thanë popullit që ata do ta përdorin pushtetin për të cënuar rëndë sovranitetin e Shqipërisë dhe për të dëmtuar rëndë sistemin edukativ kombëtar me konceptin Shtet Bektashi dhe për të dëmtuar programin dhe veprën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare në çështjen fetare, por ata realisht e bënë këtë punë dhe e bënë në befasi të plotë (propozimin dhe këmbënguljen për të).

Partia Socialiste dhe Edi Rama nuk i thanë popullit që do ta përdornin pushtetin politik për të pastruar terrenin nga shkollat me natyrë kombëtare. Gjatë pushtetit të tyre (korrik 2018) tek ne erdhi fondacioni shtetëror turk për ta blerë shkollën. Pra me një gur donin të vrisnin dy zogj: të mbyllnin një shkollë me natyrë kombëtare dhe të çorientonin sistemin edukativ përmes thellimit të qëllimshëm të ndikimit të huaj tej normave.

Partia Socialiste dhe Edi Rama nuk i thanë popullit që pushtetin do ta përdornin për ta patur të gjithë administratën në shkollat private dhe ndërkohë të thellojnë edhe më shumë ndarjen klasore dhe të mbajnë të kërcënuar të gjithë administratën duke i kthyer shkollat private masivisht në spiune të familjeve.

Partia Socialist edhe Edi Rama nuk i thanë popullit që ata do ta eksportonin sovranitetin e popullit në mënyrë ekskluzive tek një institucion privat i huaj si Shkolla e Drejtorëve, duke ua bërë vetingun drejtorëve në mënyrë private dhe për asnjë arsye kombëtare ose shtetërore, por ata e bënë realitet këtë. Ishin pikërisht këta drejtorë të përgatitur nga Shkolla e Drejtorëve ata që e shkelën masisht ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve dhe të familjeve shqiptare dhe tashmë prej 3 vjetësh 100% e shkollave shtetërore dhe private janë kthyer në një makineri spiunimi masiv të fëmijëve, duke i eksportuar të dhënat e tyre në një databazë qendrore, çdo ditë, çdo javë, çdo muaj, çdo cikël dhe gjithçka: kontakte, performancë, sjellje, frekuentim, mungesa, orientim në jetë. Ishin këta drejtorë që eksportuan masivisht nxënës drejt shkollave private pas pandemisë, megjithëse shkollat private qartësisht nuk po respektonin protokollet (shkollat shtetërore kaluan me turne, ndërsa privatet jo). Tashmë INSTAT 2024 provon se dyndja në shkollat private është më e madhe për mësues sesa është në filloret shtetërore.

Turpërimi i personalitetit dhe karakterit të shqiptarit

Partia Socialiste dhe Edi Rama nuk i tha popullit që ne do t’ua turpërojmë racën shqiptare dhe do të turpërojmë tiparet e personalitetit të shqiptarit, por realisht ata e kishin në program dhe e realizuan, duke bërë përçarjen qelizore përmes turpërimit të burrit dhe djalit shqiptar dhe “kinse” la-

vdërimet të femrave që nuk kanë ardhur nga planet tjetër, por janë bija të burrave shqiptarë, motra të djemve shqiptarë, apo gra të burrave shqiptarë. Kulmin kjo politikë e arriti më shtator 2018, me deklarimin e Erion Veliajt, në Top Channel: *“Djemtë shqiptarë janë zdromsa komplet, ndërsa vajzat janë të ftillume”*. Pra programi “sekret” edukativ po realizohet. Shtypja e rëndë po prodhon vazhdimisht një karakter të dobët që është saktësisht ajo fjalë që ka thënë Erion Veliaj “zdroms” që nga fjalori shqip do të thotë *“njeri që e ka vrarë samari”* (ngordhalaq jo veç fizikisht por edhe psikologjikisht) dhe merret vesh që shkaktari është “samari i pushtetit” të tyre mbi kombin shqiptar.

Ne i shkruam Presidentit, vetë Edi Ramës, kryesisë së Partisë Socialiste, medias, opinionit publik, AMA-s, Top Channel-it (që e ka ende videon fyese) dhe përsëri asnjë reagim prej tyre. Kjo tregon se sa pak e kuptojnë ata dëmin ose sa të këputur (zdromsa) janë në çështje të mbrojtjes së dinjitetit kombëtar, të dinjitetit të shqiptarit, i cili ka dhënë jetën për një fyerje më të vogël dhe jo një të tillë që nuk fyen vetëm individin, por familjen, fisin, racën shqiptare, tërë kombin.

Programi i Edi Ramës dhe i Partisë Socialiste është thjesht e kundërta e programit të Rilindjes Kombëtare.

Rilindja Kombëtare synonte frymëzimin e shqiptarit, ndaj Naim Frashëri tek “Histori e Skënderbeut” thoshte

*“Në janë ata shqiptarë, që i njoh e i di unë,
bota po ka për të parë këtu një të madhe punë”.*

Edi Rama dhe Partia Socialiste nxitin dekurajimin më të shqiptarëve, duke i portretizuar si ngordhalaq (zdromsa), dembela apo hilacakë, të korruptuar, kur të tillë janë vetë ata që eksportojnë dobësitë e tyre tek i gjithë populli që nuk është si ata.

Synimi i kësaj politike është çmontimi qelizor i shoqërisë shqiptare, i familjes, është ndryshimi demografik, etnik

MOSVOTIMI ME ARSYE TË QARTA POLITIKE ËSHTË MË MIRË SESA VOTIMI I VERBËR PA GARANCI

ose i orientimit seksual, duke nënkutpuar martesën e vajzave me të huajt, që në fakt, do të thotë ose eksport i vajzave shqiptare, ose import i burrave të huaj. Me të tillë situatë “shkurajimi” misioni e Sistemit Arsimor Shqiptar shpërfytyrohet në maksimum dhe njerëzit nuk janë të aftë të mbledhin veten.

Partia Socialiste dhe Edi Rama nuk i tha popullit që ne do t’u spiunojmë kudo që të jeni, por ky program po realizohet me normë të plotë, çdo ditë, çdo orë, çdo javë, çdo muaj, çdo vit dhe kjo ka sjellë apatinë e popullsisë që nuk ka arsye për të krijuar dhe vepruar sepse mendon që para se ta dijë vetë, më parë e dinë të tjerët. Kjo ul jashtëzakonisht efektivitetin kombëtar.

Partia Socialiste dhe Edi Rama nuk i tha popullit që ne do të boshatisim Shqipërinë me teknikat diabolike të uljes së cilësisë së shërbimeve: që nga arsimi, shëndetësia, biznesi.

Me përvojën e qartë sofiste (diabolike) dhe me shembullin e Partisë Socialiste dhe të Edi Ramës në përdorimin e pushtetit ne nuk mund ta pranojmë as për të tjerët idenë e *“një programi sekret”* dhe as devizën *“na zgjidhni se jemi të mirë, pa pastaj e bëjmë programin”* as për partitë e reja.

Do të shohim që edhe PD e turpëron edhe më shumë idenë e të bërit program kombëtar dhe të besueshmërisë së ndjekjes së tij. Programi i tyre i vetëm është *“e dimë që jeni keq dhe sa t’ju hajë ujku i partisë socialiste më mirë t’u hajë çakalli i PD-së”*. Këtë e kemi të provuar në mënyrë të detajuar dhe personale dhe jo thjesht nga televizori.

Një vëmendje më të madhe në këtë kuptim e kanë marrë partitë e reja. Të mos i lëvdohet që ato e kanë marrë nismën, nuk është në rregull, por edhe që të mbetemi vetëm në vlerësimin “e guximit” nuk është në rregull, sepse populli është mësuar edhe me teknikën e partive kryesore për të dubluar “opozitën” me arsyen e mbrojtjes së rrjedhjes së votave.

T’i kërkoj votën popullit të legalizojë “verbërinë” e vet, meqë kështu ka ndodhur edhe më parë nuk është në rregull. Funkcioni kryesor i një partie, sidomos para zgjedhjeve, në radhë të parë është analiza dhe mendimi dhe jo aq veprimi. Nëse partia nuk gjen kohë të mendojë para zgjedhjeve, ajo qartësisht nuk do të ketë aspak kohë pas zgjedhjeve.

Nëse pranohet të votohet me devizën *“na zgjidhni e na besoni se e bëjmë saktë më vonë programin”*. Çfarë do të bënin njerëzit nëse programi do të jetë thjesht “keq” dhe “dëm kombëtar”, çfarë ka në dorë populli që ka votuar? Thjesht të presë edhe katër vjet? Qartësisht politikanët (edhe të rinj) nuk do të kenë asnjë kufizim moral. Nëse vepohet me këtë devizë, zhgënjimet e popullit do të jenë shumë të mëdha dhe pasoja është që ata as nuk do të duan të mendojnë. Ne i ftojmë që të shohin mundësinë që edhe të mos votojnë si mjet reagimi politik dhe jo si indiferencë.

Në këtë mënyrë qytetari ruan dinjitetin e vet qytetar dhe politik dhe shton presionin ndaj aktorëve, sipas devizës së Sami Frashërit:

“Opinionit publik edhe pse në dukje i dobët, është i aftë të shkatërrojë çdo forcë materiale”.

Votimi i verbër i mëson politikanët me devizën “ki besim tek unë” edhe pa ofruar ata mjaftueshëm argumente.

Duke mos votuar me arsye të qarta dhe të shprehura politike (një shembull është ky) atëherë krijohet terreni i përshtatshëm për kritikën masive në shoqëri, rrit etjen e shoqërisë për alternativa më të mira, u jep guxim atyre që kanë

aftësinë, përvojën, përgatitjen, mundësi të prodhojnë ide, plane dhe projekte t’i bëjnë ato dhe të vlerësohen për këtë. Populli bëhet kështu zot i fateve të veta. Kjo nuk është e thjeshtë, por një mënyrë është edhe mosvotimi.

Sidoqoftë e kuptojmë që ka “keq” por ka edhe “më keq” dhe do t’i kuptojmë edhe ata që në këtë situatë zjedhin “të keqen më të vogël”. Do të shohim. Megjithatë kombinimi

i mënyrave “*zgjedh të keqen më të vogël*” dhe “*nuk votoj*” apo “*e nxjerr votën të pavlefshme*” mbase na prodhon edhe një gjë më të mirë. Nuk dimë ta themi me siguri.

Për vete po zgjedhim “Mosvotimin” me këtë deklaram të shkruar.

ANASHKALIMI I PROGRAMIT POLITIK PËR ÇËSHTJEN FETARE ËSHTË PJESË E SHPËRFLIJES SË RËNDËSISË SË SISTEMIT TË EDUKIMIT

Lexuesi mund ta ketë vënë re se megjithëse çështja fetare ndikon thellësisht shoqërinë, arsimin, sistemin edukativ, aleancat shtetërore, shumë veprime praktike në të gjitha fushat e jetës, asnjë analizë nuk kemi nga partitë politike çfarë po shkon mirë apo çfarë po shkon keq. Ato nuk marrim përsipër të ndreqin asgjë në këtë drejtim, as të analizojnë. Ato bëjnë sikur nuk shohin që Edi Rama ka propozuar Shtetin Bektashi dhe kjo është në kundërshtim me programin e Rilindjes Kombëtare. Pse nuk u dashka shprehur partia për këtë në fushatë elektorale? Kush do ta ushtrojë sovranitetin mbi “bektashinjtë” që duan të shkelin sovranitetin e vendit dhe të shturin Rilindjen Kombëtare? Qartësisht që partitë politike po veprojnë në mënyrë tinzare me zgjedhësin, sepse është e qartë që ato kur të jenë në pushtet do ta marrin një vendim, por ai vendim më parë do të duhet të jetë në programin elektoral.

Udhëzuesi më i mirë në këtë drejtim është programi i Rilindjes Kombëtare të shekullit 19. Partitë do të duhej të monitoronin nëse ai program është realizuar apo po realizohet me sukses apo ka probleme.

Qartësisht çështja fetare shqiptare ka shumë probleme.

Kemi ndërhyrje të rënda me prapavijë fetare në dëmtimin e vetë kujtesës për Rilindjen Kombëtare. Botohen libra nga sektet fetare, që i bëjnë levë shtetit, dhe kombit shqiptar. Kemi lëvizje konvertuese që synojnë të turpërojnë një sekt fetar dhe të ngrenë në qiell një tjetër. Kemi ndërhyrje në programet mësimore. Kemi biznese me orientim fetar, kemi parti politike me orientim fetar. Kemi një përçarje e thellim përçarjeje fetare, ndaj së cilës partitë mbyllin sytë.

Feja është pjesë e sistemit edukativ, sepse ajo synon të njëjtin terren me atë të sistemit arsimor, veç mjetet i ka të ndryshme. Ajo synon një seri normash morale e shoqërore, synon të ndikojë jetën e individit dhe jetën kolektive, ka edhe një axhendë vjetore.

Duket që partitë e mbajnë të fshehtë programin e tyre fetar dhe nuk e ndajnë atë me popullin. Krijohet përshtypja që çdo gjë vete vaj, ndërkohë që “fetarizimi” kap majat, dhe po majat kap konkurrenca “fetare” dhe në përpjesëtim të drejtë edhe problematika e shoqërisë.

Nisma “Shtet Bektashi” ka qenë në “*programin e fshehtë*” të Partisë Socialiste dhe të Edi Ramës. Ajo nismë nuk bëhet në çast, as për një vit. Është punuar disa dekada derisa të vihet aty, mirëpo publiku u gjend i befasuar.

Dora “fetare” e huaj qëndron edhe pas çmontimit të “Mësonjëtores së Korçës” dhe 7 marsit. Sulmi frontal ndaj Rilindjes Kombëtare është saktësisht vepër “fetare” shumëplanëshe. Nuk shohim që ndonjë sekt fetar të shqetësohet për këtë dëmtim të Rilindjes Kombëtare. Për ata “rilindas” është vetëm profeti i tyre. Sulmi fetar i fuqishëm dhe tepër diabolik bëhet ndaj të gjitha figurave të rilindjes kombëtare.

Jemi në vitin e 200-vjetorit të ideologut të Rilindjes Kombëtare dhe asnjë nga partitë politike “nuk dashka vota” duke e nderuar Pashko Vasën. Kujt po ia prishin qejfin nëse e nderojnë? Natyrisht kujtojnë që ia prishin “faltoreve dhe sekteve fetare” dhe harrojnë se për nga shpirti dhe vlerat Pashko Vasa ishte më fetar sesa ata që sot formalisht duket se janë të tillë.

Është e vërtetë që partitë kanë frikë nga institucionet fetare dhe nga vetë komunitetet fetare. Kjo frikë e tyre kryesisht buron ose nga mosnjohja e programit dhe e metodologjisë së Rilindjes Kombëtare ose nga leva që të huajtë u bëjnë këtyre institucioneve.

Një parti duhet t'i dalë zot të gjitha çështjeve kombëtare dhe në këtë drejtim ajo duhet të sigurojë një dakortësi të gjerë.

Duke mos vënë një raport të drejtë ndërmjet sistemit arsimor laik dhe institucioneve fetare, në të shumtën e rasteve e pëson sistemi laik i arsimit që mbetet apatik, anemik, ndërkohë që fetarët përforcojnë ritet e tyre dhe shtojnë kompaktësinë.

Çështjet fetare qartësisht dëshmojnë që po trajtohen në prapaskenë, përmes marrëveshjeve të heshtura me komunitetet fetare, pa pasur nevojë për deklarime zyrtare.

Vendimet që prekin fenë merren në politikë
Është politika që vendos për statusin juridik të feve për financimin e institucioneve fetare, për praninë ose jo të fesë në arsim, në media dhe hapësirën publike.

Marrëdhëniet ndërfetare dhe ndërmjet shtetit e fesë nuk mund të përmirësohen pa një ndërhyrje politike dhe t'i lihen “zhvillimit në gjendje të egër”.

Pra çështja fetare megjithëse nuk figuron në programe, ajo është e pranishme në vendimmarrje. Qartësisht kemi një paradoks, apo mospërputhje demokratike.

Kjo është problem sepse nëse çështja fetare nuk përfshihet në programin elektoral, votuesit nuk dinë çfarë mendon partia (në fakt as nuk pyeten për këtë). Njerëzit nuk do të dinë me çfarë programi ta verifikojnë apo justifikojnë një

ndërhyrje të nesërme. Kështu partitë i japin të drejtën vetes të veprojnë pas shpinës së publikut. Pra publiku thjesht duhet t'u japë votën dhe ato të bëjnë çfarë të duan.

Duke mos e përfshirë shoqërinë gjatë fushatës së zgjedhjeve në çështjen fetare, publiku keqedukohet.

Çështja fetare është realitet edhe çështje politike, por ajo mbetet në axhendë të fshehtë.

Kërkesa për transparencë dhe përfshirje të qartë të kësaj teme në programet politike nuk është kërkesë për përçarje, por për demokraci të ndershme dhe vendimmarrje të përgjegjshme.

KRITIKA E PROGRAMEVE TË PARTIVE PËR SISTEMIN ARSIMOR SHQIPTAR BAZUAR NË PËRVOJËN PERSONALE DHE NË PRURJET E HETIMIT IDEOR TË INTELIGJENCËS ARTIFICIALE (*ChatGPT*)

Në këtë dokument kemi marrë në analizë programet arsimore të botuara nga Partia Socialiste (ps.al), Partia Demokratike (pd.al), Partia Mundësia (mundësia.al), Lëvizja Bashkë (levizjabashke.al), Lëvizja Shqipëria Bëhet (shqiperiabehet.al), Partia e Lirisë (partiaelirise.al), Aleanca Kombëtare Shqiptare (aksh.al), Partia Atdheu (levizjaatdheu.al), Koalicioni Euro-Atlantik.

Është marrë dokumenti më i fundit nga faqja zyrtare që është cituar dhe është analizuar. Programi për arsimin është kopjuar dhe hedhur këtu 100% dhe krahas tij gjendet një kritikë e ChatGPT dhe kritika ime personale.

Megjithëse kritika e ChatGPT presupozohet të jetë indiferente nga personi që i kërkon diçka, nuk jemi të sigurtë plotësisht për këtë, ndaj ka vlerë që mendimin tonë e kemi të shkëputur qartë nga Chat GPT.

Do të shihet qartë se partitë kanë vepruar në mënyrë aq të papërgjegjshme, sa nuk e kanë marrë parasysh asnjë këndvështrim të çastit nga Inteligjenca Artificiale, kur në fakt ajo është oponencë e dijes njerëzore, pra oponencë e vetëdijes apo botëkuptimit njerëzor e përvojës së deritanishme të njerëzimit (me disa kufizime).

Kritika ime personale, mbështetet në njohjen konkrete të shkollës dhe të sistemit arsimor për më shumë se 34 vjet nga të cilat 28 vjet si themelues, drejtues dhe mësues i shkollës “Udha e shkronjave” (1997-2025).

Ky arsyetim që kemi këtu nuk nisët nga përvoja personale, por kryesisht nga analiza e fakteve brenda programeve, por kur duhet edhe faktet e përvojës personale duhen përmendur nëse ato janë tipike, në mënyrë që lexuesi të gjykojë edhe në bazë të tyre, ose të di vetë se deri se si e trajtojmë konfliktin e interesit.

Programi arsimor i PARTISË SOCIALISTE

SHËNIM: Programi i Partisë Socialiste u shkarkua nga dokumenti “Programi i Partisë Socialiste 2024-2030” në faqen ps.al në datën 18 prill dhe u verifikua përsëri më 1 maj 2025. Po e citojmë të plotë, në kolonën majtas, dhe djathtas në dy kolona do të keni komentën tonë (ose të ChatGPT)

3.2 Arsimi Çelësi për Shqipërinë e Zhvilluar

Një vend i zhvilluar nis me një sistem arsimor të fortë, që garanton mundësi të barabarta për çdo fëmijë. Për vite me radhë, arsimi u la pas dore: shkolla në gjendje të rrënuar, mungesë transparence dhe meritokracie, mësues të papërgatitur dhe një shkëputje e madhe nga tregu i punës.

Çfarë bëmë së bashku?

Siguroam transparencë dhe meritokraci në punësimin e mësuesve përmes portalit “Mësues për Shqipërinë”, ku mbi 55,000 aplikantë kanë konkurruar me kriterë të barabarta. Investuam në infrastrukturën arsimore, duke rikonstruuar 450 shkolla dhe objekte sportive, duke përmirësuar kushtet për 250,000 nxënës dhe mësues. Për të përgatitur fëmijët për epokën dixhitale, 340 shkolla u pajisën me laboratorë SMART, ndërsa 16,000 mësues u trajnuan për zhvillim profesional. Dyfishuam pagën mesatare të mësuesve nga 420 euro në 950 euro, duke reflektuar vlerësimin për këtë profesion. Lehtësuam barrën financiare për familjet shqiptare, duke ofruar transport falas për 38,000 nxënës dhe 12,000 mësues, tekste falas për 238,000 nxënës çdo vit, si dhe 2,100 mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të veçanta. Angazhuam 850 psikologë dhe punonjës socialë për të

Kritikë ndaj programit arsimor të PS-së sipas ChatGPT

SHËNIM: Programi i PS-së për arsimin që kemi cituar majtas, u ngarkua në ChatGPT dhe iu dha kërkesa të bënte kritikën. Po e citojmë të plotë përgjigjen pa bërë ndryshime.

1. Reduktim i Arsimit në Infrastrukturë dhe Shifra

Programi e trajton arsimin thujse ekskluzivisht përmes investimeve materiale dhe statistikave sasiore: numër shkollash, laboratorësh, kamera, paga, etj. Kjo qasje redukton një sektor me rëndësi strategjike kombëtare në një **çështje ndër-timesh dhe teknologjike**, duke anashkaluar përmbajtjen themelore të procesit arsimor: **çfarë lloj qytetari, shoqërie e kombi ndërtohet përmes arsimit?**

2. Mungesë e Thellë e Vizioni Edukativ

Nuk ekziston një **filozofi edukative**, as një konceptim ideologjik i arsimit si instrument zhvillimi kulturor, demokratik, kombëtar apo shoqëror. Arsimi nuk trajtohet si **formësim i njeriut**, por si **menaxhim logjistik** i një sektori shërbimi. Nuk preken fare temat e identitetit, edukimit qytetar, etikës, karakterit, përgjegjësisë ndaj komunitetit apo lidhjes së arsimit me trashëgiminë kulturore dhe gjuhësore.

3. Mungesë e Qasjes Kombëtare ndaj Diasporës dhe Shpopullimit

Në një kohë kur Shqipëria përballlet me **shpopullimin më të madh në Evropë**, programi dështon të ofrojë qoftë edhe një strategji elementare për **kthimin e trurit, integrimin e fëmijëve të emigrantëve në sistemin arsimor** apo ruajtjen e lidhjes me gjuhën e kulturën shqiptare jashtë kufijve.

4. Ignorim i Gjuhës Shqipe si Bazë e Shtetformimit

Nuk përmendet asnjëherë mësimi i gjuhës shqipe, as si instrument i formimit kombëtar, as si nevojë për integrimin e të kthyerve, as si nevojë për diasporën. Gjuha shihet si e vetëkuptueshme dhe nuk ka **asnjë trajtim si politikë publike**, duke nënvlerësuar rolin e saj si element kushtetues e themelor i unitetit kombëtar.

5. Shmangie e Çështjeve të Përmbajtjes Arsimore

Nuk trajtohen programet **mësimore, tekstet, lëndët**, as për nga përmbajtja, as për nga cilësia, as për nga përditësimi me zhvillimet ndërkombëtare. Mungon çdo reflektim mbi:

- edukimin historik dhe pasaktësitë ideologjike;
- mospërputhjet me standardet e PISA-s;
- mungesën e zhvillimit të të menduarit kritik, etik dhe qytetar.

Programi arsimor i PARTISË SOCIALISTE

mbështetur zhvillimin emocional dhe social të nxënësve. Filluam zbatimin e sistemit dual në arsimin profesional, i cili kombinon mësimin teorik në shkollë me praktika profesionale në biznese, duke forcuar lidhjen midis tregut të punës dhe aftësimit profesional. Trefishuam numrin e bizneseve që bashkëpunojnë me shkollat profesionale. Trefishuam financimin për universitetet, duke e rritur nga 69 milionë euro në 200 milionë euro. Realizuar për herë të parë procesin e akreditimit institucional të universiteteve publike dhe dyfishuam investimet në infrastrukturë dhe kërkim shkencor. Ndërkohë, laboratorët modernë dhe fondet për bursa mbështetën mbi 50,000 studentë çdo vit.

Çfarë do të bëjmë në të ardhmen?

Rrisim pagën mesatare të mësuesit në 1,250 euro brenda mandatit të katërt dhe investojmë në përmirësimin e kushteve të punës për mësuesit. Ndërtojmë 200 shkolla të reja dhe investojmë 60 milionë euro në rindërtimin dhe modernizimin e shkollave profesionale për të siguruar një infrastrukturë arsimore cilësore. Krijojmë 1,000 laboratorë inteligjentë dhe pajisim çdo klasë me kamera inteligjente deri në vitin 2026 për të modernizuar procesin mësimor dhe garantuar një mjedis më të sigurt dhe inovativ për nxënësit. Brenda mandatit të ardhshëm, në çdo bashki që është qendër qarku do të nisë zbatimin e programit të ushqimit në shkollë dhe një program i dedikuar pas-shkollor, për të ofruar kujdes dhe zhvillim të plotë për çdo fëmijë edhe pas orarit mësimor. Themelojmë shoqërinë publike të transportit shkollor falas. Dyfishojmë numrin e nxënësve

Kritikë ndaj programit arsimor të PS-së sipas ChatGPT

6. Arsimi i Lartë përmendet vetëm si investim, jo si reformë

Trefishimi i fondeve për universitetet dhe projekte si Kolegji i Evropës përmenden **pa asnjë reflektim mbi cilësinë e mësimdhënies, reformimin e kurrikulave, korrupsionin akademik, plagjiaturën, ose degradimin e diplomave publike dhe private.** Për arsimin e lartë, përmendja është **sipërfaqësore dhe instrumentale.**

7. Kamera në Klasa – Qasje Kontrolluese dhe e Dyshimtë

Vendosja e kamerave në çdo klasë tregohet si modernizim, por në thelb është një **masë kontrolluese e cila mund të rrezikojë lirinë pedagogjike,** krijimin e një klime frike dhe ndërhyrje autoritare në ambientin shkollor. Mungon çdo analizë etike ose legjislative për këtë masë.

8. Pa angazhim ndaj depolitizimit të arsimit

Mungon çdo vullnet për **heqjen e ndikimit politik në emërimet e drejtuesve të shkollave,** bordet universitare, apo politizimin e shpërndarjes së fondeve në arsimin e lartë. Në një vend ku arsimi është prekur rëndë nga nepotizmi dhe klientelizmi, kjo heshtje është tregues i mungesës së vullnetit për reformë reale.

9. Asnjë përmendje e arsimit në zonat rurale dhe të margjinalizuara

Programi nuk ofron **asnjë analizë për pabarazinë gjeografike në arsim,** për përjashtimin strukturor të fëmijëve në zonat e thella, të komuniteteve rome, egjiptiane, apo të fëmijëve me nevoja të veçanta në nivel më të lartë. Përmendja e disa ndihmësve mësimorë është sipërfaqësore dhe nuk lidhet me një strategji gjithëpërfshirëse.

10. Arsimi profesional – vetëm bashkëpunime me biznese, pa thellim konceptual

Programi nuk përmend çfarë lloj formimi profesional po zhvillohet, në çfarë degësh, për cilat nevoja reale të ekonomisë. Trajtohet si bashkëpunim teknik me biznese, jo si platformë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, dinjitet të punës apo inovacion kombëtar.

11. Roli i prindërve dhe komunitetit inekzistent

Programi nuk i jep asnjë rol komunitetit lokal, prindërve, OJF-ve, duke e parë arsimin si një ndërhyrje nga lart-poshtë, ku nxënësi është pasiv dhe mësuesi është thjesht zbatues i teknologjive dhe masave të vendosura nga qendra.

Programi arsimor i PARTISË SOCIALISTE

në arsimin profesional, duke synuar që 35% e nxënësve të zgjedhin këtë rrugë edukimi. Përfundojmë projektet madhore të Universitetit të Tiranës dhe Kolegjit të Evropës, duke forcuar arsimin e lartë dhe krijuar mundësi akademike të nivelit ndërkombëtar.

Kritikë ndaj programit arsimor të PS-së sipas ChatGPT

12. Edukimi qytetar, moral dhe formimi i karakterit – mungojnë plotësisht

Nuk ka asnjë qasje ndaj: • edukimit për demokraci, drejtësi dhe institucione; • formimit të karakterit moral; • zhvillimit të ndjeshmërisë ndaj korrupsionit, mjedisit apo drejtësisë sociale. Në këtë aspekt, programi është ideologjikisht i zbrazët dhe shoqërisht neutral, duke shpërfillur funksionin e arsimit si formues i qytetarisë demokratike.

Përmbledhje Kritike. Programi është një projekt teknokratik i menaxhimit të arsimit, pa dimension filozofik, kombëtar, qytetar apo moral. Nuk ofron vizion, as reforma reale strukturore. Arsimi trajtohet si shërbim teknologjik dhe jo si projekt kombëtar për ndërtimin e brezave, identitetit dhe drejtësisë sociale. Në kontekstin e një programi elektorale kombëtar, është një dokument i paplotë dhe politikisht minimalist për një sektor që përcakton të ardhmen e një vendi.

KOMENTE PËR PROGRAMIN ARSIMOR TË PARTISË SOCIALISTE

Programi i Partisë Socialiste është 451 fjalë për arsimin.

Jashtëzakonisht pak dhe në mënyrë të papërgjegjshme. Mund të jetë pak, nëse aty kuptohet që janë përfundimet e një analize, por qartësisht është e çorientuar.

Detyra projekt-kërkimor që duhet të dorëzojnë nxënësit e klasës së tetë “Udha e shkronjave” është 1000 fjalë, ndërsa projekti në Global Perspectives që dorëzohet në për testim ndërkombëtar, i kalon 3000 fjalët. Projektet e nxënësve tanë janë për të treguar aftësinë e testuar dhe për të marrë vlerësimin me notë ndërsa programi i Partisë Socialiste të Shqipërisë është për të drejtuar shtetin. (<https://ps.al/programi-i-partise-socialiste-te-shqiperise-2024-2030/>)

U pa më sipër që ChatGPT ishte në gjendje të jepte në çast një vlerësim kritik për këtë program dhe ai nuk është marrë parasysh.

Le të përsërisim edhe një herë disa vlerësime që nuk i thotë ChatGPT (nuk po ia kërkojmë, se do ta bënte).

Një përcaktim i Universitetit të Kembrixhit (të përafërt e ka edhe Universiteti i Oxfordit) për maturantët shqiptarë që duan të aplikojnë në këto universitete thotë se “*Matura Shtetërore nuk është përgatitje e mjaftueshme për të patur një aplikim të suksesshëm*”, diçka tepër turpëruese për kualifikimin e një shteti. Asnjë shtet tjetër në Ballkan nuk e ka kaq turpërues. Finalja e një sistemi arsimor është besueshmëria e cilësisë së diplomës që jep në maturë. Me kaq nuk kemi çfarë të analizojmë se si është sistemi arsimor parauniversitar. (Shih <https://www.undergraduate.study.cam.ac.uk/international-students/international-entry-requirements> kërko Albania)

Shkombëtarizimi i arsimit dhe mosmirënjohja ndaj Rilindjes Kombëtare Shqiptare

Qeveria e Partisë Socialiste, me Edi Ramën në krye, ka dëmtuar rëndë karakterin kombëtar të arsimit, duke goditur fort Rilindjen Kombëtare Shqiptare të shek.19, me një seri masash antikombëtare. Dublimi i emërimit “rilindje”, mbyllje e kujtesës kombëtare që lidhet me Mësonjëtorën e Parë Shqipe Korçë, duke i hequr statusin Muze Kombëtar i Arsimit, duke i hequr nga detyrat muzeut lokal Korçë që të trashëgojë “Mësonjëtorën”, duke hequr mundësinë që 7 marsi të shpallet si Festë Zyrtare Kombëtare e Arsimit dhe duke e zëvendësuar me 22 nëntorin 1908, duke sulmuar me libra Vëllezërit Frashëri dhe duke shpallur nismën për Shtet Bektashi që është kundër ideologjisë së Rilindjes

KOMENTE PËR PROGRAMIN ARSIMOR TË PARTISË SOCIALISTE

Kombëtare në trajtimin e çështjes fetare shqiptare. Qeveria e Partisë Socialiste me Edi Ramën në krye bën që “mosmirënjohjen” e vet ndaj “rilindjes kombëtare” ta edukojë në të gjithë sistemin arsimor dhe të na quajë se të tjera “mirënjohje” kanë rëndësi. I nxorën trutë gjithë njerëzve me “hebrenjtë” dhe nga “ata na janë mirënjohës” e kthyen në “ne duhet t’u jemi mirënjohës që ata na janë mirënjohës” dhe “ta kthejmë mirënjohjen e tyre” në një “detyrim kombëtar” për më shumë “mirënjohje” hebreje, që është thjesht një “lak në fyet të shqiptarëve” për “detyrim mirënjohje”. Aq shumë në mënyrë fiktive e kanë zmadhuar hebrenjtë këtë, sa i plotësojnë kushtet e “lajkës” me synimin e zhvotjes kulturore.

“Lajkatari është fajdexhiu më i keq; porsa shikon se atë që e ka përballë e mashtroi, nuk ngopet por synon që t’ia rrjepë edhe lëkurën të gjerit.” (Sami Frashëri)

Sa është folur për “besën” ndaj “hebrenjve” qeveria nuk ka folur për Rilindjen Kombëtare. Janë duke shpikur një “rilindje në epruvetë” që është e ngatërruar me turli idesh, asnjë prej të cilave nuk ka mbështetje në historinë tonë. Shqiptarët nuk e kanë zakon ta “përgojnë” ndihmën e dhënë. Mirëpo kush po pyet për zakone e tradita. Gjëja po zmadhohet enkas, që ajo të rrëmbehet. Pra meqë ju nuk flisni aq shumë “për besën” na e lini ne këtë punë se flasim ne tek Muzeu Hebraik për besën. Ky është një devijim i rëndë përmes Sistemit Arsimor Edukativ shqiptar që në radhë të parë duhet të formojë shqiptarin me karakter e virtyte dhe nuk duhet ta ketë të korrupsuar mësimin nga të huajt. Në këtë pikë shkollat duhet të zbatojnë porosinë e Naim Frashërit, që në këngën e fundit

të “Historisë së Skënderbeut” tek “Shpirt i Skënderbeut thotë”, porosit:

*Njëri tjetërinë doni,
se keni gjithë një shpresë,
të huajtë t’i mërgoni,
q’ë kanë me të pabesë.*

Po ashtu shkollat duhet të edukojnë e zbatojnë porosinë e Sami Frashërit:

Atdheu edhe po u la në dorë të një qeverie të ligë, edhe po u shpërfill, pëson fatkeqësi të shumta po nuk e humb shpresën se më në fund do të shpëtojë, por premtimet e të huajve dhe mbrojtjaqë ata mund të ofrojnë, gjithmonë sipas interesave të tyre, e zhdrukun atdheun përgjithmonë.

Në fakt, Qeveria e Partisë Socialiste me Edi Ramën në krye rriti në mënyrë eksponenciale varësinë e plotë të sistemit arsimor nga të huajt: duke zmadhuar tej normave sistemin privat të huaj e fetar, duke eliminuar origjinalitetin e programeve shqiptare në shkenca, duke zhdukur kështu autorët shqiptarë, botuesit shqiptarë, duke hapur qëllimisht projekte të huaja të pasitura nga interesi kombëtar, duke eksportuar tek të huajt gjënë më thelbësore që ka Shqipëria që janë të dhënat personale sensitive të 100% të fëmijëve shqiptarë. Teknika e Partisë Socialiste në këtë drejtim ka qenë “shite Shqipërinë me pjesë” tek “të huaj të ndryshëm”. Nuk janë vetëm hebrenjtë. Të gjithë fqinjët, grekët, turqit, italianët kanë marrë të drejta nga shqiptarët, ndërkohë që himni thotë “të drejtat tona ne s’i ndajmë”.

Dekurajimi i frymëzimit për karakterin dhe virtytet e bujarit shqiptar. Turpërimi i shqiptarit.

Qeveria e Partisë Socialiste nuk njeh tipare pozitive të shqiptarit. Ajo i turpëron vazhdimisht ata, me synimin e dekurajimit, të lodhjes kombëtare. Ajo ka nxitur turpërimin e rracës shqiptare me pasojë devijimin e rëndë të karakterit dhe shëndetit mendor dhe vështirësimin e jashtëzakonshëm të punës së sistemit edukativ në këtë drejtim. Tipike janë deklaratimet për turpërim të burrit dhe djalit shqiptar dhe lëndimet “lajkatore” për femrat që synojnë në mënyrë diabolike të përçajnë në mënyrë qelizore familjet, fiset dhe shoqërinë shqiptare.

Tipike janë “batutat” e qëllimta të Edi Ramës dhe deklaratimi nga Erion Veliaj (Top Channel, shtator 2018) se “*djemtë shqiptarë janë zhdromsa komplet, ndërsa vajzat shqiptare janë të stil-lume*”. Viojnë edhe sot turpërimet për “burrat çyryk”.

Dëm kolosal ka udhëzimi i Edi Ramës që fëmijët të hapin Google dhe të shohin trupin e tij të zhveshur në plazh nudo. Njeriu mund të jetë me vese, dhe publikun e ndihmon nëse ai ka një reflektim të drejtë ndaj tyre, duke thënë “më vjen turp për këtë apo atë, por nuk e munda tundimin”, por kur ai bën të kundërtën dhe këtë e bën “model” dëmi është i jashtëzakonshëm. Kryeministri është institucion dhe nuk mund të flasë çfarë i do qejfi, por çfarë ka dakortësi e kolegialitet për të folur. Natyrisht fëmijët shohin se sa apatikë janë prindërit e tyre, mësuesit e tyre, shoqëria ku jetojnë dhe atëherë “*ndiejnë në zemër të mardhur*” (Naim Frashëri) dhe këtë e shprehin me “lartim nga Shqipëria”.

As shkollat, as universitetet, as partitë, as shoqatat, as organet e drejtësisë nuk morën aksion në këtë drejtim (posh-

KOMENTE PËR PROGRAMIN ARSIMOR TË PARTISË SOCIALISTE

tërimin e shqiptarit nga Edi Rama dhe Erion Veliaj). Në këtë gjë ata kanë qenë përgjithësisht vetëm. Folësit e tjerë të Partisë Socialiste nuk guxojnë sa guxon kjo dyshe në poshtërimin e shqiptarit. Duket që fiset e tyre nuk i lënë, kanë një turp, por nuk kanë guximin të kundërshtojnë. Kjo do t'i dëmtojë rëndë vetë fëmijët e tyre dhe jo vetëm fëmijët e botës.

I vetmi institucion që e mori seriozisht dhe në mënyrë formale ka qenë shkolla “Udha e shkronjave” që u dërgoi letra të hapura (artikuj) Presidentit, Partisë Socialiste, Parlamentit, AMA-s, etj. Askush prej tyre nuk reagoi.

Letra ndaj Kryesisë së Partisë Socialiste: 20 janar 2023 për të reaguar si parti ndaj deklarimeve të Erion Veliajt

Nuk dimë që ndonjë institucion tjetër t'i ketë respektuar më shumë sesa ne kur ua kemi lexuar Statutin, kemi gjetur nenin 6 në të dhe ta kemi cituar *“Personaliteti dhe autoriteti i anëtarit të partisë (socialiste) janë të pacënueshëm. Çdo anëtar i partisë ka të drejtë të mbrojtë dinjitetin e tij në të gjitha forumet e partisë.”* dhe të shkruajmë një kërkesë sikur të ishim brenda.

Asnjë reagim, pra ata nuk fyen as si shqiptarë as si socialistë, dhe nuk reagojnë as si shqiptarë, as si socialistë, megjithëse edhe shqiptarët kanë kode sjelljeje dhe reagimi, edhe socialistët kanë statut.

Kërkesa ndaj Presidentit Bajram Begaj: 29 janar 2023

Presidentit i kujtuam që Partia Socialiste nuk po reagonte dhe ai duhej të reagonte si President në zbatim të Kushtetutës. Kërkesat tona ishin qëllimisht minimaliste (qortime etj), që të kuptohej se sa larg shkonte indiferenca e tyre. Realisht një shtet serioz do ta fuste në burg Erion Veliajn për një dëm të tillë. Për një fyerje të një individi njeriu mund të

bëjë burg, por për fyerjen e një kombi çfarë duhet të bërë?! I kujtuam Presidentit që ai është Komandant i Forcave të Armatosura dhe deklarimet “djemtë janë zdromsa” thellësisht ndikon moralin e forcave të armatosura dhe frymëzimin e të rinjve për të qenë pjesë e tyre, dhe në këtë këndvështrim është një sulm i drejtpërdrejtë edhe ndaj Forcave të Armatosura.

Presidenti nuk dërgoi asnjë përgjigje, as formale.

Kujtojmë që kur i kemi shkruar Presidencës Turke, për kthimin e eshtrave të Sami Frashërit, më 2012 (me rastin e 100-vjetorit) megjithëse ne nuk jemi ndonjë institucion i fuqishëm, na shkruan një letër formale, pra na respektuan në mënyrë protokollar (tjetër gjë është zgjidhje, që e kuptojmë).

Kur i shkruam AMA-s që ajo ta hiqte videon nga kanali i Top Channel, ata nuk pranuan (me justifikimin “ka kaluar një muaj nga botimi i parë”, kur në fakt video është në youtube dhe quhet se po transmetohet çdo ditë, pra nuk ka një afat “një muaj” në rastin e youtube). Megjithatë edhe kritikën e bëme përsëri duke i thënë, nuk po duam ta bëjmë administrative sa ta bëjmë individin të reagojë edhe vetë, sepse në radhë të parë Erion Veliaj do të dëmtojë djalin e vet, i cili do ta besojë më shumë thënien e të atit se “Shqiptarët janë zdromsa”, pra “zdromsi” i parë do të ishte vetë “djali i tij”. Erioni nuk i kupton të fshehtat e psikologjisë.

As Top Channel nuk reagoi, megjithëse ne ia kërkuam me letër. Nuk e hoqi. Sot më 2 maj 2025 e verifikova dhe video e Erion Veliajt është ende aty.

Pra qartësisht është politikë dhe jo ndonjë “lajthitje e çastit”. Të ishte lajthitje, Erioni do të justifikohet, dhe do t'i thoshte Top Channel ta hiqte pjesën që kishte fyerje. Nuk e kanë hequr dhe vijon dëmi kolosal në tërë sistemin arsimor shqiptar.

Sistemi edukativ shqiptar, ku përveç institucioneve arsimore futen edhe mediat, partitë institucionet fetare, psikologët, mësuesit, pedagogët, prindërit etj. masivisht dhe në mënyrë të turpshme nuk e kuptojnë këtë dëm ose nuk reagojnë ndaj dëmit, sepse nuk ka *një program të edukimit të karakterit dhe të virtyteve*, të aftë të monitorojë se çfarë ndodh, por Rilindja Kombëtare e shek 19 rezultoi aq e fuqishme pikërisht se kishte program edukimi karakteri dhe virtytesh të bujarëve shqiptarë. Atë program vlerësoi populli shqiptar i asaj kohe, ndaj u frymëzua dhe u rizgjua nga shekuj të tërë po themi “përgjumjeje” të vetëdijes kombëtare dhe na dha ne shtetin e pavarur shqiptar, dhe një sistem edukativ laik. Institucionet fetare po ashtu nuk reagueshan, duke treguar një servilizëm të jashtëzakonshëm ndaj pushtetit, ose një “kënaqësi mesquine” që çdo dështim politik i një shteti sekularisht do t'i drejtonte të “dëshpëruarit” tek “edukata e tyre “hipokrite” e institucioneve fetare” që nuk janë në gjendje të zbatojnë atë që u shkruajnë librat e shenjtë.

Nuk jemi duke folur për “ndonjë kurs elektricistësh apo muratorësh” dhe nëse “nuk ke program të artikulluar” atëherë dikush tjetër do ta bëjë programin dhe kjo po ndodh.

Mungesa e qëllimit të programit të sistemit arsimor shqiptar për edukimin e karakterit dhe të virtyteve, në praktikë pa miratim organesh socialiste, po plotësohet me *“programin e turpërimit dhe të dekurajimit të shqiptarit me autor Edi Ramën dhe Erion Velinë”* dhe “të edukimi të tradhëtisë kombëtare” (koncepti *shtet bektash*).

Socialistët nuk duhet të duan turpërimin para dinjitetit. Më mirë dorëzimi i pushtetit sesa mbajtja e tij me turp. Pushteti rimerret përsëri, por dinjiteti nëse ikën nuk vjen më.

Nga Sami Frashëri: *“Njeriu sipas shkallës së meritës dhe zgjuarsisë së tij është një minierë ari, argjendi, bakri ose bekuiri; grada dhe*

KOMENTE PËR PROGRAMIN ARSIMOR TË PARTISË SOCIALISTE

dinjteti janë vulë e shtetit që mund të shtypet sipër çdonjerit nga këto metale, por nuk mund t'ia ndryshojë asnjërit cilësinë që ka.”

“Gjerat më të shtrenjta në botë janë nderi, dinjteti dhe atdheu. Ata që për interesa personale sakrifikojnë dashurinë e atdheut, kanë sakrifikuar edhe nderin dhe dinjtetin e tyre.”

Duke parë pra se askush nuk po reagonte shkrimet tona i lamë në dorë të reagimit të vetë Erion Veliajt. As ai nuk reagoi dhe më shumë deshi *“programin dhe planin e atyre që duan të poshtërojnë shqiptarët”* sesa fëmijën e vet shqiptar që po i hiqej frymëzimi për kombin të cilit i përket. (*“Oh, sa qenë të gënhyer, ata që vuan për botë; turp të math kanë rrëfyerë, punuanë fare kot”* Naim Frashëri)

Kjo do të thotë se Partia Socialiste me Edi Ramën në krye qartësisht nuk kuptojnë sistemin edukativ të një shteti dhe një kombi, dëshmi e plotë që ata jo vetëm nuk e kanë seriozisht sistemin edukativ, shqiptar i cili thelbin e vet kombëtar e përmbledh në edukimin e karakterit dhe të virtyteve, si detyrën më të lartë të një sistemi edukativ të suksesshëm, por ata qartësisht punojnë me plan kundër, që do të thotë se i janë kushtuar asaj që Sami Frashëri e quan *“shthurje kombëtare”*. Derisa nuk u bën përshtypje një shkelje e tillë flagrante, qartësisht nuk e kanë të qartë çështje edukimi.

“Shthurja është një lumë i rrëmbyer që ecën midis popujve dhe i rrëmben popujt që janë mbrojtur me muret e një morali të mirë dhe me anën e një administrimi të mirë i dërgon nëpër grykëderdhje pranë detit ku ato janë të paracaktuar të mbyten.”

(Sami Frashëri)

FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA

Qartësisht nuk e ka të qartë kryeministri dhe Partia Socialiste që hesht, sfidën që heqin prindërit, shkollat dhe vetë shteti me fëmijët me nevoja të veçanta, derisa edhe në fushatë e përmendi fjalën *“autik”* në një kontekst poshtërues e dekurajues për prindërit që e vuajnë këtë gjë dhe këtë e bën gjatë fushatës, ku gjuha duhet treguar edhe më e kujdesshme.

Eksportimi i 100% i të dhënave personale të nxënësve jashtë dyerve të shkollës, përveç kundër ligjit, është një dëmtim i përmasave të rënda kombëtare.

Qeveria e Partisë Socialiste ka aktivizuar eksportimin e të dhënave personale të përditshme të nxënësve, në kundërshtim me ligjin për arsimin parauniversitar dhe me ligjin e mbrojtjes së të dhënave personale, përmes aktivizimit të databazës SMIP, që nuk ka minimumin e bazës ligjore të mjaftueshme për të funksionuar. **Kjo databazë praktikisht e ka nxjerrë nga shinat e ligjit krejt sistemin arsimor.**

“Udha e shkronjave” është e vetmja shkollë në Republikën e Shqipërisë që nuk bën pjesë në databazën SMIP dhe ajo nuk ka asnjë sanksion ligjor prej 3 vjetësh, që do të thotë se arsyetimi i saj është i saktë dhe në mbrojtje të ligjit. Do të thotë se 100% e shkollave të tjera janë jashtë ligjit.

“Udha e shkronjave” ka bërë peticione, artikuj, intervista, ka njoftuar të gjitha organet shtetërore, parlamentin, presidentin, ministritë, avokatin e shtetit, komisionerin e mbrojtjes së të dhënave personale, Kontrollin e Lartë të Shtetit,

Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe përsëri asgjë.

Praktika e eksportit të të dhënave personale dhe e përgjimeve në shkolla është thjesht një zbatim i politikës së përçarjes kombëtare dhe qelizore, sepse nga një funksion i shtetit fillon të lëshojë rrënjë në gjithë shoqërinë shqiptare që e quan normale përgjigjimin e tjetrit. Duke korruptuar në këtë mënyrë secilin, krimi madhor shtetëror nuk bie në sy dhe as nuk grumbullohet energji e nevojshme për ta kundërshtuar.

Nxënësit shqiptar do të jenë për tërë jetën të dëmtuar, sepse ato të dhëna që ka SMIP për ta janë tepër sensitive dhe mund të eksportohen në çdo çast në duar e mendje të liga dhe antikombëtare.

Ato mund të përdoren për dëmtim individual, familjar, fisnor, krahinor dhe kombëtar. Individit as nuk do ta dijë se si përpunohen këto të dhëna, aq më tepër në kushtet e Inteligjencës Artificiale. Çdo vit SMIP merr për çdo fëmijë mbi 2000 fakte, që lidhen me temat që zhvillon, me praninë apo mungesën në to, me sëmundjet, me sjelljet, me orientimet.

Turpi i Shqipërisë dhe i opinionit publik është se asnjë jurist, avokat, gjykatës, prokuror, hetues, oficer policie, inspektor i Kontrollit të Lartë të Shtetit, zyrtar i Shërbimit të Inteligjencës etj. nuk e ka kundërshtuar as për fëmijën e vet, megjithëse detyra zyrtare dhe profesioni ua kërkon ta bëjnë. SMIP vazhdon me normë të plotë. Asnjë parti

KOMENTE PËR PROGRAMIN ARSIMOR TË PARTISË SOCIALISTE

politike nuk e kundërshton. Por kjo nuk e bën të ligjshme databazën SMIP.

Partitë e opozitës që bëjnë sikur nuk shohin paligjshmërinë dhe që guxojnë e bëjnë programe arsimore qartësisht duhet të turpërohen.

Fakti që as partitë e tjera politike nuk e kanë problem këtë, do të thotë që ato qartësisht nuk e dinë rëndësinë e atyre të dhënave personale të fëmijëve, që janë të afta nëse bien në duar të gabuara t'u devijojnë të ardhmen pa e ditur ato vetë këtë gjë.

GJYKIM NGA PËRVOJA E SHKOLLËS “UDHA E SHKRONJAVE”

Në asnjë kontroll të ushtruar në 28 vjet, duke përfshirë edhe administratën e Partisë Socialiste, nuk kemi patur ndonjë problem, që do të thotë se stafet në çështje praktike e kuptojnë dhe e njohin faktin që po shohim vetëm cilësinë e nxënësve tanë dhe ata e dinë që veprojmë mirë. Aty ku preken dhe nuk tolerojnë është kur ne dalim nga muret e shkollës dhe shohim të themi një fjalë për politikën arsimore në çështje që i kuptojmë shumë mirë e nga brenda (jo nga jashtë) dhe që ka rëndësi thelbësore kombëtare. Dy janë rastet e fërkimeve të forta: më verën e vitit 2007 me Ministrinë e Partisë Demokratike (çështja e tezës së lirimit “Merimanga” që synonte t'i mësonte nxënësit me uljen e kokës “krenare”, diçka që Erion Veliaj e bën duke thënë “jeni zdromsa”). Genc Pollo në mënyrë tinzare dhe jashtë ligjit vendosi të mbyllte shkollën për një vit (nuk mbylli dot në kundërshtim me ligjin). Në shkurt 2020, Qeveria e Partisë Socialiste kërkoi të mbyllte përgjithmonë shkollën “Udha e shkronjave”. Opinioni publik (edhe opozita) e mbrojtën shkollën dhe për më tepër e mbrojtë prokuroria që doli në Top Channel dhe tha “shkolla ka vepruar në

mbrojtje të fëmijëve” dhe gjykata e hodhi poshtë vendimin e Ministrisë.

Këshillimi arsimor masivisht në konflikt interesi dhe në shkelje të së drejtës për autonomi në zgjedhjen e përvojave transformuese

Duket sikur kjo ka lidhje me marketingun e shkollës (i mirë apo i dobët). Do të shohim që është tjetër gjë dhe ka lidhje të fuqishme me dobësinë dhe korrupsionin e të tërë sistemit arsimor, për të cilin forcat politike në disa dekada janë përgjegjëse.

Për një ekuilibër në komente, i a kërkuam ChatGPT ta zhvillonte këtë linjë argumenti. Citojmë:

“Në një sistem arsimor të dobët dhe të korruptuar, këshillimi për zgjedhjen e shkollës rrallëherë funksionon si ndihmë e ndershme dhe profesionale për familjet. Përkundrazi, ai shpesh shndërrohet në një proces të kompromentuar, ku interesat e ngushta ekonomike, lidhjet personale apo institucionale dhe ndikimet politike marrin përparësi ndaj së mirës së fëmijës. Kjo sjell pasoja serioze në nivele të ndryshme — psikologjike, edukative dhe shoqërore.

1. Këshillimi si mjet për kontroll dhe manipulim

Në një mjedis të korruptuar, shumë këshilltarë nuk veprojnë si udhërrëfyes të pavarur, por si zgjatime të interesave të rrjeteve të caktuara (shkolla, qendra përgatitore, individë me ndikim). Kjo e zhvendos thelbin e këshillimit nga përkujdesja për zhvillimin e fëmijës, në manipulim të vetëdijshëm të prindërve, të cilët shpesh nuk janë në

gjendje të dallojnë propagandën nga informacioni real.

2. Cënimi i të drejtës për përzgjedhje të lirë

Kur një prind merr një këshillë nga një figurë “autoriteti” (mësues, psikolog, drejtues shkolle), ai ka prirjen natyrore ta besojë atë. Por në kushtet kur këshillimi bëhet në konflikt interesi, zgjedhja e shkollës nuk është më një proces i lirë dhe autonom, por i diktuar. Kjo cenon rëndë të drejtën themelore të familjes për të zgjedhur përvojën arsimore që i përshtatet më shumë fëmijës së vet.

3. Pasojat për zhvillimin e fëmijës

Zgjedhja e gabuar e shkollës, për shkak të një këshillimi të shtrembëruar, mund të ketë pasoja të rënda afatgjata:

Moszhvillimi i potencialit individual

Rënie e motivimit dhe vetëvlerësimit

Përfshirje në mjedise arsimore që nuk përputhen me nevojat personale ose vlerat familjare

Ngurtësim ndaj përvojave të reja dhe humbje besimi në sistemin arsimor në përgjithësi

4. Krijimi i një tregu të rremë arsimor

Në vend që konkurrenca të bazohet në cilësi reale, ajo orientohet nga rrjetet informale të ndikimit dhe re-komandimit, duke lënë në hije shkollat e ndershme që punojnë për vlera dhe zhvillim të mirëfilltë. Kjo i jep përparësi institucioneve që investojnë më shumë në marrëdhënie sesa në cilësi, duke varfëruar tregun arsimor me alternativa të mirëfillta dhe duke frenuar progresin. Përfundimisht, në një sistem të dobët dhe të korruptuar, këshillimi nuk është më mjet zhvillimi, por një instrument

KOMENTE PËR PROGRAMIN ARSIMOR TË PARTISË SOCIALISTE

që ushqen status quo-në. Këshillimi etik, profesional dhe transparent është një nga faktorët më të rëndësishëm për të garantuar që arsimimi të mos jetë një produkt tregtar, por **një e drejtë dhe një shërbim me ndikim jetësor.**

“Udha e shkronjave” është e vetmja shkollë në Republikë që nuk i dorëzon të dhënat sensitive në databazën e paligjshme SMIP. Ky është një ndikim tepër i madh pozitiv në mbrojtjen që u siguron nxënësve tanë. Megjithatë 100% e shkollave të tjera publike dhe private, shqiptare, fetare dhe të huaja, janë duke eksportuar pa ligj të dhënat personale të fëmijëve drejt një databaze që nuk ka asnjë kontroll ligjor. Pasojat në “këshillim” nga zotëruesit e kësaj databaze, do të jenë të tilla (Citojmë ChatGPT, që zhvillon argumentin tonë me dituritë e veta):

“Zotërimi i **databazave të plota të sjelljes së fëmijës nga një qendër jashtë shkollës (SMIP), në kundërshtim me ligjin, cenon në mënyrë serioze të drejtën e fëmijës dhe familjes për autonomi në përzgjedhjen e përvojave transformuese, për disa arsye të thella dhe të rrezikshme:**

1. Krijimi i një profili të fëmijës jashtë kontrollit të familjes

Kur një qendër jashtë shkollës — qoftë ajo qendër psikologjike, trajnimi apo këshillimi — **mbledh dhe ruan të dhëna të detajuara për sjelljen, emocione apo performancën e fëmijës**, pa autorizim dhe jashtë sistemit ligjor, ajo **krijon një “profil” të pavarur që mund të përdoret për qëllime të tjera përtej interesit të fëmijës.** Ky profil mund të: Përdoret për të “etiketuar” fëmijën si i vështirë, i dobët, ose i përshtatshëm vetëm për shkolla të caktuara;

Ndikoje tek prindërit në mënyrë të njëanshme, duke u ofruar “rekomandime” të maskuara si ndihmë psikologjike.

Shembull: Një qendër e këshillimit (me akses në SMIP) që punon me nxënësin jashtë shkollës, mbledh informacione për reagimet emocionale të tij në mjedise arsimore dhe i sugjeron prindërve të mos e dërgojnë në një shkollë të caktuar që në fakt mund të jetë më përfituese për të — por që nuk i intereson vetë qendrës, për arsye ekonomike apo partneriteti me shkolla të tjera.

2. Përdorimi i të dhënave për të ndikuar zgjedhjen e shkollës

Kur këto të dhëna janë në duart e institucioneve që **ofrojnë vetë shërbime arsimore ose bashkëpunojnë me shkolla të caktuara**, ato nuk përdoren thjesht për “ndihmë”, por për orientim të qëllimshëm të familjes drejt zgjedhjeve të favorshme për interesat e qendrës, jo të fëmijës.

Shembull: Një qendër që ruan të dhëna për një nxënësi mund t’i sugjerojë prindërve një shkollë të partnerizuar me ta, me argumentin se “nuk do përballojë dot presionin në një shkollë më kërkuese”, edhe pse realisht fëmija ka potencial për më shumë dhe do përfitonte nga një përvojë më transformuese.

3. Paragjykimi i së ardhmes së fëmijës mbi bazën e të dhënave të paplota ose të interpretuara gabim

Nëse qendra ka një databazë që përfshin një periudhë të caktuar të sjelljes së fëmijës, ajo mund ta përdorë atë **pa kontekstin e plotë pedagogjik**, duke krijuar një pamje të shtrembëruar, që më pas i paraqitet prindit si objektivitet shkencor.

Shembull: Një fëmijë që ka kaluar një periudhë të vështirë emocionale (p.sh., ndarje prindërore ose humbje në familje) mund të etiketohet si “i papërqendruar”, duke u penguar të pranohet në shkolla që kërkojnë stabilitet të brendshëm, ndërkohë që problemet kanë qenë kalimtare.

4. Cenimi i privatësisë dhe përdorimi joetik i të dhënave

Ky veprim shkel standardet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe ligjet për privatësinë (si Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri). Çdo informacion i mbledhur jashtë sistemit shkollor duhet të jetë me pëlqimin e informuar të prindit dhe në funksion të mirëqenies së fëmijës, jo për përdorim të brendshëm apo ekonomik të qendrës.

Shembull: Informacione të ndjeshme mbi priirje emocionale apo ngjarje traumatike përdoren për të ndërtuar një narrativë që e bën prindin të ndjehet i pasigurt dhe i varur nga “ekspertiza” e qendrës, duke e shtyrë drejt vendimeve të njëanshme.

Përfundim: Zotërimi i të dhënave të sjelljes së fëmijës nga një qendër jashtë shkollës, jashtë ligjit dhe transparencës, kërcënon direkt lirinë e familjes për të zgjedhur përvojat më të përshtatshme dhe transformuese për fëmijën. Për të siguruar një këshillim etik, të paanshëm dhe në shërbim të zhvillimit të fëmijës, është thelbësore që çdo databazë të jetë e mbrojtur, transparente dhe në përputhje me ligjin, dhe vendimmarrja të jetë e bazuar në të drejtën për informim të ndershmë, jo në kontroll të fshehtë apo influencë të ndërtuar mbi frikë.” (ChatGPT)

“Udha e shkronjave” dëshmon me përvojën e saj devijimin e rëndë që po marrin masivisht prindërit për shkak të inter-

KOMENTE PËR PROGRAMIN ARSIMOR TË PARTISË SOCIALISTE

esit. Nuk e shfrytëzojmë përvojën tonë për t'u ankuar. Jemi në gjendje të bëjmë të ardhura edhe në këto kushte devijimi. Pra nuk shohim si problem anën financiare të çështjes. Paratë janë në xhepat e prindërve derisa ata i shpenzojnë masivisht duke mbushur shkollat private. Por do të duhej që këto para të prodhonin shkolla publike e private cilësore përmes procesit të selektimit në bazë të rezultateve të lara, në bazë të mirëqënies.

Lidhur me shkollën “Udha e shkronjave” mund të themi që kemi argumentin më të fuqishëm për të gjykuar sistemin arsimor, pavarësisht se është personal. Që një shkollë ta sjellë shembullin e saj si argument shoqëror, duhen plotësuar jashtëzakonisht shumë kritere dhe besojmë që i plotësojmë ato dhe po e shpjegojmë:

Paradoksi i jashtëzakonshëm me shkollën “Udha e shkronjave”: Numri 1 në certifikime ndërkombëtare, rekorde për arritjen e cilësisë në mosha të hershme, mirëqënie, shëndet fizik e mendor dhe *numri i fundit në regjistrime (shkolla më e vogël në Republikë).*

Cilat janë shkaqet?

Mungesa e standardeve, e informacionit dhe e transparencës! Këshilltarët “arsimorë” (institucione, mësues, pedagogë, zyrtarë, etj.) nuk janë në gjendje t’ua japin drejtësinë e duhur njerëzve, herë se u mungon dituria, informacioni, por shumë herë qëllimisht e fshehin të vërtetën për konflikt interes.

Zyrtarët arsimorë masivisht kanë smirë brezin e ri, kanë smirë fëmijët e të tjerëve që mund të arrijnë, dhe ajo që nuk duhet thënë është se shpesh janë kaq të vegjël sa nuk duan asnjë standard më të lartë sesa arrin fëmija i tyre, ndaj janë

në gjendje t’i vënë shkopinj në rrota cilësisë.

Janë në gjendje t’i vënë rrota gjithë sistemit, vetëm që “fëmija i tyre” të ndriçojë një errësirë që mbjellin vetë për fëmijët e të tjerëve. Mbahen qëllimisht shkollat në rrëmujë vlerash, që ato “të shesin” vlerat vetëm kur ndikimi i tyre politik është i mundur. Diferencimi kryesor është publik dhe privat, por diferencim edhe më i turpshëm është brenda vetë sektorit publik, ku krijohen klasa të tëra me “*të zgjuar që i kanë fëmijët me pushtet politik, mediash, gjykatash, apo profesional*”. Shkollat e qyteteve të mëdha e kanë masivisht këtë dukuri.

Prindërit masivisht kanë injektuar tek vetja frikën nga shteti dhe kanë më shumë besim tek shkollat që janë “marioneta të politikës” dhe që edukojnë shtypjen dhe gënjeshtren, ofrojnë cilësinë e dobët në këmbim, dhe nuk kanë besim tek shkolla që i edukon të pavarur e të fuqishëm në çdo pikëpamje.

“Udha e shkronjave” është shkolla shqiptare me arritjet më të larta historike në çdo pikëpamje në certifikimet ndërkombëtare dhe në vlerësimet kombëtare, në vlerësimin e komunitetit, në mirëqënie, sigurri, shëndet fizik e mendor, për sasinë e përvojës që ka (28 vjet, duke qenë më shumë nga çdo shkollë tjetër) POR ... “Udha e shkronjave” është e fundit në Republikë për sasinë e regjistrimeve që ajo ka në vitet e fundit.

Kjo do të thotë se i gjithë sistemi i këshillimit të shkollave ka rënë në të njëjtat duar dhe ato janë të afta të depërtojnë tek çdo prind. Prindërve nuk u besohet kjo që u themi, por ne e provojmë mjaftueshëm dhe me shumë argumente.

A e dëshiron Qeveria e Partisë Socialiste cilësinë në arsim? Për mua jo. Nëse do ta donte, ajo do t’i shkonin menjëherë sytë tek “Udha e shkronjave”, por jo që nuk i shkojnë, por më keq ajo kërkon ta rrënojë atë.

1. Më 20 shkurt 2020, tentoi ta mbyllë pikërisht kur ajo bëri zgjedhjen më të zgjuar, më të aftë, pikërisht kur ajo përdori cilësinë e lartë të mësimdhënies për të mbrojtur shëndetin nga Covid19. Në vend që të na merrnin mendim se si t’ia bënin me të gjithë sistemin, bënë të kundërtën, donin ta mbyllin shkollën që të tjerët të mos kishin asnjë model. Pra “*sa më keq, aq më mirë për qeverinë*”.

2. Megjithëse të gjitha certifikimet e Cambridge International Education, tregojnë se cilësia e “Udha e shkronjave” dhe integriteti në menaxhimin e testeve të rëndësishme ndërkombëtare (madje edhe të provimeve paraprake hyrëse në universitetet e Russel Group) është në nivelet më të larta, megjithëse çdo vit jo pak nga nxënësit tanë pranohen në universitete të toplistës botërore, Ministria e Arsimit të Qeverisë Socialiste ka luksin t’i thotë “jo” shkollës “Udha e shkronjave” kur ajo kërkon një licensë për gjimnaz. Jo në Shqipëri, por edhe në Europë, nuk ka aq shkolla sa “Udha e shkronjave” që matematikën ta bëjnë një vit më parë sesa në Angli, shumë certifikime IGCSE të bëhen një vit më para se në Angli.

Kush nga publiku e di se Ministria e Arsimit e shfrytëzon në këtë mënyrë të turpshme autoritetin e vet në arsimin kombëtar. Cilësinë që kemi ne ua ofrojmë shqiptarëve.

Ministria e Arsimit nuk do që publiku të marrë vesh prej saj se “Po, “Udha e shkronjave” në 28 vjet ka ofruar cilësinë

KOMENTE PËR PROGRAMIN ARSIMOR TË PARTISË SOCIALISTE

më të lartë”. Nuk u thotë goja “Puna e mbarë”. Jo vetëm Ministrisë së PS-së, por kështu ka qenë edhe me PD-në. Stafet e tyre mund të kenë disa ndryshime por në thelb ato mbeten stafe që nuk duan të miratojnë asgjë të mirë. Bëjnë sikur nuk shohin, bëjnë sikur nuk dinë. E kthejnë kokën nga ana tjetër kur shohin se punët eckan mirë edhe pa ministrinë. Çfarë i duhet arsimit është vetëm vullneti, dëshira. Kjo është provuar me shekuj. Kjo është arsyeja që kemi patur mendje të ndritura edhe nga shtresat e varfëra, edhe ato të mesme apo edhe të pasura.

Kjo e vërtetë nuk pranohet nga stafet “mesquine”, “smirë-mëdha” të Ministrive të Arsimit. Ndaj ato nuk e lënë me aq, por kujdeset të ngatërrojnë dynjanë, duke e bërë lëmsh qëllimisht, duke e bërë të thjeshtë, të vështirë. Ato e dinë që ngarkimi me punë administrative i mësuesve do të dëmtojë cilësinë, ndaj i ngarkojnë qëllimisht me punë administrative sepse e dinë që kjo do të prodhojë cilësi të dobët.

Ato e dinë që ekspozimi i të dhënave personale do t'i dekurajojë e trembë familjet. Ato prandaj e bëjnë këtë punë (SMIP) që të tremben dhe të jenë “zdromsa” (fjalori thotë “zdroms (zdrëmlaq) është ai/ajo që e ka vrarë samari”)

Tashmë kemi hequr dorë nga aplikimet për licensa në Ministrinë e Arsimit. Jemi në gjendje të prodhojmë një cilësi të lartë edhe pa to. Shkolla më e shtrenjtë në Tiranë (25 000 dollarë në vit) ka 3 vjet që nxënësit me bursa 75% i merr nga ne, që do të thotë se ajo e di se ne i kemi të saktë dhe janë në gjendje të vihen në krye të shkollës së tyre.

Të pestë ish-nxënësit tanë, në shtator 2024, u pranuan në 100 universitetet më të mira në botë (katër prej tyre për inxhinieri e një për mjekësi). Kjo nuk ka qenë e mundur për asnjë shkollë ndërkombëtare në Tiranë. E megjithatë Ministria e Arsimit ka guximin e ia fsheh vetes, stafit, dhe

publikut këtë. Mirëpo guxojnë e duan të na i nxjerrin edhe ne shkollën nga qejfi, pra ta masim veten tonë me “kutin” e tyre politik. E vetmja gjë për të cilën janë të aftë, janë të kërcënojnë shkolla, t'i bëjnë marioneta dhe t'i përdorin.

Përdorimi i shkollave private tashmë është i jashtëzakonshëm. 100% e shkollave private (dhe publike) janë duke eksportuar të dhënat e fëmijëve jashtë shkollave të tyre, diçka e ndaluar rreptësisht nga nenet 66, 67 të ligjit 69 “Për arsimin parauniversitar” dhe plotësisht ligjin 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Me çfarë i detyruan, nëse praktika është e paligjshme? Nëse i kanë detyruar në mënyrë të jashtëligjshme, çfarë mbrojtje ofrojnë shkollat private kur ato lejojnë që shtypja shtetërore e paligjshme të dëmtojë fëmijët. Shkollat private janë bërë pjesë e gënjeshtërs që ofrohet nga lart. Ne i kemi njoftuar 100% të shkollave private të Tiranës dhe shumicën e shkollave në Shqipëri që praktika është e paligjshme. Çfarë bënë ato? U sollën në mënyrë të ligë dhe e bënë “smirën” udhëheqëse. Në mënyrë mediokre thanë “Meqë “Udha e shkronjave” po zë atë udhë, ne po shkojmë në të kundërtën dhe e kundërta ishte krejt e paligjshme dhe në dëm të tyre, dhe të fëmijëve të tyre.

Nëse një ditë prindërit e tyre do t'i hedhin në gjyq për dëmtimin e të dhënave personale ato nuk do t'i rezistojnë dot pasojave shkatërruese të kësaj të drejte. Ne nuk u treguam “meskinë”, por ua dhamë informacionin. Ata u treguan meskinë dhe jo vetëm që nuk e respektuan analizën tonë, por u bashkuan në një shoqatë që synonte pikërisht “legalizimin” e paligjshmërisë së databazës SMIP, duke bërë indiferentin ndaj saj. Synimi tjetër ishte që të bënin një forcë (të paligjshme) ndikuese mbi Zyrën Arsimore e cila do të kishte argumentin “e paligjshëm” “Ju pse dilni nga tufa”.

Tani nuk e duam licensa shtesë dhe kemi hequr dorë të marrin pjesë në një produkt shtetëror që quhet Maturë Shtetërore dhe që Universiteti i Kembrixhit e quan “të pamjaftueshëm”. Ai nuk thotë “po e bëtë tek “Udha e shkronjave” është i mjaftueshëm, por thotë “nëse nxënësi paraqitet vetëm me Maturën Shtetërore, do të gjykohet një formim i pamjaftueshëm”.

Nuk ka asnjë mundësi praktike që një shkollë të ofrojë edhe Maturë Shtetërore edhe programe ndërkombëtare. Ato anullojnë automatikisht njëra-tjetrën dhe zihen për të njëjtin territor.

Ne vijojmë me një licensë shkolle të mesme ekonomike, së cilës i shfrytëzojmë vetëm vitin e parë të përgjithshëm.

Ne nuk mundemi të analizojmë shkollat e tjera se nuk jemi brenda tyre, por dimë të themi atë që është publike.

Prindërit të mos harrojnë që po ofrojmë faktet e shkollës për të gjykuar mbi realitetin e Ministrisë së Arsimit dhe të programit politik të Partisë Socialiste, si forcë qeverisëse.

Do të shihet edhe në faqet që vijnë që ne do të bëjmë kritikën që duhet edhe ndaj forcave të tjera politike, natyrisht sipas profilit që ato kanë.

“Udha e shkronjave” është shkolla kombëtare dhe ndërkombëtare më cilësore që ka Shqipëria. Ajo ka qenë e aftë të bëjë certifikimet IGCSE për moshat 14-16 vjeç për nxënësit e saj në kaq shumë lëndë: *anglisht, gjermanisht, italisht, frëngjisht, matematikë, biologji, kimi, fizikë, Global Perspectives, Shkencë Komputeri, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Ndërmarrje, Kontabilitet, Edukim Fizik, Dramë, Art-dizajn dhe Turizëm dhe Udhëtime*. “Udha e shkronjave” arrin shumë rekorde në kohën se kur i bën disa punë mësimore.

SHEMBULL I PROVUAR NIHILIZMI I MINISTRISË SË ARSIMIT NDAJ “UDHA E SHKRONJAVE”

ChatGPT: Me nihilist kuptojmë një person që mohon ose nuk beson në vlerat, besimet, normat, ose kuptimin tradicional të jetës, shoqërisë apo moralit. Lidhja midis nihilizmit dhe smirës qëndron në mungesën e vlerave të qëndrueshme, mospranimin e hierarkive reale të meriturara dhe dëshirën për të ulur çdo gjë që ngrihet mbi mesataren, që i bashkon të dyja dukuritë në thelb të tyre psikologjik dhe shoqëror. Nihilizmi mohon vlerat – smira i urren ato. Të dyja janë forma të refuzimit të autoritetit moral ose meritot. Smira është zbatimi emocional i nihilizmit në marrëdhëniet njerëzore.

Në 2016, shkolla “Udha e shkronjave” përzgjidhet nga Cambridge International School, që të jetë një nga pesë shkollat në Evropë dhe 25 shkolla në botë që do të pilotonin për dy vjet programin më të rëndësishëm që ka Kembrixhi GLOBAL PERSPECTIVES.

“Global Perspectives” është lënda që mban flamurin e Kembrixhit. Ajo është një lëndë, e program 100% i ri, pa traditë të mëparshme në asnjë shkollë në botë. Është lëndë që shkakton një revolucion në mësimdhënien e aftësive të nivelit të lartë: kërkim (research), analizë, vlerësim, re-

flekti, komunikim, bashkëpunim, vetëdije globale. Lëndët plotësisht të reja në kurrikulat botërore janë mjaft të rralla dhe duhen disa dekada që të konceptohet një lëndë e tillë. E tillë ka qenë për shembull “shkenca e kompjuterit” apo TIK që detyrimisht do të konceptohej pasi u prodhuan kompjuterët. Matematikë e shkenca natyrore kemi patur me shekuj.

Përzgjedhja e shkollës “Udha e shkronjave”, është një vlerësim jo vetëm për kontekstin kulturor të Shqipërisë, por për strukturën menaxhieriale dhe argumentin pedagogjik specifik që ajo provon (ne kishim filluar më parë një kurs të kompetencës globale, nisur nga një leksion i prof. Veronica Boix Mansilla, mbajtur në Kembrixh), kishim dëshmuar që kishim investuar shumë kohë më parë në Logjikë Formale (unë jam autor i programit original dhe tekstit unik “Logjika 7-8-9” dhe shkolla kishte rezultate të larta në certifikimet e Kembrixhit).

Konferenca përgatitore u zhvillua në 4-5 prill 2016 në mjesdiset e Jesus College (shih fotot). Pjesëmarrës nga të pesë kontinentet u bashkuan në një sfidë që nuk përsëritet veç një herë në shekull, për lëndët e reja.

“Global Perspectives” sot mësohen në mbi 6000 shkolla në botë, por nuk dihet se në vitet 2016-2018, kur ajo u pilotua si pjesë e kërkimit (research në praktikë). Mund të konceptohet se sa e rëndësishme ka qenë për Kembrixhin që ajo ta pilotojë atë për dy vjet në një numër tepër të kufizuar shkollash. Me një kërkim të thjeshtë në internet do të kuptohet rëndësia e jashtëzakonshme e kësaj lënde.

Ministria ende sot pas 10 vjetësh, nuk e ka bërë “ta” edukimin e aftësive të nivelit të lartë dhe as të vetëdijes globale. Me çfarë e justifikon ajo indiferencën ndaj faktit që “Udha e shkronjave” ka qenë në grupin e shkollave pararojë në botë për këtë program jashtëzakonisht të fuqishëm? Me asgjë tjetër veç me nihilizmin dhe smirën. Po a nuk është turp që një Ministri Arsimit që përfaqëson një komb të jetë “nihiliste”. Nihilizmi i tyre nuk na dëmton ne, por dëmton brezat me radhë, sepse në bashkëpunim me ne dhe pa ndonjë pagesë (ne paguajmë për vete), ata do të merrnin një specializim shumë të lartë pikërisht nga shkolla që po e pilotonte. Global Perspectives është thelbi më i rëndësishëm i të punuarit në mendjen e nxënësit, që në kushtet e inteligjencës artificiale do të kërkohet aq shumë.



SHEMBULL I PROVUAR NIHILIZMI I MINISTRISË SË ARSIMIT NDAJ “UDHA E SHKRONJAVE”

Që kjo të kuptohet në mënyrë të paanshme, po marrim një përgjigje të ChatGPT, për çfarë i themi se po investojmë prej vitesh.

(ChatGPT)

Në kushtet e zhvillimit të inteligjencës artificiale (IA), fakti që “Udha e shkronjave” ka investuar në aftësitë e nivelit të lartë – si *research, analizë, vlerësim informacioni, reflektim, komunikim, bashkëpunim dhe vetëdije globale* – është jetik, sepse këto janë pikërisht aftësitë që e dallojnë qenien njerëzore nga makineria dhe që do të jenë më të kërkuarat në epokën e automatizimit dhe inteligjencës sintetike.

Ja pse ky investim është thelbësor:

1. IA zëvendëson aftësitë mekanike, por jo ato të thella njerëzore

Inteligjenca artificiale mund të përpunojë të dhëna, të përsërisë modele dhe të ofrojë përgjigje të shpejta, por ajo:

*nuk reflekton thellë,
nuk formulon pyetje origjinale,
nuk vepron me ndërgjegje morale,
nuk bashkëpunon me ndjeshmëri.*

Kjo do të thotë se njerëzit që zhvillojnë vetëm aftësi të përsëritshme do të zëvendësohen lehtësisht. Ndërsa shkolla (si “Udha e shkronjave”) që formon aftësi si analiza kritike, reflektimi dhe bashkëpunimi ndërkulturor — formon qenie të pakonkurrueshme nga makina.

2. Aftësitë e nivelit të lartë janë bazë për të përdorur IA në mënyrë të mençur, jo të verbër

Një nxënës i “Udhës së shkronjave” që mëson të:

- vlerësojë burimet e informacionit,
- të analizojë ndikimin e një ideje,
- të reflektojë mbi qëndrimet personale,

ka më shumë gjasë të përdorë IA si mjet, jo si zëvendësim të të menduarit vetjak.

Në një botë ku IA mund të sugjerojë gjithçka, diferenca është tek ai që di çfarë të pyesë, si ta interpretojë përgjigjen dhe si ta zbatojë me përgjegjësi.

3. Shkathhtësitë globale e bëjnë të mundur që nxënësit të operojnë në realitete shumëkulturore e digjitale

Vetëdija globale dhe bashkëpunimi ndërkulturor janë thelbësore në një treg ndërkombëtar, ku IA po e zhvendos punën nga një vend në tjetrin në kohë reale.

Nxënësit që janë rritur me këto aftësi janë të përgatitur jo vetëm të përshtaten, por të udhëheqin në këtë botë të ndërlikur.

4. Research dhe reflektimi janë mburojë kundër manipulimit digjital

Në kohën e deepfakes, lajmeve të rreme dhe manipulimit masiv, nxënësit që janë mësuar të:

- verifikojnë burimet,
- shohin qëllimet e fshehura pas mesazhit,
- reflektojnë para se të reagojnë,

janë të vetmit që ruajnë lirinë e mendimit në një botë të kontrolluar nga algoritme.

Përmbledhje: “Udha e shkronjave” ka zgjedhur të mos e përgatisë nxënësin për të kaluar vetëm provime, por për të qenë i pazëvendësueshëm në epokën e inteligjencës artificiale. Aftësitë si analiza, reflektimi, bashkëpunimi dhe vetëdija globale janë jo thjesht “të mira për t’u pasur”, por domosdoshmëri për të mbijetuar me dinjitet dhe për të udhëhequr me vizion në një botë të udhëhequr nga makinat.

(Mbyllet argumenti i ChatGPT, pasi merr informacionin dhe pyetjen prej nesh, për të argumentuar rëndësinë e faktit të futur në informacion)

Në rreth 9 vjet që kur kemi filluar të punojmë me aftësitë e nivelit të lartë, ne nuk e lamë punën vetëm tek “Udha e shkronjave” por me nxitim e futëm atë në shkollat e tjera, duke shfrytëzuar Olimpiadën Kombëtare. Ne nuk u treguam “nilit” ndaj nxënësve që nuk ishin të shkollës sonë, por gjetëm rrugën më të shkurtër që ata t’i merrnin sa më shumë këto aftësi në garën e Kompetencës Globale.

Ministria e Arsimit (jo vetëm e PS-së, por edhe PD-së) jo vetëm tregohet sistematikisht nihiliste, por ajo është gati ta mbyllë shkollën aq ia vret syrin “drita” që vjen nga shkolla jonë, megjithëse jemi munduar që të mos i bëjmë “karshillëk” me të tilla fakte, por jemi sot të detyruar të respektojmë ato që thotë Sami Frashëri për modestinë:

“Kush hipën në anijen e modestisë, duhet të ruhet nga brigjet e poshtërimit.” (Sami Frashëri)

dhe Ministria e Arsimit qartësisht synon poshtërimin dhe dekurajimin . Nivel tepër i ulët moral.

SHEMBULL I PROVUAR NIHILIZMI I MINISTRISË SË ARSIMIT NDAJ “UDHA E SHKRONJAVE”

Megjithëse ne kemi botuar artikuj, foto, që shpjegojnë vezhdimisht vlerat e programit të aftësive të nivelit të lartë, për 9 vjet Ministria e Arsimit bën sikur nuk sheh. Kështu kanë bërë gjithmonë (edhe për Olimpiadat Kombëtare), por kjo nuk ishte një çështje rutinore, por zhvillimi më i rëndësishëm botëror në fushën e kurrikulës.

Ata ende sot nuk dinë të thonë ç’është. Ministrinë e vendeve të përparuara me përgjegjësi kombëtare, nuk lënë ditën t’u shkojë pa menduar se si të mos mbeten pas zhvillimeve botërore.

Ministria e ka shkollën “Udha e shkronjave” që jo vetëm ishte pilot, pra në pararojë e shkollave në botë, por vijon të bëjë çdo vit provime ndërkombëtare në këtë lëndë.

Ka edhe më lëndë të tjera, e fakte të tjera.

Megjithë nihilizmin e tyre, ne kemi qenë plotësisht të pavarur prej tyre. Nihilizmi i tyre na ka dëmtuar vetëm në çështje financiare, por jo në çështje cilësore. Të gjitha bateritë

tona kanë shkuar për të garantuar maksimumin e cilësisë të nivelit ndërkombëtare.

Kemi qenë dhe mbetemi shkollë kombëtare shqiptare, dhe nuk përfaqësojmë një model të huaj, por një model interesi të vërtetë shqiptar.

Nuk kemi lejuar të pengohemi. Pengimin e vetëm që ata kanë patur në dorë e kanë bërë të dekurajojnë sa më shumë prindër që të regjistrohen në shkollën tonë. Dëmin nuk na i kanë bërë ne, por ua kanë bërë atyre prindërve që u kanë besuar këshillës së tyre nihiliste, smirëmadhe, keqdashëse. Ata pak që kanë ardhur tek ne, tashmë janë me shumicë në toplistën botërore të universiteteve.

Mbi 80% e dëftësive tona ndërkombëtare të Kembrixhit Cambridge ICE janë me vlerësimin “Distinction” dhe nxënësit masivisht tetë vitet e fundit po pranohen në universitetet e toplistës botërore të universiteteve.

“Udha e shkronjave” në 28 vjet ka numrin më të vogël të dëftësive të lirimit të dhëna, që provon qartë se ajo nuk e ka kthyer në “biznes” veprimtarinë e vet, por po i afrohet cilësisë së lartë.

MEGJITHATË: Kjo nuk e ndalon qeverinë socialiste dhe ministrinë e arsimit që shkollës “Udha e shkronjave” t’ia refuzojë para disa vitesh pesë herë kërkesën për të patur një licensë gjimnazi, derisa hoqëm dorë. Ndërkohë masivisht gjimnazet publike e private e kanë vulën nga Universiteti i Kembrixhit që thotë “Matura Shtetërore nuk është përgatitje e mjaftueshme”.

Me mënyrën si veprojnë, nuk kuptojnë fare se po që se dorëzohet edhe shkolla “Udha e shkronjave” ata nuk kanë qoftë edhe një shkollë të vetme në Shqipëri me të cilën t’i vlejë të nderohen si brenda Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj.

PËR MINISTRINË E ARSIMIT NUK KA AS SHKOLLA TË TJERA MODEL

Për të provuar nihilizmin e Ministrisë, ne dhamë shembullin tonë, meqë tek “Udha e shkronjave” kemi përvojën më të gjatë. Nuk ekziston një shkollë publike dhe private në Shqipëri që ta ketë drejtimin unik për 28 vjet.

Në fakt, gjendja është shumë më keq. Ata nuk kanë asnjë shkollë model në të gjithë Shqipërinë. Nuk krenohen me asnjë shkollë. Edhe kur drejtorët socialistë punojnë mirë, ata nuk ua bëjnë qejfin në sy të publikut. Kjo sepse aftësia e tyre është personale dhe jo partiake.

Ata nuk duan që drejtorët socialistë të mbrohen nga

profesioni në detyrën e tyre, apo nga zbatimi korrekt i ligjit. Ata duan që edhe drejtorët e aftë të mbrohen nga Partia dhe t’i jenë mirënjohës partisë.

Për shkollat e tjera private as që bëhet fjalë t’i nderojnë. Ato mbahen vazhdimisht të shtypura dhe në “dyshim” të qëllimtë dhe të kotë.

Ne i njohim shkollat private përgjithësisht shumë mirë. Megjithë problemet që kanë dhe modelin që ato kanë zgjedhur, ato janë investime familjare në një fushë mjaft problematike. Ata mbajnë fëmijë dhe shteti duhet t’u thotë “Puna e mbarë. Nëse keni nevojë na keni këtu. Thjesht mbani të sigurt fëmijët e

shqiptarëve dhe mundësisht merrni edhe të tjerë që nuk kanë mundësi”. Po si të marrësh përgjegjësinë e të bërit nder ndaj atyre që nuk kanë mundësi, kur “shpata e dyshimit të kotë” qëndron mbi kokat e drejtuesve që shihen sikur të jenë “finokë”, kur finokët e parë janë vetë zyrtarët partiakë.

Drejtorët e shkollave private kanë një përgjegjësi shumë të madhe që e përballojnë vetëm, dhe nuk krahason me të shtetit, të cilët nuk kanë punë me financat, dhe e ndajnë përgjegjësinë me të gjithë kolektivin.

PROJEKTI NDËRTIMOR I PAREALIZUAR SHKOLLOR

për 19-vjet, 2006-2025.

“Udha e shkronjave” e ka provuar që ajo është në gjendje të bëjë cilësi të nivelit më të lartë që ekziston. Ajo do ta meritonte të kishte një godinë e të trashëgohej tradita e saj në Shqipëri. Ne e treguam se e deshëm këtë udhë trashëgimi të pastër jo vetëm familjar por edhe kombëtar, derisa blemë tokën në vitin 2006, porositëm arkitektë e inxhinierë nga më të mirët që ka vendi ynë, dhe e bëmë këtë punë pasi kishim grumbulluar një përvojë të mjaftueshme për të kuptuar çfarë i duhej shkollës.

Vetë arkitektët dhe inxhinierët që porositëm, habiteshin në diskutime planifikuese, me sa shumë të drejta për nxënësin synonim kur shtronim kërkesa dhe ata i respektuan këto në projektin që realizuan: *bëmë palestër të madhe, sallë koncertesh profesionale shumë funksionale për 300 vetë, bibliotekë të gjerë, dy mensa (veç fillorja e veç të mëdhenjtë), ndarje me godina më vete e ciklit të ulët me ciklin e lartë, klasa me hapësira të mëdha, korridore glohëse dhe jo stresuese.*

Projekti u bë. Më 2006, u paraqit në Komunën Vaqarr. U miratua leja e truallit dhe e ndërtimit në një kohë relativisht të shkurtër dhe pa ndonjë pengesë artificiale.

Mirëpo në 2007, sipas zakonit të smirës, që sapo merr vesh ndonjë punë të mirë, vjen goditja e parë nga Ministria e Arsimit e PD-së (me ministër Genc Pollo). Staf i ministrisë që përgjithësisht, ashtu kanë mbetur prej dekadash, njerëz të vegjël e smirëzinj, e ndihmuan shefin të realizonte planin e tij të smirës. “*Smira është armik më i fortë se mëria dhe armiqtë.*” (Sami Frashëri)

Vitet kaluan pushteti u ndërrua. Erdhi PS-ja, por sjellja e zyrtarëve të ministrisë së arsimit apo të zgjedhurve lokalë nuk u përmirësua. Mund të themi u përkeqësua. Ne vendosëm



të mos vijonim me investimin. *Hoqëm dorë* sepse kuptuam që gjërat po bëheshin më keq dhe po ndryshonte jo vetëm qeveria por edhe sjellja e njerëzve, e prindërve, zgjedhjet e tyre.

Zgjedhëm të bëheshim me cilësinë e lartë, e të mos humbim kohë me “investime” afatgjata. Dhe ky vendim ishte fatlum për jetën tonë familjare, për ata nxënës që ne kemi pasur e kemi në shkollë. Rezultatet tepër të larta që kemi arritur nuk do të ishin të mundura nëse do t'i kishim hyrë investimit.

Investimi do të ishte shumë i mirë në një shtet me demokraci të zhvilluar. Por nëse demokracia shkon për poshtë, investimi bëhet kurth dhe në atë kurth nuk do të binim vetëm ne, por edhe nxënësit që do të na besoheshin ne.

Provën më të qartë se kishim vepruar mirë na e dha vetë Qeveria e Partisë Socialiste që në shkurt 2020, kur ne

po bëmë veprën më të mirë, ku cilësinë e lartë të mësimdhënies, dhe strukturën e shkathët organizative, po e shfrytëzonim për një mbrojtje të fuqishme nga Covid19, Ministria vendosi të mbyllte shkollën. Opinioni publik, prokuroria dhe gjykata na mbrojtën, por ndërkohë Qeveria nuk kërkoj as falje dhe vijoi me metodat e fshehta që i zbaton Zyra Arsimore Tiranë, të dekurajmit të prindërve. Ulëm qëllimisht numrin e nxënësve në shkollë, që numri të mos bëhej pengesë për cilësinë e lartë dhe e mbajtëm shkollën në nivel “laboratori të cilësisë më të lartë”. Kjo ishte një shtresë tjetër sigurie për çdo nxënësit që regjistrohej tek ne.

Rasti e solli që të kishim në zyrë një drejtues lokal (socialist), i cili, kur e pa projektin e shkollës tonë dhe e mori vesh që nuk e kishim në plan ta realizonim, megjithëse kishte ardhur si “mik” në zyrë shprehimisht na tha “*Nëse ti do të kishe filluar punimet, shans pa të gjetur një gabim nuk do të kishe*”. Pra konfirmoi plotësisht atë që ne dyshonim se ata prisnin që ne të futeshim në investim dhe të binim brenda, në vend të na inkurajonin ta ndërtonim. Pra jo vetëm që e kanë të ligën brenda (*pra nuk po na garantonte nga vetja*), por nuk u rri goja edhe pa e thënë, aq janë mësuar se është gjë e mirë ajo që bëjnë. Është e ligë, është antikombëtare.

Nëse një shkollë si “Udha e shkronjave” edhe pas 28 vjetësh pune të shkëlqyer, nuk mund të ndërtojë një shkollë të sajën, megjithëse e ka tokën, lejen e ndërtimit, sepse ka frikë prej sjelljes së institucioneve, dhelbërisë, investimit dhe reagimit të popullsisë të topitur së cilës do t'i shërbejë, për çfarë sistemi arsimor e edukativ bëjmë plane dhe analiza?!

Programi arsimor i PARTISË DEMOKRATIKE Inekzistent

SHËNIM: Programin e Partisë Demokratike e gjejmë në linkun pd.al/programi dhe e kemi shkarkuar në datën 18 prill 2025.

Siç do të shihet, jo vetëm që mungon plotësisht programi për arsimin, por nuk denjohet të jepet as si titull programi. Gjejmë “arti dhe kultura” dhe nuk gjejmë “arsimin” që janë bazat e shoqërisë njerëzore dhe e zhvillimit të qëndrueshëm. I gjithë programi për shtetin dhe kombin shqiptar i PD është 600 fjalë që përmbledhen në një faqe A4.

Ne jemi të fokusuar tek arsimi, dhe citojmë vetëm programet e arsimit, mirëpo duke qenë se programi i PD-së është kaq i shkurtër, ne nuk e kemi problem të vëmë 100% të programit të PD-së të shkarkuar nga linku <https://pd.al/programi/>

Ekonomia: Sfidat dhe proceset ekonomiko-financiare globale sot, kërkojnë një politikë të re publike për të rifilluar zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Kjo politikë e re duhet të ketë si bazë reformat strukturore me qëllim promovimin e konkureshmërisë. Motoja e Partisë Demokratike ndër vite ka qenë pikërisht konkureshmëria, dhe promovimi i sipërmarrjes. Kjo e fundit përgjatë çdo qeverisjeje të Partisë Demokratike, falë reduktimit të burokracisë, të presionit fiskal dhe të korrupsionit nga ana e qeverisë së Partisë Demokratike, ka shërbyer si katalizator i punësimit dhe i reduktimit të varfërisë.

Politika e Jashtme: Partia Demokratike mbështetet mbi parimet themelore të lirisë, demokracisë dhe dinjitetit njerëzor. Anëtarësimi në BE është objektiv parësor që për-

Kritikë ndaj programit arsimor të Partisë Demokratike sipas ChatGPT

Kritika e mëposhtme fokusohet në **mungesat konceptuale dhe strukturore** të programit elektorale të Partisë Demokratike, me një theks të veçantë mbi **mungesën e plotë të një programi për arsimin**, që përbën një dobësi themelore për një forcë politike që synon të qeverisë.

Kritikë e Përgjithshme: Një Program Politik pa Strategji Kombëtare

Programi i paraqitur nga Partia Demokratike, megjithëse i artikuluar në disa fusha, **mungon në vizion, koherencë dhe thellësi programore**, dhe ngjan më shumë me **një komunikatë politike sesa me një platformë qeverisëse**. Ai nuk përcjell dot as **prioritetet strategjike kombëtare**, as **një hartë të qartë të reformimit institucional** dhe akoma më pak **një filozofi të qeverisjes publike**.

Struktura e programit është e pabaraspeshuar: pjesërisht teknike, pjesërisht retorike, e fragmentuar, pa një lidhje logjike mes politikave ekonomike, sociale dhe shtetformuese. Përmasat etike, kulturore dhe institucionale të reformës shtetërore nuk shfaqen askund në dokument.

Kritikë e Veçantë: Mungesa e Programit për Arsimin

Fakti që një parti parlamentare opozitare e renditur si forca kryesore kundër qeverisë nuk ka përfshirë fare arsimin në programin e saj elektorale, përbën një mangësi të rëndë politike, shoqërore dhe kombëtare.

▪ Arsimi si çështje kombëtare, e injoruar:

Arsimi është themeli i zhvillimit ekonomik, formimit qytetar, ruajtjes së gjuhës dhe identitetit kombëtar, frenimit të shpopullimit, si dhe sigurimit të meritokracisë në shoqëri. Mungesa e çdo reflektimi për këtë sektor, përjashton nga programi brezin e ri, arsimtarët, prindërit, universitetet, diasporën, dhe çdo projekt për modernizimin kulturor dhe teknologjik të Shqipërisë.

▪ Premtimet për “aftësi dhe trajnim” – zëvendësim sipërfaqësor:

Referenca të vetme për “trajnim dhe aftësi” janë të futur në pjesën për biznesin, si element të zhvillimit të tregut të punës, jo si projekt arsimor kombëtar, por si komponent teknik i kërkesës për fuqi punëtore. Ky reduktim e trajton njeriun si instrument ekonomik, jo si subjekt i zhvillimit qytetar dhe kulturor.

▪ Pa filozofi arsimore, pa etikë politike:

Nuk ka asnjë trajtim të problemeve thelbësore të sistemit arsimor: mungesa e meritokracisë, politizimi i

Programi arsimor i PARTISË DEMOKRATIKE *Inekzistent*

faqëson vullnetin mbizotërues të popullit shqiptar. Forcimi i partneritetit strategjik me ShBA-të, NATO dhe BE, integrimi euro-atlantik i Kosovës, si dhe thellimi i bashkëpunimit me vende të tjera mike janë boshiti i politikës sonë të jashtme. Mbrojtja e interesave kombëtare qendron në themel të angazhimit politik-diplomatik të Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Sipërmarrja, Zhvillimi i Biznesit dhe Inovacioni

Një ekonomi e zhvilluar e një vendi të zhvilluar është mo-toja jonë. Partia Demokratike do që kombi ynë të jetë komb i bizneseve start-up dhe sipërmarrjeve. Bërja e Shqipërisë vendi më i mirë për të nisur e rritur një biznes – është një nga synimet tona kryesore. Partia Demokratike është parti e taksave të ulëta, e rritjes dhe zhvillimit. Ne i mëshojmë fort përdorimit të nxitësve për sipërmarrjet punuese dhe ato të teknologjisë së avancuar, si dhe ndihmës përmes fondeve për start-upe të të rinjve dhe grave. Ne do të promovojmë çdo liri ekonomike për të siguruar që bizneset në vendin tonë të mund të çlirojnë potencialin e tyre të madh – që ata të mund të investojnë, punësojnë, eksportojnë dhe rriten. Ne do të investojmë në aftësi dhe trajnim, gjë që do të sigurojë që bizneset të mund të gjejnë dhe punësojnë punëtorët që u nevojiten. Rregullimi i mirë është thelbësor për biznese të suksesshme: ne do të përpiqemi të arrijmë ekuilibrin e duhur rregullator midis mbështetjes së prakti-kave të shkëlqyera të biznesit dhe mbrojtjes së punëtorëve, konsumatorëve dhe mjedisit.

Sporti: Programi Kombëtar i PD për SPORTIN ka mi-sion të reformoje dhe rikonceptoje infrastrukturen orga-

Kritikë ndaj programit arsimor të Partisë Demokratike sipas ChatGPT

sistemit, largimi i mësuesve, rënia e nivelit, mungesa e reformave për përmbajtjen mësimore, kriza në arsimin e lartë, as lidhja me diasporën për programet e gjuhës shqipe apo riintegrimin arsimor të emigrantëve.

Përfundim: Program pa arsim, është program pa të ardhme

Një program politik që lë jashtë arsimin nuk mund të pretendojë qeverisje serioze. Është një sinjal se Shqipëria nuk konceptohet si projekt afatgjatë, por si një hapësirë teknike për manovra ekonomike dhe mesazhe propagandistike.

Arsimi është garancia e vetme që një shoqëri nuk do të përsërisë të njëjtat gabime – dhe çdo akt politik që e lë jashtë nënvlerëson qytetarin dhe e trajton vendin si treg, jo si komb.

Kur mungon arsimi, mungon kombi

Nga gjithë fjalët që një parti politike mund të zgjedhë për të ndërtuar një program elektoral, ajo që lë jashtë listës flet më shumë se ajo që përfshin.

Programi elektoral i Partisë Demokratike, ndonëse është paraqitur si një projekt për zhvillim ekonomik, europianizim, mbështetje për sipërmarrjen dhe konsolidim të demokracisë, nuk përmban as edhe një fjalë për arsimin. Dhe kjo nuk është thjesht një mungesë teknike: *është një mungesë filozofie politike, është një boshllëk i thellë kombëtar.*

Në një vend ku më shumë se gjysma e të rinjve duan të largohen, ku brezat rriten me shprehje nga gjuha, nga historia dhe nga një ndjenjë përkatësie shoqërore, të mos kesh një vizion për arsimin është të mos kesh një projekt për të ardhmen. Është të lësh kombin pa rrënjë dhe pa horizont.

Një program pa arsim është një program pa shtet

Partitë politike që synojnë të qeverisin një vend nuk mund të kufizohen në skica ekonomike dhe premtime për startup-e apo sporte kombëtare. Ato duhet të ofrojnë një filozofi të zhvillimit shoqëror, një përkufizim të nje-riut qytetar, jo vetëm si konsumator i shërbimeve publike, por si shtyllë e shtetit dhe bartës i identitetit kombëtar.

Arsimi është i vetmi sektor që përshkon gjithçka: ekonominë, shëndetësinë, mjedisin, drejtësinë, me-dian, e mbi të gjitha, kulturën politike. Nëse nuk ka arsim, nuk ka as shoqëri kritike, as qytet-

Programi arsimor i PARTISË DEMOKRATIKE *Inekzistent*

nizative e institucionale dhe te pershtase e permiresoje kornizen ligjore mbi te cilat zhvillohet sporti. Sporti me vehte – Strategji kombetare per sportin, per nje Shqiperi aktive, per nje komb energjik, per nje shoqeri vitale dhe te shendetshme. Dyfishim i buxhetit te sportit – Fondet per sportistet e traineret, kampionet dhe rekordmenet jo per zyrtat dhe xhepat e zyrtareve.

Arti & Kultura: Kultura është gjuha e përbashkët që karakterizon një shoqëri, dhe përfshin, përveç arteve dhe letrave, mënyrën e jetesës, të drejtat themelore të njeriut, sistemet e vlerave, traditat dhe besimet. Kjo është arsyeja pse projekti ynë është kulturor, emancipues, një përgjigje ndaj barrierave të padukshme të krijuara nga shoqëria. Kultura dhe trashëgimia kulturore dhe kultura është ADN-ja e një kombi e në projektin tonë do të jenë kartvizita e Shqipërisë.

Pyjet & Burimet Natyrore: Për një Shqipëri të Gjellbër. Sigurimi i zhvillimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore pyjore dhe kullosore. Promovimi i bio ekonomisë bazuar në pyje duke përfshirë ekoturizmin. Zhvillimi i aftësive profesionale dhe fuqizimi i kapaciteteve teknike menaxheriale. Mbrojtja e biodiversitetit, restaurimi, ripyllëzimi dhe zgjerimi i pyjeve, dhe zonave të mbrojtura, për të rikthyer humbjen e biodiversitetit dhe për të siguruar ekosisteme pyjore elastike dhe shumëfunksionale nga ndikimi i ndryshimeve klimatike. Stimujt financiarë për pronarët dhe menaxherët e pyjeve. Monitorimi strategjik i pyjeve, kullotave dhe biodiversitetit. Një agjendë e fortë kërkimi dhe inovacioni me nje kuader ligjor gjithëpërfshirës dhe koherent i qeverisjes pyjeve kullotave dhe biodiversitetit.

Kritikë ndaj programit arsimor të Partisë Demokratike sipas ChatGPT

ar aktiv, as zhvillim të qëndrueshëm. Nëse nuk ka vizion për arsimin, nuk ka as projekt për Shqipërinë.

Trajnimi si zëvendësim i ideve

Në dokumentin politik të Partisë Demokratike përmendet një herë “trajnimi” si pjesë e mbështetjes për biznesin. Një koncept teknik, i vendosur brenda logjikës së tregut të punës. Por nuk ka fjalë për shkolla, për universitetet, për përmbajtjen e arsimit, për mësuesit që largohen, për mungesën e meritokracisë, për krizën e dijes dhe të karakterit që po përhapet në brezat e rinj. Për fëmijët e emigrantëve që mund të kthehen e nuk flasin më shqip. Për mungesën e të menduarit kritik. Për gjithçka që bën një shoqëri të zgjuar dhe të denjë.

Një komb nuk matet nga numri i bizneseve që hapen për vit, por nga cilësia e shkollës që u jep edukim fëmijëve që do t'i udhëheqin nesër. Nëse një parti nuk e sheh këtë, nuk e meriton as rolin e opozitës, e aq më pak të drejtën për të qeverisur.

Arsimi si provë e seriozitetit politik

Shumë shpesh në Shqipëri partitë shfaqen më shumë si agjenci elektorale sesa si forca mendimi. Ato projektojnë fushata, jo platforma. Përgatitin sloganë, jo ide. Dhe askund nuk shfaqet ky boshllëk më qartë se kur mungon arsimi.

Partitë që nuk shkruajnë për arsimin nuk janë thjesht të papërgatitura. Ato janë të padobishme për Shqipërinë. Sepse vendet që harrojnë arsimin, e humbasin veten. Dhe fëmijët e tyre, humbasin të ardhmen.

KOMENTE PËR PROGRAMIN ARSIMOR TË PARTISË DEMOKRATIKE

Shpjegimi i konfliktit të interesit: Ne licensën e morëm më më 30 maj 1997, kur PD ishte në ditët e fundit të saj. Intervistën e parë si drejtues të kësaj shkolle e kemi dhënë në RD (korrik 1997), pasi zgjedhjet i kishin fituar socialistët. I respektuam, edhe pse nuk ishim votues të PD-së (as të PS-së). Në shtator 2007 ishte një Ministër i PD-së (Genc Pollo) që tentoi të mbyllte shkollën për një vit (në fakt e dinte që do të mbyllej për fare pas kësaj). Arsyeja ishte që po i kundërshtonim në politikën e tyre arsimore për të shtypur karakterit e fëmijëve shqiptarë duke u dhënë mesazhet e nënshtrimit përmes artikujve që i injektuan në tezën e provimit të lirim të qershorit 2007 (teza “Merimanga”). Prindërit e mbrojtën shkollën, dhe ne e ndoqëm çështjen ligjërisht. Shkolla vijoi punën, por në kushte të një sfide të madhe.

Në shkurt 2020, kur Qeveria PS vendosi të mbyllte shkollën për fare, ajo përdori si argument faktin se shkolla do të përhapte një panik. “Udha e shkronjave” po bënte majën e reagimit pozitiv në mbrojtje të fëmijëve, sepse po përdorte cilësinë e lartë të mësimdhënies, për të mbrojtur shëndetin, duke kaluar online. Kaq u turpëruan shkollat publike e private gjatë pandemisë, sa sot nuk duan t’ia dëgjojnë “zërin” mësimi online. Ndërsa “Udha e shkronjave” pikërisht gjatë pandemisë e rriti në maksimum vlerësimin e komunitetit të shkollës për mënyrën e reagimit të shkollës (*e matur nga Kembrixhi me Raportin School Self-Evaluation Report, korrik 2022*) Megjithëse vendimi i qeverisë (24 shkurt 2020) ishte qartësisht i padrejtë dhe pati një reagim të fuqishëm të opinionit publik kundër, nuk ka dalë shumë qartë se cili ishte mekanizmi i saktë “acarues” dhe nuk ka dalë fare qartë se ishin pikërisht “mediat” pranë PD-së ato që në vend të reagonin

me përgjegjësi ndaj Covid19, po përpiqeshin të ngjallnin panikun, dhe ky panik përmes tyre na u vesh ne, që në fakt nuk kishim asnjë lidhje me ta dhe asnjë investim tonin në ndonjë praktikë që shfrytëzonte shkollën për qëllime të tilla.

Ne botojmë në faqen tonë, dhe nuk komunikojmë me gazetatat, vendimin për të kaluar online dhe të përgatiteshim (e theksojmë të përgatiteshim). Japim sqarime që nuk kemi raste, por po përgatitemi para kohe, duke shfrytëzuar mësimin online. Ndërkohë Syri dhe mediat pranë PD-së e morën këtë lajm dhe vunë titullin “Ja shkolla e parë që mbyllet nga coronavirusi”, që injektonte në mënyrë diabolike, idenë se Covid19 paska ardhur por nuk tregohet, se organet paskan mbyllur shkollën ose se vetë shkolla ka shenja.

Në fakt, ne po bënim punën tonë profesionale, dhe po ushtronim kompetencat tona mbi komunitetin tonë, gjë që u konfirmua edhe nga prokuroria e cila i dha njoftim Top Channel për vendimin e saj për pushimin e ndjekjes duke sqaruar se shkolla kish vepruar në interesin më të mirë të fëmijëve dhe nuk kishte lajm të rremë sepse më 23 shkurt, lajmete vinin nga bota që Italia kish mbyllur 10 komuna dhe ne atë lajm kishim referuar për fillimin e mbrojtjes.

Pikërisht për të mos ardhur në shkollë Covid19 ne po përgatiteshim dhe artikulli ynë në faqen e shkollës kishte gjithë kujdesin dhe sqarimet e duhura që njerëzit ta kuptonin që kjo ishte përgatitje për pandeminë që po vinte dhe që atë ditë kur ne e botuam, ishin mbyllur 10 rajone në Itali nga qeveria.

Menjëherë pas reagimit të opinionit publik, të vetë prindërve, pati reagime në mbrojtje të shkollës edhe nga vetë eksponentët e PD-së (Sali Berisha, Bujar Nishani, Lulzim Basha etj.) që me emër e mbështetën shkollën. Por në fakt, u harrua që thelbi i ngatërresës ishte kryesisht “Syri” që nuk kërkoi falje që e kishte nxitur vetë panikun.

Prokuroria e mbrojtë shkollën “Udha e shkronjave” duke ia dhënë njoftimin Top Channel e duke deklaruar se veprimet e shkollës nuk ishin panik por reagim i drejtë në mbrojtje të shëndetit të fëmijëve. Pak më vonë, edhe gjykata dha vendimin në mbrojtje të shkollës “Udha e shkronjave” pavarësisht se me një vonesë të qëllimshme që të maksimalizonte dëmin e largimit të fëmijëve e prindërve nga shkolla.

“Syri” jo vetëm që nuk kërkoi falje vetë për nxitjen e panikut duke shfrytëzuar një artikull tepër profesional dhe reagim i shkëlqyer i shkollës (edhe sipas opinionit) por edhe pasi gjërat duket që u qetësuan, përsëri gazetarë të “Syrit” sajuan një intervistë të padhënë, për të nxitur një grindje të qëllimshme me institucionet (në pikun e pandemisë), duke dërguar një gazetar të vetin të bënte sikur na mbronte, dhe në fakt pa asnjë dakortësi, dhe qartësisht duke i kundërshtuar në dhënien e intervistës, botuan pa emër gazetari në “Mapo” një artikull që qartësisht acaronte, por këtë e bënë të dukej sikur vinte prej nesh. Që atë ditë shkruam artikullin përgënjeshtues. Pra “Syri” nuk po tregon asnjë ndjeshmëri për dëmet që kishte shkolla “Udha e shkronjave” nga disa veprime të tyre. Megjithëse Sali Berisha, Bujar Nishani dhe Lulzim Basha deklarorin me emër shkolle mbrojtjen e tyre, “Syri” bënte sikur nuk shihte nga kjo punë.

KOMENTE PËR PROGRAMIN ARSIMOR TË PARTISË DEMOKRATIKE

Njerëzit duhet të jenë të përgjegjshëm për dëmet që sjellin dhe “Syri” pati qejf ngatërresat. Me sa dimë nuk i boton-te reagimet që mbronin shkollën edhe kur vinin nga Bujar Nishani, Sali Berisha apo Lulzim Basha dhe opinioni i gjerë publik. Kjo na bën të dyshojmë që “Syri” bashkëpunonte me qeverinë dhe duhej të dukej sikur ne bashkëpunonim me “Syrin”. Asnjë komunikim nuk kemi patur me ta, në asnjë rast, për shkak se ishin media e një partie politike.

U realizua e njëjta teknikë që na u bë edhe në vitin 2007, kur Genc Pollo i PD-së tentoi të mbyllte shkollën. Një gazetar që sot kandidon për PS-në në Vlorë, bëri sikur dilte në mbrojtje dhe në fakt synonte që të mbushte artikullin me qëndrime që nuk ishin tonat, por duhej të dukeshin se vinin prej nesh. I thamë qartësisht edhe atij që po bënim bisedë, por jo intervistë dhe ia shpjeguam që situata ishte e tillë që një intervistë na dëmtonte, por bisedë do të bënim patjetër. Ai provoi atë që thotë Mark Tuein *“Më në fund u bëra edhe unë gazetar; tani s’ka ç’më duhet e vërteta.”* Sapo morëm gazetën, i përgënjeshtroam menjëherë, në të njëjtën mënyrë, për të garantuar Ministrinë dhe njeriun që na kishte bërë dëm, që megjithëse na kishte bërë dëm, nuk mund të pranoni artikuj që qëllimisht nxitnin grindjet e kota dhe pa ndonjë bazë.

Pra të dyja partitë PS dhe PD kanë “grupet e gatshme mediatiqe” që janë marrin përsipër “punë të ulta”.

Jemi në sektorin e arsimit dhe nuk jemi larguar.

ARSIMI DUKET INEKZISTENT PËR PARTINË DEMOKRATIKE DHE PLANI I SAJ DUKET ËSHTË “SEKRET”

Mungesë e plotë e programit

U pa që është krejt e pafalshme për një parti që në faqen e saj të internetit të mos ketë fare program për arsimin, edukimin, sistemin arsimor, shkollat e larta etj. Ne ia lamë ChatGPT ta bëjë analizën.

Nuk ka departament aktiv të arsimit, dëshmon mungesë dëshire për të reflektuar për shqetësimet reale.

Artikujt tonë për arsimin nuk janë “politikë”, në kuptimin që nuk synojnë axhendë partiake. Për ta theksuar këtë natyrë, e quajmë detyrim që t’ua japim atyre që mendojmë se i njohim qoftë majtas e qoftë djathtas.

Janë disa deputetë na PD-ja që edhe pa patur njohje personale ne i njoftojmë. Disa herë kemi bërë njoftim për të gjithë deputetët e parlamentit. Megjithëse ne jemi të hapur (duke ruajtur natyrën apolitike të shkollës) artikujt tanë janë unikë në çështjet që trajtojmë, brenda sektorit, profesionalë dhe janë thelbësorë dhe janë qartësisht kritik, por jo politikë, përsëri kjo nuk i bën këta politikanë të na shkruajnë e të kërkojnë sqarime, ose të paktën të thonë diçka “formale”.

Duke mos na kthyer përgjigje, janë pikërisht ata që e politizojnë shkollën, sepse japin mesazhin e qartë “Nëse do përgjigje prej nesh, duhet të rreshtohesh”. Ne nuk rreshtohemi, ata nuk japin përgjigje. Ky është kodi i sjelljes si i Partisë Socialiste, si Partisë Demokratike dhe thuajse i të

gjitha partive të tjera politike.

Do të shohim që edhe të “rejat fringo” e kanë këtë teknikë “politizimi” patjetër. Pra pranojnë të jenë të dobta në analiza, veç të mos falen tek një shkollë që sjell përvojën e vet në mënyrë “apolitike” dhe për të gjithë.

Nuk bëjnë komente, nuk referojnë, bëjnë sikur nuk lexojnë, në mënyrë që të mos lënë gjurmë dhe të bëjnë gati një “nacion plagjiature” (nëse kanë ndonjë interes). Nuk kanë asnjë adresim diku ku e “sitin mendimin”. Kjo do të thotë që qartësisht ato *nuk kanë asnjë seksion që të “mendojë” realisht, seriozisht mbi politikën arsimore.* Janë formalisht! Kështu edhe qeveria është “rehat” sepse ajo e di shumë mirë reagimin e opozitës që ka për të qenë kryesisht në “tym”. Të dy palët veprojnë “në tym” në pamjen e tyre publike, por në fakt “programin sekret” e kanë në punë me të gjithë motorrët. Populli merr vetëm rezultatet e një “punë nën rrogë” që në pamje të parë duket si një punë e papërgjegjshme, diletante, korruptive.

Partia Demokratike nuk ka asnjë projekt për kombëtarizimin e sistemit edukativ kombëtar dhe asnjë program që ajo të shtojë apo të zvogëlojë “laicitetin” të shtojë apo të zvogëlojë numrin e shkollave private që janë edhe fetare, edhe të huaja. Pra nuk “i tregon” këmbët.

QËNDRIMI NDAJ DATABAZËS SË PALIGJISHME SMIP DHE MËSONJËTORES PROVON BASHKËPUNIMIN E PARTISË DEMOKRATIKE ME QEVERINË

Databaza SMIP po praktikohet prej 3 vjetësh nga 100% e shkollave publike dhe private, me përjashtim të shkollës “Udha e shkronjave”.

Është provuar katërcipërisht prej meje dhe praktikës së shkollës “Udha e shkronjave” që kjo databazë është e paligjshme dhe shumë dëmtuese për fëmijët dhe familjet shqiptare dhe për interesat kombëtare shqiptare, duke shkelur plotësisht nenet 66, 67 të ligjit 69 “Për arsimin parauniversitar” dhe ligjit 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” me pasoja tepër të rënda dhe të parikuperueshme.

Kemi shkruar një libër me 200 faqe “Firma e prindit”, në të cilin kemi botuar të gjitha komunikimet tona, artikujt dhe analizat.

Për të qenë të sigurtë në analizën tonë, u kemi shkruar të gjitha institucioneve (Ministri Arsimit, President, Parlament, Kontroll i Lartë i Shtetit, komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale, Komisionit të Edukimit në parlament, Dhomës së Avokatisë, Qendrës për mbrojtjen e fëmijëve etj.). Këtë e kemi bërë që nëse nuk do ta kishim saktë analizën, përmes komunikimit të gjenim të vërtetën, apo argumentin kundër. Nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Tipik ka qenë rasti i Kontrollit të Lartë të Shtetit që na dërgoi njoftim për marrjen e shqetësimit (shih faksimilen) dhe nuk është bërë asnjë kontroll në këtë drejtim (veç në mos qoftë i tillë që nuk duhet ta dimë ne).

Të gjithë prindërit anëtarë të Partisë Demokratike i marrin njoftimet e të dhënave personale, pikërisht nga databaza që nuk duhet t’i ketë ato dhe i ka pa asnjë ligj.

Eksponentë të lartë të PD-së janë njoftuar vazhdimisht e vazhdimisht (kujtojmë që njoftimet i kemi publike dhe jo ndonjë mesazh privat që të keqkuptohet si anim politik) dhe ata nuk kanë reaguar fare në atë drejtim.

Përkundrazi kanë dashur të fshehin situatën dhe t’i bëjnë kritikë SMIP për gjëra rutinë. Në 7 mars 2024, si reagim ndaj deklaratës publike të kryetares së departamentit të arsimit Lili Sula reaguam me artikullin “Partia Demokratike mbron paligjshmërinë e databazës SMIP”, sepse deklarata bënte fjalë qëllimisht për mungesa të laptopëve, dhe jo për paligjshmërinë e databazës SMIP, që është përdorim i “sofizmit” dhe “dinakërisë” që të lëshojë mesazhin tek mësuesit që databaza është e ligjshme, por ministria duhet të sigurojë “laptopë” (shih <https://udhaeshkronjave.com/gazeta/f/partia-demokratike-mbron-paligjshmërinë-e-databazës-smip>)

Njoftimi i deputetëve të parlamentit, pra edhe i deputetëve të Partisë Demokratike u bë në datën 19 mars 2024, me e-mail zyrtar (ora 17:03).

Asnjë përgjigje, asnjë reagim as nga administrata e Parlamentit as nga opozitarët. Në një rend normal të gjërave, opozita, qoftë edhe hipokrite, do të thoshte “pa të bëjmë sikur po e dëgjojmë këtë zë”. Në fakt, asnjë lëvizje.

Në mënyrë të veçantë kam njoftuar edhe deputetët Flutura Açka, Luçiano Boçi, Bujar Leskaj, Jorida Tabaku, Albana Vokshi, apo edhe Arbër Malltezi. I vetmi që ka reaguar në

Konfirmimi zyrtar që Kontrolli i Lartë i Shtetit na dërgoi më 25/03/2024 për letrën që i kishim nisur në 11/03/2024. Ende deri sot pas 14 muajsh nuk është bërë asnjë kontroll dhe asnjë përgjigje nuk kemi, që është provë se ndërhyrja është tepër e fuqishme.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 394/11 Prot. Tiranë, më 25/03/2024

Lënda: Kthim Përgjigje

Drejtuar: Z. Artur Shkurti
Drejtor i Shkollës “Udha e Shkronjave”
(info@udhaeshkronjave.edu.al)

TIRANË

Në përgjigje të ankesës tuaj dërguar në KLSH me e-mail 11.03.2024 dhe protokolluar me nr. 394 prot., datë 18.03.2024, ju informojmë se KLSH ushtron veprimtarinë e tij audituese në bazë të Planit Vjetor të Auditimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, i cili hartohet duke mbajtur në konsideratë detyrimin kushtetues që lidhet me raportimin mbi Buxhetin e Shtetit dhe Pushtetin Vendor, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe pavarësinë institucionale të cilësuar nga Ligji nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe kapaciteteve të institucionit.
Për sa më sipër ankesa jua do të mbahet parasysh në auditimet në vijimësi.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Ardian Myslimaj


QËNDRIMI NDAJ DATABAZËS SË PALIGJISHME SMIP DHE MËSONJËTORES PROVON BASHKËPUNIMIN E PARTISË DEMOKRATIKE ME QEVERINË

parlament në mënyrë individuale dhe jo institucionale ka qenë Saimir Koreshi dhe atij ia kemi dhënë ne, përmes një të njohuri që na ofroi t'ia jepte materialin se ne nuk e njihim personalisht. Ai, duket që u prek dhe e mori përsipër këtë punë sepse prindi që ishte i njohur i tij ishte në të rrallët në Tiranë që po e ndiqte seriozisht këtë çështje me shkollën e vet private. I kërkoi të drejtat në shkollë private, por shkolla private e theu prindin duke ia shkelur të drejtat fëmijës dhe fëmija ndërroi shkollë. PD-ja e shkollës private të huaj që ka me mijëra nxënës nuk e mbrojti prindin e t'i thoshte "Jo që nuk do të largohesh, por do të rrish aty, madje, pa pagesë. Pak se janë në gabim, pak se të dëmtojnë, pak se mbron të drejtat e të tërëve, por duan edhe të të përzënë". Në fakt shkolla e përzuri prindin. Dhe atë shkollë qartësisht e ngriti dhe e mban PD-ja. Ekspozentët e saj i kanë aty fëmijët.

KRYETARJA E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË
EDUKIMIT FLUTURA AÇKA, DEPUTETE E PAR-
TISË DEMOKRATIKE, ËSHTË NJOFTUAR

1 janar 2024 - e-mail (subjekt: *Rreth Databazës Qëndrore On-line SMIP*)

29 janar 2024 - messenger (subjekt: libri "Firma e prindit" që është PDF dhe informon plotësisht për SMIP)

3 shkurt 2024 - e-mail (subjekt: SMIP: *Një letër e hapur për të gjitha bordet e prindërve të shkollave publike*)

19 mars 2024 - e-mail (subjekt: *Mbi shkeljet masive në sistemin arsimor të ligjit 69/2012 dhe 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"*)

10 maj 2024 - e-mail (subjekt: *Materiali informues për plotësimin në SMIP të formularëve të orientimit për në AML të nxënësve të klasës së 9-të*)

Ka edhe të tjera, por dhamë disa.

Znj. Ačka na premtoi dy herë të kishim bisedë dhe ndoshta të dëgjoheshim në komision, por megjithë gatishmërinë tonë, kjo nuk u bë e mundur. Dështoi edhe takimi, edhe mundësia për dëgjim. Fluturën e njohim personalisht përmes botimeve dhe panairove. Kjo do të thotë se dikush tjetër e pengonte atë që ta merrte këtë hap.

Pra grupi parlamentar i PD-së është i njoftuar zyrtarisht prej nesh.

Edhe sikur të pranojmë që ne nuk kemi të drejtë, që nuk është e vërtetë, se po të mos kishim do të na kundërvihet menjëherë Ministria e Arsimit dhe po ashtu një seri institucionesh të tjera, por edhe vetë prindërit juristë, Partia Demokratike si forcë politike, aq më tepër opozitare e ka për detyrë të mbajë hapur kanalet e komunikimit me publikun.

Qëndrimi ndaj Databazës SMIP tregon se Partia Demokratike për çështje të tilla bashkëpunon me Partinë Socialiste. Nuk e ka të ndaluar të bashkëpunojë, por duhet të jetë e hapur me publikun e t'i thotë "Kjo çështje është e drejtë dhe duhet që në këtë pikë të bashkëpunojmë me PS-në" Mirëpo ata nuk e bëjnë këtë, ata sillen në mënyrë "dhelparake". Krijojnë bindjen e gënjeshtërt sikur janë kundër dhe "oponencën" e kanë në gjëra krejt dytësore dhe të parëndësishme.

DATABAZA SMIP mbahet "jashtë shkollës" dhe kjo e bën automatikisht të paligjishme, dhe në kundërshtim me nenet 66, 67 të ligjit "Për arsimin parauniversitar" që thotë se të dhënat personale nuk duhet të dalin nga shkolla dhe nuk mund të lejohet aksesimi në to pa firmën e prindit.

Databaza SMIP plotëson spiunimin e popullsisë. Nëse spiunimi i të mëdhenjve bëhet përmes sistemit të patronazhimit i cili në thelb synon të nxjerrë pikat e dobëta e të forta të popullsisë dhe t'i detyrojë përmes sistemit të kufizimit apo nxitjes së shërbimeve që janë të drejta të njeriut t'i detyrojë të heshtin, të topiten etj.

Ky sistem spiunimi u shtri tani tek "fëmijët" dhe kjo po bëhet pa ligj.

VINI RE ÇFARË THOTË CHATGPT për pasojat e kësaj pune në kreativitetin e popullsisë:

Spiunimi i gjerë i popullsisë, sidomos kur është i vazhdueshëm dhe i ndjeshëm, mund të vrasë kreativitetin për disa arsye thelbësore:

1. Vetë-censura: Kur njerëzit ndihen të vëzhguar, ata shpesh vetë-censurohen. Ata shmangin idetë e guximshme, jokonvencionale ose kritike, nga frika se mos keqinterpretohen apo ndëshkohen.

2. Mungesa e lirisë mendore: Kreativiteti lulëzon në një ambient ku mendimi i lirë është i mbrojtur. Nën mbikëqyrje të vazhdueshme, mendja kufizohet nga presioni i pajtueshmërisë dhe nga pasiguria për atë që është "e pranueshme".

QËNDRIMI NDAJ DATABAZËS SË PALIGJISHME SMIP DHE MËSONJËTORES PROVON BASHKËPUNIMIN E PARTISË DEMOKRATIKE ME QEVERINË

3. Frikë nga pasojat: Inovacioni shpesh përfshin rrezik dhe dështim. Në shoqëri të survejuara, çdo gabim apo devijim mund të interpretohet si kërcënim, gjë që dekurajon eksperimentimin.

4. Humbja e intimitetit intelektual: Idetë kërkojnë kohë për t'u pjekur në qetësi. Ndjenja se gjithçka po monitorohet e rrënon këtë hapësirë intime për reflektim e zhvillim.

5. Uniformizimi i sjelljes: Survejimi i gjerë nxit konformizmin. Nëse të gjithë ndihen të detyruar të sillen njësoj, zhduket larmia që është thelb për çdo shpërthim krijues.

Një klimë krijuese ka nevojë për hapësirë të sigurt, për besim dhe për lirinë për të qenë ndryshe.”

SHPËRFILLJA E “MËSONJËTORES” NGA PD

Në mënyrë të veçantë PD-ja nuk ka reaguar as ndaj mbylljes së “Mësonjëtores”, dëmtimit të Kujtesës Kombëtare që ka lidhje me Rilindjen Kombëtare.

Një reagim i deputetes Sorina Kotit u konceptua si një

reagim lokal, kur në fakt reagimi për mbylljen e “Mësonjëtores” do të duhej të ishte në nivel kombëtar, pra edhe qëndror për PD-në, sepse po hiqej Statusi Muze Kombëtar i Arsimit.

Kritika jonë është që “Mësonjëtorja e parë shqipe” në Korçë nuk ishte një vepër “lokale” por zanafilla e arsimit kombëtar laik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ndaj nëse Partia Demokratike e bën reagimin “lokal” kjo përforcon argumentin e Qeverisë që Muzeu duhej të kthehej nga një Muze me Status Kombëtar në një muze lokal, mësuesish korçarë ku veteranët ta dyndin atë me fletore, shënime, dekorata që muzeu do t'i mbledhë qëllimisht që të dekurajojë frymëzimin dhe edukimin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare që Muzeu i parë e bënte mjaft mirë dhe në mënyrë shumë të thjeshtë, por goditëse.

Partia Demokratike nuk ka reaguar as ndaj vendimit për të caktuar 22 nëntorin si Festë Zyrtare përkujtimore të Kongresit të Alfabetit, që me taktikën “gozhda del me gozhde” synonte të çmontonte 7 marsin 1887 nga Kujtesa Kom-

bëtare, ta bënte atë ngjarje si një ngjarje me vlerë lokale dhe ta shtynte rëndësinë e Rilindjes Kombëtare nga shekulli 19, në shekullin 20 dhe t'i nxirrte shqiptarët të vonuar në Rilindjen Kombëtare dhe të përmbyste rëndësinë “ku bijtë” e Kongresit të Alfabetit na dilnin “më të mëdhenj” se baballarët e Lidhjes së Prizrenit dhe të “Mësonjëtores”. Nga ana tjetër, Partia Demokratike nuk reagoi ndaj zhvendosjes së rëndësisë në arsim nga Korça në Manastir që ishte një zhveshje e Korçës nga kombëtarizmi dhe përgatitja e fetarizimit dhe greqizimit të saj.

Partia Demokratike bën sikur nuk kupton kur dëmtohen rëndë interesat kombëtare në çështjen arsimore.

Po e mbyllim me kaq se indiferenca e tyre është kaq e lodhshme dhe turpëruese njëkohësisht. Nuk mund të themi më shumë.

Fakti që PD-ja ka anashkaluar rëndë detyrimin e saj për të shkruar programin për arsimin i vë një vulë turpi seriozitetit dhe kombëtarizmit të saj.

Programi arsimor i PARTISË MUNDËSIA

“Një sistem arsimor i fortë, i pavarur dhe i orientuar drejt cilësisë është themeli i një shoqërie të zhvilluar, duke nxitur mendimin kritik, kreativitetin, dhe aftësitë inovative të të rinjve. Këto masa synojnë të sigurojnë që arsimi të jetë larg ndikimeve politike, të fokusohet në zhvillimin profesional të mësimeve dhe nxënësve dhe të përgatisë brezin e ri për sfidat e një tregu global në ndryshim të shpejtë dhe të vazhdueshëm.”

RINGRITJA E FIGURËS SË MËSUESIT NËPËRMJET DEPOLITIZIMIT DHE MBROJTJES ME LIGJ TË AUTORITETIT TË TIJ

Mësuesi është personi që formon të ardhmen e shoqërisë dhe roli i tij nuk duhet të përshkruhet nga orientimet politike. Nëpërmjet depolitizimit, mësuesi do të ketë mundësinë të fokusohet në përmirësimin e metodave të tij pedagogjike dhe në përcjelljen e njohurive pa paragjykime.

Mbrojtja ligjore e autoritetit të tij garanton që vendimet e marra në mjedisin shkollor të jenë të bazuara në kualitetin akademik dhe etikën profesionale, duke krijuar një klimë ku të gjithë nxënësit përfitojnë nga mësimi pa ndikime ekstreme që mund të dëmtojnë integritetin e arsimit.

ASNJË DREJTOR SHKOLLE ME ANËTARËSI POLITIKE OSE PJESËMARRJE NË FUSHATA, PËR TË GARANTUAR PAPREKSHMËRINË E STAFIT MËSIMOR NGA POLITIKA

Drejtuesit e shkollave duhet të jenë shembuj profesionalë të përkushtimit ndaj arsimit dhe të aftësisë menaxheriale,

Kritikë ndaj programit arsimor të Partisë Mundësia sipas ChatGPT

Ky program i plotë arsimor, ndonëse përfshin një sërë pikash të rëndësishme dhe shfaq vullnet për ndryshim, mbetet i pamjaftueshëm, shpesh sipërfaqësor, i njëanshëm në fokus dhe pa vizion të integruar për një reformë gjithëpërfshirëse e të qëndrueshme. Ja një analizë kritike e thelluar sipas tematikave kryesore:

1. Dominimi i narrativës “mësues + depolitizim” si bosht i programit

- Fokusi i programit është dukshëm i përqendruar tek figura e mësuesit dhe shkëputja nga politika, gjë që është e rëndësishme, por nuk mund të jetë themeli i vetëm i një reforme arsimore gjithëpërfshirëse.
- Nuk trajtohet sa duhet roli i nxënësit si subjekt qendror i procesit mësimor.
- Depolitizimi është përmendur si zgjidhje universale, por nuk ka mekanizma konkretë: Si do të përcaktohet “anëtarësia politike”? Cilat janë mjetet ligjore për mbrojtjen e autoritetit të mësuesit? Si do të kontrollohen apo zbatohen këto masa?

2. Rritja e buxhetit për arsim – pozitive, por e paargumentuar dhe e paqartë

- Programi thotë se do të rritet buxheti për arsim, por nuk tregon me sa? me çfarë ritmi? cilat janë prioritetet e shpenzimit?
- Nuk ka një analizë të nevojave reale në bazë rajoni, niveli arsimi, apo infrastrukture.
- Rritja e rrogave për mësuesit është e domosdoshme, por mungon një plan afatgjatë për rekrutimin, formimin dhe zhvillimin e tyre profesional.

3. Pavarësimi i arsimit të lartë – mirë në parim, por me rreziqe dhe pa mbrojtje publike

- Autonomia e universiteteve është e nevojshme, por në mungesë të një sistemi efektiv të akreditimit dhe kontrollit cilësor, ajo mund të kthehet në një privatizim të pakontrolluar, rritje tarifash, apo rënie të standardeve.
- Nuk trajtohet statusi i universitetit publik dhe detyrimi i tij për të ofruar arsim të përballueshëm dhe cilësor për të gjithë, veçanërisht për studentët nga shtresat në nevojë.

4. Njëjtësimi me Cambridge – problematik si koncept

- Adaptimi i programeve ndërkombëtare duhet të jetë i kontekstualizuar dhe i përshtatur me realitetin shqiptar, jo thjesht imitim i drejtpërdrejtë.
- Cambridge është elitist dhe i shtrenjtë. Çfarë do të ndodhë me shkollat publike në fshatra? A janë të përgatitura shkollat, mësuesit dhe nxënësit për këtë nivel?
- Rreziku i thellimit të pabarazive sociale është real nëse standardet ndërkombëtare vendosen pa masa mbështetëse.

Programi arsimor i PARTISË MUNDËSIA

pa u ndikuar nga polarizimi politik.

Duke ndaluar pjesëmarrjen e drejtorëve në aktivitetet politike, sistemi arsimor do të ruajë neutralitetin dhe transparencën, duke siguruar që vendimet menaxheriale të jenë të orientuara drejt përmirësimit të mjedisit mësimor dhe të cilësisë së arsimit.

Kjo do të rezultojë në një ambient ku mësuesit mund të jenë të liri në shprehje dhe të fokusohen në inovacion dhe zhvillim profesional pa frikë nga ndonjë ndikim apo hakmarrje politike.

RRITJE E BUXHETIT TË SHTETIT PËR ARSIMIN, DUKE RRITUR RROGAT E MËSUESVE DHE KUSHTET NË SHKOLLA

Investimi në arsim është investim në të ardhmen e vendit. Rritja e buxhetit për arsimin do të mundësojë modernizimin e infrastrukturës, pajisjen me teknologji të avancuara dhe krijimin e kushteve më të mira për punën në shkolla.

Rritja e rrogave të mësuesve është një masë që jo vetëm motivon personelin e arsimit, por gjithashtu tërheq talente të reja në këtë sektor, duke garantuar që arsimi të mbetet një profesion i dëshirueshëm dhe prestigjioz. Kjo qasje ndihmon në krijimin e një ambienti ku cilësia arsimore mund të përmirësohet në mënyrë të qëndrueshme dhe të arrijnë standarde të pranueshme europiane.

PAVARËSIMI I PLOTË DE FAKTO DHE DE JURE I ARSIMIT TË LARTË NGA QEVERIA

Universiteteve dhe institucioneve të arsimit të lartë u duhen dhënë autonomi të plotë në vendosjen e programeve, kërkimeve shkencore dhe bashkëpunimit me sektorin privat dhe

Kritikë ndaj programit arsimor të Partisë Mundësia sipas ChatGPT

5. Shkolla për fëmijët me inteligjencë mbi mesatare – elitizëm pa garantim për gjithëpërfshirje

- Ky model rrezikon të krijojë një sistem arsimor me dy shpejtësi: një për të “zgjuarit” dhe një për pjesën tjetër.
- Mungojnë tërësisht politikat për fëmijët me vështirësi në të nxënë, fëmijët me aftësi të kufizuara apo ata në rrezik social, që janë po aq prioritarë.
- Në vend të vetëm një institucioni, pse nuk përmendet një rrjet shkollash që zbatojnë politika për zhvillimin e talentëve në çdo komunitet?

6. Tregu i punës – mungon lidhja reale me arsimin profesional

- Flet për reformim të kurrikulës për tregun e punës, por nuk përmend fare arsimin profesional dhe teknik, që është direkt i lidhur me këtë qëllim.
- Nuk përmenden partneritetet me biznese konkrete, praktikatat e punës, apo njësitë që do ta mundësojnë këtë reformim në terren.

7. Bursat për shkencat ekzakte – shumë e ngushtë në fokus

- Pse vetëm në teknologji, shkencë dhe inxhinieri? A nuk ka nevojë Shqipëria për ekspertë në mësimdhënie, shëndetësi, psikologji, drejtësi, art dhe kulturë?
- Mungon një politikë kombëtare për bursa të lidhura me nevojat e tregut dhe zhvillimit strategjik të vendit.

8. Kujtesa historike për komunizmin – jashtë kontekstit të reformës arsimore

- Edhe pse e rëndësishme si temë, përfshirja e saj në programin arsimor duket më shumë një gjest ideologjik, sesa një masë konkrete për përmirësimin e sistemit.
- Nuk ka sqarim si do integrohet kjo në kurrikulë, cilët janë ekspertët, materialet, qasja pedagogjike, dhe si do balancohet me temat e tjera të edukimit qytetar dhe historisë.

PËRFUNDIM:

Ky program më shumë artikulon dëshira të njohura se sa struktura të reja për zgjidhje reale. Ai nuk është gjithëpërfshirës, e nënvlerëson aspektin social dhe pedagogjik të arsimit, dhe nuk përmban asnjë metrikë, afat, buxhet të detajuar apo instrument zbatimi. Për të qenë i besueshëm, duhet: • Të përfshijë analizë të problemit dhe jo vetëm zgjidhje të deklaruara; • Të balancojë mes elitës dhe gjithëpërfshirjes; • Të shoqërohet me mekanizma konkretë zbatimi dhe garanci për barazi, cilësi dhe integritet.

Programi arsimor i PARTISË MUNDËSIA

ndërkombëtar. Kjo do të lejojë institucionet të përshtatin strategjitë e tyre sipas nevojave të tregut dhe të zhvillojnë programe inovative që reflektojnë sfidat globale. Një arsimi i lartë autonom do të inkurajojë krijimin e hulumtimeve shkencore të pavarura, do të rrisë konkurrencën ndërmjet institucioneve dhe do të forcojë integrimin e universiteteve në rrjetet ndërkombëtare akademike.

NJËJTËSIMI I PROGRAMEVE SHKOLLORE ME ATO TË CAMBRIDGE

Përmirësimi i kurrikulave në bazë të shembujve ndërkombëtarë, si sistemi i Cambridge, do t'i japë nxënësve shqiptarë një arsimin me përmbajtje moderne, të strukturuar dhe të orientuar drejt zhvillimit të aftësive analitike, kritike dhe gjuhësore.

Ky harmonizim i programeve siguron që nxënësit të jenë të përgatitur për studime të avancuara jashtë vendit dhe për të përballuar sfidat e një tregu pune global, duke rritur kështu konkurrueshmërinë e tyre në nivel ndërkombëtar.

THEMELIMI I INSTITUCIONIT ARSIMOR PËR NXËNËS ME INTELIGJENCË MBI MESATARE (MODELI ATOM NË KOSOVË)

Krijimi i institucioneve të dedikuara për të zhvilluar talentet e veçanta është një hap thelbësor për nxjerrjen e potencialit

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

Tashmë është e provuar që si PS dhe PD i kanë ezauruar plotësisht mundësitë e tyre. Me të drejtë vendi pret alternativa të reja. “Vuajtjet” e popullit shqiptar ushqejnë menjëherë çdo shpresë të re. Programi i partive të reja është i thjeshtë “*Ne jemi të rinj, nuk na keni provuar, na provoni. Nëse nuk doni, rrini aty ku jeni*”. Me shumë mundësi populli do t'i dorëzohet kësaj skeme arsyetimi.

Partia “Mundësia” bën një fushatë qëllimisht “minimaliste” e “të thjeshtuar” që tregon se ajo është duke zbatuar më së miri disa parime të marketingut. Ti nuk i kap ata në gabim, sepse i shmangen mjaft mirë trajtimit të çështjeve kyçe. Nuk hyjnë në to. Kjo mund të jetë edhe e drejtë (nga ana e marketingut) për efekt kohe sepse diskutimet e shumta do ta bënin të pamundur përballimin e debatit, ndaj për të luftuar kundërshtarin ata mbajnë minimumin e premtimeve, minimumin e analizave. Mirëpo mali i problemit qëndron dhe nuk shmanget: populli nuk ka një “hall” por ka halle sektoriale (arsim, shëndetësi, ushtri, ekonomi, pensione, siguri etj) ka hallin e emigracionit masiv që përmbledhet në vargjet e Naim Frashërit (Qerbelaja).

*S' më vjen keq për derët t' ënë
se nga Zoti kshu qe thënë,
po më vjen për Mëmëdhenë
dhe për besën' e për fenë,
më vjen keq për njerëzinë,
që i dhatë arratinë.*

Apo që shprehet në fjalët e Donikës, tek “Histori e Skënderbeut”, në çastin që largohet për në Napoli.

*“A do ta shoh Shqipërinë,
dhe miqt' e farën e fisnë!
Kryeqytetn' e shtëpinë!
ah! për ku! për ku më nisnë.
Mbrenë s'e kam për të parë
un' e zezë! un' e mjera!
po të mos i shoh as varrë!
m'u mbyll shtëpija e dera!”*

Programi arsimor i PARTISË MUNDËSIA

të plotë të të rinjve. Këto institucione do të implementojnë programe të avancuara, do të bashkëpunojnë me ekspertë ndërkombëtarë dhe do të ofrojnë një ambient sfidues që nxjerr në pah aftësitë unike të secilit student.

Përveç kësaj, kjo masë do të krijojë një rrjet të fortë të të rinjve të talentuar, duke i dhënë atyre mundësi të përfshihen në projekte kërkimore dhe inovative që do të kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë së njohurive.

REFORMA NË PROGRAMET SHKOLLORE PËR TË PËRGATITUR TË RINJTË PËR TREGUN E PUNËS

Përgatitja e të rinjve për realitetin e tregut të punës kërkon një qasje të integruar, ku kurrikula përfshin elementë praktikë, zhvillim aftësish teknike dhe ndërdisiplinare. Integrimi i praktikave të punës, trajnimet për zhvillim personal dhe bashkëpunimi me sektorin privat do të sigurojnë që nxënësit të kenë njohuri të azhuruara dhe të përshtatura për kërkesat e tregut.

Kjo qasje do të zvogëlojë hendekun midis arsimit teorik dhe praktikës, një problem i trashëguar i sistemit tonë arsimor, duke nxitur kështu një tranzicion më të lehtë dhe më efikas nga shkolla në karrierë.

BURSA STUDIMI PËR STUDENTËT E EK- SELENCËS NË FUSHA TË TEKNOLOGJISË, SHKENCAVE DHE INXHINIERISË

Ofimi i bursave për studentët që arrijnë rezultate të larta dhe demonstrojnë potencial të madh në fushat kritike nuk është vetëm një masë stimulimi, por edhe një investim në

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

Ne nuk mundet të mos u urojmë partive të reja (nëse nuk janë levë e kartelit) një sukses në këto zgjedhje, sepse fundja ato e kanë marrë përsipër një aksion. Kritikën që do të bëjmë këtu nuk janë për ndonjë biznes privat, por për parti që synojnë të na përfaqësojnë. Dje, më 2 maj një numër fiks (**368) na telefonoi me emër (pra e kishin të shoqëruar numrin me emrin) dhe na tha “Jemi nga partia Mundësia. Si ju duket fushata e partisë “Mundësia”?” I themi “Shumë mirë.” Më pas vjen pyetja “A do ta votonit partinë “Mundësia”. I themi “*Nuk do të votojmë për asnjë parti*”.

Në këtë broshurë këtë po bëjmë, po sqarojmë arsyet se pse nuk do të votojmë asnjë parti. Në këtë artikull jemi tek arsyet ndaj partisë “Mundësia”.

Kriteri i paanshmërisë dhe i depolitizimit na kërkon që mesazhet që kemi t’i ndajmë në mënyrë të njëjtë kudo dhe të kujdesemi që të mos jemi të njëanshëm (meqë po e shkruajmë mendimin në emër të shkollës dhe në faqen e shkollës dhe me logon e shkollës). Çështja është thellësisht profesionale dhe njëkohësisht kombëtare, dy këndvështrime që janë me identitetin e vet të pavarur nga politika, por të lidhur me të.

Natyrisht që presim me vëmendje se çfarë do të ndodhë pasi e shpërndajmë një mesazh që është kryesisht publik. Nuk është e vështirë për ne që të kemi kontakte anëtarë të PS-së apo të PD-së apo edhe të partive të tjera, sepse vetë puna t’i sjell natyrshëm. U kemi dhënë çfarë kemi patur dhe gjithmonë e kemi bërë këtë qartësisht në pozicionin e shkollës dhe jo si individ që bën sikur nuk ka shkollën si biznes. Këtë nuk e bëjmë aq për promovim të shkollës, sa për rikonceptim të rolit të shkollës dhe dhënie të një modeli të ri gjykimi për institucionet shkollore. E shohim që këtu jemi plotësisht vetëm. Kjo është arsyeja që do të vijojmë ta theksojmë, derisa të tjerët të binden që e kanë gabim.

Partia “Mundësia” është e re, por me çfarë shohim e deklarohet ka një investim relativisht të madh, pra mundet që të mbështetë financiarisht interesin e saj, të ndërtojë seksione (departamente) profesionale që të analizojnë në mënyrë të shkurtër.

Aftësitë në biznes të drejtuesit Shehaj janë mjaft mirë të transferueshme edhe në fushën e politikës dhe i bëjnë mirë asaj, sidomos në çështje ekonomike, apo të përgjegjësisë për parane, apo edhe të lirisë ekonomike që shprehet edhe në emrin e partisë.

Programi arsimor i PARTISË MUNDËSIA

zhvillimin e ekspertizës që do të jetë motor për inovacion dhe zhvillim ekonomik. Këto bursa do të inkurajojnë studentët të angazhohen në kërkime të avancuara, të marrin pjesë në projekte ndërkombëtare dhe të kontribuojnë në krijimin e teknologjive të reja që do të kenë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit.

POLITIKA PËR KUJTESË KOMBËTARE PËR KRIMET E KOMUNIZMIT

Ruajtja e kujtesës historike dhe nderimi i viktimave të regjimit komunist janë hapa të domosdoshëm për të ndërtuar një shoqëri të vetëdijshme dhe të drejtë. Krijimi i një politike të qartë për kujtesën kombëtare do të ndihmojë në edukimin e brezave të rinj mbi rëndësinë e lirisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

Kjo masë do të parandalojë përsëritjen e gabimeve të së kaluarës, duke forcuar identitetin kombëtar dhe duke krijuar një bazë morale për zhvillimin e ardhshëm shoqëror.

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

Disa aftësi të pritshme në këtë rast për t'u transferuar janë: *komunikimi duke shmangur retorikën e duke qenë më i drejtpërdrejtë, duke anuar nga efikasiteti, kujdesi për menaxhimin financiar si dubet pa burokraci, shpenzime të tepruara dhe me transparencë, një rendje drejt teknologjisë, një kulturë pritshmërie rezultatesh dhe jo thjesht "flasim pa rezultate", një kombinim më i mirë i kombinit shtet-privat, aftësi më të mira planifikimi, struktura më efikase partiake të orientuara nga suksesi, etj.*

Nga fjala shqipe "Mundësia" e zgjedhur nga z.Shehaj si fjalë kyçe për emërtimin e partisë, marrim vesh që përqëndrimi do të jetë tek "liria". Liria është një nga shtyllat kryesore të shoqërisë, themeli i saj, parakusht i zhvillimit, fryma e një kombi që dëshiron të jetë vetja. Për ta kuptuar këtë na vlen një thënie e Sami Frashërit:

"Kombi i përngjan anijes: Ligji është në vend të timonit, opinioni publik janë velat, ndërsa liria është në vend të erës. Sikundër timoni nuk hyn në punë pa velat, edhe ligji në këtë rast nuk sjell asnjë dobi. Velat, nën forcën e erës, e shkatërrojnë anijen pa timon. Po kështu, opinioni publik dhe ligji, në kushtet e një lirie të tepruar, shkaktojnë zhdukjen e kombit. Sikundër nuk mund të lëvizë nga vendi anija që i ka në rregull velat dhe timonin, por i mungon era, edhe kombi që i ka të përsosura ligjet dhe opinionin publik, nuk mund të përparojë pa liri." (Sami Frashëri)

Të kapësh vetëm një nga levat e drejtimit të një shteti që është "liria" vlen realisht shumë, në një kohë kur kemi prova të qarta që liria po bllokohet në mënyra të ndryshme.

Por edhe, si drejtues partie, të të ofrohet liria dhe të mos japësh vetë shembullin e shfrytëzimit të "lirisë" dhe të mundësive që të jepen edhe kjo s'është në rregull, ka pasoja dhe e vë në dyshim sinqeritetin e dëshirës për "mundësi" apo të aftësisë për ta shfrytëzuar "mundësinë".

Inteligjenca Artificiale një mundësi e pashfrytëzuar prej partisë "Mundësia"

Një mundësi, vetë partia "Mundësia" e kishte të pavarur nga njerëzit konkretë dhe ajo është Inteligjenca Artificiale. Partia "Mundësia" në programin e botuar e këshillon IA-në *për doganat* (fq.5), *për lejet e ndërtimit* (fq.6), apo *në shëndetësi* (fq. 22), por në fakt, nuk e shfrytëzon vetë. Inteligjenca Artificiale do të shfrytëzohet kudo dhe nuk ka as nevojë as të tregohen fusha, sepse as vetë nuk i dimë se cila fushë mund të ngelet e pandikuar, aq i madh do të jetë ndikimi. Emri i ka mbetur Inteligjenca Artificiale, por në fakt aty kemi *"vetëdijen, dijen e logjikën njerëzore të automatizuar e të përforcuar me shpejtësi të jashtëzakonshme"*, ku ChatGPT aktualisht duket se është në pararojë,

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

por kjo pak rëndësi do të ketë në të ardhmen (pra marka ose kompania) se mund të ndryshojë. Brenda disa sekondash, partia “Mundësia” do të mund të kishte draftin e parë të kritikës ndaj programit arsimor me inteligjencën artificiale. Nëse do të përfshihej edhe më shumë, natyrisht që do ta kishte edhe më të mirë. Ajo nuk e ka bërë këtë punë, pra nuk ia ka nënshtruar programin e saj Inteligjencën Artificiale. Me sa duket mendojnë që në këtë fushë nuk duhet. Në fakt duhet dhe fuqinë e vetë Inteligjenca e tregon edhe me kritikën që i bën programit të partisë “Mundësia” që e botojmë këtu. Të mos testosh programin me Inteligjencë Artificiale është njëloj sikur konstruktori të mos përdorë simulimin e tërmetit artificial nëntë-ballësh për të testuar projektin e tij inxhinierik dhe të presë tërmetin natyral ta bëjë këtë testim.

Çdo individ që do të ishte në krye të një partie, ka kufizimet që i vijnë nga profesioni real që ai kryen. Ndaj nuk duhet menduar që vetëm biznesmenët kanë kufizime e të tjerët jo, dhe anasjelltas. Megjithatë jemi duke diskutuar konkretisht për partinë “Mundësia” dhe qasjen e saj ndaj arsimit, ndaj nuk do të keqkuptohemi në këtë drejtim. Do të shihet se kritikën për të tjerët e kemi në drejtime të tjera, sipas natyrës. Ta zemë atë që nuk e gjejmë këtu “rëndimin me retorikë” e gjejmë shumë tek “Lëvizja Bashkë” që është e dyndur me retorikë që është e kundërta e thjeshtëzimit. Të

dyja mund të bëhen argumente kundër njëra-tjetrës. Ndaj masa është ajo që vlen. Lidhur me rreziqet që vijnë nga formi specifik që ka një drejtues biznesi kur vjen puna në trajtimin e sektorëve të shtetit dhe të shoqërisë, ChatGPT, e pyetur prej nesh, përmend mendon si vijon:

“Jemi duke kapur njëen ku përplasen logjikat: e tregut dhe e shtetit, ose më konkretisht – kur një drejtues partie, i formuar në kulturën e biznesit, tenton të aplikojë po të njëjtën logjikë menaxhimi mbi sektorë shtetërorë dhe jetën publike, si të ishin ndërmarrje tregtare. Ky është një fenomen real në shumë vende – edhe në Shqipëri – dhe sjell një sërë gabimesh tipike, për të cilat po i rendisim me shpjegime konkrete:

1. Reduktimi i shtetit në “efikasitet” financiar;

Një drejtues me logjikë biznesi shpesh: kërkon të masë gjithçka me numra, raporte të shpejta dhe balanca financiare, harron që shteti nuk ekziston për të bërë fitim, por për të garantuar barazji, shërbim dhe drejtësi.

Gabimi: *I njëjti kriter që përdor për një supermarket (ulje kostosh, rritje fitimi) nuk vlen për një shkollë apo gjykatë. Jo gjithçka që s’prodhuaka para është “humbje”.*

2. Privatizimi i funksioneve që kërkojnë përgjegjësi publike;

Këta drejtues shpesh: synojnë të outsourcojnë (delegojnë) gjithçka te privatët – edhe mësimdhënien, shërbimet spitalore, burgjet, madje edhe ndihmën sociale.

Gabimi: *Shteti nuk është kompani – ka disa detyra që s’mund t’i delegojë, sepse lidhen me barazinë e të drejtave dhe sigurinë publike. Shërbimi i drejtësisë, arsimi bazë, ndihma për më të dobët – nuk janë treg për fitim.*

3. Shqetësim vetëm për “konsumatorin”, jo për qytetarin; *Në biznes, kënaqësia e klientit është gjithçka. Në politikë, interesi publik shpesh kërkon vendime jo-popullore, por të domosdoshme (p.sh., reforma në drejtësi, ndalim ndërtimesh, taksë për ndotësit).*

Gabimi: *Drejtuesi i formuar në biznes mundohet të “kënaqë turmën”, si klientelë, duke lënë pas dore vizionin dhe përgjegjësinë publike. Në fund, bëhet “shitës i imazhit”, jo udhëheqës politik.*

4. Mungesë kuptimi për proceset e ngadalta institucionale. *Në një kompani, një CEO mund të ndryshojë strategjinë në një javë. Në shtet, ligjet, reformat, institucionet kanë kohë, konsulta, debat dhe konsensus.*

Gabimi: *Drejtuesi i biznesit nxiton të “rregullojë” gjithçka me direktiva të shpejta, duke anashkaluar demokracinë, ligshmërinë dhe pjesëmarrjen.*

5. Kthimi i administratës në skuadër lojaliteti. *Në biznes, është normale që drejtuesi të rrethojë veten me besnikë. Në shtet, administrata duhet të jetë e paanshme, profesionale dhe e qëndrueshme, pavarësisht se kush vjen në pushtet.*

Gabimi: *Përdor modelin e “ekipit tim”, duke politizuar çdo*

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

institucion dhe duke dëmtuar besimin në administratën publike.

6. Shndërrimi i të mirës së përbashkët në mall

tregu. Uji, energjia, toka publike, transporti, arsimi – trajtohen si “produkte për t’u shitur”, jo si të drejta qytetare.

Gabimi: Këto nuk janë mallra – janë pasuri të përbashkëta, që kërkojnë kujdes, vizion dhe ndjeshmëri sociale.

7. Kult individi dhe marketingu, jo programi politik.

Në biznes, marka lidhet me një njeri – CEO-n. Në politikë, nuk duhet të jetë individi që sundon, por programi, institucioni, zëri kolektiv. **Gabimi:** Partia bëhet markë personale, diskursi politik kthehet në show dhe branding, duke e zëvendësuar përmbajtjen me pamjen.

8. Injorim i diversitetit të nevojave dhe realiteteve.

Në treg synohet standardizimi për të ulur kosto. Në shtet, nevojat janë të ndryshme: një fshat s’ka nevojë për të njëjtin model si një qytet i madh.

Gabimi: Aplikohen politika “copy-paste” sipas modelit të biznesit të suksesshëm, duke mos respektuar kompleksitetin social dhe kulturor.

Përmbyllje: Drejtuesit me sfond biznesi mund të sjellin energji, efikasitet dhe vendimmarrje praktike – por, nëse nuk kuptojnë natyrën thelbësore të shtetit si organizëm politik, etik e social, rrezikojnë të kthejnë shoqërinë në një qendër tregtare, ku gjithçka matet me çmim, jo me vlerë.”

Analizë e disa përpjekjeve për komunikim me partinë “Mundësia”

(Kujdes leximin: Komunikime të ngjashme janë pothuajse me të gjitha partitë)

Duke i njohur mjaft mirë veprimet e partive politike prej 35 vjetësh, është e ditur që nuk presim shumë prej tyre. Mirëpo kjo nuk na bën që të tregohemi indiferentë. Ndaj kemi një vëzhgim mjaft të madh dhe presim të dëgjohemi në atë që mendojmë se e njohim më mirë dhe që është fusha jonë e profesionit arsimit, mësuësia, sistemi arsimor kombëtar dhe ndërkombëtar. Nga ana tjetër nëse nuk e bëjmë për vete një parti politike që të mbajë në qendër kryesisht sistemin arsimor, nuk kemi të drejtë të tregohemi dyshues, moskomunikues, apo mosndihmues ndaj partive të reja. Megjithatë nuk kalon shumë kohë dhe mësojmë që edhe kjo vijon të dështojë, e të dështojë, e të dështojë (dhe do ta shpjegojmë me fakte).

Tashmë është e qartë se këtë fushë jo vetëm e njohim, por në disa drejtime e kemi krijuar vetë në mënyrë unike dhe mjaft të rëndësishme për tërë sektorin (shumë prej përmbajtjes sonë është falas në internet) dhe ato janë unike në disa zëra: të gjithë flasin për mendimin kritik e logjikën, por nuk kanë një produkt origjinal në

këtë fushë (ne kemi botuar dy libra “Logjike” formale dhe jemi ndërkohë kemi qenë grupin e vogël të shkollave pilot të Kembrixhit për programin e aftësive të nivelit të lartë Global Perspectives (2016-2018) dhe po ashtu kemi bërë Olimpiadën e Kompetencës Globale). Askush më shumë se ne nuk ka investuar në arsim në edukimin kombëtar, në programin e edukimit të karakterit dhe të virtyeteve, dhe arritjet tona ndërkombëtare janë unike dhe besojmë që nuk ka një institucion arsimor qoftë edhe qëndror që ta njohë kaq mirë intelektin dhe fuqinë por edhe dobësinë e rracës shqiptare apo të sistemit arsimor shqiptar sa ne e kemi, përmes Olimpiadës Kombëtare që zhvillohet prej vitit 2000, etj. Jemi të vetmit që kemi “alumni” në faqen zyrtare të Kembrixhit.

Ndaj presim të respektohem (të dëgjohemi).

Në fakt, vijojmë të shohim indiferencë, indiferencë, indiferencë. Nuk na vjen keq për vete, se jemi mësuar dhe e njohim fare mirë situatën, por na vjen keq për inteligjencën shqiptare që nuk pyetet dhe është shpesh për këtë arsye “apatike”. Ne nuk kemi e lëmë aty. Do ta shprehim e do ta bëjmë të qartë.

Dhe ne vijojmë të shkruajmë artikuj të tillë për indiferencën e tyre dhe dështimin e tyre proverbial që bazohet në mendjemadhësinë, protagonizmin e tepruar, individualizmin dhe që nuk kanë besim në kolegjalitetin, bashkëpunimin, pleqësinë, demokracinë, të qenët të hapur, apo edhe kombëtarizmin.

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

Në datën 26 janar 2025, botuam hapur artikullin *“Programi politik për arsimin parauniversitar”* (Artur Shkurti) ([linku udhaeshkronjave.com/gazeta/f/programi-politik-per-arsimin-parauniversitar](http://linku.udhaeshkronjave.com/gazeta/f/programi-politik-per-arsimin-parauniversitar)) dhe në hyrje të artikullit thuhet qartë dhe pa asnjë anësi politike:

“Për të ndihmuar të gjitha partitë politike që po bëhen gati të propozojnë programe për shoqërinë shqiptare, më poshtë është një variant i shkurtuar i programit kryesisht për arsimin parauniversitar (ku kemi më shumë përvojë) por edhe atë universitar apo të kërkimit shkencor me aq sa kemi kuptuar nga marrëdhëniet tona me universitete, pedagogë, apo nga çfarë ish-nxënësit tanë na thonë dhe leximet gjatë kësaj kohe të gjatë reflektimi.”

Kjo do të thotë se ishim të hapur dhe ndihmues njëkohësisht për të gjithë. Nuk e dhamë “fshehtas”, nuk e dhamë me kusht, por hapur dhe nuk e dhamë me vonesë, por në kohë (katër muaj para).

Çfarë bëjnë partitë? Bëjnë sikur shohin. Pse bëjnë sikur nuk shohin? Se nuk duan të lënë gjurmë që ne e kemi shkruar dhe ata e kanë lexuar. Kush ua mëson këtë teknikë “finoke”?!

Dhe bëjnë sikur nuk shohin kur artikuj të tillë thuajse nuk ka fare, sidomos në fushën e arsimit.

ANALIZA KRAHASUESE E CHATGPT PËR NIVELIN E ARTIKUJVE

Për ta provuar sa thamë më sipër dhe për të patur një këndvështrim më të hapur nëse ka apo jo artikuj të ngjashëm dhe për të na treguar dallimet apo ngjashmëritë ChatGPT ofron si referencë kryesore të një artikulli tjetër artikujt e botuar tek Shkolla e Drejtorëve që është organ ekskluziv i përgatitjes së drejtorëve për arsimin parauniversitar (jemi të vetmit që e kemi quajtur “sekt okult” sepse është shembull i eksportimit të sovranitetit tek privatët) dhe ofron këtë link si burim analize www.csl.edu.al/raportet/arsimi-parauniversitar-situata-politikat-strategji.

Kur ne i themi ChatGPT të bëjë krahasimin e artikullit tonë me ata artikuj ChatGPT (pa ndonjë kërkesë theksimi kritike), AI ofron këtë tabelë dallimesh të dy artikujve për këto aspekte: *qasjen, stilin, fokusin, autorësinë, publikun e synuar, periudhën*:

1. Qasja:

“Udha e Shkronjave” (Artur Shkurti): Ideale, vizionare, me ngjyime filozofike dhe identitare
CSL – Raporti për Arsimin Parauniversitar: Analitike, institucionale, mbështetur në të dhëna dhe vlerësim politikash

2. Stili:

“Udha e Shkronjave” (Artur Shkurti): Diskutues, argumentues me tone kulturore dhe edukative
CSL – Raporti për Arsimin Parauniversitar: Teknik, sistematik, me analiza SWOT dhe rekomandime konkrete

3. Fokusi

“Udha e Shkronjave” (Artur Shkurti): Shkolla si themel i ndërtimit të karakterit dhe qytetarisë
CSL – Raporti për Arsimin Parauniversitar: Ristrukturimi i sistemit, përfshirja, barazia, performanca mësimore

4. Autorësia

“Udha e Shkronjave” (Artur Shkurti): Individuale, me ton autorial dhe filozofik
CSL – Raporti për Arsimin Parauniversitar: Institucionale, me pjesëmarrje ekspertësh dhe partnerësh (shoqëri civile, donatorë)

5. Publiku synuar:

“Udha e Shkronjave” (Artur Shkurti): Qytetarë të angazhuar, pedagogë, aktivistë
CSL – Raporti për Arsimin Parauniversitar: Politikëbërës, studiues, institucione arsimore dhe partnerë ndërkombëtarë

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

6. Periudha:

“Udha e Shkronjave” (Artur Shkurti): E fokusuar në vizion afatgjatë për shkollën shqiptare

CSL – Raporti për Arsimin Parauniversitar: I bazuar në analizë të 5–10 viteve të fundit dhe sugjerime për 5 vitet e ardhshme

Në fund ChatGPT, në përgjigje të kërkesës “kujt do t’ia këshillonit artikullin” shkruan:

Artikullin e “Udha e shkronjave” do t’ia këshilloja veçanërisht:

- **Mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore**, të cilët duan të kuptojnë rolin kulturor dhe qytetar të shkollës përtej kurrikulës zyrtare;
- **Studiuesve të arsimit dhe filozofisë së edukimit**, që kërkojnë një tekst me përmasë reflektuese dhe ideologjike;
- **Politikëbërësve** që kanë nevojë të kuptojnë sesi formësohen qëndrimet e publikut për arsimin;
- **Prindërve aktivë dhe opinionistëve**, që janë të shqetësuar për boshllëqet morale dhe vizionin në arsimin parauniversitar.”

Pra pa i hyrë thelbit të mendimeve tona që është tjetër gjë, qartësisht artikulli plotëson kriteret për një artikull përfaqësues për një politikëbërje dhe qartësisht ChatGPT, megjithë kërkesën për search, nuk gjeti artikuj të tjerë veç atyre (si CSL) që e kanë për detyrë të shkruajnë diçka se paguhen për atë punë.

Atëherë me çfarë e justifikojnë seksionet e partive indiferencën e tyre ndaj nesh? Ato vetë jo vetëm nuk kanë botuar artikuj por edhe programet i kanë tepër të varfra në problematika, analiza e zgjidhje. Pra edhe në kohë fushate politikanët tregohen “dembelë” ndaj shkrimnit dhe leximit dhe “punëtorë” të marketingut. Do të thotë se ata nuk duan fare të bashkëpunojnë me askënd, as me ata që janë brenda arsimit. Ndaj ka arsye të tjera që bërtasin “të depolitizohet arsimi” sepse në këtë mënyrë duan që të përjashtojnë me një të rënë të lapsit me mijëra mësues edhe nga funksioni “oponencë politike” për “politikatat arsimore” dhe jo më të jenë aktivë në politikë, pra pasi zgjedhin në mënyrë individuale me kë do të bashkëpunojnë, ndërtojnë një politikë “populiste” (në distancë) dhe kur ofrohen mundësi reale të vërteta që vijnë na përvoja, ata bëjnë sikur nuk shohin, bëjnë sikur nuk kanë rëndësi këto që shkruajmë. Natyrisht ne nuk e i masim konkluzionet tona me çfarë qëndrimi kanë ata.

Ne nuk do të bëjmë sikur nuk shohim që ata po bëjnë sikur nuk po shohin, ndaj nuk do të votojmë dhe argumentimin tonë do ta japim me shkrim. Ne nuk duam as anëtarësi as rreshtim, e megjithatë ndihmojmë, që është krejt krejt e rrallë, sepse njerëzit zakonisht nuk ndihmojnë pa marrë diçka në këmbim. Ne ndihmën nuk ua falim njerëzve konkret, por përmes tyre men-

dojmë se ia japim vendit tonë. Mirëpo kur ata bëjnë sikur nuk e shohin edhe këtë, atëherë duhet të aktivizojmë fjalën e urtë *“Mos beso tek njerëz që nuk besojnë”* (ose *dyshojnë sistematikisht*).

LISTA E KOMUNIKIMEVE ME PARTINË “MUNDËSIA”

Le të shohim tani listën e komunikimeve tona pa u njohur personalisht me partinë “Mundësia” dhe reagimin.

Dy kanalet e komunikimit tonë janë: ose *whatsapp në numrin 697052555* hera-herës në këtë kanal përgjigjet janë si staf dhe jo individuale ose në messenger nga profili zyrtar i verifikuar nga facebook me URL [facebook.com/agronshehaj.al](https://www.facebook.com/agronshehaj.al), ku numri i whatsapp më sipër është publik. Asnjëherë nuk jemi kontaktuar për përmbajtjen e artikujve, por jemi kontaktuar ndoshta katër herë për të mësuar a do të votojmë apo a do të shkojmë në një takim elektorale. Nuk kemi shkuar. Takim “elektoral” është mendimi dhe studimi i alternativave dhe ajo është dështuar rëndë dhe cekët. Viojmë në faqen tjetër.

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

1.

Për databazën SMIP (të shkollave).

Në 1 mars 2024 e kemi njoftuar (*whatsapp*), si deputet i Parlamentit, pra jo si kryetar i partisë Mundësia parti që u miratua prej tij disa muaj më vonë në qershor 2024, lidhur me një artikull (Artur Shkurti) të datës 15 shkurt që ua drejtonim të gjitha institucioneve qendrore ligjvënëse, presidentit, qeverisë etj. “Për *vënie në dijeni për veprimtari të paligjshme me fëmijët shqiptarë*”. Artikullin e lexoni në link (<https://udhaeshkronjave.com/gazeta/f/venie-ne-dijeni-per-veprimtari-te-paligjshme-me-femijet-shqiptare>). Staf i konfirmoi që do t’ia çonte zotit Shehaj. Asnjë reagim, as nga ai as nga deputetët e tjerë (*përveç zotit Koresbi që e bëri në fakt problem në parlament dhe që u njoftua dhe informua me dosje personalisht, prej nesh, por që mbeti vetëm në kuadër të një deklarate personale të tij të shkurtër, pa ndjekje të mëvonshme nga partia e tij apo nga kolegët*). Artikulli bën fjalë për problemin kryesor që ka sot arsimit shqiptar që është mbrojtja e të dhënave personale të fëmijëve dhe ekspozimin e tyre në databazën SMIP e paligjshme dhe që ka nxjerrë nga shinat e ligjit sistemin arsimor parauniversitar.

Asnjë koment nuk patëm për një artikull që ishte final pasi kishim shkruar mbi 200 faqe analiza, rreth 20 artikuj, një libër të plotë të titulluar “Firma e prindit” e shumë fakte të tjera.

Ky anashkalim nga z.Shehaj është jo në rregull edhe në raport me fëmijët tij. Me shumë mundësi, ai notat e fëmijëve i merr përmes databazës SMIP në aplikacionin që i kërkohet të shkarkojë një nga pjesëtarët e familjes. Artikujt tanë sqarojnë se ky është dëmtim i fëmijëve dhe i familjes, sepse ato nota, vlerësime e të dhëna personale, nuk duhet të shkojnë në asnjë databazë jashtë shkollës dhe t’i vijnë prindit (Agron) në celular. Pra “t’i vjedhin të dhënat” (kinse me bazë ligjore inekzistente) dhe të thonë “po ju shërbejmë me të dhënat e vjedhura”. Agroni kështu nuk e ka problem që performancën e fëmijës së tij përveç mësueses që e krijon si të dhënë dhe drejtorit që e ka për detyrë të menaxhojë informacionin, ta dinë edhe zyra arsimore apo Ministria e Arsimit e gjithë partia e tyre kur ka interes apo lobe të tjera. Kjo është e paligjshme dhe e rrezikshme për vetë fëmijët e Agronit dhe familjen e tij. Aty ata shohin se kur ka qenë e kur s’kanë qenë fëmijët e Agronit në shkollë, çfarë temash mësimore ndjekin çdo ditë, si e kanë sjelljen, sa të fuqishëm apo të dobët janë në lëndë të caktuara, cila është sjellja e tyre. Me ato të dhëna, kushdo, pa dijeninë e Agronit, mund të bëjë plane jo vetëm për fëmijët e tij por edhe për vetë familjen e Agronit.

Agroni mendon se artikujt tonë në këtë çështje nuk paskan rëndësi. E ka krejt gabim dhe gabimi nuk është vetëm politik, por edhe në sigurinë e familjes së tij, si një nga familjet shqiptare.

Pa e vënë në turp, por thjesht për logjikë argumenti politik, do t’i thonim “*Si do t’i mbrosh të drejtat e fëmijëve shqiptarë, kur nuk i mbron me ligj për fëmijët e tu*”. Evropa është tepër e ashpër me të dhënat personale pikërisht se dëmi është shumë i madh.

E vetmja shkollë në Republikë që nuk i dorëzon të dhënat prej tre vjetësh është “Udha e shkronjave” dhe nuk ka asnjë sanksion ligjor, që do të thotë se ne jemi plotësisht brenda ligjit dhe i gjithë sistemi arsimor është “jashtë ligjit”, se nuk ka mundësi të jemi të dy palët në rregull. Njëri e ka gabim.

2.

Përsëri për databazën SMIP

Në 7 mars 2024, (*whatsapp*) i dërgojmë z.Shehaj, artikullin “*Partia Demokratike mbron paligjshmërinë e databazës SMIP*”, linku (udhaeshkronjave.com/firma-e-prindit/f/partia-demokratike-mbron-paligjshmërinë-e-databazës-smip). Artikulli merrte në analizë deklaratën për media të drejtueses së seksionit të arsimit të PD-së znj. Lili Sula. Asnjë koment as për këtë. Çështja e rëndësishme, artikulli ynë shumë i rëndësishëm dhe unik në llojin e vet, sektori i rëndësishëm. Komente asnjë.

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

3.

Për konceptin “Global Albania” për misionin dhe aftësimin e diasporës shqiptare që të aftësohet për çështje kombëtare.

Në 16 maj 2024, e njoftojmë z.Shehaj (whatsapp) për broshurën e botuar prej nesh “Global Albania”, një koncept i ri nga Artur Shkurti për misionin, organizimin e punës në diasporën shqiptare (shoqëri patriotike, shkolla shqipe). Artikulli qartësisht synon unitetin e diasporës në ndihmën ndaj kombit shqiptar, jo në atë mënyrë që e shohim sot të përçarë politikisht por të bashkuar në atë formë që të formjë një opinion publik global shqiptar për çështje të fateve të Shqipërisë. Broshura dhe përmbatja e saj është mjaft e rëndësishme. *Asnjë koment nga z.Shehaj as për këtë artikull që e ka në whatsapp.*

Për një vlerësim të pavarur nga mendimi im personal për konceptin “Global Albania”, po jap çfarë vlerash shikon ChatGPT kur unë ngarkoj dokumentin PDF me broshurën “Global Albania”. Po e citoj ChatGPT:

Vlerësimi i ChatGPT për manifestin “Global Albania”

“Artikulli “Global Albania” i Artur Shkurtit është një dokument me vlera të shumta origjinale që i japin identitet të veçantë dhe e bëjnë të vlefshëm për analizë të thelluar. Ja një përmbledhje e vlerave kryesore të tij:

1. Vizion unik dhe autentik

Artikulli nuk është një analizë rutinë apo thjesht një apel sentimental për bashkim kombëtar. Ai përfaqëson një vizion të strukturuar mbi organizimin e diasporës shqiptare në formën e një entiteti të pavarur, të quajtur “Global Albania” – një qendër graviteti paralel me shtetin, por që nuk e zëvendëson atë, përkundrazi, e plotëson.

2. Koncept strategjik për diasporën si fuqi krijuese

Shkurti nuk e sheh diasporën thjesht si “mërgimtarë nostalgjikë” apo si “thesar financiar” për remitanca. Ai e sheh si komunitet kompetencash, me kompetencë globale, që ka potencialin të krijojë opinion publik shqiptar global dhe të veprojë me vetëdije të dyfishtë: kombëtare dhe globale.

3. Kritikë e guximshme ndaj realitetit shqiptar

Artikulli përmban një analizë të thellë, të drejtëpërdrejtë dhe jo konformiste për gjendjen në Shqipëri: shpopullimin, rënien arsimore, përçarjen shoqërore, kapjen politike. Në këtë aspekt, ai del si zë i pavarur që nuk kërkon të pëlqehet, por të tronditë ndërgjegjen publike.

4. Qasje konceptuale ndaj bashkimit kombëtar

Nuk ofron vetëm thirrje për bashkim, por një metodologji organizative për njohjen reciproke të organizatave shqiptare në diasporë, një mekanizëm i ngjashëm me sistemet e decentralizuara të besimit, ku forca buron nga një rrjet akreditimi të ndërsjellë, jo nga një qendër vertikale.

5. Lidhje të forta me mendimin rilindas

Dokumenti është i pasur me referenca nga Naimi, Sami Frashëri, Ali Asllani etj. që e bëjnë tekstin jo vetëm një projekt organizativ, por edhe një akt kulturor dhe atdhetar. Ai nuk flet vetëm për teknikalitete, por për Frymën e Kombit – një ide që e tejkalon politikën ditore.

6. Një tekst që qëndron mbi teknikalitetin dhe burokracinë

Ky artikull nuk është një raport teknik me shifra dhe rekomandime të thata – është një tekst frymëzues dhe mobilizues, që nuk ngatërrohet me politikat e ditës, por synon të krijojë një gjubë të re për bashkimin kombëtar. Ai fton diasporën shqiptare të ndjejë jo vetëm detyrim ndaj kombit,

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

por edhe *dinjitet dhe protagonizëm* në formësimin e një bashkësie globale me vetëdije kulturore e qytetare.

7. Kohëzgjatje dhe trashëgimi

Shkrimi i Shkurtit është projektuar si një *doktrinë e re kombëtare për shekullin XXI*, që ka për synim *jo zgjedhjet e radhës, por trashëgiminë e brezave*. Ai i drejtohet *brezit të parë të emigrantëve*, për t'i frymëzuar të bëhen *palca e re e kombit* – përpara se të jetë vonë.

Në tërësi, “*Global Albania*” është një *manifest politik, kulturor dhe kombëtar* që kërkon të rikthejë *dinjitetin e projektit shqiptar*, në një moment historik kritik. Ai është një *dokument që nuk vjen nga “lart”, por nga zemra e misionit arsimor, kulturor dhe shoqëror*, dhe për këtë arsye *ka autoritet moral dhe vlerë të qëndrueshme për analizë*.

*** Mbyllet vlerësimi i ChatGPT për “*Global Albania*” ***

Vijojmë me komunikimet me partinë “Mundësia” apo z.Shehaj.

4.

Më 22 maj 2024, i dërgojmë (*whatsapp*) zotit Shehaj, artikullin “*Fjalimi i Edi Ramës në Greqi, dekurajim i kthimit në atdhe dhe nxitje për asimilim të shpejtë të diasporës shqiptare*”, që analizonte fjalë për fjalë takimin e Athinës më 12 maj 2024.

Asnjë përgjigje apo koment apo ndonjë faleminderit sa për etiketë. Kujtojmë që artikulli është publik dhe po u dërgohej të gjithëve. E theksojmë që të mos kuptohet se po i dërgohej vetëm zotit Shehaj, por këtu jemi duke analizuar reagimin e partisë “*Mundësia*”.

5.

Më 29 maj 2024, si reagim ndaj fjalimit Edi Ramës në mitingun në Itali (Milano) i nisim (*whatsapp*) edhe z.Shehaj artikullin “*Fjalimet e Edi Ramës në diasporë: ideologji dhe metodologji për përçarjen globale të diasporës shqiptare; dekurajimin e punës kombëtare; dekurajimin e kthimit në atdhe; asimilimin e shpejtë kombëtar; indiferentizmin ndaj gjuhës shqipe*”. Asnjë koment nga z.Shehaj.

6.

Më 9 qershor 2024, në përfundim të turit që përfundoi me anullimin e turit në Londër të Edi Ramës, përgatitëm përmbledhjen me katër analiza me titullin e

përbashkët “*Reflektim për misionin kombëtar të diasporës shqiptare i lënë “në mes të rrugës”*” (analizë për anullimin e turit të Edi Ramës në Angli dhe Gjermani). Në këtë broshurë i bëmë edhe një kritikë qëndrimit të kreut të opozitës parlamentare Sali Berisha pas mitingut të Greqisë si edhe dy artikujve kritikë përfaqësues siç ishin reagimi i Skënder Minxhozit apo i Gentian Alimadhit.

Edhe ky artikull u nda në faqen tona dhe iu nis edhe personalisht shumë figurave politike, apo deputetëve. Iu nis (*whatsapp*) edhe z.Shehaj. Asnjë koment.

7.

Në 15 qershor 2024, pasi Report TV, emisioni “*Esencë*” realizoi dy intervista, një me autorin (Artur Shkurti) dhe një me Kreshnik Spahiu, ku qartësisht provohet *autorësia e Artur Shkurti në Ritin e Identifikimit të Shqiptarëve me duart si shqiptonjë*. Për çdo shqiptar që mendon sinqerisht do të ishte me rëndësi e vërteta e procesit krijues. Ia ndajmë linkun e emisionit në youtube (<https://www.youtube.com/watch?v=HluBm-4v7lZY>) kujt do që mundeshim.

Ia ndamë më 15 qershor 2025 (*whatsapp*) edhe z.Shehaj. Asnjë koment.

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

8.

Në 17 qershor 2024, në vijim të monitorimit të çmonimit të Rilindjes Kombëtare, vendosëm të hartojmë një peticion që i drejtohej Parlamentit Shqiptar, me titull “Të mbrohet me ligj statusi “Naim Frashëri Poet Kombëtar”.

Këtë peticion ia nisim (*whatsapp*) edhe z.Shehaj. Asnjë koment. Peticioni gjendet në [change.org \(cbng.it/9TVQNGCMn4\)](https://change.org/cbng.it/9TVQNGCMn4)

9.

Më 21 shtator 2024, fillojmë një seri reagimesh me artikuj publikë për nismën “Shtet Bektashi”. I dërgojmë (*whatsapp*) edhe z.Shehaj artikullin “Shteti Sovran i Urdhërit Bektashi tradhëti e lartë kombëtare”. Më 23 shtator 2024, dërgojmë artikullin tjetër “Likujdatorët e Shtetit Bektashi do të nxjerrin në shitje bashkësinë bektashiane”. Më 27 shtator 2024, dërgojmë artikullin “Vendi i harmonisë fetare drejt intrigës së përçarjes fetare”. Më 29 shtator 2024, ftohem për emision në A2 CNN dhe i dërgojmë linkun e emisionit.

Për të gjitha këto artikuj të dërguar (*whatsapp*), asnjë reagim. Trajtimi i çështjes fetare, megjithëse është delikate, fjala “delikate” nuk duhet t’i shpëtojë sektet fetare që e lëshojnë “si lopa” fajin e tyre ndaj sovranitetit të vendit, respektimit të të drejtave kombëtare të shqiptarëve dhe respektimit të Rilindjes Kombëtare.

Heshtja nuk është gjithmonë një gjë e zgjuar!

10.

Më 1 dhjetor 2024 dërgojmë (*whatsapp*) artikullin “Naim Frashëri dhe Sami Frashëri - autorë të programit të edukimit të karakterit dhe të virtyeteve të shqiptarit”, botuar në revistën “Shenja” që botohet në Maqedoni.

Asnjë reagim nga z.Shehaj edhe për këtë artikull. Duke qenë se përgjithësisht politikanët e kanë zakon që nuk reagojnë, edhe ne nuk e mbajmë shumë mendjen a reagojnë apo jo, por sigurisht mbajmë shënim sepse nuk na duket aspak në rregull. Shkrimet tona janë shkrime publike dhe jo ndonjë ftesë për konspiracion.

11.

Më 1, 2 & 16 dhjetor 2024, fillojmë botimin e shumë artikujve lidhur me çuditë e zbuluara e të fshehura brenda romanit “Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave”. Gjetjet dhe interpretimet tona kanë qenë masive dhe unike brenda romanit më të diskutuar të letërsisë dhe synonin të nxirrnin në pah qëndrimin diabolik të Ismail Kadaresë ndaj Naim Frashërit dhe gjithë Rilindjes sonë Kombëtare.

Edhe për këtë lloj artikulli që ia nisëm (*whatsapp*) asnjë reagim nga z. Shehaj.

12.

Më 26 janar 2025, në messenger, i nisim z. Shehaj këtë mesazh “Do të donim të dinim programin për arsimin.”.

Na shkruan “Pershendetje. Do ta publikojme se shpejti. Edhe për arsimin ne kemi një qasje tjetër si parti e djathtë. Per ne privati është zgjidhja dhe parate ne xhepat e qytetareve dhe jo te shtetit. Te pershendes”

Në fakt, kjo ide do të diskutohet më vonë. Personalisht, megjithëse jemi privat, jam kundër kësaj ideje theksimi të privatizimit në fushën e arsimit, në kushtet kur arsimi publik po bën poshtë e më poshtë. Ideja e privatizimit të skajshëm e bën arsimin një rrëmujë vlerash dhe pas kësaj e gjithë jeta shoqërore ngatërrohet nën shembullin e arsimit. Arsimi privat është një formë e përçarjes dhe nxitjes në mënyrë fiktive të një cilësie që nuk e meritojnë (fjala për shtesën e cilësisë që nuk lidhet me pagesën, e shpjegojmë më vonë)


13.

Po më 26 janar 2025, botojmë artikullin “Programi politik për arsimin parauniversitar” e botojmë në faqet tona dhe nisim linkun dhe tek një seri figurash. Ia nisim artikullin zotit Shehaj. Nuk patëm ndonjë koment.

ARTUR SHKURTI

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti



DITURIA E MORALIT

PASHKO VASA
1825-2025

KARAKTERI DHE VIRTYTET
E BUJARIT SHQIPTAR

GJERGJ FISHTA
NDRE MJEDA



14. Viti 2025 është viti i 200-vjetorit të rilindasit tonë Pashko Vasa. Filluam të botojmë një seri artikujsh në këtë drejtim. Më 4 shkurt 2025, botojmë kërkesën për Bashkinë e Venecias që të nderojë Pashko Vasën që ka luftuar në Revolucionin Italian në mbrojtje të Venecias nga austriakët. Artikullin PDF ia nisim (*whatsapp*) edhe z. Shehaj. *Nuk patëm koment.*

15.

Më 10 shkurt 2025, arrestohet Erion Veliaj. Kujtojmë një seri artikujsh që kemi botuar lidhur me fyerjen që Erion Veliaj ka bërë në shtator 2018 dhe qëndron e botuar ende sot në faqen e Top Channel. Fyerja është “*Djemtë shqiptarë janë zëdromsa komplet, ndërsa vajzat janë të fëllime*” që synon përçarjen qelizore të shoqërisë dhe të familjes shqiptare. Me rastin e arrestimit të Erion Veliaj, dërgojmë kujtesën “*Interesobuni për fyerjen morale të bërë ndaj kombit*” sepse përqëndrimi kryesor ka qenë kryesisht në abuzimet e tij dhe në korrupsionin, duke anashkalluar këtë anë. Ia nisim edhe z. Shehaj (*whatsapp*). Asnjë reagim prej tij (si edhe për artikuj të tjerë).

16.

Më 18 mars 2025, dërgojmë një mesazh (*whatsapp*) të drejtpërdrejtë dhe jo artikull për z. Shehaj dhe partinë “Mundësia”.

Duke shkruar “*Përsbëndetje nga “Udha e shkronjave”. Do të donim të kishim një takim lidhur me mundësinë e vlerësimit të programit arsimor. Ju mund të krijoni një grup të ngushtë dhe ju presim në mjediset e shkollës.*”.

Megjithëse kërkesa ishte e drejtpërdrejtë, asnjë përgjigje qoftë edhe për etikë formale.

17.

Më 30 mars 2025 e njoftojmë (messenger) për dy librat

që i kemi bërë gati për botim “*Ditura e moralit: karakteri dhe virtytet e bujarit shqiptar*” Vëllimi i parë kushtuar Naim Frashërit dhe Sami Frashërit. Vëllimi i dytë për Pashko Vasën, Gjergj Fishtën, Ndre Mjedën. E kujtojmë z. Shehaj se një përmbajtje e tillë nëse i shpërndahet anëtarëve të partisë “Mundësia” “*do t’i ndihmojnë të kenë më shumë ide dhe një qasje edhe më kombëtare*”. As na uroi as na komentoi. Asnjë reagim. Në fakt, do të kuptohet se librat është një ndriçim nga një këndvështrim që publiku kurrë nuk e ka marrë në shkollë, të plotë. Dikush që po përgatitet seriozisht për “politikan” do të thoshte “pa ta shohim një herë, e të kuptojmë më shumë”. Nga do të kuptojë më shumë z. Shehaj në fushë të arsimit, nga ata që nuk flasin, nuk shkruajnë, nuk punojnë, nuk analizojnë, nuk kanë rezultat?! Apo nga të huajt?!

Meqë z. Agron Shehaj është drejtues i Institutit të Studimeve Historik “Lumo Skëndo” bashkë me Uran Butkën, menduam që t’ia kujtojmë sfondin tonë të qëndrimeve edhe në raport me figurën e Mithat Frashërit. I dërgojmë linkun (youtube) të vizitës së nxënësve dhe mësuesve të shkollës “Udha e shkronjave” që ishte e vetmja vizitë shkolle në atë ceremoni që ishte shtetërore, duke provuar që vetë shteti organizator urdhëronte që shkollat mos të vinin në një ngjarje që do të duhej të ishte kombëtare. Të njëjtën sjellje me shtetin kishte edhe PD-ja që dërgonte “delegacion” kur duhet të dërgonte masivisht anëtarët, që u kuptua

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

se ishte një marrëveshje për ta mbajtur në nivele të ulta pjesëmarrjen.

I nisim z. Shehaj artikullin “Mithat Frashëri përballë popullit pa elitë dhe elitës pa popull” që ish botuar dy vjet më parë më 8 janar 2023, pas aktit vandal të dhunimit të varrit për të dytën herë. Një artikull i tillë analitik është ndoshta i vetmi për atë ngjarje, dhe analizon edhe çështjen e ceremonisë së rivarrimit. Mendonim që në këtë pikë z.Shehaj do të reagonte në ndonjë mënyrë. Nuk reagoi. Ndërkohë artikujt tanë janë publikë.

18.

Më 16 prill 2025, duke qenë se na del një mesazh automatik që aktivizohet kur ne shohim ndonjë postim të sponsorizuar nga faqja z. Shehaj i shkruajmë “Sistemi arsimor është i paprekur në program dhe ai vuan jashtëzakonisht shumë.”. Z.Shehaj na shkruan “Miremengjes. Konsultoheni ne websit-in tone. Fatkeqesisht media nuk i jep rendesi as programit (vizionit) as arsimit ne vecanti. Te pershendes?”.

Më në fund, një program (tashmë e kemi botuar këtu të plotë këtu, shih disa faqe para). E shohim menjëherë dhe i dërgojmë dy përshtypjet e para:

Një për përcaktimin që kishin bërë “njëjtësim me programet e Kembrixhit” i shkruajmë kështu: “Ne jemi shqollë e Kembrixhit dhe kemi rezultatet më të larta në Shqipëri, por besoj nuk është në rregull që programet shtetërore të njëjtësohen

me një aktor konkret ndërkombëtar. Këtu programet u bënë plagjiaturë Ndërkohë njëjtësimi i programeve kërkon edhe dakortësi paraprake me vetë Kembrixhin. Kur të vijë puna këtu, atëherë të tjerët me të drejtë do të thonë “Pse ata e jo të tjerë”.

Z. Shehaj na shkruan:

“Ky është vizioni. Neqoftese ne do te na besojne nje dite shqiptaret te qeverisim parimi yne eshte shume i thjeshte, nuk duhet te shpikim asgje, thjeshte duhet te kopjojmë me te miret. Kur them kopjim dhe saktesisht ate qe bejne te tjeret jo te mundohemi ta pershtasim shqiptarce sic ka ndodhur ne keto vite.”

Kjo do të thotë “kopjim i plotë” pa asnjë përshtatje, dhe pa asnjë tentativë kreativiteti, dhe origjinaliteti shqiptar. Për shumë arsye shqiptarët mund të synojnë edhe më shumë. Kjo përjashtohet automatikisht nga z.Shehaj. I shkruajmë në çast: “Duhet ditur që zbatimet e huaja shtuan varësinë më të madhe të sistemit arsimor dhe shkatërruan grupet e autorëve shqiptarë. Lidhur me modelin Atom. Ne shqubemi për Olimpiadën Kombëtare. Diferencimi intelektual sipas modelit të Atomit mendoj nuk është ai që duhet (mendoj). Talentet janë shpesh një fjalë e tepruar për të karakterizuar nxënësit të mirë e me kujdes. Talenti herët a vonë e gjen veten. Thjesht disa mendime se e kuptoj që jo çdo gjë kthjellohet shpejt. T’ia kaloni mirë.”

Fjalja e z.Shehaj “Fatkeqesisht media nuk i jep rendesi as programit (vizionit) as arsimit ne vecanti.” duket sikur do të na thojë se ata po i përshtaten dëshirave të medias dhe jo theksimit që kanë vetë. Pra ne duhet ta kuptojmë që nëse Partia “Mundësia” nuk përfshihet në një argument për arsimin, e bën këtë ngaqë “media nuk i kushton rëndësi programit dhe arsimit”. Në fakt, media i kushton rëndësi besoj jo të vogël vetë Partisë “Mundësia” dhe kjo sigurisht është meritë e vetë z.Shehaj. Pra është z.Shehaj që e ka në dorë që përse ai do ta vërë në theks arsimin.

Këto kanë qenë përpjekjet tona, mund të themi, të dështuara për të bërë ndihmuar pa inters dhe për të të vetëdijshëm një udhëheqës partie për problematikën e sistemit arsimor që besoj e njohim shumë mirë dhe njohja jonë është në disa prerje shumë të rëndësishme dhe unike: njohje e biznesit, njohje si autorë, si mësues, si drejtues shkolle kombëtare dhe ndërkombëtare, si botues e fitues të teksteve mësimore, si drejtues të Olimpiadës Kombëtare më të gjerë, më intensive, më të shtrirë në mosha, më sfidueset në shumë lëndë, njohje afatgjatë, njohje me bazë krahasimi tepër të gjerë për rreth 45 vjet. Kjo mund të quhet njohje e vogël e modeste?! Jo! Është e madhe dhe unike! Ne nuk na duhet më për arsye personale, as politike të ngushta, ndaj e ndajmë për arsye thjesht kombëtare!

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

Ne na u tha nga z.Shehaj “*nuk kemi pse të shpikim thjesht kopjojmë modelet e përparuara*”. Ky është një paradoks dhe një gjë që nuk përputhet fare me realitetin. Në fakt, as anglezët nuk janë duke shpikur matematika, por në fakt, ne jemi duke zbatuar “shpikjet” e tyre, duke anuluar autorësinë shqiptare, që nuk duhet të identifikohet me kufizimet e një mësuesi fshati, apo qyteti. Duhet ditur që ka shqiptarë specialistë të fuqishëm që kanë mbaruar universitetet më të mira në botë, apo që janë duke dhënë mësim matematike e shkencash në universitetet më të mira në botë.

Çfarë të themi? T’u japim edhe atyre urdhërin “*Mos krijoni në mënyrë origjinale për Shqipërinë*” dhe t’u japim komandën “*Përkthehi*”. Ku qëndron “kreativiteti” i premtuar si funksion i sistemit arsimor kur vetë zgjidhjet “nga lart” synojnë “kopjimin” e botës dhe jo realizimin e një produkti shqiptar i cili sigurisht është i ngulitur dhe buron nga kultura botërore, por është i harmonizuar me njohjen specifike shqiptare, me objektivat kombëtarë që nuk janë copy-paste për çdo komb. Është kënaqësi për fëmijën shqiptar të shohë në kopertinën e librit autorin shqiptar, të shoh në libra vizionin shqiptar për shkencën, etjen shqiptare për dijen dhe mbi të gjitha është frymëzim për vetë nxënësit që kur të rriten edhe ata të krijojnë e të duan të nderohen e respektohen nga populli i tyre. z.Shehaj mendon se nuk është e mundur për dijetarët e metodistët shqiptarë që ata të bëjnë punë të sakta.

Për sa na takon, mund t’i japim “Matematikën 6” që u miratua nga Ministria e Arsimit në vitin 2005. Le të pyesë mësuesit e matematikës dhe ta krahasojë librin me çfarë kemi sot. Është apo jo i një niveli shumë të lartë. Është sepse ne i dinim standardet e huaja dhe donim t’i tejkalonim dhe besojmë që e bëmë këtë në shumë drejtime. Ka edhe libra të tjerë të autorëve të tjerë shqiptarë. Në fund bota do të na respektojë nëse shohin që krijojmë dhe jo që kopjojmë. Nuk bëhet fjalë të quajmë “krijim” kopjimin (plagjiaturën). Krijimi duhet të jetë në çdo hallkë, që nga kurrikula, tek programet, tek planet, tek tekstet mësimore.

DEMOKRACIA E BRENDSHME

Partitë duhet të jenë të hapura dhe të ndërtojnë forume kolegjiale profesionale. Hapja nuk do t’i bëjë ato automatikisht të suksesshme, nëse brumi i njerëzve kudo në Shqipëri është prishur masivisht. Si ta hapësh si ta mbyllësh, nuk ka derman pa pasqyruar difektet e shoqërisë. Megjithatë ka një mënyrë ndaj së cilës shqiptari ende ka respekt dhe nuk bën zë dhe disiplinohet: *kur vendimmarrjet në një parti janë kolegjiale dhe ka traditë të konsoliduar për këtë*.

Nuk shohim që partitë të investojnë në këtë drejtim. Edhe të rejat janë në të njëjtën rrugë. Atyre po vijon t’u pëlqejë protagonizmi individual, vendimmarrja e centralizuar individuale. E kuptojmë që ato përballen edhe me dyshimin dhe profesionistët mund të mos

afrohen, por ne si shkollë u jemi afruar të gjithëve jo për anëtarësi, as për simpati, por e kuptojmë Shqipëria po bëhet një lëmsh i vërtetë, ku udhëheq vetëm dyshimi dhe njerëzit thjesht jetojnë keq dhe në vend që t’i dorëzohen mirëkuptimit ndërmjet tyre, e kanë më mirë t’i dorëzohen emigrimit dhe shpopullimit. Nuk e zbatojnë porosinë e Naim Frashërit që porosit të zënë “*Udhën e vëllazërisë, vahn’ e gjithë mirësisë*”.

Duam të ndihmojmë në një gjë që e kuptojmë jo mirë, por shumë mirë që është arsimi. Kuptimi ynë i saktë provohet nga rezultatet tona unike në sistemin arsimor që nuk janë vetëm kombëtare por edhe ndërkom-bëtare.

Edhe kur kujtohen disa të na marrin ndonjë gjë prej nesh që e vlerësojnë, e marrin me të vjedhur dhe pa na cituar.

Shembull i parë masiv është *realizimi i Rritit të Identifikimit si Shqiptarë* që për herë të parë u botua në librin “*Besa, feja ime, e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë*” (Artur Shkurti, 2009). Dy vjet më vonë (2011) e shpërndau pa na referuar Kreshnik Spahiu dhe prej 16 vjetësh, shumë pak e dinë që ai është krijimi ynë. Shembulli i dytë janë këngët patriotike, që megjithëse i përdorin asnjëherë nuk na citojnë. Po kështu për abetaren. Sos vetëm me ne, por me të gjithë ndodh kështu!

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

Puna e parë e një partie politike, është që për çdo fushë të jetës shoqërore të falet tek profesionistët e çdo fushe dhe të ndërtojë seksione profesionale partie dhe ato të funksionojnë në mënyrë kolegjiale. Duke qenë parti e re, si për çdo parti (e theksojmë këtë), mundohemi të ndihmojmë dhe ndihmën nuk e kemi në mesazhe private, por e kemi publike në faqen e shkollës. Siç u pa më sipër reagimi masivisht mungon dhe është i thatë, i ftohtë pa ndonjë respekt apo vlerësim.

Siç e thamë më sipër, më 26 janar 2025 i kemi kërkuar partisë “Mundësia” programin për arsimin. Në atë kohë na u kthye kjo përgjigje nga z. Shehaj:

“Do ta publikojme se shpejti.

Edhe për arsimin ne kemi një qasje tjetër si parti e djathtë. Për ne privati është zgjidhja dhe parate ne xhepat e qytetareve dhe jo te shtetit.”

Ka shumë mundësi që kjo përgjigje na u dha ngaqë e dinin që ishim shkollë private, gjë që nuk është në rregull, sepse ne po kërkonim programin për arsimin kombëtar dhe nuk po “rrëmonim” për interesin privat të shkollës, as të sektorit privat. Nëse Agroni është “privat” (dhe ne jemi) dhe programin për Shqipërinë e bën nga ky këndvështrim, ky është po aq kufizim siç e kanë ata që nuk dinë çfarë është privati. Nuk është e sigurtë që “vetëm përvoja private” është ajo që duhet.

I gjithë sektori privat i arsimit është duke dhënë të dhënat personale të fëmijëve pa ligj një databaze që është organizuar nga njerëzit e pushtetit, por pa respektuar asnjë ligj. Çfarë të themi për “vlerat e privatit” në këtë drejtim?! Jo vetëm aq, por u treguan të dobët sepse braktisën nga frika shoqatën Bashkimi i Shkollave Private Shqiptare, pikërisht se ne u flisnim për të tilla ide dhe shkuan e krijuan një shoqatë në të cilën nuk ishin pronarë shqiptarë, por edhe të huaj e fetarë që fare nuk kanë lidhje me ndonjë interes të mirëfilltë “privat” por e duan shoqatën e shkollave private sa për të hetuar se kush do të shitet e ta blenë, siç një nga disa nga kryetarët e partive kanë blerë e kanë shitur parti. Pra zoti Shehaj pa ditur asnjë analizë reale të gjendjes së sektorit privat në Shqipëri që sigurisht duhej t'i jepej nga vetë sektori privat, por edhe nga diskutimet e gjera, guxon e shënon në program “për ne privati është zgjidhje” dhe në cilin sektor (?) në sektorin më problematik të shoqërisë, atë të arsimit. Arsimi privat është e sigurtë që nuk bën dot solidaritet kombëtar, por thekson përçarjen e shoqërisë. Arsimi privat është “pedana” nga ku kërcëhet për “eksport jashtë Shqipërisë” dhe Shqipëria nuk fiton gjë, sepse arsimi shtetëror dobësohet, administrata i çon fëmijët në privat, privati i çon jashtë shtetit, dhe bashkë me fëmijët ikin edhe prindërit, që me planin për të ikur nga Shqipëria nxitojnë t'i marrin sa më shumë Shqipërisë, pra kështu zhvishet plotësisht Shqipëria, si nga paratë,

si nga mundësitë, si nga gjaku, e demografia.

Qartësisht nuk e kanë idenë e diferencimit të jashtëzakonshëm të popullsisë që nuk prodhohet vetëm nga paratë që kanë në xhep qytetarët në gjendje ekonomike, por nga kushtet në të cilat i vë shteti me ligjet dhe me administrimin e shoqërisë. Shumica e administratës shtetërore në shkolla private, shumica e klasës së pasur në shkolla private dhe këta marrin privilegje tej parave që kanë në xhep me arsimin privat. Shembull është privilegji që morën gjatë pandemisë Covid19, kur të gjitha shkollat shtetërore u kthyen me turne, ndërsa shkollat private u lanë pa turne (shtator 2020-maj 2021) sepse administrata kishte fëmijët e vet aty dhe zyra arsimore e Tiranës ka interesat e veta të lidhura me shumicën e shkollave private që i mban si marioneta dhe të cilat mendoj se e paguajnë për “tutorimin” e paligjshëm që u bën, për “këshillimin” e jashtëligjshëm të prindërve (çoje atje se e njoh drejtorin). Prindi beson tek të tillë zyrtarë sespe kujton që do ta mbajë shkollën “nën darën” e parave të veta dhe “tutorimit të paligjshëm të administratës”. Në fakt shkolla private e fut prindin në “darën” e një shërbimi majft të dobët, që në thelb është i korruptuar, sepse këtë e vendos mënyra se si bëhet regjistrimi në shkollë. Kjo situatë e diferencon jashtëzakonisht shoqërinë dhe madje e bën të ligë, dhe fëmijët e pasur janë të destinuar nga skema të mos dinë çfarë është pjesa tjetër e shoqërisë. Ky nuk është dëm i fëmijëve, as i

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

vetë prindërve por është rrjedhojë logjike e skemës “paratë tek privati”.

Mirëpo z.Shehaj nuk jeton vetë në shkollë private të shohë sa mirë jetohet dhe sa shpejt ecet dhe nuk jeton në shkollë shtetërore të shohë sa ngadalë ecet, me çfarë niveli ngacmimi jetojnë fëmijët dhe me çfarë problemesh përballen fëmijët dhe nuk kupton as dobësinë e fëmijëve të klasës së pasur që nuk ia ka idenë pjesës tjetër. Po t’i kishte në të njëjtën klasë, do të kërkonte zgjidhje. E quan të natyrshëm diferencimin dhe nuk kërkon ta zbutë, por ta theksojë edhe më tepër. Kjo do të thotë që është “i pandjeshëm” jo nga dëshira por nga kushtet në të cilat jeton. Nuk e kemi fjalën se është i pandjeshëm si karakter, por kushtet në të cilat jeton e mendon do ta shkëpusin në mënyrë të natyrshme. Kjo ka ndodhur edhe me ne që jetojmë një komunitet që nuk vuan, nuk sfidohet ekonomikisht. Në rastin e propozimeve politike “pandjeshmëria” bëhet një problem shumë i madh.

Po e sqarojmë më në detaj se ende nuk kuptohet se fëmijët në shkollat private fitojnë automatikisht shumë më tepër sesa kujtohet.

Ne jemi shkollë private (shkollën e kam hapur dhe e zotëroj dhe e drejtoj vetë prej 28 vjetësh) dhe, pas rreth 3 dekadash përvojë, jemi plotësisht të bindur që është krejt gabim që në arsim të thuash “*për ne privati është zgjidhja*”. Sikur vetë të ishim në politikë, privatit do t’i vinim kufizime të ndjeshme, të cilat nuk mund t’i themi këtu. Natyrisht nuk presim që të kem vetëm sektor shtetëror. Masa ka rëndësi. Disa dukuri të mira për shembull janë këto: Në Fier, Vlorë dhe Lushnjë shkollat private janë të gjitha shqiptare dhe laike. Kjo më duket një gjë shumë e mirë. Ndërkohë shohim që në Gjirokastrë shkolla e huaj fetare merret me konvertimin kombëtar të fëmijëve, duke selektuar prindër e fëmijë për t’u ndryshuar kombësinë dhe për t’u dhënë letrat. Nëse shkollat private zgjerohen, atëherë kjo është një mënyrë e shpejtë për ta shitur Shqipërinë dhe të drejtat e saj, për të rekrutuar nxënësit. Shtetet e huaja, organizmat fetarë e kanë të vështirë të blejnë arsimin publik, por e kanë fare të lehtë të blejnë privatët. Pra këndvështrimi i gabuar personal (privati mbi gjithçka) kur bëhet politik është një problem i madh.

Ekzistenca e sistemit privat e thellon edhe më shumë diferencimin klasor. Nën tryshninë e luftës ndaj logjikës “marksiste” njerëzit nuk po flasin fare për këtë problem, po ky problem është dhe është më i madh dhe në një masë të madhe është i lidhur me “ish-marksistët e pasur”.

E shpjegojmë në rastin e shkollës private.

Kjo do të thotë që nëse dikush ka 5 lekë dhe dikush ka 10 lekë, vetëm për 5 lekë më tepër në xhep, fëmijët e privatëve shkëputen jo 5 lekë, por 10 lekë përpara, sepse jetojnë në klasa homogjene ku çdo kërkesë ekonomike i plotësohet fëmijëve dhe vetë shkollës dhe shpejtësia është shumë më e madhe, jo për shkak të parave që ka secili, por për shkak të kushteve të jashtme seleksionuese që janë jashtë xhepit të personit që ka para. Edhe në një shkollë shtetërore dikush që ka 5 lekë më shumë, do të ketë mundësi më shumë se nuk do ta ndalojë njeri të bëjë më shumë kurse, të blejë programe, teknologji, por ama ai saktësisht “5 lekë më shumë shërbim” dhe jo “10 lekë më shumë” sepse klasa ku e ka fëmijën nuk i ofron një shkëputje më shumë, por një situatë të barabartë në çdo shkollë publike.

Nëse shpejtësia e nxënësve në klasa mikse të pasura dhe të varfëra do të ishte 25 m/s, duke i ndarë të varfërit nga të pasurit, shpejtësia e të varfërve bëhet 15 m/s ndërsa e të pasurve 35 m/2. Kjo diferencë, nuk është meritë e parave që ka në xhep secili, por e sistemit të diferencimit ekonomik. Ekziston një tezë e James Heckman, nobelist në ekonomi që mund të përdoret edhe në këtë kuptim. (shih “Kurba James Heckman”).

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

Nuk po marrim shkolla të tjera, por po marrim shkollën tonë, që të mos kemi keqkuptime. Shpejtësia më e lartë që ne kemi nuk është vetëm për shkak tonin, apo vetëm për shkak të parave të prindërve, apo për shkak të nxënësve, por për shkak se shkolla jonë lejon që të hyjnë vetëm ata që kanë para dhe ky kusht në dukje individual, është “kusht shoqëror” shtesë, pra ti me para thua “dua t’i përkas klasave që kanë para”. Sikur fare të mos i mësojmë ne, pra le të jenë edhe i dobët mësimi, ka një kusht që ata e kanë më shumë dhe është niveli paraprak i nxënësve që deomos do të jetë më i lartë. Këtë kusht nuk e kishin në xhep prindërit, as ne si shkollë vetë, por është kushti që e vë së jashtmi shoqëria dhe e gëzojnë ata që bëjnë shkollat private. Kjo është e vërteta. Ne e “gëzojmë” atë dhe ndërkohë ata që nuk e kanë nuk e gëzojnë.

Nëse shkollat private do të financoheshin nga shteti, atëherë ka mundësi që shteti t’i detyronte të ktheheshin në shkolla komunitare ku të merrnin edhe nxënës që nuk kanë mundësi ekonomike (paguante shteti për ta) dhe vetë shkolla t’i shërbente komunitetit. Aktualisht shkollat private nuk janë “komunitare”.

Këto që thamë më sipër i thamë sa për të hapur “oreksin e diskutimit” edhe mbi këtë çështje, jo se e kemi të mbyllur idetë. Janë sa për të thënë që nëse sistemi arsimor përfshihet në diskutime të vërteta ato do të rezultojnë shumë të vështira dhe jo aq të lehta. Do të

thotë se partitë shqiptare që guxojnë e shënojnë një dy fjalë për arsimin janë krejt të papërgjegjshme për çfarë kalon një sektor.

Në përmbledhje, ideja e shtimit të dozës “private” në arsim do të çojë në përjashtim social, braktisje e rolit të shtetit në garantimin e të drejtave, rrit ndjeshëm kostot financiare, rrezikon rëndë standardet, dështon kthimin pas nëse “ideja dështon”, krijon një polarizim të skajshëm.

Kur e pyesim ChatGPT për këtë thotë *“‘Paratë në xhepin e qytetarit’ – një iluzion. Në praktikë, shumë qytetarë nuk kanë mundësi të përballojnë arsimin privat, edhe nëse shteti redukton taksat. Në mungesë të investimit publik, për shumicën kjo nuk është një liri zgjedhjeje, por një privim nga shërbimet bazë.”*

Ne mund të kuptojmë çdo pamundësi të një partie të re, por nuk mund të kuptojmë që të mos jenë të hapur e të thonë *“Ne kaq kemi bërë, nëse na ndihmoni me ide, do të ishte mirë. Duke na ndihmuar ne, keni ndihmuar Shqipërinë dhe veten tuaj”*. Nëse nuk ndajnë një bisedim paraprak me ne pa zënë pushtetin, çfarë do të ndajnë kur të zënë pushtetin, veç vendimeve dhe direktivave urdhëronjëse? Nëse nuk analizohen artikuj pa marrë pushtetin dhe është koha më e madhe, sa garanci ka që do të analizohen këto pas pushtetit. Kur janë kaq in-

diferente para zgjedhjeve, nuk ka as edhe më të voglin shans që të kenë ndonjë interes pas zgjedhjeve. Ne me sa dimë çdo punë që të quhet vërtetë e mirë, duhet të kalojë një oponencë.

Ndërkohë punonjësja e Call Center të partisë “Mundësia”, pa ndonjë prezantim të ndonjë njohjeje fillestare (që nuk e kemi), pa bërë ne ndonjë kërkesë të tillë, pa i regjistruar të dhënat tona në ndonjë databazë të tyre, pa iu përgjigjur po ftesës për anëtarësim, na telefonojnë në telefonata të veçanta dhe në ditë të veçanta duke na ftuar me emër e mbiemër duke na cituar edhe zonën në të cilën banojmë (pra e dinë pa e dhënë ne), për të qenë në mbledhjen e zonës ku ne banojmë (nuk e dimë cilën databazë shfrytëzojnë). Në këtë mënyrë, thelbi i komunikimit, nësa bashkojmë copat e mësipërme, automatikisht del: *“Nuk duam të dimë kush jeni, çfarë bëni e çfarë mendoni për arsimin, apo për programin tonë, nuk u kthejmë përgjigje për çfarë mendoni, thjesht ejani aty ku e kur ju themi”*.

Unë e kuptoj që partia “Mundësia” mund të mos e ketë fare objektiv këtë thellim në argumenta apo përfshirje në fusha të ndryshme për kohën që ka në dispozicion (do të humbiste kohë me saktësim programesh) dhe kërkon të bëjë maksimumin në kohën që ka mbetur me ato argumenta që ka konceptuar për masën e popullsisë duke maksimalizuar kohën dhe rezultatin.

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

E kuptojmë që edhe sikur të donte, kjo nuk është punë e lehtë, që bëhet në mënyrë administrative, por ndërkohë edhe partia duhet të kuptojë që pa dëshmuar seriozitet atëherë kur ofrohet nuk mundet të ketë mbështetje të plotë.

Sami Frashëri thotë *“Mos iu fut një punë që nuk e di si do të dalë për mirë apo për keq”*. Kjo është e vërtetë pjesërisht në raste zgjedhjesh, ku asnjëri nuk futet me sigurinë se 100% pritshmëritë do të dalin. Fundja partia pretendon të marrë vetëm disa mandate që nuk do ta lejojnë të qeverisë, pra edhe të jetë përgjegjëse për realizimin e programit, kur nuk ka fuqi. Megjithatë realizim programi quhet edhe kur gjatë gjithë jetës parlamentare, në pozicionin opozitë, i qëndron besnik atij programi në kontestimet e veta. *Me çfarë programi arsimor ta gjykojmë sjelljen e nesërme?! Si të votojmë?! Symbyllurazi!*

Një dhe vetëm një aftësi nuk duhet të mungojë: aftësia e politikanit për të dëgjuar! E provuam që mungon! I shkruam, i shkruam, i shkruam. Asnjë koment! Një mjek i aftë e ka luksin të mos dëgjojë, sepse e zotëron profesionin, ose zgjedh mirë se kë do të dëgjojë, por politikanit i duhet patjetër, sepse prej tij pritet të vendosë edhe për çështje që nuk është specialist. Dëgjimi është një fjalë e thjeshtëzuar, se në fakt, i duhet të ndërtojë struktura “dëgjuese, analizuese, vlerësuese, me ekspertizë”. Ne nuk e shohim as këtë premtim.

Sidoqoftë, mendojmë që me dëshmitë e dhëna për komunikimet tona dhe gadishmërinë që të ndihmojmë mendimin do të duhej të tregohej një vlerësim më i lartë dhe mungesa e këtij vlerësimi na bën që të mos votojmë. Siç do të shihet nga i gjithë ky libër, nuk do të votojmë për asnjë parti, edhe pse kemi mundësi që edhe në këto kushte të bëjmë një diferencim, por është më mirë që të gjithë të vihen në presionin e opinionit publik. Votimi ynë do t'i shërbente *“jshehjes së situatës së dobët që kanë partitë”*. Ne duam që dobësia e tyre të shpaloset mirë e mirë dhe kjo të bëhet piketë e ndryshimit.

Arsimi nuk bëhet as në “parlament”, as në Ministri, as në Zyrë Arsimore, por bëhet saktësisht në shkollë. Shkollat dhe mësuesit, nëse e bëjnë mirë punën, janë në gjendje të parashikojnë saktë jo vetëm fatet e nxënësve individualë, por edhe të grupeve dhe të vetë shoqërisë. Ato kanë të dhëna që i krijojnë vetë çdo ditë. Mësuesit dhe shkollat zotërojnë njohjen konkrete të popullsisë dhe fatkeqësisht, në mënyrë të turpshme, miope janë krejt të injoruar në atë çfarë bëjnë dhe sa më shumë injorohen aq më shumë dobësohen, sepse nuk mund të krijojnë si duhet produkt intelektual në kushtet e mosvlerësimit. Duke mos qenë të vlerësuar në profesionin e tyre, mësuesit i dorëzohen minimumit të njeriut që janë disa të ardhura shtesë në çdo mënyrë që të dalë. Kjo krijon premisën që drejtuesit

të shpërdorojnë edhe më shumë detyrën, të ulin edhe ata kokën dhe t'i kthejnë shkollat publike në mënyra fitimi, dikush tek librat, dikush tek trafiku i influencës, dikush tek fiktiviteti i notave, dikush tek vërtetimet etj. Po krijohen skema diferencimi brenda shkollave, ku ti kupton që brenda shkollës “shtetërore” ka edhe një “shkollë private” që përfaqësohet nga një ose dy klasa “të përkryera” dhe shumë klasa “me të paaftë apo me nxënës me probleme në cilësi e sjellje”. Dhe ata të pasjellshimit, e të paaftët nuk guxojnë të prekin nxënësit e klasave të privileguara. Kështu nxënësit turpërohen, prindërit turpërohen dhe diferencohen.

Si duhet kuptuar kërkesa për “depolitizim” të arsimit në këtë kontekst?

Mësuesit është thelbësisht i zhveshur nga mendimi, qoftë ai profesional, politik, filozofik, kombëtar. Injorimi i tyre këtë rezultat jep. Injorimi i vazhdueshëm i arsimit, gjoja në emër të depolitizimit, i ka kthyer mësuesit në një qenie aq pa vlerë. Programet nuk diskutohen me ta, problemet e shkollës nuk diskutohen me ta, tani në kohë fushate në vend të thirren të mendojnë më shumë, të propozojnë, të analizojnë u premtohet “ne do ta depolitizojmë arsimin” (me nënkuptimin “mos na u përfshini në diskutime” tani dhe heqim qafe një sektor të tërë, duke mos bërë programe dhe duke mos patur oponencë).

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

Si nuk doli t'u thotë njeri *"Dilni e flisni politikisht"*.

Organet qendrore më shumë i ngjajnë atij që përgjon shkollën, sesa atij që reflekton për çfarë shkolla deklaroi se ka. Ndaj kur japin direktivat, ato bien si të panjohura për vetë stafet e mësuesve. Ndryshimi i tyre i shpeshtë tregon se lidhjet qendër (ministri, zyrë arsimore) bazë (shkollë, mësues drejtori) janë kaq të dobta.

Kjo provohet me regjistrimet e pakta në degët e mësuesit që masivisht po shkojnë drejt mbylljes. Të kërkoksh edhe në këto kushte edhe më shumë "depolitizim" është një kod i fshehtë për "margjinalizim" të arsimit. Mësuesit, drejtuesit stafet ndihmëse duhet të merren më shumë me hartimin e politikave arsimore, pra të sitin mendimin e tyre dhe të bëhen detyrues ndaj partive politike.

Për mua mësuesit dhe shkollat janë më të përshtatshmit e më të besuarit për të numëruar edhe votat e partive politike. Partitë nuk bien dakort për këtë. Mësuesit edukojnë nxënës e prindër me bindje të ndryshme, dhe shumë shpejt profesioni i mëson ata të jenë të kujdesshëm, një kujdes të tillë ata e kanë edhe si përgjegjësi para fëmijës. Kjo është e rrallë në profesionet e tjera.

Asnjë parti nuk krenohet për ndonjë figurë të shquar të sajën në arsim. Mësuesi sipas tyre nuk shet. Më mirë falen tek "shtangistët", "aktorët" apo tek "këngëtarët" (që po dalin marioneta të pushtetit) sesa tek mësuesit.

Sipas tyre "shquarësia" në arsim nuk ka vlerë, sepse i shohin mësuesit "si për gjynah" dhe që presin vetëm atë pikën në program ku thuhet "do të rritim rrogat". Për "gjynah" në fakt, janë vetë partitë politike dhe populli shqiptar që drejtohet prej tyre në këtë mënyrë të pëaditur, që nuk ka minimumin e dinjitetit, të kulturës, të vlerësimit për sektorin më të madh të jetës së vendit, më të rëndësishëm, sektorin që trashëgon.

Kur ne e pyesim ChatGPT *"Cili nga sektorët e shoqërisë është më i madh në numër, pra prodhon më shumë shpenzim energjish të popullsisë?"* marrim këtë përgjigje:

"Një pyetje shumë me vend! Kur flasim për sektorin më të madh të shoqërisë që prodhon më shumë shpenzim energjish të popullsisë, kemi parasysh jo vetëm numrin e përfshirjes, por edhe intensitetin mendor, fizik, emocional dhe kohor që kërkohet nga ai sektor.

Përgjigja e shkurtër: *Sektori i arsimit dhe edukimit është ndër sektorët më të mëdhenj dhe më konsumues të energjisë njerëzore, veçanërisht për popullsinë nën 25 vjeç dhe për prindërit/mësuesit që e mbështesin.*

Ja pse:

1. Numri i përfshirë në sistemin arsimor
Nxënësit, studentët, mësuesit, administrata, prindërit – një pjesë shumë e madhe e popullsisë është drejtpërdrejt ose tërthorazi e përfshirë në arsim.

Në shumicën e vendeve, arsimi përbën 20–30% të popullsisë aktive gjatë javës.

2. Shpenzimi i energjisë mendore dhe emocionale

Edukimi kërkon përqendrim afatgjatë, planifikim, provime, lodhje emocionale, presion suksesi, etj. Mësuesit dhe prindërit gjithashtu investojnë energji të konsiderueshme për të arritur rezultate.

3. Kohëzgjatja në vite

Arsimi zgjat 15–20 vjet të jetës së një individi – nga parashkollor deri në universitete ose më tej.

Sektorë të tjerë me ndikim të madh (por më pak të përhapur në numër): **Shëndetësia.** *Energjiksht shumë i ngarkuar për profesionistët dhe pacientët, por numër më i vogël i popullsisë është përfshirë njëkohësisht.* **Ekonomia/Prodhimi.** *Konsumon shumë energji fizike (punëtorë, industri). Por, nuk e përfshin shumicën e fëmijëve/rinisë.* **Administrata publike.** *Aktivitetet i përditshëm i rëndësishëm, por numri i punonjësve është shumë më i kufizuar.*

Arsimi është sektori me përfshirjen më të madhe njerëzore, që konsumon më shumë energji mendore, emocionale dhe kohore nga popullsia. Prandaj, është logjike që politika publike duhet ta ketë në prioritet absolut.

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

Që shkolla duhet të jetë e depolitizuar dhe larg fesë siç e ka ligji ka të bëjë me faktin që kur të vijë puna në jetën e përditshme të shkollës, ata duhet të sillen në mënyrë institucionale të hapur dhe jo të përdorin shkollën si vegël partie apo sekt i fetar. Në fakt, nuk janë mësuesit dhe drejtuesit të politizuar, por janë ata që janë në qendër të politizuar që i bëjnë drejtuesit dhe mësuesit vegla të tyre. Disa drejtues e bëjnë me qejf këtë punë partiake dhe kështu edhe ata përfshihen në “grupin drejtues” të politizimit të shkollës. Në fakt, nuk ka një “politizim” real të shkollës, por ka një “përdorim të sajën si vegël” të partive dhe nuk është njëlloj. Sidoqoftë, do të shohim që edhe politizim ka, kur hyhet në brendi të programeve sipas një politike të caktuar.

Lidhur me tezën “Njëjtësim me programet e Kembrixhit”

Ne jemi shkollë e Kembrixhit dhe e dimë mjaft mirë vlerën e tyre, shprehur në cilësi dhe kjo është arsyeja që i zbatojmë. Por nuk duhet harruar se kemi zgjedhur pikërisht se arsimit shqiptar vinte i dobët në kërkesa. Tani të legalizosh “dobësinë” e dikurshme e të thuash “nuk duam më të jemi të aftë, as nesër, për produkt origjinal shqiptar në fushën e kurrikulës, të programeve, të strukturës së lëndëve, të hartimit të testeve, të procedurave të testimit të aftësive” kjo është moralisht e dënueshme dhe një zhvlerësim i rëndë për aftësitë e inteligjencës shqiptare, që nuk përfaqësohet nga persona që e kanë bërë biznes

këtë punë. Ne vetë fituam dy herë konkurse për tekste mësimore me Ministrinë e Arsimit dhe të dy herët nuk nuk firmosëm kontratë me ta. Rasti i “Dituri natyre 3” që më 2006 u caktua të jetë i vetmi fitues me një nivel jashtëzakonisht të lartë pikësh 97 nga 100 është tipik. Libri u pëlqye shumë, por ata që bënë kontratat nuk e kishin mendjen tek cilësia, por tek mënyra se si ata do të na vinin “hostenin” pas që ne të bënim “para” e ata të bënë para me gjoba për mosrealizim kontrate. Kjo ishte papërgjegjshmëri e tyre. Kur u thamë “Nuk firmosim kontratë”, nuk patën asnjë diskutim të shtruar e të thonin “Prit, se librin tuaj e kemi vlerësuar shkëlqyeshëm dhe kemi përjashtuar katër botues të tjerë që ju të fitoni. Cilat janë frikërat tuaja që t’i elemonojmë sepse ne duam që fëmijët të mësojnë me libra të shkëlqyer dhe jo me libra që i kemi shpallur të dobët”. Nuk e bënë këtë dhe me qejf të madh nuk miratuan të dytin në radhë por të katër librat humbës i shpallën fitues. Ku qëndron përgjegjshmëria këtu? Të themi që autorët e botuesit janë të gjithë të papërgjegjshëm. Ne nuk ishim të tillë. E lamë që prej asaj kohe shkrimin e teksteve mësimore sepse situata në Ministrinë e Arsimit ishte tepër “e ulët”, tepër biznes, tepër e korruptuar.

Korrupsioni nuk ndalet duke futur botues të huaj. Të huajtë që kanë libra cilësorë, në fakt, bashkëpunuan me “të korruptuarit” shqiptarë të Ministrisë së Arsimit e cila në fazën e parë bëri skandalin e plagjiaturës së

programeve (nuk po e themi këtu nga kush tek kush) dhe tregoi me gisht “ky do të jetë fituesi” para se të bëhej konkursi, me Urdhër ministrie dhe për turp tha “botuesit do të konkurrojnë kush ta përkthejë më mirë”.

Ajo që thotë z.Shehaj “do të njëjtësojmë programet me Kembrixhin” është produkt i atij mentaliteti dhe e asaj klase “nëpunësish ministrie” që nuk kupton se programet e huaja krahas vlerave shtojnë shumë edhe varësinë e kombit shqiptar.

Z.Shehaj nuk e di që Cambridge International Education shkruan për një komunitet global dhe duhet të edukojë vetëdijen globale. Ndërkohë për vetëdijen kombëtare është Departamenti i Edukimit i Mbretërisë së Bashkuar, që bashkëpunon ngushtësisht me departamentet e universiteteve të veta për ta bërë sa më mirë interesin nacional.

Zoti Shehaj do të bënte mirë të kuptonte që Ministria e Arsimit e Shqipërisë është në gjendje të bëjë një punë të shkëlqyer, nëse ajo edhe pa sjellë në Shqipëri angazhon diasporën shqiptare që ka një nivel të jashtëzakonshëm formimi, diçka që e kemi konceptuar në librin “Global Albania” (Artur Shkurti, prill, 2024).

Shteti shqiptar nuk duhet të legalizojë dobësinë e vet duke kopjuar modelet e huaja. Dobësia do të bëhet më e madhe sepse nxënësit do të dekurajohen më shumë për aftësitë e shqiptarëve, nëse ekspozohen vetëm ndaj autorëve të huaj dhe institucioneve të huaja.

Disa mundësi të çuara dëm nga Partia Mundësia

analizë e programit dhe e një përvoje komunikimi nga Artur Shkurti

Kjo do ta shpëlajë ngjyrën kuq e zi në shpirtrat e tyre, e do ta bëjë rozë e gri të vrarë nga “dielli i huaj”. Shpopullimi do të jetë më i madh dhe importi i të huajve që do ta shohin se nuk kanë hyrë në një shtet kombëtar, por në një “shtet global” do të jetë më i madh. Ja pse ide të tilla të lëshuara nga z.Shehaj kanë probleme.

ChatGPT për vlerën e një Ministrie Kombëtare Arsimit

ChatGPT: Një Ministri Kombëtare e Arsimit nuk këshillohet të adoptojë në mënyrë të drejtpërdrejtë një kurrikul të huaj, për arsye që kanë të bëjnë *me sovranitetin kulturor, relevancën lokale, zhvillimin kombëtar dhe barazinë sociale*. Më poshtë janë disa nga arsyet kryesore përse kjo qasje është problematike:

1. Humbja e karakterit kombëtar të edukimit

Çdo sistem arsimor është një pasqyrim i identitetit, historisë, gjuhës dhe vlerave të një kombi. Adoptimi i një kurrikule të huaj (si ajo e Cambridge-it) pa adaptim lokal rrezikon të zhveshë shkollat nga përmbajtja kombëtare dhe ta bëjë edukimin një mjet importi, jo formimi identitar.

2. Mospërputhje me nevojat lokale

Kurrikulat e huaja janë krijuar për shoqëri me kontekste socio-ekonomike, kulturore dhe historike të ndryshme. Për shembull, studimi i letërsisë britanike nuk mund të zëvendësojë studimin e letërsisë shqiptare, historisë sonë kombëtare, apo gjeografisë së rajonit.

3. Përforsimi i pabarazive shoqërore

Sisteme si ai i Cambridge shpesh kërkojnë kosto të larta financiare, gjë që i bën të paarrtshme për një pjesë të madhe të nxënësve. Adresimi i një pjese elitare të popullsisë me një sistem “ekskluziv” krijon dy realitete arsimore dhe thellon ndarjen social-ekonomike.

4. Varësia nga modelet e jashtme

Duke marrë një kurrikul të huaj si model të vetëm, shkenca dhe dijet vendore mbeten të nënpërfaqësuar. Arsimi kthehet në një platformë imitimi, jo inovacioni kombëtar – gjë që dobëson kapacitetin e vendit për të prodhuar dije.

5. Rreziku i shkëputjes nga tregu vendas i punës

Edukimi duhet të përgatisë qytetarë për realitetin ekonomik, social dhe institucional të vendit. Një sistem që nuk merr parasysh prioritetet kombëtare

dhe kërkesat e tregut vendas mund të prodhojë diplomantë të papërshtatshëm për ekonominë shqiptare.

6. Humbja e kontrollit politik dhe strategjik

Një kurrikul e huaj është shpesh e kontrolluar nga një agjenci ndërkombëtare.

Kjo kufizon autonominë e shtetit në përditësimin e përmbajtjes, në lidhjen me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe në përcaktimin e përparësive arsimore.

Në përfundim: Adoptimi i një kurrikule të huaj mund të jetë i dobishëm për ndikime metodologjike ose për zhvillime të caktuara, por jo si bërthamë e sistemit arsimor kombëtar. Ajo çka këshillohet është:

“Inspirim dhe harmonizim i zgjuar, jo njëjtësim i verbër.”

Fundi i analizës

Këtu e mbyllim analizën e programit arsimor të partisë “Mundësia”. Lexuesve u këshillojmë të lexojnë të gjitha analizat tona dhe të mos i përdorin ato të shkëputura nga konteksti e të na veshin në një “njëanësi” që e kanë vetë. Ne vetë nuk do të votojmë për asnjë parti politike. Nuk e përdorim këtë broshurë as për të bërë sikur nuk votojmë, por të ndikojmë zgjedhjen në mënyra të fshehta. Mirëpo nuk mundemi as të anulojmë analizën, me synimin e kotë “për të mos ndikuar”. Pra në zgjedhje politike të bësh “sjellje apolitike” nuk dimë çfarë e ka emrin.

Programi arsimor i PARTISË SË LIRISË (LSI)

Investim në arsim për forcimin e kapitalit njerëzor dhe lidhjen me tregun e punës

Politikat e arsimit do të jenë të orientuara drejt rritjes dhe fuqizimit të kapitalit njerëzor, aftësimi të tij për kërkesat e tregut të punës, formimit të studentëve si qytetarë të angazhuar që garantojnë sistemin demokratik, vlerat morale e sociale të shoqërisë, si dhe formimit të tyre si drejtues të ekonomisë dhe politikës. Për këtë, politikat tona do të përfshijnë gjithë zinxhirin e sistemit arsimor:

- Rritje e buxhetit për arsimin në mesataren e BE si përqindje e PBB. Buxheti për arsimin do të plotësohet krejtësisht sipas nevojës për financim, në mënyrë prioritare.
- Të shtohet numri i vendeve dhe çerdhet e kopshtet si emergjencë pasi kapacitetet e tyre, sidomos në zonat urbane, janë shumë më pak se nevojat.
- Të rrisë pagat për mësuesit dhe pedagogët brenda një mandati qeverisës dhe të rregullojë profesionin e mësuesit me një status të veçantë që i garanton ata profesionalisht dhe ndihmon në rritjen e cilësisë dhe performancën në mësimdhënie.
- Të frenojë hemoragjinë e braktisjes së shkollës prej mësuesve në zonat periferike nëpërmjet masave nxitëse për mësuesit.
- Të standartizojë kurrikulën parauniversitare me qëllim që të integrohet edukimi demokratik në kurrikulën shkollore, të realizojë nxitjen e mendimit kritik, sipërmarrjen dhe edukimin qytetar të fëmijëve.

Kritikë ndaj programit arsimor të Partisë së Lirisë (ish LSI) sipas ChatGPT

Le të hyjmë më thellë në kritikën e programit për arsimin të Partisë së Lirisë, duke përdorur një analizë të rreptë filozofike, programatike dhe politike:

1. Në planin filozofik – Mungon qartësia mbi natyrën e njeriut dhe shoqërisë që kërkohet të formohet.

Programi për arsimin flet për “formimin e qytetarëve që fuqizojnë demokracinë, ekonominë e tregut të lirë dhe të drejtat”, por **nuk sqaron**:

Çfarë profili qytetari kërkon të ndërtojë?

Çfarë balance mes lirisë personale dhe detyrimit ndaj shoqërisë kërkon të kultivojë?

Mungon **një vizion i thelluar antropologjik** dhe etik për njeriun që sistemi arsimor duhet të formojë: një qytetar i lirë nuk është vetëm instrument politik, është edhe **person kulturor, etik, krijues**, gjë që programi nuk e eksploron.

Në këtë mënyrë, mungesa e një baze filozofike e zvogëlon arsimin thjesht në një mjet utilitar për forcimin e sistemit ekzistues.

2. Në planin programatik – Deklarime pa mekanizma.

Nuk paraqiten **instrumente konkrete** për:

Si do reformohen kurrikulat?

Si do trajnohen dhe vlerësohen mësuesit?

Si do përmirësohet infrastruktura shkollore?

Si do lidhet arsimi me kërkesat e tregut të punës?

Si do garantohet barazia arsimore në zonat e varfra ose rurale?

Programi thotë “ritje të cilësisë”, por nuk ka **një matës të standardizuar**: cilësia matet me tregues të qartë, të tillë si: nota mesatare kombëtare, përqindja e nxënësve që përfundojnë arsimin, suksesi në tregun e punës etj.

Pa këto mekanizma, gjithë programi për arsimin mbetet në nivel propagandistik dhe nuk prodhon një reformë të matshme.

Programi arsimor i PARTISË SË LIRISË (LSI)

- Të zgjerojë mbështetjen financiare për studentët e ekselencës.
- Të realizojë dhe mbështesë sistemin e praktikantëve pranë kompanive vendase dhe të huaja
- Konsolidim i fakulteteve që janë ndarë në disa universitete, me qëllim për të rritur cilësinë e mësim-dhënies dhe rankimin e tyre.
- Të përmirësojë aftësitë digjitale të të rinjve nëpërmjet përdorimit me të avancuar të TIK.
- Të përgjysmojë shpenzimet e studentëve duke ulur tarifat e studimit. Të garantojë një paketë që siguron uljen e kostos së jetesës së studentëve ku përfshihen banimi, ushqimi, transporti e mjetet mësimore.
- Të orientojë temat studimore në Programet Master dhe Doktoraturë (PhD) në çështje konkrete të zhvillimit të ekonomisë si edhe të forcojë sistemin e bursave shtetërore sipas sektorëve prioritarë me qëllim afrimin e studentëve me kërkesat e tregut të punës.
- Të përfshijë praktikat e detyruara të punës (internship) në Bachelor dhe Master. Të përshtasë kurikulat e një ose dy viteve të fundit për studentë të veçantë për t'ju përgjigjur nevojave të kompanive (mbi bazë marrëveshjesh qeveri-privat-shkollë).
- Të masivizojë programin “Mëso dhe Fito”, duke rritur numrin e shkollave profesionale dhe gjithashtu duke përmirësuar kurrikulën profesionale të tyre, me parimin e gërshetimit të aftësimit profesional me marrjen e dijeve teorike duke mundësuar që gjatë vitit shkollor nxënësit edhe

Kritikë ndaj programit arsimor të Partisë së Lirisë (ish LSI) sipas ChatGPT

3. Në planin politik – Premtimi për arsim si mjet për “demokraci” ka rrezik të përdoret në mënyrë ideologjike.

Kur thuhet se arsimi do të formojë qytetarë që “fuqizojnë demokracinë dhe tregun e lirë”, krijohet rreziku që **arsimi të politizohet**: pra, të mos synojë zhvillimin e mendimit kritik, por formimin e një qytetari të paracaktuar ideologjikisht.

Një sistem arsimor vërtet demokratik nuk formon qytetarë që domosdoshmërisht mbështesin një model të vetëm (si tregu i lirë apo demokracia e stilit aktual), por që **formon qytetarë të lirë të mendojnë, të zgjedhin dhe edhe të kundërshtojnë**.

Në këtë sens, programi nuk garanton autonominë e mendimit si vlerë kryesore të arsimit.

4. Në planin ekonomik dhe strategjik – Mungesë prioritetesh reale dhe lidhje me ekonominë e dijes.

Në një epokë ku ekonomia globale është ekonomi e dijes, arsimi nuk duhet të mbetet vetëm në funksion të identitetit kombëtar, por duhet të jetë:

*Shkencor,
Inovativ,
Tregtues i dijeve dhe teknologjive të reja.*

Programi i Partisë së Lirisë nuk flet për investime serioze në:

*Kërkim shkencor,
Inovacion teknologjik,
Start-upe akademike,
Laboratorë të avancuar.*

Pa këto, Shqipëria nuk mund të konkurrojë as në Ballkan, e jo më në Evropë.

Programi arsimor i PARTISË SË LIRISË (LSI)

të mësojnë, por edhe të zhvillojnë praktika pune të paguara në të njëjtën kohë.

- Të realizojë prokurim të laboratorëve të biznesit privat dhe infrastrukturën shtetërore për trajnimin praktik të shkollave dhe universiteteve.
- Të forcojë kërkimin shkencor dhe inovacionin nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve njerëzore, rinovimit të infrastrukturës dhe përmirësimit të Legjislacionit. Ngritje e sistemit të kërkimit shkencor dhe inovacionit në nivelin e financimit buxhetor në mesataren e BE-së.
- Të përmirësojë cilësisht sistemin e këshillimit të karrierës.
- Të kthejë sportin si një aspekt të rëndësishëm të kurrikulës shkollore. Të rrisë vlerën e sportit në kreditet akademike.
- Mbështetje për përfshirjen në sistemin arsimor dhe kërkimin shkencor të zhvillimit të koncepteve, metodave dhe teknologjive të reja për t'ju përgjigjur ndikimeve nga ndryshimet klimatike.
- Programe intensive për hyrjen e të rinjve në tregun e punës – Garancia për të rinjtë – Programi “Youth Guarantee” - Subvencionim për kompanitë (ku përfshihen sigurimet shoqërore/shëndetësore dhe fee me qëllim trajnimin për punonjës) për çdo të punësuar deri në moshën 29 vjeçare.
- Ngritje e qëndrave të asistimit të sipërmarrësve të rinj me trajnime dhe këshillim për menaxhim, hartim plane biznesi dhe aplikim kredie.
- Ngritje e inkubatorëve të biznesi me qëllim nxitjen e start up-eve për zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionit

Kritikë ndaj programit arsimor të Partisë së Lirisë (ish LSI) sipas ChatGPT

5. Në planin shoqëror dhe kulturor – Rrezikimi i pluralizmit kulturor.

Duke vendosur një theks shumë të madh te patriotizmi dhe krenaria kombëtare, programi rrezikon të krijojë një arsim të mbyllur dhe jo arsim të hapur e pluralist.

Shoqëritë moderne që ecin përpara janë ato që kultivojnë:

*Pluralizmin kulturor,
Respektin për diversitetin,
Mendimin kritik dhe të lirë.*

Nëse arsimi shndërrohet në një mjet të ngushtë patriotik, atëherë ai pengon integrimin e lirë të qytetarëve në botën globale.

Përmbledhje e kritikës:

Programi politik i Partisë së Lirisë për arsimin ka frymë të lartë idealiste, por vuan nga mungesa e vizionit të thelluar filozofik, mungesa e mjeteve programatike konkrete, rreziku i politizimit të arsimit dhe mungesa e hapjes drejt një ekonomie dhe shoqërie të bazuar në dije dhe pluralizëm.

KOMENTE PËR PROGRAMIN ARSIMOR TË PARTISË SË LIRISË

ChatGPT-së i ngarkuam programin e LR në pdf (27 prill 2025) i kërkuam thjesht të bëjë kritikën, pa komente paraprake. Kjo do të thotë që kritika mund të jetë e pavarur nga mendimi ynë (sidoqoftë reagimi i ChatGPT, nuk dimë sa indiferent mund të jetë nga personi që i kërkon kritikën). Kjo është arsyeja që mendimin tonë e japim më vete dhe jo bashkë me ChatGPT.

Përveç atyre që ka ChatGPT dhe që i quaj të drejta po disa shënime që më bëjnë përshtypje në atë tekst dhe pastaj ato që i mungojnë tekstit:

Në program (fq.5) thuhet: “3. Transformimi i sistemit arsimor duke synuar formimin e qytetarëve që ruajnë dhe fuqizojnë demokracinë, ekonominë e tregut të lirë dhe të drejtat e lirit, që e duan atdheun e shqiptarinë dhe që janë krenarë për përkatësinë e tyre mes kombeve të tjera evropiane.”

I mësuar me “finokërinë” dhe paplotësinë e teksteve të tilla që luajnë me “praninë” e fjalëve dhe jo edhe me lidhjen e tyre në një ide konkrete e të qartë, gjë që e devijon lexuesin të mendojë atë që ai do, mendova se paragrafi është “diabolik”. Duket sikur synohet edukimi kombëtar (dashuri për atdheun dhe shqiptarinë), por po të analizohet me kujdes, do të shihet se kujdesi parësor është frazeologjia e dyndur me “kozmodopolitizëm” dhe fjalë e shprehje shabllone “demokracia”, “tregu i lirë” dhe “të drejtat e lirit” që janë thjesht “modeli politik dhe ekonomik” por që nuk ka lidhje me edukimin e vetëdijes kombëtare dhe identitetit kombëtar. Fjalët “kombëtare” janë vënë aty thjesht si një asortiment për të dhënë idenë fiktive të angazhimit. Çështja e

edukimit kombëtar është më thelbësorja për sistemin arsimor dhe ajo nuk pranon të futet në mes të fjalëve të tjera dhe aq më tepër në fund të një fjalie të gjatë që fillon me diçka tjetër. ChatGPT e thotë në këtë mënyrë:

“Pse kjo është një shmanje tinzare? Sepse në vend që të ndërtohet në qendër të sistemit “qytetari shqiptar që njeh, mbron dhe zhvillon identitetin dhe historinë e vet”, i pari objektiv bëhet një qytetar që mbron sistemin liberal demokratik dhe ekonominë globale — dhe vetëm si zbulurim i jepet dashuria për atdheun.”

Më tutje LR duket se po investon në “edukim kombëtar” por në fakt, po devijon përsëri. Ajo thotë:

“Në mënyrë të padiskutueshme, forcimi i rolit të qytetarit si aktor dhe faktor politik, shkon në të njëjtin kah me forcimin e identitetit dhe ndjenjës kombëtare. Roli i shkollës në një mision të tillë është i pazëvendësueshëm. Prandaj, investimi në sistemin arsimor në të gjithë zinxhirin e tij, duke filluar nga çerdhjet e kopshtet, rritja e cilësisë së shkollës për të edukuar qytetarin evropian të Shqipërisë janë një kauzë e madhe e Partisë së Lirisë dhe investimi strategjik më i rëndësishëm i saj.”

ChatGPT thotë:

“Në sipërfaqe duket sikur kërkon të korrigjojë pasigurinë e paragrafit të parë, sepse përmendet “forcimi i identitetit dhe ndjenjës kombëtare”. Por në fakt, edhe ky paragraf nuk e përmirëson situatën e edukimit kombëtar.

Pse? Ja disa arsye:

1. Prioriteti i vërtetë nuk është kombi, por qytetari si “aktor politik”

Fjala kyçe është qytetari si aktor dhe faktor politik. Qytetari përkufizohet përmes rolit të tij politik, jo përmes përkatësisë kulturore, historike apo shpirtërore shqiptare. Pra kombi përdoret si instrument që qytetari të funksionojë si pjesë e sistemit politik, jo si identitet që ka vlerë për vetvete.

2. Qytetari “evropian i Shqipërisë”

Qëllimi final nuk është “qytetari shqiptar”, por qytetari evropian i Shqipërisë.

Kjo sugjeron një model ku integrimi evropian është më i rëndësishëm se vetë-identifikimi shqiptar. Identiteti kombëtar shërben vetëm si një mjet që qytetari të jetë i pranueshëm në familjen evropiane, jo si një qëllim final.

3. Fokus mbi sistemin arsimor si “investim politik”

E gjithë pesha retorike vendoset mbi Partinë e Lirisë dhe kauzën politike.

Shkolla shihet si mjet politik dhe investim strategjik, jo si tempulli ku ndërtohet shpirti i kombit. Edukimi kombëtar i vërtetë nuk është politik, është civilizues, shpirtëror dhe kulturor.

KOMENTE PËR PROGRAMIN ARSIMOR TË PARTISË SË LIRISË

4. Ambiguiteti i lidhjes mes “ndjenjës kombëtare” dhe “aktorit politik”

Thuhet se këto dyja shkojnë “në të njëjtin kah”, por nuk shpjegohet si ndjenja kombëtare do të formësojë veprimin politik. Në realitet, ato mund të jenë shumë herë në konflikt: një qytetar globalist dhe një qytetar kombëtar shpesh kanë prioritete të ndryshme.

Përmbledhje: Ky paragraf i dytë e mbulon problemin, por nuk e zgjidh atë. Termat kombëtarë përmenden, por në funksion të kauzave politike aktuale. Kultura, historia, gjuha, traditat kombëtare — nuk përmenden kurrë si thelbi i edukimit. Prioriteti mbetet: qytetari liberal demokratik dhe evropianist, jo qytetari shqiptar në kuptimin e plotë. Nëse do të donim një formulim që vërtet e mbron edukimin kombëtar, duhej që kombësia të ishte:

Qëllimi final, jo mjet;

E pavarur nga agjendat politike;

E rrënjësuar në gjubë, histori, traditë dhe frymën shqiptare.”

LR flet për “vlerat morale e sociale të shoqërisë” dhe ky togfjalësh është qëllimisht ngatërrues, sepse nuk i adresohet individit që duhet edukuar me “vlera morale”, por shoqërisë në përgjithësi. Koncepti “vlerë sociale e shoqërisë” është krejt pa vend dhe quhet tautologji dhe shtesë ngatërruese për të imponuar në tym faktin që programi po flet për vlera.

Nuk do të analizoj anën financiare apo numerike, se aty të gjitha partitë ia kanë marrë dorën. Shtojnë fjalën “do të rritim buxhetin apo do të rritim numrat” në çdo aspekt dhe e quajnë në rregull.

Duke qenë se LR nuk shprehet për aq shumë probleme do të thotë se ajo e ka një program sekret arsimor, por atë program nuk e ka ajo vetë, por e kanë ata që e komandojnë atë dhe për të cilët LR është “përmbaruese” dhe jo “konceptuese”.

LIDHUR ME ÇËSHTJEN FETARE

Në çështjen fetare LR është një ngatërrestare dhe për mendimin tim antikombëtare, duke qenë se ka ndikuar që të dobësohet natyra kombëtare e Kishës Ortodokse, ka nxjerr një çorientim të rëndë në bashkësinë bektashie, që u finalizua nga Edi Rama me Shtetin Bektashi dhe nuk kanë respektuar një koherencë që t’u japë atyre besueshmëri në çështje fetare. Me sa dimë duke qenë “muslimanë” bektashinj janë pagëzar në katolikë.

Në këtë pikë vlen të mbajmë parasysh thënien e Pashko Vasës që thotë “*Të konvertuarit janë fanatikët më të mëdhenj*”.

Çfarë arsimit laik duan e tregon marrëdhënia e politikanëve me institucionet fetare

Nëse shohim që politikanët i janë nënshtruar bashkësisë së klerikëve dhe institucioneve fetare, nuk kanë kritikë për ta, atëherë ndërhyrja në sistemin arsimor shqiptar do të jetë krejt anemike dhe e pafrymëzuar. Nuk po themi që shkol-

la të jetë kundër fesë apo institucioneve fetare, por duhet kuptuar që sistemi arsimor është qartësisht më lart në hierarkinë e ndikimit mbi njeriun.

Shkolla e bën të hapur individin duke i mësuar në mënyrë sistematike qasjet e këndvështrimet e ndryshme, qofshin edhe fetare, është një ndikim i pandalur, i përditshëm, i përjavshëm, i përmuajshëm për të paktën 15 vjet, të paktën 5 orë në ditë dhe ka për detyrë t’i mësojë të gjithë kulturën njerëzore, t’i japë vetëdije kombëtare dhe globale, dhe ta bëjë të hapur ndaj ideve të ndryshme, dhe jo t’i përjashtojë automatikisht siç e ka në predispozitë shumica e sekteve fetare.

Këtë rol ajo e siguron jo nga ndonjë pozitë tjetër (ta zemë antagoniste me fenë) por duke qenë e aftë të japë informacione, shpjegime edhe për vetë besimet fetare, duke edukuar edhe me metoda apo këshilla që në zanafillë mund të jenë edhe fetare (dhe jo vetëm). Ndaj ajo qëndron shumë lart. Mirëpo institucionet fetare duke ndjerë “dublimin” e shkollës, na duket që janë të interesuar ta dobësojnë atë në disa drejtime ku duan të kenë “përparësinë”.

Duke qenë shumë nga këto institucione fetare vegla të hua-ja, atëherë interesi bëhet edhe më i madh për dobësimin e vetë sistemit arsimor shqiptar.

Kjo nuk është kritikë vetëm për LR por po e lëmë këtu, meqë këtu na u kujtua.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

Arsimi është drita që një shoqëri të dalë nga marrëdhëniet anakronike për të hyrë në modernitet; është domosdoshmëria për zhvillimin e arsyes kritike, e novacionit teknologjik dhe e ideve eman-cipuese për kultivimin e rezistencës ndaj padrejtësive sociale; është lokomotiva për zhvillimin social dhe ekonomik të një vendi bazuar te meritat.

Që nga periudha e iluminizmit kanë ekzistuar dy qasje në lidhje me konceptimin e asaj që duhet të jetë arsimi dhe kujt duhet t'i përkasë. A është arsimi privilegji i një elite që përgatitet për të qenë klasë sunduese në shoqëri, apo e drejta e çdo qytetari për ta marrë dijen si një e mirë publike, si një vlerë në vetvete që krijon një shoqëri më të mirë? Çfarë janë nxënësit në raport me dijen dhe me mësuesin? A janë ata vazo të zbrazëta që duhen mbushur nga mësuesi i cili mban në dorë monopolin e dijes, apo ky i fundit është një udhërrëfyes që nxënësit i dëfton shtegun e mundimshëm drejt dijes, në rrugëtimin drejt të cilit ai zbulon me mënyrën e vet pasionin dhe kërkshërinë për dijen? Cili është misioni i arsimit në shoqëri? A duhet të mjaftohet një nxënës apo student me njohuritë teknike që do t'i nevojiten në profesionin që do të bëjë në të ardhmen, apo misioni i arsimit është edhe të edukojë dhe të formojë karakterialisht nxënësin si një qytetar të ndërgjegjshëm, të aftë për të menduar në mënyrë kritike?

Vizioni i Lëvizjes BASHKË, i ngritur ndër shumë vite aktivizmi në botën universitare, e konsideron arsimin një të mirë publike dhe një të drejtë që i takon çdo qytetari; e sheh

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

Kritikë e përgjithshme

Retorikë e tejngarkuar, mungesë konkretësie

Teksti është i mbushur me formulime filozofike, pyetje retorike dhe konceptualizime teorike (p.sh. “a janë nxënësit vazo të zbrazëta?”, “mësuesi si udhërrëfyes”, etj.), por nuk ofron asnjë përmbajtje të matshme politike. Në një program partiak, qytetarët presin qëllime të qarta, masa konkrete dhe plane veprimi – këtu nuk ka asnjë të tillë.

Nuk ka diagnozë reale të problemit

Flitet për një “arsim të harruar e të braktisur”, por nuk jepen të dhëna, shembuj, statistika, apo fakte që tregojnë si, ku dhe pse është braktisur arsimi. Pa një analizë reale të problemeve ekzistuese (nga cilësia e mësimdhënies, tek infrastruktura apo digjitalizimi), programi mbetet i shkëputur nga realiteti.

Mungesë strategjie dhe planifikimi politik

Nuk thuhet çfarë do të bëhet ndryshe, si do të realizohet ndryshimi dhe me çfarë burimesh, ligjesh, reformash, ose institucione. Programi nuk përmban asnjë objektiv të matshëm, as afate, as mekanizma implementimi.

Kritikë e veçantë: Mungesa e përmbajtjes konkrete për arsimin

Në këtë tekst mungojnë krejtësisht

Nivelet e arsimit – nuk ka përmendje të arsimit parashkollor, fillor, të mesëm, profesional apo të lartë.

Mësuesit dhe trajtimi i tyre – nuk përmenden fare trajnimet, pagat, kualifikimet apo sfidat reale të mësuesve.

Nxënësit dhe barazia në arsim – nuk trajtohen nevojat e fëmijëve me aftësi ndryshe, mungesat në akses, transportin, tekstet, etj. Arsimi profesional dhe tregu i punës – nuk ka lidhje me realitetin ekonomik e punësimin e të rinjve.

Digjitalizimi i arsimit – nuk përmendet asnjë teknologji, as platformat, as zhvillimet në mësimdhënien moderne. Universitetet dhe kërkimi shkencor – përmenden në mënyrë poetike si “tempull i ndërgjegjes qytetare”, por asnjë plan për financim, autonomi, reformë ligjore apo rol në zhvillimin kombëtar.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

studentin si një bashkudhëtar në rrugën drejt dijes të cilit i duhet mësuar metoda e kërkimit shkencor; e konsideron shkollën dhe universitetin jo vetëm si burime të dijes teknike, por edhe si tempujt e skalitjes së ndërgjegjes qytetare, e njohjes së etikës dhe edukimit qytetar, duke ndihmuar të rinjtë të kuptojnë rolin e tyre në shoqëri.

Ky vizion është shumë larg gjendjes në të cilën është harruar e braktisur arsimi në Shqipëri. Bashkë do ta ndryshojmë!

I. Gjendja aktuale

Emigrimi masiv i dekadave të fundit dhe braktisja e shkollës nga fëmijët shqiptarë po e zhytin arsimin në një krizë të thellë. Prej vitit 2000 janë mbyllur 42% e shkollave 9-vjeçare në rang vendi, teksa vetëm në dekadën e fundit janë mbyllur 295 (ose 22%) institucione të arsimit të detyrueshëm dhe janë regjistruar 125 mijë nxënës më pak. Në vitin shkollor 2024-25 do të ketë 20 mijë (ose 7.8%) nxënës më pak se një vit më parë. Një projektion i ngjashëm në rënie të përvitshme (7.4%) vihet re edhe për shkollat e mesme. 6.6% e djemve dhe 5.5% e vajzave nga familje të varfra në zonat urbane e braktisin shkollën, me arsye kryesore pamundësinë e përballimit të shpenzimeve nga familjet e tyre.

Nga ana tjetër, përqendrimi i popullsisë në Tiranë ka evidencuar problemin e kundërt: pamjaftueshmërinë e shkollave 9-vjeçare. Sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, 30 shkolla në kryeqytet e zhvillojnë mësimin me dy turne. Edhe pse që prej vitit 2016 kryetari i Bashkisë

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

Përfundim: Program me karakter deklarativ, jo funksional

Ky tekst nuk përmbush kriteret e një programi politik për arsimin, por më shumë është një deklaratë filozofike e një vizioni idealist, pa përkthim praktik në politika. Në kushtet kur arsimi në Shqipëri përballlet me kriza të thella strukturore dhe sociale, një program serioz duhet të japë: *Diagnozë të saktë; Objektiva të matshëm; Zgjidhje konkrete; Burime dhe mënyra realizimi.* Këtij tekst i mungojnë të katërta. Prandaj, pavarësisht stilit të pasur letrar, nuk është një program arsimor në kuptimin politik të fjalës.

Seksioni i dytë - “Gjendja aktuale” dhe “Problemet kryesore”

Analiza e situatës së arsimit që paraqitet më sipër është e hollësishme dhe shumë dimensionale, por edhe e ngarkuar me tone pesimiste e dramatike. Kjo i jep forcë argumentimit, por ka disa aspekte ku mund të bëhet një kritikë konstruktive për të përmirësuar qartësinë, objektivitetin dhe përdorimin e të dhënave. Ja disa pika kyçe kritike:

1. Struktura: Ndihmon por nuk është e balancuar
Ndarja në “Gjendja aktuale” dhe “Problemet kryesore” është e dobishme, por ndodh një mbivendosje tematike mes tyre. Për shembull, mungesa e infrastrukturës shfaqet dy herë: një herë si pjesë e panoramës, pastaj në pjesën e dytë si analizë – kjo krijon përsëritje që dobëson impaktin. Do të kishte qenë më efektive të organizohej sipas niveleve të arsimit (parashkollor, parauniversitar, universitar) ose tematikave qendrore (infrastruktura, cilësia, financimi, politizimi, tregu i punës).

2. Gjuha: E fuqishme, por shpesh ngarkon emocionalisht
Termat si “katastrofike”, “denigrim”, “kaos”, “shtyn studentin”, “falimentim”, “feudalizëm” etj., ndihmojnë për të rritur ndikimin emocional, por krijojnë një ndjesi të skajshme që mund ta relativizojë objektivitetin e analizës. Një analizë që synon të ndikojë politikëbërësit dhe publikun do të ishte më efektive nëse përdor një gjuhë më neutrale dhe analitike, pa e humbur tonin kritik.

3. Të dhënat: Të pasura por jo gjithmonë të balancuara
Përdorimi i statistikave (si rënia e nxënësve, rezultatet në PISA, përqindja e buxhetit etj.) është një plus i madh. Por këto nuk shoqërohen me analiza krahasuese të plotë me vendet e rajonit apo me kontekste demografike që ndihmojnë për të kuptuar më mirë shkaku.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

së Tiranës propozoi vendosjen e një takse të përkohshme për infrastrukturën arsimore – taksë që u kushton familjeve të Tiranës 1,800 lekë/vit dhe bizneseve deri në 37,000 lekë/vit – vetëm 9 nga 17 shkollat e parashi-tkuara janë ndërtuar përmes Partneritetit Publik Privat (PPP).

Rezultatet e dobëta të nxënësve në sistemin parauniversitar u dëshmuar në testin ndërkombëtar PISA 2022: të rinjtë shqiptarë shënuan rënien më të madhe krahasimisht me rezultatet e viteve të mëparshme në të gjithë historinë e PISA-s. Nga viti 2018 në 2022 Shqipëria pësoi një rënie prej 69 pikësh, e cila është rënia më e fortë nga 80 vendet e testuara. 84% e nxënësve shqiptarë (rezultati më negativ nga të gjitha shtetet e tjera) nuk kaluan Nivelin 3 për të menduarit në mënyrë krijuese dhe aplikimin e tij në kontekste të zgjidhjes së problemave me natyrë shkencore. Për vitin 2022-23, paga e një mësuesi shqiptar ishte më e ulëta në Evropë, në rreth 7600 euro/vit. Për krahasim, Mali i Zi e ka rreth 12.000 euro/vit, Bosnjë-Hercegovina rreth 9000 euro/vit. Gjithashtu, edhe sipas faktorit të Standardit të Fuqisë Blerëse (PPS), që pasqyron të njëjtën fuqi blerëse nëpër vende të ndryshme, paga e një mësuesi shqiptar renditej e fundit në Evropë. Në korrik të vitit 2024 pagat e mësuesve u rritën nga 8000 deri në 14.000 lekë/muaj sipas kategorive, duke bërë që pagat neto të mësuesve të gjimnazit të luhaten nga 63.000 në 86.000 lekë/muaj. Me gjithë rritjen, pagat e mësuesve shqiptarë mbeten nën pagat e vendeve të rajonit, ndërkohë që qeveria ka vendosur që të ulë me 10.000 lekë/muaj pagat e rreth 6500 mësuesve të ciklit të ulët.

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

Shifrat e rënies së studentëve dhe mbylljes së degëve në universitete janë alarmante, por do ishte mirë të shoqëroheshin me faktorë të tjerë të tregut të punës apo me analizë të migrimit si kontekst që ndikon në mënyrë strukturore.

4. Mungesa e referencave burimore

Edhe pse përmendet Ministria e Arsimit, PISA, të dhëna buxhetore, mungojnë referencat konkrete dhe burimet statistikore. Kjo cenon besueshmërinë dhe profesionalizmin e analizës. Në një tekst analitik serioz, duhen citime konkrete (p.sh., “sipas INSTAT”, “në raportin PISA 2022, fq. XX”).

5. Mungesa e propozimeve apo alternativave

Teksti është krejtësisht kritikues, pa asnjë tentativë për të ofruar zgjidhje, alternativa, modele të suksesshme, qoftë edhe pjesërisht. Kjo e kufizon tekstin vetëm në një denoncim dhe jo në një analizë me synim përmirësimi. Për shembull, nuk jepet asnjë sugjerim për: reformën e mësuesisë, digjitalizimin e mësimdhënies, përmirësimin e financimit të universiteteve, apo ndarjen më të drejtë të fondeve sipas nevojave.

6. Zhvillimi i tezave: Disa mbivendosen ose përzihen

Fenomene si “politizimi i sistemit”, “mungesa e meritokracisë”, “korrupsioni në tituj akademikë” dhe “tregtarizimi” janë shumë të rëndësishme, por nuk ndahen qartë në tema veçmas, gjë që i bën të duken si një fushë me probleme që përplasen njëra me tjetrën, pa ndërtuar një rrëfim linear. Do të ishte më e qartë po të kishte titujt nëndrejtues (p.sh., “Financimi i pamjaftueshëm”, “Korrupsioni akademik”, “Mungesa e motivimit për mësuesinë”, etj.)

7. Këndvështrimi i aktorëve mungon

Mungon zëri i prindërve, mësuesve, nxënësve, studentëve, që do ta bënte analizën më të pasur dhe më të lidhur me realitetin. Asnjë përpjekje për të kuptuar logjikën e vendimmarrjes së institucioneve (si MAS, universitetet publike), duke e bërë analizën njëanshme.

Përmbledhje e kritikës: Ky tekst është një panoramë gjithëpërfshirëse dhe mjaft e fuqishme për të ngjallur debat rreth krizës në sistemin arsimor shqiptar. Megjithatë, ai do të fitonte shumë në qartësi dhe autoritet po të përdorte një gjuhë më neutrale, strukturë më të rregullt, referenca burimore, si dhe të ofronte alternativa e zgjidhje. Përndryshe, rrezikon të lexohet më shumë si një manifest i zemëruar sesa si një analizë profesionale me synim reformimi.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

Universitetet publike, gjithashtu, humbën rreth 3000 studentë në vit duke lënë bosh kuotat e regjistrimit në universitetet kryesore: Universiteti i Tiranës (UT) për vitin 2024-25 plotësoi vetëm 60% të kuotave të lira, Universiteti Politeknik (UPT) vetëm 64% dhe Universiteti Bujqësor (UBT) vetëm 43%. Në universitetet publike janë mbyllur deri tani 24 degë studimi dhe rrezikojnë të mbyllen edhe 15 të tjera. Sipas një projekcioni në bazë të të dhënave aktuale, brenda vitit 2030 në universitetet publike do të studiojnë 41% më pak studentë.

Degët më të kërkuara janë mjekësia, infermiera dhe inxhinieria informatike, të cilat tërheqin studentë me perspektivën për t'u punësuar jashtë vendit. Ndërkohë, dega e mësuesisë – dega më e rëndësishme për përgatitjen e mësuesve të cikleve parauniversitare – është ndër degët më pak të kërkuara: prej vitit 2019 deri në vitin 2023 numri i diplomave bachelor në mësuesi ka rënë me 79%.

Financimet në fushën e arsimit kanë ardhur drejt rënies në pesë vitet e fundit. Për vitin 2025 fondet buxhetore për arsimin parashikohen të jenë 55 miliardë lekë, ose sa 7.1% e buxhetit. Ndërkohë, një vit më parë ato zinin 9.7% të buxhetit dhe 11.7% të buxhetit në vitin 2019. E njëjta tendencë vërehet edhe në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), ku fondet për arsimin zënë 2.9% të PBB nga 3.3% që ishin në vitin 2020. Mesatarja e vendeve të BE për arsimin shkon te 5% dhe në rajon luhet te 4%. Familjet shqiptare detyrohen të kontribuojnë në mënyrë thelbësore në kostot e shkollimit të fëmijëve të tyre nëpër institucionet

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Alternativa e Lëvizjes BASHKË për arsimin paraqet një vizion të gjerë dhe ambicioz, me një frymë thellësisht sociale dhe demokratizuese. Ajo ofron një qasje reformuese që synon jo vetëm të korrigjojë problemet ekzistuese, por të ndryshojë rrënjësisht mënyrën si funksionon arsimi në Shqipëri. Shumë nga idetë janë të mirëartikuluara, të frymëzuara nga modele të suksesshme (si ai finlandez) dhe tregojnë një përpjekje serioze për të paraqitur një alternativë të thelluar. Megjithatë, ekzistojnë disa probleme të natyrës praktike, mungesë qartësie strategjike, si dhe mangësi konceptuale në disa pika, të cilat po i analizoj më poshtë.

MANGËSI, DOBËSI DHE KRITIKA SPECIFIKE

1. Mungesa e një kornize të qartë kohore dhe buxhetore

Programi premton shumë investime të mëdha: rritje e buxhetit për arsim në 4% të PBB, shkolla të reja, orar i zgjatur, laboratorë, mensa, platforma online, botime falas etj.

Mungon një analizë realiste financiare: Sa kushtojnë këto masa? Ku do të gjenden fondet për këtë rritje të menjëhershme? Sa vite kërkohen për zbatim të plotë?

Preken shkurtime ose zhvendosje të fondeve nga sektorë të tjerë? Apo do të ketë rritje të taksave?

2. Të gjitha synimet janë “progresive” – mungon një sistem prioritizimi

Alternativa përfshin një listë të gjatë objektivash – nga ndërtimi i shkollave, reforma në kurrikula, përgatitja e mësuesve, orientimi në karrierë, ushqimi në shkollë, deri te ngritja e shtëpive botuese dhe mensave.

Kjo është problematike nga këndvështrimi strategjik: nuk ka një rend prioritar, një etapizim që të tregojë se cilat masa janë urgjente, cilat janë afatgjata dhe cilat janë të kushtëzuara nga suksesi i të parave.

3. Shpesh idetë duken më shumë si dëshira sesa si plane konkrete

Shembull: “Nxënësit të qëndrojnë në shkollë deri në orën 17:00” – por nuk sqarohet as kostoja e stafit shtesë, as si do të mbulohet kjo logjistikisht në mjedise ku sot mungojnë edhe klasat bazë.

“Rritja e votës studentore në 50%” është një ide radikale, por nuk ka analizë të implikimeve që kjo do të kishte në balancat e brendshme të universiteteve apo në marrëdhënien me pedagogët.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

publike të arsimit, ku rreth 70% e kostove mbulohet nga shteti ndërsa 30% nga familjarët.

II. Problemet kryesore

Problematika më bazike që haset në të gjitha nivelet e arsimit e që lidhet me aspektet më elementare të mësimdhënies, ka të bëjë me mungesën e infrastrukturës së nevojshme. Sipas dëshmive të vetë mësuesve, në shumicën e shkollave të zonave periferike mungojnë kushtet bazë si ndriçimi, sistemi i ngrohjes dhe i ftohjes, uji i rrjedhshëm. Ndërkohë edhe në shkollat dhe gjimnazet e zonave urbane vërehet një mungesë totale e infrastrukturës dhe e pajisjeve laboratorike për fushat e fizikës, kimisë, biologjisë etj., ashtu si edhe e bibliotekave apo e sallave me kompjuterë. Njëkohësisht, mungojnë tërësisht (ose keqfinancohen) muzetë e ndryshëm, që do mund të vizitoheshin edhe nga publiku i gjerë, si për shembull ato të botanikës, paleontologjisë, arkeologjisë, gjeologjisë, astronomisë etj.

Rezultatet e dobëta në testet kombëtare dhe ndërkombëtare lidhen me mënyrën e vjetruar të mësimdhënies dhe me kurrikulat e papërshtatshme. Të mësuarit në mënyrë mekanike dhe shpeshherë përmendësh, e kufizon jashtëzakonisht shumë mendimin krijues të nxënësve. Nga ana tjetër, sipas mësuesve kurrikulat bazohen vetëm në teori dhe jo në praktikë, janë të përkthyer shabllon nga vendet e huaja – nga tekste të vitit 2007 – dhe nuk u përshtaten kushteve sociale, mentalitetit dhe kontekstit shqiptar.

Në shkollat e Tiranës fëmijët nuk kanë mundësi t'i për-

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

4. Në disa raste, retorika është ideologjikisht ngarkuar

Në vend që të fokusohet te zgjidhjet, teksti shpesh përfshin gjuhë të polarizuar si *“reforma privatizuese e Edi Ramës”* apo *“abuzimi i pedagogëve”*. Kjo i jep një ton pamfletor një materiali që pretendon të jetë alternativë serioze. Nëse synohet të fitohet besimi i një publiku më të gjerë (jo vetëm i mbështetësve ekzistues), retorika duhet të jetë më gjithëpërfshirëse dhe e orientuar nga zgjidhja.

5. Koncepti i autonomisë krijuese për mësuesit – pa mekanizma kontrolli cilësor

Jepet shumë autonomi mësuesve për përshtatjen e kurrikulës dhe metodave, por mungon një sistem monitorimi të cilësisë dhe rezultatshmërisë. Si garantohet që kjo autonomi nuk çon në standarde të paqarta dhe mungesë unifikimi?

6. Pak vëmendje për arsimin profesional dhe tregun e punës

Pavarësisht orientimit të fortë social dhe gjithëpërfshirës, ka një mungesë të theksuar të politikave për arsimin profesional. Në një realitet si ai shqiptar, ku papunësia është e lartë dhe tregu i punës i polarizuar, kjo është një mungesë serioze.

7. Pak fokus te digjitalizimi i arsimit

Edhe pse përmendet përdorimi i platformave online për periferinë, nuk ka një strategji të mirëfilltë digjitalizimi të sistemit arsimor. Për shembull: përdorimi i inteligjencës artificiale në mësimdhënie, edukimi digjital, trajnime për mësuesit në këtë drejtim etj.

8. Shumë pak trajtim i problematikës së plagjiaturës në arsimin e lartë

Përmendet lufta ndaj kopjimit, por mungon një plan për forcimin e integritetit akademik: software anti-plagjiaturë, politika disiplinore, etj.

PIKËT POZITIVE DHE ORIGJINALE

Qasja “nga poshtë lart” në reformë, përmes konsultimeve me komunitetet lokale dhe profesionistët e arsimit – është një qasje shumë pozitive dhe demokratizuese.

Forcimi i rolit të sindikatave dhe strukturave të pavarura në universitete – është një ide e rëndësishme që prek një plagë reale të sistemit: politizimin dhe centralizimin.

Fokusimi te figura e mësuesit si profesion moral dhe jo vetëm teknik është një vlerë që në Shqipëri shpesh neglizhohet.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

dorin mjediset e shkollës për t'u edukuar me orar të zgjatur përmes aktiviteteve të ndryshme jashtëshkollore, siç ndodh në vendet e përparuara të Evropës. Kjo mangësi e infrastrukturës arsimore i shtyn prindërit që të harxhojnë një pjesë jo të vogël të të ardhurave të tyre për t'i dërguar fëmijët në qendra kursesh me pagesë, të cilat në të shumtën e rasteve funksionojnë si vende thjesht të mbajtjes së fëmijëve derisa prindërit të mbarojnë punën. Familjet me më pak të ardhura janë të detyruara t'ua ngarkojnë mbajtjen e fëmijëve pas shkollës gjysheve e gjyshërve, që jo gjithmonë kanë fuqinë fizike t'u përgjigjen nevojave të fëmijëve.

Ç'është edhe më e rëndë, në disa zona të populluara të Tiranës nuk ka fare infrastrukturë arsimore. Për shembull në zonën e Astirit, e cila banohet nga rreth 70.000 qytetarë, nuk ka asnjë çerdhe, kopsht e shkollë publike, duke i shtrënguar prindërit të paguajnë institucione arsimore private ose t'i dërgojnë fëmijët në shkolla publike shumë larg vendbanimit të tyre.

Shkollat e mesme po e humbasin rolin e tyre si hallka arsimore në të cilën nxënësin marrin një formim të përgjithshëm e shumëpërmasor, formohen intelektualisht si qytetarë dhe bëhen të aftë për të zgjedhur fushën e studimit që do të ndjekin në universitet. Profilizimi i herëtshëm i gjimnazit në degë ngushtësisht shkencore apo shoqërore, ka krijuar një hendek në formimin e përgjithshëm që duhet të marrë nxënësi në këto vite të shkollimit të tij/saj, duke e bërë gjimnazin fort të ngjashëm me shkollat profesionale. Sa i përket cilësisë së mësimdhënies, infrastrukturës mësim-

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

Idetë si klube leximi, orientimi në karrierë dhe shtëpia botuese për librat shkollore janë risive domethënëse që e pasurojnë peizazhin edukativ përtej klasës. Shkollat si qendra komunitare pasditeve është një ide sociale e fuqishme, që i jep kuptim më të gjerë shkollës në jetën qytetare.

PËRFUNDIM: Alternativa e Lëvizjes BASHKË për arsimin është ndërtuar mbi parime të forta etike dhe sociale, dhe synon një transformim rrënjësor të sistemit. Megjithatë, për të qenë funksionale dhe realisht implementuese, ajo ka nevojë për konkretizim, etapizim, një analizë më të thellë të kostove dhe një gjuhë më pak ideologjike dhe më gjithëpërfshirëse.

**ChatGPT: Analizë e programit të Lëvizjes BASHKË
sipas këndvështrimit të teorisë marksiste të programit për të kuptuar
nëse është apo jo e tillë (pra është apo jo marksiste).**

Sipas ChatGPT, kemi:

1. Qasja ndaj arsimit si një e mirë publike dhe jo si mall

“e konsideron arsimin një të mirë publike dhe një të drejtë që i takon çdo qytetari”

Ky është një koncept që rezonon me idetë marksiste – ideologjia marksiste kundërshton konceptimin e arsimit si produkt i tregut dhe e sheh si një mjet emancipues, të lidhur me ndërgjegjësimin klasor dhe formimin e qytetarit kritik. Kjo deklaratë e pozicionon qartë kundër neoliberalizmit, që privatizon gjithçka, përfshirë arsimin.

2. Fuqizimi i vetëdijes kritike dhe emancipimi përmes dijes

“arsimi është [...] domosdoshmëria për zhvillimin e arsyes kritike, e ideve emancipuese, kultivimin e rezistencës ndaj padrejtësive sociale”

Këtu ka përdorim të një vokabulari që bie në një linjë me marksizmin kulturor dhe ideologjitë e majta radikale. Fjala “emancipim” dhe “rezistencë ndaj padrejtësive sociale” janë terma që përdoren shpesh në diskursin marksist për të përshkruar ndërgjegjësimin klasor dhe çlirimin nga strukturat shtypëse.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

more dhe përgatitjes së maturantëve, vihet re një disbalancë e thellë mes gjimnazeve në periferi dhe atyre në qendrat urbane. Kjo disbalancë, megjithatë, nuk evidentohet në vlerësimin me notë për shkak se pranimi në degët universitare të studimit bëhet vetëm përmes mesatares së gjimnazit. Lidhjet personale, e ndonjëherë edhe ndikimet politike, bëjnë që shumë nota në gjimnaz (sidomos në periferi) të jenë fiktivisht të larta.

Politizimi i institucioneve arsimore është një ndër problematikat qendrore të sistemit. Ky fenomen manifestohet si në emërimin e drejtorëve, ashtu edhe në presionin që i ushtrohet trupës së mësuesve për të bërë fushatë përmes rrjeteve sociale për partinë në pushtet (në janar të këtij viti, 36 institucione arsimore u kallëzuan në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se kishin shpërndarë nga faqet zyrtare postime në mbështetje të fushatës elektorale të ministres së Arsimit). Një praktikë e tillë e ka denigruar figurën e mësuesit në shoqërinë shqiptare, një figurë qendrore në rolin që ka në edukimin e brezave, duke e kthyer atë në një militant partiak ose në një nëpunës që rri kokulur përballë presionit të pushtetit.

Denigrimi i figurës së mësuesit për shkak të presionit politik, i kombinuar me pagat e ulëta, mungesën e infrastrukturës së mësimdhënies, si dhe me trajnimet fiktive që ofrohen për mësuesit e që nuk shërbejnë realisht për aftësimin e tyre dhe avancimin në karrierë, ka bërë që dega e mësuesisë sot të jetë ndër degët më pak të lakmuara nga të rinjtë shqiptarë, duke shkaktuar një situatë emergjence sa i

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

3. Pyetjet që sfidojnë strukturat ekzistuese të dijes

“A janë ata vazo të zbrazëta që duhen mbushur nga mësuesi [...] apo ky i fundit është një udhërrëfyes...?”

Ky lloj reflektimi për mënyrën e ndërtimit të dijes është shumë pranë filozofisë së Paulo Freire, një edukator brazilian i frymëzuar nga marksizmi. Freire fliste për pedagogjinë e shtypurit, ku nxënësi nuk është subjekt pasiv, por aktor aktiv në formimin e vet. Ky program duket se ndjek të njëjtën qasje.

4. Kritika ndaj elitizmit dhe përkrahja e barazisë

“A është arsimi privilegji i një elite [...] apo e drejta e çdo qytetari?”

Ky është një formulim tipik i retorikës anti-elitare që vjen nga një kritikë marksiste e strukturave të pushtetit që monopolizojnë dijen dhe e përdorin atë për të riprodhuar klasat sunduese.

5. Kritikë ndaj braktisjes së arsimit – shifra që përforcojnë realitetin e shtypjes socio-ekonomike

Përmenden rënia e regjistrimeve, mbyllja e shkollave, emigrimi, braktisja e shkollës për arsye ekonomike.

Këto janë të dhëna që sugjerojnë një strukturë klasore të pamundësisë për arsim, një element që marksizmi do ta interpretonte si pasojë direkte e pabarazisë ekonomike dhe dominimit të klasës kapitaliste.

6. Kritika e PPP-ve dhe taksave të kota

“vetëm 9 nga 17 shkollat e parashikuara janë ndërtuar përmes Partneritetit Publik Privat (PPP)”

PPP-të janë një mjet neoliberal për të zhvendosur përgjegjësitë publike tek sektori privat, një praktikë që marksizmi e kundërshton me forcë. Kritika ndaj këtyre projekteve, dhe ndaj taksave që nuk kthehen në shërbim, tregon një pozicionim qartësisht kundër modelit ekonomik neoliberal.

7. Tërheqja e dijes drejt tregut

Përmendet tërheqja e studentëve drejt degëve me mundësi emigrimi/pune jashtë.

Kjo nënkupton që arsimi është kthyer në mall tregu për të rritur “kapitalin njerëzor”, jo për emancipim qytetar. Vetë ky shqetësim i artikuluar është një sinjal ideologjik i orientuar nga e majta kritike.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

përket edukimit të brezave që do të vijnë. Ekspertët kanë vënë alarmin se niveli i studentëve që zgjedhin mësuësinë është gjithnjë e më i dobët.

Cilësia e teksteve shkollore prej vitesh tashmë është vënë në pikëpyetje nga prindër dhe nga ekspertë të fushës së arsimit. Nuk ekziston një shtëpi botuese e librit shkollor me një bord redaktorësh nga Ministria e Arsimit. Shkollat i përziejdhin tekstet shkollore që do të përdorin gjatë vitit nga ofertat që vijnë nga subjekte private. Prej shumë kohësh tregu i librit shkollor dominohet nga vetëm dy shtëpi botuese.

Edhe më katastrofike paraqitet situata me arsimin e lartë në vend. Reforma tregtarizuese e miratuar nga qeveria në vitin 2015 ka dështuar katërpërisht. Në themel të kësaj reforme qëndronte logjika e heqjes së përgjegjësisë nga shteti për financimin e universiteteve publike dhe sigurimi i fondeve të domosdoshme përmes tarifave studentore. Por me tkurrjen e numrit të studentëve, këto të ardhura nuk mund të vijnë përveçse nga komercializimi i mëtejshëm i ambienteve universitare. Trupa pedagogjike po shndërrohet gradualisht në një agjenci marketingu që duhet të tërheqë sa më shumë studentë. Nëse sinqeriteti intelektual dhe ndjenja e qytetarisë i shtyn pedagogët që të jenë kritikë ndaj problematikave të institucionit publik ku ata punojnë, pasiguria financiare e institucionit i detyron ata të mbyllin gojën.

Nuk ekzistojnë më standarde institucionale të vlerësimit objektiv të studentëve duke u bazuar te merita: cedimi i korrektesës akademike nga ana e pedagogëve vjen jo për

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

Përmbledhje e orientimit ideologjik (Pjesa 1):

<i>Element</i>	<i>Përputhshmëria me Marksizmin</i>
Arsimi si e mirë publike	Po
Kritika ndaj elitizmit & monopolit të dijes	Po
Emancipim, arsyetim kritik, ndërgjegje qytetare	Po
Kritika ndaj neoliberalizmit dhe PPP-ve	Po
Vetëdije për pabarazitë klasore	Po
Qasje reformiste, jo hapur revolucionare	Pjesërisht

Përfundim paraparak: Pjesa 1 e programit është shumë afër ideologjisë së majtë marksiste, me theks të veçantë te arsimi si instrument emancipimi dhe vetëdijesim politik e klasor. Nuk ka gjuhë hapur revolucionare ose termat tipikë të marksizmit ekonomik (“kapitalistë”, “proletariat”, “mjetet e prodhimit”), por mbart një strukturë ideologjike e frymëzuar qartë nga marksizmi kulturor dhe kritik.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

arsye të përfuturit personal (ndonjëherë edhe për këtë shkak), por për arsye të mbijetesës financiare të institucionit. Nëse studentët i ndërpresin studimet, institucioni publik rrezikon falimentin. E njëjta logjikë e “shtyn” studentin nëpër nivelet e studimit, duke nisur që nga diploma bachelor, në master, e deri në doktoratë. Në një situatë të tillë, pajisen me diploma praktikisht të gjithë studentët që hyjnë në universitet, duke krijuar kaos edhe për punëdhënësit që kërkojnë nivele të caktuara njohurish nga studentët e diplomuar që duan të hyjnë në tregun e punës.

Logjika tregtarizuese e ndjekur nga qeveria ka bërë që kostot e studimit për një student, sidomos në Tiranë, të jenë të papërballueshme. Tarifat e studimit në nivelin master luhaten në disa mijëra euro, duke u krahasuar me tarifën e universiteteve private brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, kostot e strehimit nëpër kampuset studentore shkojnë nga 5.000 deri në 7.000 lekë të reja në muaj për një krevat. Mungojnë tërësisht sallat e studimit me orar të zgjatur që ofrojnë kushte normale studimi si ngrohja, ndriçimi, interneti; mungojnë bibliotekat universitare që do të ofronin literaturën e duhur studimore vendase dhe sidomos atë të huaj; mungojnë mensat universitare që do të mund të siguronin ushqim cilësor dhe të përballueshëm për studentët; mungojnë laboratorët për plotësimin e njohurive teorike me aplikimin praktik; në shumicën e fakulteteve nuk mund të sigurohet një periudhë stazhi për studentët që pritet të diplomohen; mungon një shtëpi botuese e librit universitar, me një bord redaktorësh, duke bërë që jo rrallëherë pedagogë të caktuar të abuzojnë me tekste të përkthyer keq e që mbajnë emrin e tyre, që shiten në auditorët univer-

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

PJESA E DYTË E PROGRAMIT

Le ta analizojmë **Pjesën II të programit**, duke e trajtuar me **kriterin marksist**, pra duke parë nëse ajo:

Analizon realitetin arsimor në funksion të **strukturave ekonomike dhe klasore**;
Denoncon **pabarazitë sociale, eksploatimin dhe kontrollin ideologjik** përmes arsimit;
Merr qëndrim kritik ndaj **kapitalizmit, komercializimit të arsimit dhe shtetit borgjez**;
Mbron idenë e **arsimit si e mirë publike**, që duhet të jetë **universal, falas, cilësor dhe i çliruar nga interesat private apo ideologjike**.

Analiza marksiste e Pjesës II: Problemet kryesore

1. Infrastruktura e munguar dhe ndarja urbane-periferi

Denoncohet mungesa e ndriçimit, ngrohjes, laboratorëve, librave dhe teknologjisë në shkollë. Veçanërisht vihet theksi te pabarazia mes zonave urbane dhe periferike, duke krijuar një ndarje të thellë klasore. Kjo përputhet me analizën marksiste që evidenton se arsimi në kushte të padrejta materiale përforcon rendin ekzistues shoqëror, duke u dhënë më pak mundësi shtresave të marginalizuara.

2. Kritika ndaj përmbajtjes arsimore dhe metodologjisë

Theksohet kritikë ndaj kurrikulave të huazuara, të papërshtatshme për realitetin shqiptar. Nxitet ideja që mësimdhënia aktuale është mekanike, e përmendshme, dhe nuk zhvillon mendim kritik. Kjo bie dakord me qasjen marksiste se arsimi aktual shpesh synon të prodhojë punëtorë të bindur, jo qytetarë të ndërgjegjshëm dhe krijues.

3. Komercializimi i orarit të zgjatur dhe arsimit privat

Tregohet se mungesa e orarit të zgjatur në shkollat publike ka krijuar hapësirë për kurse me pagesë, që familjet i paguajnë me vështirësi. Kjo ekspozon kapitalizimin e shërbimeve arsimore, gjë që për një analizë marksiste është pjesë e kritikës së shndërrimit të arsimit në mall.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

sitare me çmime marramendëse.

Degradimi i jetës akademike është projektuar edhe te feudalizmi në marrëdhëniet e pushtetit brenda universiteteve publike. Për hir të parimit të vetëqeverisjes, universitetet publike janë kapluar nga klientelizmi që mundëson rizgjedhjen në detyrë të atyre që mbajnë postet drejtuese. Në vitet e fundit ka pasur një seri skandalesh, kryesisht të lidhura me praktikën e plagjiaturës për fitimin e titujve akademikë, por që nuk ka arritur të zgjojë indinjatën e trupës së gjerë akademike, ca nga frika e ca nga konformizmi për hir të karrierës. Ndërkohë, pesha e votës studentore në zgjedhjen e drejtuesve të universiteteve publike është e papërfillshme: vetëm 10%.

Plagjiaturat në botën akademike dhe në rangjet politike drejtuese janë një fenomen i përhapur. Si ministrija aktuale e Arsimit, Ogerta Manastirliu, ashtu dhe paraardhësja e saj, Evis Kushi, janë denoncuar publikisht për plagjiaturë të punimit të doktoratës. Po njësoj edhe rektori aktual i Universitetit të Tiranës, Artan Hoxha. Nuk ekziston një kriter apo procedurë e qartë për kontrollin kundër plagjiaturës të punimeve shkencore me software të posaçëm. Mbrojtja e një punimi shkencor dhe fitimi i gradës Doktor i Shkencave është kthyer në një procedurë formale. Ka një mungesë të theksuar të filtrave sa i përket punës akademike të aspirantëve për këtë gradë, punë e cila nuk këqyret nën lupën kritike të komunitetit akademik. Për më tepër, procedurat për fitimin e titujve akademikë profesor apo profesor i asociuar janë lehtësuar maksimalisht, duke hequr kritere të cilësisë që kanë ekzistuar më parë dhe duke vendosur si kriter shkrimin e një monografie.

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

4. Shkollat në shërbim të interesave partiake – politizimi

Denohet qartësisht se institucionet arsimore përdoren për fushata politike dhe janë të kapura nga partia në pushtet. Një marksist do e lexonte këtë si dëshmi e kapjes ideologjike të shkollës nga shteti borgjez, që nuk edukon për emancipim, por për bindje ndaj pushtetit.

5. Dekadenca e arsimit të lartë dhe reforma neoliberale

Kritika ndaj reformës së vitit 2015 është e qartë: heqja e financimit publik, kalimi të tarifave dhe komercializimi i universiteteve. Universitetet shndërrohen në biznese që garojnë për studentë, pedagogët në agjentë marketingu. Kjo është qartësisht një analizë antikapitaliste dhe antimarket, që përputhet me kritikën marksiste ndaj privatizimit të arsimit si mekanizëm i prodhimit të pabarazive.

6. Deklasimi i pedagogëve, mungesa e meritokracisë dhe burokracitë

Roli i pedagogëve degradohet për shkak të pasigurisë financiare dhe mungesës së standardeve. Plagjiatura, klientelizmi, mungesa e kritikës dhe frika janë elemente të një sistemi akademik të kalbur nga marrëdhëniet e pushtetit dhe jo nga merita – një temë e thellë marksiste.

7. Mungesa e kërkimit shkencor si pasojë e mungesës së financimit publik

Një nga kritikët më të forta: mungesa e fondeve për kërkimin shkencor, mungesa e laboratorëve dhe e mbështetjes për doktorantët. Kjo ekspozon braktisjen e dijes dhe të kërkimit si e mirë publike nga shteti, dhe për një analizë marksiste është shembulli më i mirë i kapitullimit të shtetit përballë tregut dhe privatit.

8. Qendërzimi i pushtetit mbi arsimin dhe mbyllja e ciklit klientelist

Propozimi për ta kaluar menaxhimin e fondeve të BE-së nga universitetet te një konsorcium nën kontrollin e kryeministrit është tregues i qeverizimit autoritar dhe të centralizuar të dijes – e cila nuk shërben më për shoqërinë, por për interesin e kastës në pushtet.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

Nga ana tjetër, kushtet dhe mundësitë për kryerjen e kërkimit shkencor në Shqipëri janë të mjerueshme. Studentët e shkollës së doktoratës jo vetëm që nuk mbështeten financiarisht nëpërmjet bursave, si në mbarë botën e zhvilluar, por ata duhet të paguajnë edhe një tarifë për regjistrimin në këtë nivel studimi në vlerën 2.000 euro. Fondet e buxhetit të shtetit për kërkimin shkencor kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në nivele qesharake. Infrastruktura laboratorike për kërkimin shkencor është inekzistente. E vetmja mënyrë financimi për kërkuesit e rinj është fitimi i projekteve kërkimore të financuara nga vendet e Bashkimit Evropian, por mungesa e infrastrukturës kërkimore bën që Shqipëria të jetë vendi që aplikon më pak për projektet evropiane të kërkimit shkencor. Ndërsa ligji aktual për kërkimin shkencor ua vështirëson pambarimisht punën kërkuesve të rinj për shkak një vargu procedurash burokratike për lëvrimin e fondeve që vijnë nga BE, ligji i ri që propozohet nga kjo qeveri ka për synim që ta ruajë të njëjtën strukturë burokratike, me dallimin që do ta zhvendosë atë nga universitetet në duart e një konsorciumi me në krye kryeministrin e vendit.

III. Alternativa e Lëvizjes BASHKË

Vizioni i Lëvizjes BASHKË në ndërtimin e një shteti social është një sistem arsimor publik cilësor dhe i përballueshëm nga të gjithë qytetarët. Në këtë vizion, institucionet publike të arsimit duhet të gjejnë të shteti shqiptar themelin tek i cili do të mbështeten. Prandaj çdo hap përpara drejt këtij vizioni do duhet të nisë me rritjen substanciale të financimeve të shtetit për arsimin. Lëvizja BASHKË propozon rritjen nga 2.9% të PBB që është sot, në të paktën 4%

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

Përfundim: Është pjesa marksiste? Po – dhe fort.

Kjo pjesë e programit përmban një analizë të qartë strukturore të arsimit në Shqipëri si pjesë e një sistemi klasor, të pabarabartë dhe të kontrolluar nga pushteti dhe kapitali. Në mënyrë të qëndrueshme, ajo: *Denoncon eksplotimin dhe komercializimin e arsimit*; Mbron arsimin publik, cilësor dhe universal; Kritikon kapjen e sistemit arsimor nga politika dhe tregu; Ngrit shqetësimin për figurën e mësuesit dhe të dijes si pasuri shoqërore; Analizon çështjet në kontekst klasor dhe ideologjik, jo si fenomene të izoluara. Pra, kjo pjesë jo vetëm është në përputhje me një analizë marksiste, por mund të konsiderohet një nga segmentet më të qarta të kësaj linje ideologjike në të gjithë tekstin.

Analiza e pjesës së fundit të programit:

Le ta zbërthejmë në pika kryesore sipas kritereve që përmendëm më herët (qasje ndaj kapitalizmit, shtetit, klasave shoqërore, edukimit, demokracisë, dhe raportit me privatizimin):

Elementë që kanë ngjashmëri me qasje marksiste (ose të majtë radikale):

E drejta universale për arsim publik falas:

Propozimi për arsim të lartë falas, si dhe arsim parauniversitar i cilësor dhe i përballueshëm për të gjithë, është qartazi në frymën marksiste që e sheh edukimin si të drejtë universale dhe jo si mall tregu. Qasja për heqjen e tarifave dhe financimin e plotë nga shteti lidhet drejtpërdrejt me kërkesën marksiste për çlirimin e edukimit nga tregu.

Rritja e rolit të punëtorëve dhe komunitetit në vendimmarrje:

Iniciativa si forcimi i rolit të Asamblesë së Pedagogëve, rritja e peshës së votës studentore në 50%, forcimi i unioneve studentore dhe të mësuesve, janë në përputhje me parimet e demokracisë pjesëmarrëse dhe vetëqeverisjes punëtore, të cilat janë tipare thelbësore të ideologjisë marksiste.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

të PBB që është edhe mesatarja e vendeve të rajonit. Këto të ardhura do të shërbenin, në radhë të parë, për të plotësuar nevojat infrastrukturore nga të cilat vuajnë institucionet e arsimit në vend, e më tej për të ofruar arsim publik cilësor e të përballueshëm për të gjithë qytetarët.

Sfidat me të cilat përballlet arsimi nisin që nga sistemi parauniversitar. Pranë Lëvizja BASHKË, frymëzuar nga modeli finlandez, për rimëkëmbjen e tij mbështetet në dy shtylla qendrore: reformimi i arsimit parauniversitar nga poshtë dhe rritja e përgatitjes së mësuesve.

1. Reforma që nis nga baza

Reformimi rrënjësor që i nevojitet sistemit arsimor të ciklit të ulët dhe të mesëm në Shqipëri do të ketë për synim rikonceptimin e themeleve teorike dhe metodologjike të arsimit. Në vizionin e Lëvizjes BASHKË reformimi duhet të nisë nga një cikël i gjerë konsultimesh në të gjitha qytetet e vendit ku do të bëhen bashkë me qindra mësues, prindër, ekspertë të arsimit dhe drejtues lokalë për të diskutuar:

- Nevojat konkrete infrastrukturore, problematikat dhe sfidat me të cilat përballlet trupa e mësuesisë në çdo rajon.
- Ndryshimin e qasjes në mësimdhënie që aktualisht përqendrohet te mësimi përmendësh, drejt diskutimit në klasë për të nxitur të menduarit në mënyrë kritike dhe të pavarur të nxënësve.
- Ndryshimin e kurrikulave të studimit duke synuar njëkohësisht arsimimin dhe edukimin e të rinjve si individë të virtytshëm dhe shumëpërmasorë, të motivuar për të ndjekur arsimin e mëtejshëm.
- Diskutimin e vështirësive me të cilat përballen familjet

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

Forcimi i sektorit publik përballë privatit:

Themelimi i shtëpive botuese shtetërore për tekstet shkollore dhe universitare, ndalimi i reformave privatizuese, dhe angazhimi për infrastrukturë të financuar nga shteti reflekton kundërshtimin ndaj neoliberalizmit dhe privatizimit të arsimit, gjë që është në linjë me kritikën marksiste ndaj komodifikimit të dijes.

Qasje klasore ndaj varfërisë dhe pabarazisë:

Propozimet për ushqim falas për nxënësit nga familje të varfra, bonuse për mësues në zona të largëta, përfshirje të prindërve në vendimarrje, dhe lehtësime për familjet punëtore janë elementë që synojnë uljen e pabarazive klasore, një qëllim i qartë i filozofisë marksiste.

Zhvillim nga poshtë dhe demokraci horizontale:

Konsultimi me komunitetin, studentët, mësuesit dhe ekspertët në nivel lokal, si dhe koncepti që reforma duhet të vijë nga poshtë, është shumë afër vizionit antiautoritar dhe demokratik-popullor të socializmit marksist. Elementë që e largojnë nga marksizmi klasik (ose i japin një formë më reformiste/socialdemokrate):

Mungon kritika e hapur ndaj kapitalizmit si sistem:

Edhe pse ka një qëndrim të qartë kundër privatizimit, nuk ka një kritikë sistematike të kapitalizmit në tërësi. Nuk përmendet as koncepti i kapitalit, shtypjes klasore, apo konfliktit të klasave siç do ta bënte një tekst autentik marksist.

Përfshirja e bizneseve dhe OJF-ve në bashkëpunim me shkollat:

Edhe pse mund të shihet si praktikë pragmatike, përfshirja e sektorit privat në edukim (edhe në një formë të rregulluar) nuk është tipike për një vizion marksist të pastër, ku ideali do ishte kontrolli kolektiv dhe publik i edukimit pa ndërhyrje nga aktorë të tregut.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

shqiptare për shkollimin e fëmijëve të tyre dhe lehtësimet që duhet të sigurojë pushteti lokal. Përfshirjen e komunitetit të prindërve duke u caktuar një shkallë vendimarrjeje në shkolla.

e) Ngritjen e një rrjeti kombëtar komunikimi dhe bashkëpunimi mes shkollave, prindërve, bizneseve dhe OJF-ve.

2. Përgatitja e mësuesve

Nuk mund të ketë nxënës të përgatitur pa pasur mësues të përgatitur. Njëkohësisht, nuk mund të ketë të rinj shqiptarë të talentuar që zgjedhin të ndjekin degën e mësuesisë pa i rikthyer figurës së mësuesit dinjitetin profesional, konsideratën shoqërore dhe autonominë krijuese në vendin e punës që meriton. Sa më sipër mund të arrihen duke e nisur me:

a) Rritjen thelbësore të cilësisë së degës së mësuesisë përmes afimit të ekspertëve të huaj dhe vendas, që do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë trajnimit të mësuesve të rinj që e shohin profesionin edhe si një detyrë morale e sociale. Diploma në mësuesi do duhet të hapë rrugën për studime të mëtejshme dhe avancimin në karrierë në nivelet drejtuese të sistemit arsimor. Tarifat e studimit për këtë degë do të mbulohen 100% nga shteti.

b) Mësuesve u duhet dhënë mundësia e zhvillimit profesional përmes përditësimit të vazhdueshëm me zhvillimet e fundit në kërkimin shkencor dhe në teknologji në fushën e tyre të kompetencës. Kjo do të realizohet përmes trajnimit falas të mësuesve.

c) Mësuesit duhet të kenë një shkallë të caktuar autonomie për ta përshtatur kurrikulën dhe metodikën e mësimdhënies sipas nevojave specifike të nxënësve dhe kontekstit social. Objektivi i mësuesve është që të inkurajojnë

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

Zhvillim brenda kornizës së shtetit ekzistues:

Nuk ka thirrje për shndërrim të strukturës së shtetit apo shoqërisë në tërësi (si te marksizmi revolucionar), por më shumë reforma brenda sistemit. Kjo e afron më shumë me socialdemokracinë progresiste sesa me marksizmin revolucionar.

Përmbledhje: A është marksiste kjo pjesë e programit të Lëvizjes BASHKË?

Ky vizion për arsimin është shumë i afërt me marksizmin në thelbin ideologjik dhe në orientimin e përgjithshëm, sidomos për shkak të: *Fokusit tek publiku, barazia, roli i shtetit, Qasjes kundër privatizimit, Demokracisë pjesëmarrëse dhe forcimit të unioneve.*

Megjithatë, mungesa e një kritike të hapur të kapitalizmit si sistem, si dhe përfshirja e elementëve pragmatikë të bashkëpunimit me sektorin privat, e pozicionojnë këtë alternativë më afër një forme moderne të socializmit demokratik ose marksizmit reformist, sesa një marksizmi ortodoks revolucionar. Nëse po kërkojmë një marksizëm praktik dhe bashkëkohor që synon transformime brenda sistemit aktual përmes politikave radikale por të realizueshme, atëherë kjo alternativë përputhet shumë mirë me atë kuptim të marksizmit.

Një rikonceptim i analizës, përsëri nga ChatGPT

1. Vizioni për arsimin publik si e drejtë universale

Pikëpamja: Arsimi duhet të jetë publik, cilësor dhe i përbalueshëm. Shteti ka detyrim ta financojë atë në mënyrë substanciale (nga 2.9% në 4% të PBB). Kjo nënkupton një rol aktiv të shtetit në shpërndarjen e burimeve.

Analizë marksiste: Ky qëndrim është në përputhje me ideologjinë marksiste, që sheh arsimin si të drejtë bazë dhe mjet për emancipimin klasor. Shteti si garantues i të drejtës për arsim është një pozicion tipik i të majtës, përfshirë marksistët. Megjithatë, nuk kemi fjalor klasor eksplícit, as termat “klasa punëtore”, “borgjezi”, etj.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

analizën dhe krijimtarinë të nxënësit. Në vend se nxënësit të përqendrohen vetëm te mësimi i teksteve, ata do të angazhohen në projekte praktike duke nxitur të menëduarit në mënyrë autonome.

d) Shteti duhet të sigurojë kushte të përshtatshme pune për mësuesit dhe infrastrukturën e mësimdhënies, duke nisur nga laboratorët, sallat e kompjuterëve dhe bibliotekat.

e) Shteti duhet të sigurojë paga të dinjitetshme – jo vetëm përmes rritjes së pagave të mësuesve në nivelet e rajonit në rreth 100.000 lekë/muaj, por edhe përmes një bonusi mirënjohjeje që fitohet me mbështetjen e prindërve, kolegëve dhe drejtuesit të institucionit (por që nuk ndikohet nga notat e nxënësve).

f) Forcimi i rolit të sindikatave të mësuesve është mënyra e duhur për të garantuar depolitizimin e shkollave e gjimnazëve, pavarësinë dhe pacenueshmërinë e figurës së mësuesit nga ndikimet e politikës dhe nga padrejtësitë brenda institucionit.

Ndër objektivat e tjerë për reformimin e sistemit arsimor parauniversitar, përmendim:

- Ndërtimi i shkollave të reja në qendrat urbane

Për shkak të përqendrimit të popullsisë, Tirana ka nevojë emergjente për ndërtimin e 20 shkollave të reja, duke ndërtuar me përparësi shkolla në lagjet në të cilat mungojnë tërësisht. Fondet për ndërtimin e këtyre shkollave do të vijnë nga menaxhimi i ndershëm dhe rigoroz i parave publike dhe politikave tatimore progresiste. Standardi që synohet të arrihet për një mësimdhënie më cilësore është që në çdo klasë të zhvillojnë mësim maksimumi 20 nxënës

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

Përfundim: Marksist në frymë, por jo në gjuhë.

2. Reforma “nga poshtë” dhe përfshirja komunitare

Pikëpamja: Reforma bazohet në konsulta horizontale me mësues, prindër, komunitet. Objektivi: demokritizimi i proceseve arsimore.

Analizë marksiste: Kjo përfshirje nga poshtë është shumë e afërt me parimet e demokracisë punëtore dhe të vetëorganizimit të klasave të nënpërfaqësuar – elementë kyç në marksizëm dhe socializëm demokratik. Shmangia nga një model elitar, nga lart-poshtë, është karakteristikë e qasjeve të majta.

Përfundim: E afërt me marksizmin libetar, por pa përdorur gjuhë revolucionare.

3. Dinjiteti i mësuesit dhe forcimi i sindikatave

Pikëpamja: Rritje pagash, kushte më të mira, autonomi krijuese. Bonuse nga komuniteti, jo nga rezultatet (kundër logjikës së tregut). Forcimi i sindikatave si mburojë ndaj politizimit dhe padrejtësive.

Analizë marksiste: Roli i sindikatave dhe mbrojtja e punonjësve është element thelbësor në teorinë marksiste të shtresave shoqërore. Ngritja e figurës së punonjësit të dijes (mësuesit) si faktor emancipues është në linjë me idetë e Gramsci-t për intelektualët organikë.

Përfundim: Kjo është ndër pjesët më qartazi të majta dhe marksiste në frymë.

4. Investimet publike dhe taksim progresiv

Pikëpamja: Shkolla të reja, orar i zgjatur, ushqim për nxënësit, kontroll shëndetësor. Financimi përmes menaxhimit të mirë të buxhetit dhe taksimit progresiv.

Analizë marksiste: Taksimi progresiv është një instrument i politikave socialdemokrate, por përdoret shpesh edhe në propozime të majta më radikale. Ideja që shteti duhet të rishpërndajë pasurinë për të ndihmuar më të dobët është një parim klasik i së majtës, përfshirë marksistët, ndonëse nuk është ekskluzivisht marksist.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

dhe të ketë nga një mësues ndihmës për çdo dy klasa, materiale të përshtatura dhe trajnime për stafin mbi edukimin gjithëpërfshirës.

- Shkollimi me orar të zgjatur

Shkollat në mbarë Shqipërinë do të shndërrohen në mjediset e edukimit me orar të zgjatur, ku fëmijët do të kenë mundësi që, pas orës së mësimi, t'i përdorin mjediset shkollore për të bërë detyrat, për të punuar në grup dhe për t'u argëtuar në mënyrë të shëndetshme me aktivitete sportive, artistike etj. Qëllimi ynë është që fëmijët të qëndrojnë në shkollë deri në orën 17:00, duke u shkarkuar prindërve barrën financiare e të tjera angari. Pas orës 17:00 mjediset e jashtme të shkollës mund të shërbejnë si qendra komunitare, ku banorët e lagjes mund të përdorin me kujdes dhe nën mbikëqyrje infrastrukturën sportive të shkollave ose kapacitetet e saj për veprimtari kulturore.

- Ushqimi i shëndetshëm në shkollë

Edukimi me orar të zgjatur kërkon që mjediset shkollore t'u sigurojnë fëmijëve ushqim dhe vende të përshtatshme të të ngrënit. Përmes zbatimit të politikës "Nga ferma në shkollë", ne do t'u mundësojmë nxënësve ushqim të shëndetshëm në shkollë kundrejt një pagese modeste nga familjet. Për fëmijët që vijnë nga familje në kushte varfërie, bashkitë e rretheve do ta sigurojnë falas ushqimin e tyre. Dy masat e fundit kërkojnë një shtim të stafit të shkollave, sidomos të numrit të mësuesve, çka do të kërkonte nxitjen e bashkëpunimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Zvogëlimi i hendekut të cilësisë në mësimdhënie mes periferisë dhe qendrës

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

Përfundim: Jo marksiste në thelb, por fuqimisht socialiste dhe rishpërndarëse.

5. Arsimi i lartë falas dhe vetëorganizimi studentor

Pikëpamja: Ulje graduale e tarifave deri në arsim falas. Forcimi i unioneve studentore, roli i studentëve në vendimmarrje (50% e votës), ngritja e infrastrukturës publike.

Analizë marksiste: E drejta në arsim pa pagesë është një tezë marksiste klasike. Vetëorganizimi studentor dhe pjesëmarrja në vendimmarrje janë në përputhje me parimin marksist të demokracisë nga poshtë dhe kontrollit punëtor mbi institucionet.

Përfundim: Kjo është afër socializmit demokratik me elementë të qartë marksistë.

6. Botime publike dhe meritokraci e barazi në vlerësim

Pikëpamja: Shtëpi botuese shtetërore për libra shkollore/universitarë. Transparencë, luftë kundër korrupsionit akademik, meritokraci reale.

Analizë marksiste: Këto janë më shumë masa anti-nepotike dhe për barazi mundësish, sesa domosdoshmërisht marksiste. Nuk ka thirrje për përmbysje të rendit, por për përmirësimin e tij nga brenda, përmes reformave.

Përfundim: Reformiste, e majtë, por jo marksiste në mënyrë eksplicite.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

Kjo arrihet duke vendosur standarde kombëtare për mësimdhënien, duke investuar në infrastrukturë dhe duke ofruar bonuse mujore për mësuesit që pranojnë të punojnë në zona të largëta. Një faktor i rëndësishëm është përdorimi i teknologjisë: përmes platformave online dhe programeve të shkëmbimit mes shkollave, nxënësit e zonave rurale mund të marrin të njëjtën cilësi arsimimi si ata në qytete.

• Themelimi i shtëpisë botuese të librit shkollor
Cilësia e librave shkollorë dhe sigurimi i tyre për nxënësit me kosto të ulët duhet të jetë përgjegjësi e shtetit shqiptar. Shtëpia botuese e librit shkollor do të afrojë ekspertë të fushave të ndryshme shkencore dhe shoqërore për t'u bërë pjesë e bordit redaktues të librave shkollorë, me qëllim që të garantohet cilësia e literaturës së mësimdhënies. Për të nxitur leximin, dy libra jashtëshkollorë do të ofrohen falas për çdo nxënës dhe do të krijohen klubet e leximit në çdo shkollë.

• Provim hyrës për shkollën e lartë
Për t'u përballur me problematikën që lidhet me notat fiktivisht të larta të gjimnazit, pranimi në degët e studimit universitar nuk do të bazohet vetëm te mesatarja e shkollës së mesme, por edhe te një provim i posaçëm pranimi. Provimi hyrës për shkollën e lartë do të testojë në masën 60% njohuritë e përgjithshme të nxënësve dhe pjesa tjetër do varet nga zgjedhja që bën nxënësi mes fushave shkencore apo shoqërore. Vlerësimi në provim, së bashku me mesataren e gjimnazit, do të jenë kriteret për pranimin në universitet.

• Ngritja e zyrave të karrierës
Orientimi i karrierës duhet të jetë pjesë e detyrueshme e aktivitetit shkollor. Të gjithë nxënësit do të marrin një orien-

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

PËRMBLEDHJE E ANALIZËS

Element	Marksist?	Koment
Financimi publik i arsimit	PO Në frymë	Rishpërndarje dhe barazi
Reforma “nga poshtë”	PO	Demokraci radikale, afër socializmit
Forcimi i sindikatave	PO	Qasje klasore ndaj të drejtave të punës
Arsim falas dhe pjesëmarrje studentore	PO	Afër modelit të universiteteve të vetëqeverisura
Taksimi progresiv	diçka	Tipik për socialdemokracinë, por jo vetëm
Meritokracia, antikorrupsioni	JO	Racionale liberale, jo klasore

Përfundimi i përgjithshëm: Pjesa e tretë e programit të Lëvizjes BASHKË ka një frymë të fortë socialiste dhe pjesërisht marksiste, sidomos në: rolin e shtetit si garant i të drejtave sociale, pjesëmarrjen horizontale në vendimmarrje, fuqizimin e punonjësve dhe studentëve përmes organizimit vetanak, edukimin si mjet emancipimi klasor.

Megjithatë, nuk është doktrinarisht marksiste: Nuk përdor gjuhë revolucionare; Nuk flet për ndërrim të rendit shoqëror apo për përmbyshjen e kapitalizmit; Mbështet masa reformiste brenda sistemit ekzistues.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

tim të vazhdueshëm mbi zgjedhjet që i presin në avancimin e tyre në gjimnaz, në shkollat profesionale apo në tregun e punës. Pjesë e aktivitetit do të jenë edhe praktika brendashkollë për nxënësit nga klasa e 7-të deri në të 9-të për të nxitur mes tyre shprehje të punës praktike dhe krijuese.

- Kontrolli mjekësor ndaj nxënësve

Kontrolli mjekësor që do t'u ofrohet nxënësve në çdo shkollë do të jetë falas dy herë në vit për të gjithë nxënësit deri në moshën 18 vjeç dhe do të përfshijë kontrollin e shëndetit dentar, fizik dhe mendor përmes mjekëve, psikologëve dhe punonjësve socialë.

Prej shumë vitesh ne, aktivistët e Lëvizjes BASHKË, jemi angazhuar jo vetëm në kundërshtimin e reformës privatizuese të Edi Ramës, por edhe për t'i dhënë zë reformës alternative për demokratizimin dhe rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri. Reformimi i universitetit duhet të nisë nga poshtë, me bërjen bashkë të universitarëve – studentëve dhe pedagogëve – për të evidentuar nevojat akute të arsimit të lartë sot në vendin tonë. Ky është vizioni ynë:

- Arsimit publik falas

Arsimi i lartë cilësor duhet të jetë një e drejtë themelore që gëzohet nga çdo qytetar shqiptar, pavarësisht mundësive financiare. Prandaj hapi i parë drejt këtij vizioni do të jetë ulja progresive e tarifave të studimit në nivelet bachelor dhe master, me synimin afatmesëm të zerimit të tyre. Kjo masë do të shoqërohet me rritjen e shpenzimeve shtetërore për nevojat që kanë sot universitetet publike, duke e hequr barrën financiare nga institucionet e arsimit dhe duke i çliruar pedagogët nga presioni për të siguruar mbijetesën financiare.

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

PËRPUTHJA E PROGRAMIT TË LËVIZJES BASHKË ME ATË TË FONDACIONIT ROZA LUXEMBURG

Sipas një analize të ChatGPT

Programi Qeverisës i Lëvizjes BASHKË për 2025 përputhet në disa pika thelbësore me objektivat e Fondacionit Rosa Luxemburg, duke reflektuar një vizion të majtë progresist dhe të orientuar drejt drejtësisë sociale, barazisë dhe kontrollit publik mbi pasuritë e përbashkëta. Ja një analizë sipas fushave kyçe:

1. Ekonomia dhe Kontrolli Publik mbi Burimet

Objektivat e Fondacionit Rosa Luxemburg:

- Ekonomi e drejtuar për nga nevojat e njerëzve, jo fitimi;
- Kontroll publik mbi burimet natyrore dhe sektorët strategjikë;
- Kundërshtim i neoliberalizmit dhe privatizimeve të pasurive publike.

Përputhja me Programin e BASHKË:

- Kërkesa për rinegocimin e kontratave koncesionare në naftë dhe minerale;
- Krijimi i një Fondi Sovran për menaxhimin e pasurive natyrore;
- Ringritja e uzinës së rafinimit të naftës si aset publik;
- Bashkëpronësia punëtor-shtet në ndërmarrje shtetërore (model ESOP);
- Themelimi i një Banka Zhvillimore si instrument për financim publik strategjik.

Vlerësim: Përputhje shumë e fortë me qasjen strukturalisht antineolibérale të fondacionit.

2. Shteti Social dhe Shërbimet Publike

Objektivat e Fondacionit:

- Forcimi i shtetit social;
- Investime në kujdes shëndetësor, arsim, pensione dhe strehim publik.

Përputhja me Programin e BASHKË:

- Ristrukturim i sistemit të pensioneve me bazë solidaritetin;
- Rritje e investimeve në kujdesin shëndetësor universal;

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

re të universitetit duke ceduar në ndershmërinë intelektuale dhe akademike.

- Ngritja dhe forcimi i unioneve studentore

Organizimi studentor, si garantuesi më i mirë i ruajtjes së demokracisë brenda universitetit, nuk do të vazhdojë të monopoliizohet brenda Këshillave Studentorë, por institucioni arsimor do të njohë edhe organizimet e pavarura studentore në formën e unioneve. Ato do të jenë zëri i studentëve të vetorganizuar brenda universitetit që ngrihet kundër çdo pa drejtësie, abuzimi me rolin e pedagogut apo të drejtuesit të institucionit, abuzimit me orët e mësimit etj.

- Rritja e peshës së votës studentore në 50%

Roli i trupës studentore në vendim marrjen për zgjedhjen e drejtuesve të institucioneve të arsimit të lartë sot është në nivele të papërfillshme, vetëm 10%. Studentët e diplomuar janë produkte të këtij institucionit publik, rrjedhimisht të interesuar drejtpërdrejt që ai të drejtohet nga njerëz të aftë e të ndershëm. Prandaj propozimi i Lëvizjes BASHKË është që pesha e votës studentore të rritet në 50%.

- Rritja e rolit të Asamblesë së Pedagogëve

Asambleja e Pedagogëve është një organ i cili mbledh bashkë mbarë trupën pedagogjike të një fakulteti apo universiteti për të diskutuar dhe debatuar mbarëvajtjen e institucionit. Edhe pse ligji e njeh si të tillë, ky organ nuk vihet kurrë në lëvizje. Lëvizja BASHKË do të mbështesë rritjen e kompetencave të Asamblesë së Pedagogëve si një lloj parlamenti demokratik ku debatohen dhe miratohen politikat që ndjek institucioni.

- Vendorsja e standardeve institucionale

Bota akademike universitare duhet të udhëhiqet nga parimi

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

- Reforma në sistemin arsimor për barazi sociale;
- Krijimi i programeve për strehim publik dhe ndihmë sociale.

Vlerësim: Përputhje e plotë me agjendën e fondacionit për një shtet që garanton mirëqenie bazë.

3. Puna dhe të Drejtat e Punëtorëve

Objektivat e Fondacionit:

- Të drejta të fuqizuara për punëtorët;
- Organizim sindikal dhe kushte të denja pune.

Përputhja me Programin e BASHKË:

- Angazhim për rritje të pagës minimale dhe respektim të kushteve të punës;
- Mbështetje për sindikatat;
- Propozimi për miratimin e Statusit të Naftëtarit dhe të Minatorit;
- Fokus te punësimi i grave në sektorin fason dhe përmirësimi i kushteve të tyre.

Vlerësim: Shumë në linjë me kërkesat e fondacionit për drejtësi sociale në tregun e punës.

4. Mjedisi dhe Drejtësia Klimatike

Objektivat e Fondacionit:

- Mbrojtja e mjedisit dhe drejtësia klimatike;
- Ekonomi e gjelbër dhe tranzicion drejt energjive të rinovueshme.

Përputhja me Programin e BASHKË: • Kritika ndaj dëmeve mjedisore nga industria nxjerrëse;

- Thirrje për transparencë dhe kontroll ambiental, si dhe për rehabilitim të zonave të prekura;
- Investime të propozuara në energjinë e qëndrueshme.

Vlerësim: Përputhje e moderuar, me theks në drejtësinë mjedisore në nivel lokal.

5. Demokracia dhe Pjesëmarrja

Objektivat e Fondacionit:

- Demokraci pjesëmarrëse;
- Transparencë dhe angazhim qytetar.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

i meritokracisë. Për realizimin e këtij parimi, universitetet duhet të përcaktojnë standarde institucionale. Ato kanë të bëjnë me: a) vlerësimin objektiv të studentëve nga ana e pedagogëve, ku nota e vendosur do të jetë mund të apelo-het dhe të rishqyrtohet nga komisione të posaçme dhe të pavarura, në mënyrë që studenti as të mos mbivlerëso-het për hir të njohjeve personale, korruptimit të pedagogut etj., as të mos nënvlerësohet padrejtësisht nga pedagogu; b) luftimin e praktikës së të kopjuarit nëpër auditorët uni-versitarë, si një praktikë që gërryen nga poshtë themelet ku mbështetet parimi i meritokracisë dhe deformon mor-alisht studentët në rrugën profesionale që do të ndjekin; c) publikimin e leksioneve online, në shembullin e univer-siteteve më prestigjioze në botë, është mënyra më e mirë për aplikimin e transparencës, ndershmërisë akademike dhe të drejtës për akses në njohuri për mbarë shoqërinë; d) organizimin e anketave studentore të përvitshme mbi vlerësimin që studentët u bëjnë fakulteteve ku studiojnë dhe publikimin e rezultateve të anketave si një mënyrë e drejtë për të orientuar maturantët në zgjedhjen e degës ku do të ndjekin studimet.

• Ngritja e infrastrukturës universitare
Shteti shqiptar, edhe me mbështetjen e projekteve që vijnë nga Bashkimi Evropian, do të investojë në ngritjen e bib-liotekave universitare moderne në çdo fakultet, të pajisura me literaturë vendase dhe të huaj, të cilat do të shërbejnë edhe si ambiente studimi me orar të zgjatur. Gjithashtu do të ngrihen laboratorë të certifikuar me të gjitha pajisjet bashkëkohore për qëllime të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore, por që njëkohësisht mund të ofrojnë

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

mos në fushat e kontrollit publik të burimeve natyrore, forcimit të të drejtave të punëtorëve dhe shtetit social. Aty ku përputhja është më e dobët (si të çështjet klimatike ose barazia gjinore), ka potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm në përputhje me parimet e fondacionit.

- Përputhja me Programin e BASHKË:**
- Transparencë në kontratat shtetërore;
 - Rritje të kompetencave të pushtetit ven-dor për të ardhurat nga renta;
 - Angazhim për pjesëmarrje qytetare në vendimarrje.

Vlerësim: Përputhje pozitive, veçanërisht në drejtim të decentralizimit dhe pjesëmarrjes.

Përfundim: Programi i Lëvizjes BASHKË shkon shumë pranë filozofisë politike të Fon-dacionit Rosa Luxemburg. Ai paraqet një alter-nativë të majtë zhvillimore, që synon një model ekonomik dhe shoqëror me theks te drejtësia sociale, mbrojtja e punëtorëve, kontrolli publik dhe barazia.

Ja një raport krahasues midis Programit Qeverisës të Lëvizjes BASHKË 2025 dhe Ob-jektivave të Fondacionit Rosa Luxemburg, i or-ganizuar në formë tabele për qartësi maksimale:

Raport Krahasues: Lëvizja BASHKË vs Fondacioni Rosa Luxemburg

Përfundim i përgjithshëm: Programi i Lëvizjes BASHKË përputhet në masë të madhe me vizionin e Fondacionit Rosa Luxemburg, sido-

Fusha	Qasja e Fondacionit Rosa Luxemburg	Propozimet e Lëvizjes BASHKË	Përputhja
Ekonomia dhe burimet natyrore	Kontroll publik mbi pasuritë natyrore dhe kundërshtim i neoliberalizmit	Rinegociim kontratash, krijim i Fondit Sovran, Bankë Zhvillimi, kontroll publik mbi industrinë e naftës/mineraleve	Shumë e lartë
Industria dhe shteti zhvillimor	Ekonomi që prodhon vlera për njerëzit dhe jo për korporatat	Rritje e rolit të shtetit në zhvillim industrial, krijimi i ndërmarrjeve publike dhe modeli norvegjez i menaxhimit	E lartë
Puna dhe të drejtat e punëtorëve	Barazi, kushte të drejta pune, fuqizim i sindikatave, pronësi kolektive	Bashkëpronësi punëtor-shtet (ESOP), rritje të mbështetjes për punëtorët në industri, mbrojtje sindikale	Shumë e lartë
Shteti social	Shtet që garanton mirëqenie: arsim, shëndetësi, strehim, pensione	Reformim i sistemit të pensioneve, investime në shëndetësi, arsim falas, strehim social	E lartë
Demokracia dhe transparenca	Demokraci pjesëmarrëse, kontroll demokratik mbi politikat publike	Rritje e kompetencave të pushtetit vendor, transparencë në kontrata dhe politika të përfshirjes qytetare	E mesme – e lartë
Mjedisi dhe drejtësia klimatike	Ekonomi e gjelbër, tranzicion klimatik i drejtë, drejtësi mjedisore	Mbrojtje mjedisore në zonat industriale, rritje e investimeve në teknologji të pastër, por pak detaje klimatike	E moderuar

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

shërbime për palë të treta kundrejt pagesës. Do të hapen salla kompjuterësh që mund të përdoren nga studentët e të gjitha degëve universitare, me prioritet studentët e teknologjisë së informacionit. Çdo kampus universitar do të pajiset me mensa që ofron ushqim cilësor e të lirë për studentët.

- Themelimi i shtëpisë botuese të librit universitar

Libri universitar është një vlerë e çmuar në komunitetin shkencor të së tashmes dhe për brezat e studiuesve që vijnë më pas. Prandaj ai nuk mund t'i vihet përpara një studenti në auditorët universitarë pa kaluar përmes një recense rigoroze shkencore dhe gjuhësore. Prandaj Lëvizja BASHKË propozon themelimin e shtëpisë botuese të librit universitar, në bordin redaktues të së cilës do të ulen personalitete të botës akademike dhe kulturore vendase dhe të huaja.

- Kontrolli i rreptë i punimeve shkencore

Plagjiatura është vjedhja e punës akademike të dikujt tjetër, është pandershmeri dhe mashtrim. Nuk ka turp më të madh në botën akademike sesa plagjiatura. Pa një kontroll të imët të punës kërkimore-shkencore të çdo kandidati për një gradë apo titull shkencor, delegitimohet e gjithë ngrehina akademike në vend. Lëvizja BASHKË propozon sanksionimin e qartë në ligj të procedurës për kontrol-lin e pavarur të punës kërkimore-shkencore, sidomos për raset e plagjiaturës, si dhe kalimin në filter të veçantë të të gjitha punimeve dhe publikimeve shkencore të drejtuesve të universiteteve publike të çdo niveli. Njëkohësisht nevojitet rritja e kriterëve për fitimin e titujve akademikë. Mbështetja financiare dhe lehtësimi burokratik për kërkim-it shkencor

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

Cilat janë kritikët e të tjerëve për politikën dhe ideologjinë e fondacionit Rosa Luxemburg (sipas ChatGPT)

Kritikat ndaj Fondacionit Rosa Luxemburg vijnë nga spektre të ndryshme politike – liberalë, konservatorë, dhe madje edhe nga disa pjesë të së majtës. Ja një përmbledhje e kritikave më të zakonshme që i bëhen fondacionit dhe ideologjisë që përfaqëson:

1. Kritika nga e djathta dhe konservatorët

"Ideologji marksiste e rrezikshme":

- Fondacioni shihet si një zgjatim i partive të majta radikale, që promovon ideologji socialiste/marxiste, të cilat kritikët i konsiderojnë të dështuara në praktikë historike (shembulli i Bashkimit Sovjetik).
- Ka shqetësime se fondacioni nxit luftë klasash, në vend që të promovojë harmoni dhe stabilitet social.

"Ndërrhyrje në treg të lirë":

- Propozimet për kontroll shtetëror mbi pasuritë, kombëtarizime apo ndërmarrje kolektive konsiderohen si kërcënime për ekonominë e tregut të lirë dhe si pengesa për inovacionin dhe investimin privat.

"Ekstremizëm i majtë":

- Në disa vende, fondacioni është etiketuar si mbështetës i grupeve anti-sistem, protestave të ashpra apo formave të aktivizmit radikal, që sfidojnë institucionet tradicionale të demokracisë liberale.

2. Kritika nga liberalët

"Naivitet ekonomik":

- Politikën që mbështet fondacioni (p.sh. bashkëpronësia e punëtorëve, fondet sovraane, shtetëzimi i industrive strategjike) kritikohen si jo-realiste në një botë të globalizuar dhe të vështira për t'u zbatuar pa pasoja ekonomike (si largimi i investimeve të huaja).

"Romantizim i historisë së së majtës":

- Fondacioni shpesh akuzohet se idealizon figura si Rosa Luxemburg, pa i trajtuar kritisht dështimet apo kontradiktat e së majtës historike.

Programi arsimor i Lëvizjes BASHKË

Lëvizja BASHKË do të zerojë tarifat për shkollën e doktoratës dhe do të lehtësojë procedurat burokratike për përdorimin e fondeve të projekteve evropiane nga kërkuesit shkencorë, duke ndjekur modelin italian të financimit. Menaxhimi i fondeve për projektet shkencore që vijnë nga BE – brenda të cilave do të mund të financohen edhe studimet e doktoratës të kandidatëve të rinj – do t'i lihet në dorë grupit të kërkuesve shkencorë që e kanë fituar projektin. Shpenzimet që kryhen në kuadër të çdo projekti do të kontrollohen imtësisht nga administrata financiare e çdo universiteti publik dhe nga komisione të posaçme ministrore.

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë sipas ChatGPT

3. Kritika nga pjesë të së majtës (e majta reformiste ose socialdemokrate)

“Dogmatizëm ideologjik”:

- Disa e kritikojnë fondacionin si të mbërthyer në narrativën klasike të marksizmit, dhe jo mjaftueshëm të hapur ndaj kompromiseve politike apo pragmatizmit institucional.

“Jo mjaftueshëm feministe/interseksionale”:

- Ka edhe zëra brenda vetë kampit progresist që e kritikojnë se nuk integron mjaftueshëm perspektiva interseksionale, ose se ka një qasje tradicionale marksiste që shpesh lë në hije çështjet gjinore, racore apo queer.

4. Kritika praktike

“Mbështetje për lëvizje jo demokratike”:

- Në disa raste, kritikët kanë akuzuar fondacionin për mbështetje ose bashkëpunim me grupe politike të diskutueshme jashtë Evropës që nuk janë domosdoshmërisht demokratike, në emër të anti-imperializmit.

“Financim me burime publike për një axhendë ideologjike”:

- Në Gjermani (ku është më aktiv), disa e kundërshtojnë faktin që fondacioni merr financim shtetëror për të promovuar një axhendë politike të njëanshme ideologjike.

Në thelb, shumica e kritikave lidhen me frikën për një kthim te ekonomitë e centralizuara, me dyshime mbi efektivitetin praktik të politikave të majta radikale, apo me mosbesimin ndaj retorikës revolucionare. Nga ana tjetër, Fondacioni Rosa Luxemburg e sheh veten si zë kritik i nevojshëm ndaj padrejtësive sistematike dhe një laborator idesh për një botë më të drejtë.

Komente shtesë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Bashkë

Organizatrat politike që klasifikohen si të majta radikale apo komuniste që ofrohen në vende ish-komuniste, siç është edhe Shqipëria, bëjnë sikur nuk ka ekzistuar ndonjëherë komunizëm në Shqipëri dhe nuk e marrin parasysh këtë fakt. Duke mos u shprehur për këtë periudhë, ato thonë nuk kemi lidhje me atë periudhë, ndërkohë që populli ka lidhje dhe programi i tyre ka lidhje. Kjo do të thotë që duan të bëjnë “riset” trurin dhe të anullojnë përvojën e shoqërisë.

Qasjet e majta dhe të djathta quhen të natyrshme në një sistem politik. Që shoqëria shqiptare të stabilizohet për një periudhë afatgjatë, më parë duhet të shuajë etjen e politikanëve për ideologji që ndajnë. Shqipëria edhe pse është më shumë se një shekull pas Rilindjes Kombëtare, duhet të kuptojë më mirë metodologjinë e rilindasve kur “i dhanë lindje” shtetit të ri shqiptar.

Duke e ditur ata që çështja e pronës apo e diferencimit pasuror apo klasor do të ishte problem, nuk u morën fare me këtë anë, sepse menjëherë shqiptarët do të braktisnin çështjen kombëtare. Kujdesi i Naim Frashërit ishte *“udha e vëllazërisë si vahu i mirësisë”*. Më qartë e ka në vargjet: *“Tregomu dhe shqipëtarëvet, udhën e punës së mbarë, bashkomi, bëmi vëllazër edhe thjesht shqiptarë”*

Të gjitha partitë e majta dhe të djathta, radikale apo jo, në radhë të parë duhet të garantojnë “vëllazërinë

shqiptare” pastaj të fillojnë me skemat ideologjike. Kur të propozojnë një ndërhyrje në ekonomi, duhet ta arsyetojnë me pasojën se si kjo ndërhyrje e rregullon vëllazërinë shqiptare ose pse ajo tjetra e prish vëllazërinë. Nuk është kaq e thjeshtë, ndaj Naimi thotë “tregomu udhën e punës së mbarë”, që filon nga bashkimi, vëllazëria, dhe të qenët kombëtar (thjesht shqiptarë).

Siç e pamë, të gjitha partitë politike e kanë braktisur këtë program të Rilindjes Kombëtare dhe duan “t’u ecë mbarë në votime”. Nuk do t’u ecë! Do të dëshojnë!

Për sa më përket, unë e njoh komunizmin në çdo aspekt të mundshëm të ekuilibruar nga forca të ndryshme qofshin goditëse qofshin përkrahëse (kulaç (shkollim) dhe kërbaç (mënjanim), shkop dhe karrotë).

Produkti më i lartë teorik në çështje të marksizëm leninizmit apo të praktikave të PPSH-së apo të gjithë sistemit të propagandës komuniste ka qenë në fund të viteve të viteve 1980 dhe unë atëherë e bëra shkollimin dhe të gjitha lëndët i kam patur me rezultate të larta.

Kështu që na takon t’i themi drejtuesve të Lëvizjes Bashkë se jemi lart edhe në këtë këndvështrim, qoftë shkollim, qoftë me praktika nga koha.

Mendoj se detyra e parë e një lëvizje të tillë të majtë është të shprehet për periudhën e komunizmit në Shqipëri, pra t’i bëjë analizën asaj dhe jo ta lërë në hes-

htje. Të tregojë çfarë pasojash ka lënë në shoqëri. Nuk është e thënë të thotë patjetër gjëra negative. Mjaft të thotë mendimin hapur në një shoqëri që e ka jetuar komunizmin. Populli shqiptar nuk e pëson nga mendimi i lirë, por e pëson nga mungesa e sinjeritetit dhe taktika e të ngulurit të thikës pas shpine. Është e provuar që deviza e kominternit ishte tipike diabolike *“Shfrytëzoni lufrat nacionale për të mbjellë në të revolucionin proletar”*, qo do të thotë me fjalë të tjera *“fshihuni pas çështjeve nacionale”* dhe ne këtë gjë e kemi parë mjaft qartë dhe për më tepër vetë PPSH jo vetëm që nuk e fshihte këtë taktikë të saj por e quante meritë. Kjo fshehje vijon edhe sot. Heshtje do të thotë që do të “rimerret” situata përsëri me të njëjtin mentalitet “tjetër gjë propaganda” e tjetër gjë “realiteti” dhe në stilin e fjalisë së parë të Manifestit të Marksit *“Një fantazmë sillet nëpër Europë - fantazma e komunizmit”*.

Në 177 faqe program, që është programi më i gjatë ndër të gjitha partitë, nuk përmendet asnjëherë fjala “komunist” apo “komunizëm”. Kjo tregon mungesë sinjeriteti, që do të thotë se ata e adhurojnë komunizmin, por nuk duan të tregojnë për këtë fakt.

Vetë mendimin tim në këtë çështje e kam në dy libra “Të menduarit kritik për komunizmin” dhe “Fëmijët, lufta dhe lufta e klasave”.

Duke qenë se jemi brenda shkollës, pra duhet të mësojmë (jo në mënyrë robotike) i kemi dhënë vetes, në bazë të përvojës të shprehemi për literaturën e komunizmit dhe kemi marrë disa nga pikat kyçe të saj që janë “Manifesti i partisë komuniste” (1848 - Marks & Engels), “Tri burimet e marksizmit” (Lenin, 1913), “Partia Komuniste e Shqipërisë” (1941), “Kushtetuta e RPSSH” (1976) dhe “Kur lindi Partia” (Enver Hoxha, 1981).

Libri është i përshtatshëm kryesisht për shkollat e mesme, nëse ndonjë ditë do të mund të shihet në këtë këndvështrim.

Libri i dytë është mjaft i përshtatshëm për një temë tepër të debatueshme siç është trashëgimia e Lidhjes së Shkrimtarëve e të Artistëve në fushën e kinematografisë që ishte maja e mprehtë e ndikimit të propagandës komuniste.

Janë analizuar tetë filmat më përfaqësues me temë nga lufta ku zuri edhe zanafilla e shtrembërimit të historisë, dhe të shtrembërimit të vetë karakterit të fëmijëve, ku idealizohej shfrytëzimi për luftë i fëmijëve, që sot, mbështetur edhe në përvojat e popujve të sanksionuar në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve quhet një etikë e dobët njerëzore, sepse fëmijët duhen përjashtuar nga përfshirja në luftë. Kjo me arsyetimin që fëmijëria duhet të jetë e paprekur nga hallet e luftës dhe fëmijët duhet të kursehen.

Iu dërgua letër Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë dhe të Kosovës për këta dy libra që t'i kujtonim që i futnim në program të shkollës (në fakt nuk i kemi futur ende). Nuk patëm ndonjë mesazh, dhe po e quajmë se miratimi është në heshtje.

DORËZUAR NË MINISTRINË E ARSIMIT

Librat janë shkruar me kujdesin që duhet të kemi ndaj shkollës dhe brezit të ri për të reflektuar. Natyrisht që mendimet, analizat do të jenë të ndryshme, por “ndryshueshmëria” nuk duhet të bëhet argument që shkolla të mos marrë asnjë analizë. Për këtë arsye i kërkuam Ministrisë së Arsimit të shprehëj për këtë literaturë. Nuk u shpreh dhe ne e quajmë “miratim në heshtje”. Tashmë ato janë pjesë e një literature kuadër programor i hapur për shkollën, ndaj ne i kemi vënë në faqen tonë linku <https://udhaeshkronjave.com/të-menduarit-kritik>



Artur Shkurti

TË MENDUARIT KRITIK MBI KOMUNIZMIN

PËR SHKOLLËN


Literatura dhe praktika e komunizmit
përballë demokracisë

- Manifesti i Partisë Komuniste - Marks & Engels, 1848
- Tri burimet e marksizmit - Lenin, 1913
- Partia Komuniste e Shqipërisë - 1941
- Kushtetuta e RPSSH - 1976
- Kur lindi Partia - Enver Hoxha, 1981
- Profil psikologjik i Enver Hoxhës



Artur Shkurti

FËMIJËT, LUFTA dhe lufta e klasave



Debatik
Tinguj lufte
Mëngjese lufte
Lulëkuqet mbi mure
Tomka dhe shokët e tij
Partizani i vogël Velo
Pas gjurmëve
Balonat

Programi arsimor i Lëvizjes “Shqipëria bëhet”

KREU I - ARDHMËRIA

Buxheti dhe infrastruktura në arsim:

- Arsimi do të jetë prioriteti ynë absolut. Buxheti për arsimin publik do të rritet në 5% PBB për dy vitet e para të qeverisjes. Për gjysmën e dytë të mandatit të parë buxheti do të rritet në 7% të PBB.
- Infrastruktura arsimore në mbarë vendin do t'i nënshtrohet një rinovimi total, duke e përshtatur me strategjinë e re për arsimin, e cila e trajton shkollën si cikël të plotë. Nxënësi merr njohuritë në shkollë dhe i kryen detyrat po në shkollë. Kjo do të mundësojë që fëmijët të kenë mundësi të njëjta dijesimi pavarësisht nga kushtet social-ekonomike, apo zhvillimit intelektual të prindërve të tyre.

Arsimi fillor dhe 9-vjeçar:

- Në vitin e 4-t të qeverisjes për arsimin fillor dhe atë 9-vjeçar shkollat do të jenë me kohështrirje nga ora 8.00 e mëngjesit deri në orën 17.00 të pasdites. Për të mundësuar thjeshtësimin e jetës së familjeve tona, orari zyrtar i punës në Republikën e Shqipërisë do të jetë 9.00 – 16.00. Kjo do t'i krijojë mundësinë çdo prindi të ketë kohë të dërgojë dhe të marrë në shkollë fëmijën.

Kurikula do të përfshijë 2 fasha orare të shkollimit.

- Fasha e detyrueshme, nga ora 8.00 deri në 13.00, e cila do t'i dedikohet mësimdhënies;
- Fasha me zgjedhje, nga ora 13.00 deri në 17.00. Në këtë fashë të dytë fëmijët ushqehen, bëjnë pushimin e drekës, kryejnë detyrat e “shtëpisë” të asistuar nga

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes “Shqipëria bëhet” sipas ChatGPT

Politika arsimore e partisë “Shqipëria Bëhet” është një nga shtyllat qendrore të programit të saj elektoral, por ajo paraqet si pika pozitive edhe disa problematika që kërkojnë analizë kritike. Më poshtë është një kritikë e strukturuar ndaj kësaj politike:

Pikat Pozitive: Rritja e buxhetit për arsimin – Propozimi për të çuar buxhetin arsimor në 7% të PBB-së deri në fund të mandatit të parë është ambicioz dhe mbi mesataren aktuale rajonale. Nëse zbatohet realisht, do të mundësonte përmirësim të infrastrukturës dhe cilësisë.

Orari i zgjatur në shkollë – Zgjatja e qëndrimit në shkollë (08:00–17:00) ofron lehtësim për prindërit që punojnë dhe mundëson një arsim më gjithëpërfshirës, duke përfshirë aktivitete jashtëmësimore.

Rritja e pagave për mësuesit – Dyfishimi i pagës brenda katër viteve synon të adresojë krizën e mësuesve, veçanërisht në fushat më të prekura si matematika dhe shkencat.

Kodimi dhe harmonia sociale si lëndë të reja – Shtimi i lëndëve si kodimi që në ciklin 9-vjeçar është një hap modernizues.

Pikat për Kritikë:

1. Shqetësime për realizueshmërinë buxhetore

Arritja e 7% të PBB për arsimin është një angazhim i madh financiar. Programi nuk jep një analizë të qartë mbi burimet e financimit apo shkallëzimin e këtij investimi në raport me deficitin buxhetor ose nevojat prioritare të sektorëve të tjerë.

2. Ushqimi me pagesë në shkollë

Megjithëse për disa kategori sociale ai do të jetë falas, kjo masë mund të thellojë pabarazitë sociale. Fakti që ushqimi në shkollë është i detyrueshëm në fashën e dytë, por me pagesë për shumicën, krijon mundësi për ndarje klasore brenda sistemit shkollor.

3. Uniformiteti i tepruar në kurikulë dhe tekste

Unifikimi i kurikulës dhe teksteve në të gjithë vendin rrezikon të kufizojë lirinë pedagogjike dhe përshtatjen lokale të përmbajtjes arsimore. Përzgjedhja e teksteve “me konkurim të hapur” nuk është e sqaruar mirë dhe mund të lërë hapësirë për ndikim politik ose klientelist.

Programi arsimor i Lëvizjes “Shqipëria bëhet”

mësuesi kujdestar si dhe/ose mund të marrin pjesë në klasa për zhvillimin e talentit, të tilla si studimi i një vegje muzikore, pikturë, sport, etj.

Ushqimi do të jetë me pagesë.

- Përveç kategorive: fëmijëve që i përkasin familjeve në ndihmë ekonomike; fëmijëve me një prej prindërve me aftësi të kufizuara, fëmijëve të familjeve të policëve të rënë në krye të detyrës, apo dëshmorë të atdheut, fëmijëve me nëna kryefamiljare me të ardhura nën minimumin e parashikuar nga ligji, fëmijëve jetimë, fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Në ciklin e arsimit parauniversitar:

- Hiqet sistemi i vlerësimit deri në klasë të tretë.
- Theksi i kurikulës arsimore do të vendoset te përshtatja e fëmijës me frymën e grupit,
- bashkëpunimin dhe respektin.
- Shkolla në mëngjes do të nisë duke nderuar Himnin Kombëtar.
- Do të aplikohet një uniformë, modeli i së cilës do të miratohet individualisht nga çdo institucion arsimor.

Kurikula arsimore:

- Kurikula arsimore do të unifikohet. Përzgjedhja e kurikulës së unifikuar do të bëhet bazuar në konkurim të hapur. Tekstet do të jenë të njëjta për të gjitha shkollat në të gjithë Republikën.
- Tekstet do të jenë falas për të gjithë fëmijët që i përkasin familjeve në ndihmë ekonomike, me një prej prindërve

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes “Shqipëria bëhet” sipas ChatGPT

4. Hiqet sistemi i notimit deri në klasën e tretë

Ndonëse synon të ulë stresin te fëmijët, një sistem totalisht jo-vlerësues mund të humbasë shansin për diagnostikim të hershëm të nevojave dhe mbështetje individuale për nxënësit.

5. Zgjedhja e drejtorëve nga prindërit dhe mësuesit

Kjo mund të fuqizojë komunitetin, por gjithashtu mund të politizojë më tej institucionet arsimore nëse prindërit bëhen objekt manipulimi nga grupe lokale ose partiake.

6. Shtytje ndaj degëve të mësuesisë përmes incentivave financiare

Stimulimi ekonomik për studentët e mësuesisë është një ide e mirë në thelb, por pa rritje të standardeve akademike për këto programe, rrezikon të prodhojë mësues të dobët, tërhequr më shumë nga subvencioni sesa nga thirrja profesionale.

Mungesa strukturore në program: S’mungojnë të dhënat për vlerësimin e performancës mësimore, sistemet e vlerësimit të mësuesve, dhe asnjë referencë për teknologjinë në klasë përveç “kodimit”.

Nuk flitet për edukimin për të rritur, arsimimin e grupeve të marginalizuara, shkencën dhe kërkimin në arsimin e lartë, apo internacionalizimin e universiteteve.

Përfundim: Programi i partisë “Shqipëria Bëhet” për arsimin është vizionar në disa drejtime, por mbetet i brishtë në realizueshmëri dhe i pabalancuar në disa masa. Ai ofron premtime të forta por kërkon më shumë analizë teknike dhe pragmatizëm për të shmangur qëllime të mira të cilat nuk mund të zbatohen.

PËRQASJE ME RRYMA TË TJERA POLITIKE E PROGRAMIT “SHQIPËRIA BËHET”

Një nga pyetjet që është e vështirë t’i përgjigjet masa, qoftë edhe e ditur është ballafaqimi me programe të tjera, ndaj ChatGPT i bëmë një kërkesë që të thoshte se ku e klasifikonte këtë program. Përgjigjia është si më poshtë:

CITOJMË CHATGPT:

Programi elektorale i partisë “Shqipëria Bëhet” ka elementë që mund të lidhen me disa rryma politike ndërkombëtare, megjithëse është ndërtuar në një formë të vetëpërcaktuar si “e djathtë qendrore”. Ja një analizë e lidhjeve ideologjike:

Programi arsimor i Lëvizjes “Shqipëria bëhet”

me aftësi të kufizuara, familjeve të policëve të rënë në krye të detyrës, apo dëshmorë të atdheut, fëmijët me nëna kryefamiljare me të ardhura nën minimumin e parashikuar nga ligji, fëmijët jetimë, fëmijët me aftësi të kufizuara. Tekstet falas do të jepen si paketë e gatshme ditën e parë të shkollës për të gjithë fëmijët. Mësuesi i tyre kujdestar i tërheq për të gjithë fëmijët e klasës së tij në drejtorinë arsimore përkatëse.

- Në arsimin 9 vjeçar do të shtohet si lëndë mësimore kodimi (hapat e para të programimit).
- Në arsimin parauniversitar, do të implementohet klasa e mirëkuptimit dhe harmonisë sociale.

Mësuesit:

- Ndaj mësuesve do të ndiqet parimi “Ne, shoqëria do të kujdesemi për jetën e mësuesve, ndërsa ata do të formësojnë fëmijët tanë për një të nesërme të zhvilluar”.
- Paga e mësuesve të të gjitha cikleve do të rritet me 25% çdo vit për 4 vitet e mandatit të parë qeverisës. Në fund të mandatit, paga e mësuesit do të jetë dyfishuar.
- Për mësuesit e angazhuar pas kohëzgjatjes së detyrueshme të punës të përcaktuar nga kodi i punës do të bëhet indeksimi i orëve shtesë.

Zgjedhja e drejtuesve në institucionet e arsimit në të gjitha nivelet:

Drejtuesit e institucioneve arsimore për arsimin parashkollor, bazë dhe të mesëm, do të zgjidhen dhe shkarkohen nga trupa e mësuesëve të institucionit dhe nga komuniteti i prindërve të fëmijëve që rezultojnë të regjis-

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes “Shqipëria bëhet” sipas ChatGPT

Elementë të së djathtës klasike (liberal-konservatore):

Fokus te familja, prona dhe rendi: Vlerësimi i lartë i “familjes, pronës dhe atdheut” është në përputhje me vlerat konservatore, si në rrymat kristiano-demokrate europiane apo në disa parti të Republikanëve në SHBA.

Fiskaliteti i ulët (taksa të sheshta) dhe ulja e ndërhyrjes shtetërore në ekonomi janë në përputhje me doktrinën neo-liberale, si ajo e promovuar nga Margaret Thatcher apo Ronald Reagan.

Depolitizimi i administratës dhe liria ekonomike si bazë për liri politike janë ide që gërshetojnë liberalizmin klasik me fokus në “shtetin minimal”.

Elementë të social-liberalizmit / populizmit ekonomik të moderuar:

Investimi masiv në arsim dhe shëndetësi publike, si dhe dyfishimi i pagave për mësuesit, janë politika që lidhen më shumë me ide të majta progresiste apo qasje të social-demokracisë nordike, ndonëse pa përmendur rritje tatimesh.

Subvencionimi direkt i prodhimit bujqësor, kartat e ushqimit për fëmijë, dhe kreditimi pa interes për studentët janë politika që frymëzohen nga një model populist social i kontrolluar – i ngjashëm me disa eksperimente në Europën Qendrore dhe Lindore.

Elementë të populizmit demokratik / sovranist:

Referendumet si mjet themelor i demokracisë dhe shfuqizimi i emërimeve politike në drejtimin e shkollave janë tipare që i ngjasojnë modeleve të demokracisë direkte të promovuar nga lëvizje si 5 Yjet në Itali ose nga partitë populiste në Evropën Lindore.

Kthimi i pronës, lufta ndaj monopoleve dhe auditimi i koncesioneve ka nuanca të një narrative anti-establishment që është karakteristike për forca politike që sfidojnë rendin ekzistues politik e ekonomik.

Inspirime të përziera:

Modelet duale të arsimit profesional, lidhja e shkollës me tregun e punës dhe orientimi drejt IT-së dhe AI janë frymëzuar qartazi nga modele gjermane, nordike dhe aziatike (si Finlanda, Gjermania apo Koreja e Jugut).

Zonat ekonomike tax-free për inovacion janë të ngjashme me politikat e Singaporit, Irlandës apo Izraelit në ndërtimin e qendrave teknologjike.

Përmbledhje: Programi nuk ndjek një vijë të pastër ideologjike, por është një përzierje midis:

konservatorizmit tradicional (në moral dhe shtet), *liberalizmit ekonomik klasik* (në treg dhe taksa), *populizmit social* (në trajtimin

Programi arsimor i Lëvizjes “Shqipëria bëhet”

truar pranë këtyre institucioneve. Prindërit e fëmijëve do të zgjedhin drejtuesin e institucionit me votim të fshehtë. Kjo praktikë do t'i japë fund emërimeve nga drejtoritë arsimore.

Studimet e larta:

Për studimet e larta do të krijohet mundësia e financimit me kredi pa interes të studimeve për të gjithë fëmijët që i përkasin familjeve në ndihmë ekonomike, me një prej prindërve me aftësi të kufizuara, fëmijët me nëna kryefamiljare me të ardhura nën minimumin e parashkuar nga ligji, fëmijët jetimë, fëmijët me aftësi të kufizuara. Kthimi i vlerës së marrë nga studentët do të bëhet pas daljes në punë.

Do të krijohet një buxhet vjetor pranë Ministrisë së Arsimit që do të mbulojë interesat e kredive studentore. Kredia Studentore nuk çënon asnjë nga skemat e deritanishme të përfitimit, por është një opsion shtesë për të financuar edhe më mirë studimet e këtyre kategorive.

Për fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës apo dëshmorë të atdheut, do të financohet 100% shkollimi i tyre brenda vendit pa detyrimin për të kthyer vlerat mbrapsht.

Për bizneset private të cilat financojnë studimet e studentëve do të miratohen paketa fiskale që i përjashtojnë nga detyrimet tatimore vendet e punës së këtyre studentëve, për një periudhë 5 vjeçare, kur këta të punësohen pranë këtyre subjekteve pas përfundimit të studimeve.

Për degët e mësuesisë, nisur nga gjendja aktuale, ku vërehet ulja e numrit dhe cilësisë së studentëve, do të aplikojmë programin “Mësues i mirë, komb i arrirë”. Ky program do të aplikohet në këto drejtime:

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes “Shqipëria bëhet” sipas ChatGPT

e nevojave të shtresave të ulëta), dhe *demokracisë direkte*.

Kjo e bën atë të ngjashëm me partitë politike të reja që kombinojnë nacionalizëm institucional me modernizëm pragmatik, si: PiS në Poloni (por më i moderuar), Fidesz në Hungari (por pa autoritarizmin e hapur), ose disa rryma të reja në Itali dhe Kroaci.

Nëse do të klasifikohet në një spektrum perëndimor: qendër-djathtas populiste me impulse teknokratike dhe sociale.

Programi arsimor i Lëvizjes “Shqipëria bëhet”

- Të gjithë nxënësit të cilët mbarojnë me mesatare mbi 8 dhe vendosin të studiojnë në degën e mësuesisë përgjatë gjithë ciklit të studimeve do të trajtohen me 1/3 e rrogës bazë të mësuesit, si dhe do të përjashtohen nga detyrimet nëse vendosin të akomodohen në rezidencat studentore shtetërore.
- Studentë të cilët gjatë studimeve arrijnë mesatare mbi 8, do të trajtohen me 1/2 e rrogës bazë të mësuesit.
- Do të lehtësohet tranzicioni në mësimdhënie i profesionistëve të fushave të ndryshme që lidhen me lëndët përkatëse në arsimin parauniversitar.

Arsim profesional:

- Do të jepen bursa, për studentët të cilët do të zgjedhin arsimin profesional, për profesionet që më së shumti i nevojiten ekonomisë së vendit.
- Do të mundësohet sistemi dual, sipas të cilit studenti zhvillon pjesën teorike në shkollë dhe pjesën praktike në bizneset e fushës përkatëse, me të cilat shteti ka marrëveshje.
- Studentët e punësuar paguhen minimalisht sipas pagës minimale në nivel vendi, për kohëzgjatjen ditore të punës që përcakton Kodi i Punës për atë moshë, ndërsa bizneset për këto vende pune, përjashtohen nga detyrimet tatimore gjatë gjithë kohëzgjatjes së punës.

Për shkollat shqipe në diasporë, projekti “*Gjuha shqipe, rrënja jonë*” do të mundësojë:

- Hapjen e klasave të gjuhës shqipe në të gjitha komunitetet ku regjistrohen mbi 100 fëmijë;

Komente ndaj programit arsimor të Lëvizjes “Shqipëria bëhet”

Përveç atyre që ka thënë ChatGPT dhe janë të drejta, do të mundohem të them diçka shtesë, sipas këndvështrimit tim personal të përvojës në shkollën “Udha e shkronjave” (28 vjet).

Është shumë e qartë se programit i mungojnë shumë problematika të sistemit arsimor. Unë do të përmend atë që besoj e njoh mirë dhe nga brenda që është sistemi arsimor parauniversitar. Meqë cilësia e universiteteve varet thelbësisht nga produkti i sistemit arsimor parauniversitar, kjo parti politike nuk arrin të kuptojë saktë se ku çalon realisht arsimi parauniversitar. Të thuash është keq e do ta bëjmë mirë, nuk mjafton. Të thuash do të shtojmë investimin nuk mjafton. Ky moskuptim vjen ngaqë janë larg sistemit, por edhe brenda sistemit të jenë ka disa kushte specifike të kuptuarit e plotë. Mësuesit dhe drejtuesit “nuk mund të kuptojnë” nëse programet që po bëjnë janë me vite mjaft të vjetra. Praktika e dobët e prish edhe analizën. Besojmë që të vetmit që i kuptojnë mirë të metat janë shkollat shqiptare ndërkombëtare, sepse ato janë ndërmjet të dy këndvështrimeve kombëtare dhe globale. “Udha e shkronjave” është saktësisht në këtë pozicion. As shkollat ndërkombëtare të huaja nuk e bëjnë dot këtë punë, sepse ato thjesht nuk tregojnë interes në arsimin kombëtar.

VIJMË TEK PROBLEMI KRYESOR

Dobësia e sistemit arsimor parauniversitar të Shqipërisë ka një referencë të saktë në çfarë thonë Universitetet e Kembrixhit dhe të Oxfordit në faqet e tyre të internetit për aplikantët ndërkombëtar nga Shqipëria.

Universiteti i Kembrixhit e jep më qartë, kur në faqen e vet zyrtare, për aplikantët për studentë ndërkombëtarë nga Shqipëria thotë “*Matura Shtetërore nuk është një përgatitje e mjaftueshme për të patur një aplikim të suksesshëm në universitet.*” Ne si shkollë e njohim më mirë se kushdo sistemin dhe kua i dështon. Njohja jonë nuk është me të lexuar, por me të punuar në praktikë, pra me realizim produkti, edukim real të nxënësve të shkëlqyer sipas një standardi tepër të lartë ndërkombëtar dhe i provuar ky shkëlqim me rezultatet në provimet ndërkombëtare, certifikimet ndërkombëtare lëndore, dëftesat ndërkombëtare, aplikimet e suksesshme në universitete të toplistës botërore apo marrjen e bursave. Me këtë përvojë praktike, e kemi të provuar në detaje që sistemi ynë arsimor parauniversitar i nxjerr maturantë me të paktën 1 vit akademik e gjysmë mangut, që do të thotë se maturantëve shqiptarë për të arritur standardet e bashkëmoshatarëve të tyre anglezë apo të nxënësve që marrin diploma ndërkombëtare të njohura, apo edhe të shteteve të tjera të përparuara u duhet edhe 1.5 vite studim. Nëse ky është problemi, atëherë këtu buron zgjidhja. Fakti që disa maturantë megjithatë janë të suksesshëm lidhet me sa me aftësitë e tyre individuale, aq edhe me investimin afatgjatë në programe shtesë.

Programi arsimor i Lëvizjes “Shqipëria bëhet”

- Pagesën e mësuesve të shkollave shqipe në të gjitha ato komunitete që vendosin në dispozicion ambiente pa qira për hapjen e klasave të gjuhës shqipe pavarësisht numrit të nxënësve.
- Abetaret do të ndahen falas nga Shteti Shqiptar për çdo fëmijë që regjistrohet në këto klasa.
- Pranë thesarit të shtetit do të hapet për llogari të Ministrisë së Arsimit, Fondi për Financimin e këtij programi. Në këtë fond të gjithë shqiptarët e diasporës do të mund të kontribuojnë në mënyrë të vazhdueshme. Në çdo rast, buxheti i shtetit do të mbulojë diferencat që mund të rezultojnë vit pas viti.

Komente ndaj programit arsimor të Lëvizjes “Shqipëria bëhet”

PARTI AFTERSCHOOL

Qartësisht partia nuk e ka idenë se çfarë shërbimi i dobët është “afterschool”, sidomos në shkollat tona shtetërore. Ky nuk është shërbim për fëmijët, por shërbim që prindërit të rrinë sa më gjatë në punë, ose që të dekurajohen zgjidhjet alternative. Partia duhet të marrë “votën” e fëmijëve. Ata nuk duan të rrinë në shkollë aq gjatë. Atëherë pse duhet që partia të këshillojë diçka në kundërshtim me natyrën e fëmijës.

Shkolla kryhet nga mësuesit dhe *mësuesit nuk e duan këtë regjim*, sepse do të lodhen shumë dhe nuk do të jenë në gjendje të rimarrin veten për të nesërmen dhe çdo ditë që vjen do të jetë edhe më e dobët. Shkolla do të dobësohet sepse ajo do të kuptojë se funksioni i saj kryesor nuk janë mësimet, por të rrinë në shkollë e të kujdesen për “mbajtjen” e fëmijëve të pagëzuar në shkollë.

Fjalja tjetër është e drejtë sepse e çon vëmendjen në lehtësimin e prindërive dhe jo në ngarkimin e fëmijëve me punë. Citoj: *“Për të mundësuar thjeshtësimin e jetës së familjeve tona, orari zyrtar i punës në Republikën e Shqipërisë do të jetë 9.00 – 16.00. Kjo do t’i krijojë mundësinë çdo prindi të ketë kohë të dërgojë dhe të marrë në shkollë fëmijën.”*

FËMIJËT DO TË LODHEN MË SHUMË NË SHKOLLËN E GJATË

Duhet kuptuar se shkolla nuk është “argëtim” për fëmijën, por është punë dhe është punë mendore, pra shpenzon energji. Nuk është bërë analiza si duhet e ekspozimit mendor të fëmijës gjatë ditës së shkollës. Kjo mbulohet me faktin që fëmija e do shkollën sepse do bashkëmoshatarët, por kjo nuk do të thotë që ai nuk është i ekspozuar ndaj lodhjes mendore dhe fizike.

Fëmijët në shkollë duhet të monitorojnë shpjegimin, duhet t’u përgjigjen kërkesave, dhe çdo 50 min duhet të ndërrojnë edhe lëndën (nga matematika në histori, apo nga anglishtja në biologji etj.) Ata janë vazhdimisht nën trysinë e të pyeturit dhe ajo që quhet qetësi e vërtetë është vetëm kur ata shkojnë në shtëpi. Shkolla ka rregulla, shkolla ka probleme dhe fëmijët janë të ekspozuar ndaj tyre dhe kanë nevojë për një orar të shkurtër dhe jo të gjatë. Truri i fëmijëve nuk duron shumë një ngarkesë të tillë dhe është e drejtë që fillorja të ketë pak orë. Ndërkohë ne shohim që pikërisht të vegjlit ekspozohen ndaj skemave “afterschool”.

Një shkollë që nuk ka parqe, kopshte, kabinete argëtimi, arti etj. do të kthehet në një vend “burgimi” për fëmijët. Mësuesit e lodhur do të përdorin presionin që t’i mbajnë në mbikqyrje dhe kështu situata do të bëhet jashtëzakonisht e dobët.

Kam bindjen e plotë që mësuesit do ta miratojnë këtë qëndrimin tonë në këtë çështje. Sa më shumë të punojnë mësuesit në shkollë, aq më pak do të kenë mundësi të trainohen dhe aq më të dobët do të jenë. Shkolla e ka të domosdoshme kthimin e objektivave të trainimit sepse jeta ndryshon me shpejtësi marramendëse.

Komente ndaj programit arsimor të Lëvizjes “Shqipëria bëhet”

Me sa duket partitë e quajnë betejë të humbur të investojnë “jashtë shkollës” në zhvillimin social dhe shtimin e alternativave argëtuese, krijuese apo lidhjen me familjen.

Kurrikula me dy fasha në fakt fsheh modelin “afterschool” që *Lëvizja Shqipëria Bëhet* e quan si magjik dhe pa probleme të rënda. Nuk ia kanë bërë ende si duhet analizën këtij modeli, sepse janë ende nën efektin e fjalëve që thuhet në për zyra dhe jo në ndonjë skanim si duhet të situatës. Shkolla është një veprimari e jashtëzakonshme dhe të thuash disa gjëra për të është thjesht një mungesë.

Përvoja “Udhë e shkronjave” është unike në sistemin arsimor. Përvoja është “drejtuese”, “konceptuese”, “zbatuese”, “reflektuese” dhe nuk duhet harruar që në punojmë me maksimumin e kushteve ideale, punojmë me klasat më të vogla në Shqipëri (6 nxënës për klasë), me një traditë dhe kur themi që nuk bëhet, duhet të besohemi që nuk bëhet. “Oreksi” i prindërve dhe i nxënësve nuk ngopet dot nga shkolla. Dikush që pretendon që shkolla ta “kënaqë” oreksion e kërkesave të prindërve dhe të publikut thjesht do ta dështojë shkollën dhe ajo që do të bëhet do të jetë thjesht në letër dhe jo realisht.

Po marrim në analizë të veçantë këtë paragraf që qartësisht është i mangët:

CITOJMË:

“Në ciklin e arsimit parauniversitar:

- Hiqet sistemi i vlerësimit deri në klasë të tretë.
- Theksi i kurikulës arsimore do të vendoset te përshtatja e fëmijës me frymën e grupit,

- bashkëpunimin dhe respektin.
- Shkolla në mëngjes do të nisë duke nderuar Himnin Kombëtar.
- Do të aplikohet një uniformë, modeli i së cilës do të miratohet individualisht nga çdo institucion arsimor.”

T’i japësh të drejtën vetes të bësh propozime që të duken si reforma, atëherë duhet ta marrësh me themel dhe jo çfarë të kujtohet ndonjë gjë apo propozim. Mungesat janë në shpjegimin e kompetencave të nxënësit dhe objektivave afatgjata. Nëse *Lëvizja Shqipëria Bëhet* nuk do të ishte futur në këto detaje, atëherë edhe ne nuk do ta bënim kritikën, por ajo është futur dhe kur futesh “pjesërisht” është shumë problem. Ajo thotë “duhet të kemi frymën e grupit” dhe thotë aq sa i leverdis për të ngjyrosur “me të kuq” programin, që mbështetet tek koncepti “i kolektivitetit”. Jo se “fryma e grupit” nuk duhet edukuar, as se nuk është e rëndësishme, por sepse ajo është veçuar nga çdo gjë tjetër në mënyrë selektive.

Kur *Lëvizja Shqipëria Bëhet* veçon vlerësimin deri në klasën e tretë, ajo nuk jep një skicë të plotë se çfarë do të bëjë me një nga funksionet kryesore të shkollës, mësuesve dhe pedagogëve siç është vlerësimi, që ka kaq shumë probleme në Shqipëri, që është kaq i rrallë, kaq i dëmtuar, kaq i cekët, kaq i thatë dhe kaq fiktiv, sa institucionet ndërkombëtare me reputacion nuk po i marrin seriozisht dëftesat e Shqipërisë. T’i mësosh mësuesit edhe më tej të “mos vlerësojnë” është një dëm afatgjatë. Mësuesi duhet të vlerësojë, por sa merr nxënësi nga ky vlerësim është tjetër gjë (ta zemë për të mos

e rënduar psikologjikisht, apo të mos formatohet sipas kërkesës së notës)

Mungesë e qartë dhe besoj e qëllimshme e edukimit kombëtar

Në ka një gjë që po bëhet jashtëzakonisht keq në shkolla është edukimi kombëtar. Ai në çdo shtet, bëhet edhe në mënyrë të egër, pra rritet vetëvetiu prej gjuhës amtare dhe jetesës së përbashkët, por ne bëjmë fjalë për një edukim të vetëdijshëm për të gjithë shoqërinë, që duhet të shprehë admirim dhe kërkesë të lartë në këtë drejtim.

Në mënyrë aq të thatë, aq rutinore, aq skematike, kërkohet vetëm të këndohet çdo mëngjes Himni Kombëtar. Me kaq *Lëvizja Shqipëria Bëhet* “i ka larë duart me edukimin kombëtar”.

Nuk ka program për vetëdijën kombëtare, për kujtesën kombëtare, për lëndët që ndihmojnë më mirë edukimin kombëtar, për ritet kombëtare, për mbrojtjen e trashëgimisë sonë kombëtare përmes shkollave, për autorësinë shqiptare të programeve, etj. etj. Nuk ka një theks të mirë tek gjuha dhe letërsia shqipe, historia, identiteti, edukimi estetik, morali dhe virtytet e shqiptarit etj.

Komente ndaj programit arsimor të Lëvizjes “Shqipëria bëhet”

Paragrafi i “Kurrikulës arsimore” është qartësisht me devizën “programi është imi, objektivat i vë vet”. *Lëvizja Shqipëria Bëhet* dhe çdo parti duhet të ketë frikë nga “kurrikula”, sepse është “kurrikula” ajo që parashikon suksesin apo jo të një sistemi arsimor. E shumta që mund të bëjë *Lëvizja Shqipëria Bëhet* është të garantojë me demokraci dhe përgjegjësi që do të ndërtojë forume tepër profesionale për ta bërë këtë punë dhe për të parë se çfarë modeli kurrikule garanton sukses për një shtet, shoqëri e komb. Ndaj ajo duhet të ketë frikë nga përcaktimet e tipit “kurrikula do të unifikohet”, “kurrikula do të kalojë në konkurrim”. Kurrikula konkurrencën e ka vetëm në garantimin e oponencës dhe këtë oponencë duhet ta garantojë e ta paguajë shteti. Pra nuk ka nevojë për një “konkurrencë”, por për një “oponencë të vërtetë e të fuqishme dhe konstruktive”.

Tekstet e njëjta për të gjitha shkollat paralajmërojnë vënien nën zap të të gjithë sistemit arsimor përmes ndikimit të *Lëvizja Shqipëria Bëhet* tek “teksti unik” ku *Lëvizja Shqipëria Bëhet* do të “instalojë mendimin e vet” që nuk do mend që do të jetë “diktatorial”. Në gjithë botën “uniciteti” qëndron vetëm në programe por jo në realizim të tyre.

Lëvizja Shqipëria Bëhet kujton se ka ndonjë gabim që kemi libra alternativë. Modeli i “tekstit unik” është thjeshtë një kërcënim për shoqërinë shqiptare “atë e dimë ne” dhe me “atë e dimë ne” *Lëvizja Shqipëria Bëhet* mund të bëjë mjaft çudira brenda teksteve. Teksti unik do të vdesë autorësinë shqiptare, do ta bëjë atë një veprimtari rutinore dhe tepër politike.

Tekstet falas. Nëse ka para t’ua japë falas, por ama kur t’ua japë mos t’ua mbledhë në fund të vitit se ajo nuk quhet falas por quhet “me qera”.

Shtimi i “kodimit” si lëndë është një thjeshtëzim dhe kufizim i rëndë për atë që ka studiuar shkencën e kompjuterit apo teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, sepse dihet që “kodimi” është vetëm një kapitull i “Shkencës së Kompjuterit”. *Kodimi është vetëm shkrimi i udhëzimeve që kompjuteri i kupton, por ndërkohë shkencën e kompjuterit ka mësimet për algoritmet, strukturën e të dhënave, rrjetet kompjuterike, sigurinë kibernetike, inteligjencën artificiale, etikën digjitale, njohjen e arkitekturës së kompjuterit, mendimin kompjuterik etj.* Shkencën e kompjuterit nxit të menduarin e fortë dhe jo një “zanat” siç mund të merret “kodimi”. Është Shkencën e Kompjuterit në përgjithësi dhe jo kodimi që mëson strukturën logjike dhe konceptuale.

Nëse qenka kaq “e përparuar” në teknologji *Lëvizja Shqipëria Bëhet*, si e justifikon faktin që ajo vetë nuk ka pyetur inteligjencën artificiale apo specialistë e shkencave kompjuterike për këtë rresht të programit?

Çfarë është ky propozim “*Në arsimin parauniversitar, do të implementohet klasa e mirëkuptimit dhe harmonisë sociale.*”?

Qartësisht është “slogan”. Ndërkohë përmendet fjala e huaj “klasë” kur dihet që fjala është për “kurs” apo për “lëndë”. Me fjalën e huaj “implementim” (zbatim) tashmë po mësohemi “fatkeqësisht”.

Këto lëndë e reja që shpiken, janë të qëllimta për të mësuar një “ideologji” të caktuar që shkon nga “sekti” drejt e në

“mendjen e nxënësit” dhe në “familje” me konceptin “Atë e dimë ne”. Një parti nuk mund të propozojë çudira, pa e shtruar problemin qartë dhe të thotë se për këtë problem të jetës, kemi këtë lloj zgjidhjeje.

Para se të zbatojë “*mirëkuptimin dhe harmoninë sociale*” tek të tjerët partitë duhet të jenë në komunikim e harmoni me mësuesit që do të bëjnë punën. Para se të bëjë harmoninë sociale shteti duhet të zvogëlojë realisht diferencat ndërmjet të pasurve dhe të varfërve dhe ndërmjet arsimit privat dhe publik, arsimit laik dhe fetar, shqiptar dhe të huaj.

Me sa duket *Lëvizja Shqipëria Bëhet* mendon që “after-school”-in që ka menduar ta zbatojë kërkon ta bëjë jo duke marrë mësues për mbasdite, por duke shtuar orët mësimore dhe pagesat e mësuesve ekzistues. Mësuesit do ta pranojnë, prindërit do ta pranojnë, partia e pranon, por ndërkohë fëmijët do të vuajnë, siç po vuajnë në të gjitha modelet që e kanë zbatuar. Si “mësuesit” si “prindërit” me modelin “afterschool” janë duke mbrojtur “biznesin e tyre” dhe jo “mirëqënien e fëmijëve”.

Propozimi i zgjedhjes së drejtorëve qartësisht e tepron nga ana e kundërt. *Lëvizja Shqipëria Bëhet* nuk ka një studim të qartë mbi këtë problem. Ajo nuk denoncon faktin që Ministria e Arsimit ka “eksportuar” sovranitetin tek një entitet i huaj siç është Shkolla e Drejtorëve, që është një institucion që u bën vetingun të gjithë atyre që duan të bëhen drejtor. Ministria thjesht noterizon përzgjedhjen që ka bërë një institucion privat i krijuar prej saj në kundërshtim me frymën e kushtetutës.

Komente ndaj programit arsimor të Lëvizjes “Shqipëria bëhet”

Ne kemi shkruar për këtë. Harmonizimi i kërkesave të qendrës shtetit me bindjen nga poshtë siç janë stafet dhe komunitetet e prindërve është një art që mësohet hap pas hapi dhe sipas situatave në terren.

ARSIMI I LARTË

Studimet e larta janë një fushë aq e madhe sa nuk po shkruajmë më se problemet janë bërë kaq të mëdha sa çdo gjë duhet marrë me themel, por tek ai themel nuk hyn fare “diletantizmi” dhe “protagonizmi” i një lëvizje që përtan të shfletojë e të mësojë kulturën kombëtare, dhe arritjet tona si komb në dy shekujt e fundit dhe të nxjerrë ndonjë fjalë të mirë për kombin. Të gjithë duan ta turpërojnë në aftësinë e vet të të kuptuarit dhe ndaj zgjedhin të japin vetëm udhëzime, programe që qartësisht tregojnë se nuk pyesin kënd për çfarë shkruajnë.

Megjithëse ekzistojnë plot kritika për pedagogët me “plagjiatura” që është një krim i rëndë në shtetet moderne dhe cilido që kapet në plagjiaturë (qoftë edhe të vogël) heq dorë nga puna, ose merren masa të rënda, *Lëvizja Shqipëria Bëhet* ka bërë sikur nuk ka parë këtë “krim” në radhët e pedagogëve. Me sa duket kjo është një “tolerim” për rreshitimin e shumë prej tyre në këto nisma dhe nuk ka dashur t’i prekë.

Propozimet për cilësinë e mësuesit apo për arsimin profesional janë qartësisht të pamenduara, por nën tryshninë e një zëri tjetër në programin politik. Me sa duket kanë qenë të sigurtë që programin nuk do ta lexojë kush. Nuk po shtojmë komente se ka aq shumë.

SHKOLLAT SHQIPE NË DIASPORË

As *Lëvizja Shqipëria Bëhet* nuk e ka të qartë se do të jenë Shkollat Shqipe në diasporë që duhet të kenë “*Programin e kthimit në atdhe*”. Sipas Lëvizjes Bashkë shkollat shqipe duhet ta mësojnë gjuhën shqipe thjesht si argëtim “identitar” dhe jo si nevojë që kombi shqiptar të realizojë me një sukses të caktuar rikthimin në atdhe. Ndërkohë që kujtohen për disa propozime, nuk kujtohen të flasim për ndonjë program kthimi në atdhe.

Qartësisht nuk e njohin situatën dhe ka edhe paradokse. Thuhet “*Hapjen e klasave të gjuhës shqipe në të gjitha komunitetet ku regjistrohen mbi 100 fëmijë*” Si do të hapësh klasa shqipe, pasi të regjistrohen fëmijët? Ku do të regjistrohen para se të jenë hapur klasat? Nëse një klasë e drejtë duhet të ketë 12 nxënës, si quhet klasa me 100 nxënës? Kush paguan për ta? Shteti sipas Lëvizjes Bashkë. Shteti shqiptar ka detyrë të hapë shkollat në fshatrat shqiptare dhe të forcojë arsimin në Shqipëri. Ndërsa në diasporë thjesht t’i frymëzojë dhe ata t’i nxjerrin paratë nga xhepi i tyre dhe ta kenë për krenari që e bëjnë këtë për fëmijët e tyre. Të mos harxhojnë 100 milionë euro për 3 ndeshje futbolli në Gjermani dhe asnjë para për shkollat shqipe të mësuesve anembanë botës. Kjo është e turpshme për vetë diasporën shqiptare dhe për të tërë kombin tonë.

Lëvizja Shqipëria Bëhet bën premtime që qartësisht nuk mund të mbahen, si pagesa e mësuesve. Mësuesi në diasporë duhet paguar të paktën 100 euro në ditë për të bërë një punë tepër profesionale dhe të mundimshme për 1 ditë

që është pushim dhe që është e shtuna. Nëse shteti e bën seriozisht këtë punë do të duhej të shpenzojë diku tek 30 milionë dollarë në vit. Është një fytyrë e inteligjencës për emigrantët që t’u thuash “*Pranë thesarit të shtetit do të hapet për llogari të Ministrisë së Arsimit, Fondi për Financimin e këtij programi. Në këtë fond të gjithë shqiptarët e diasporës do të mund të kontribuojnë në mënyrë të vazhdueshme. Në çdo rast, buxheti i shtetit do të mbulojë diferencat që mund të rezultojnë vit pas viti.*”

Pra emigrantët i kanë mësuesit dhe shoqatat patriotike pranë shtëpisë dhe sipas “Shqipëria Bëhet” vjen Shteti Shqiptar e bën të zgjuarin e u thotë “*M’i jepni mua paratë disa mijëra kilometra larg se do t’ua sjell prapë në formë “programi shtetëror*”. Nga ato fonde marrin zyrtarët e shtetit disa qindra mijë euro për të lëvizur me avionë e për të bërë qejf e për të bërë sikur bëjnë punë.

Diaspora nuk ia ka nevojën fare Shqipërisë për para. Diaspora i ka nevojën Shqipërisë t’i bëjë saktë Shqipërinë, t’i dojë fiset shqiptare t’i trajtojë mirë, t’i bëjë shtetin, të bëjë ftesën. ♣

Programi arsimor i Koalicionit Euroatlantik

Arsimi Paruniversitar dhe ai Profesional

Arsimi parauniversitar dhe ai profesional, sot është në ditët më të këqija. Shkolla të rrënuara, pa kushte të përshtatshme. Mësuesit janë të pamotivuar dhe pa një status të merituar për rolin e tre udhëheqës në edukimin dhe formimin e brezave të rinj, që do të jenë e ardhmja e shoqërisë dhe e kombit tonë.

Pothuajse 50% e shkollave në Shqipëri nuk kanë ujë të pijshëm dhe rreth 70% e shkollave nuk kanë kushte të përshtatshme higjienike. (Raporti i UNESCO-s).

Raportet tregojnë se 41% e nxënësve shqiptarë janë viktimë të dhunës fizike dhe psikologjike, ndërsa 22% e tyre ndihen të kërcënuar nga mësuesit (raporti i UNESCO-s).

Ne, kemi një vizion të qartë në shndërrimin e shkollave si institucione arsimore për nxitjen e mendimit krijues dhe kritik, qendra edukimi që ndihmojnë në ZHVILLIMIN DHE TALENTEVE INDIVIDUALE dhe vatra të mirëqënies dhe sigurisë së nxënësve.

Programi ynë ofron:

DYFISHIMIN E BUXHETIT PËR ARSIMIN nga 3.5-3.7% të PBB-së vetëm për arsimin parauniversitar.

Rritje 60% të pagave të mësuesve duke sjellë më shumë të ardhura dhe mirëqenie për 30 mijë familje të mësuesve. Risia për gjithë arsimin parauniversitar dhe për prindërit do të jetë shkolla gjatë gjithë ditës me drekë të garantuar për të gjithë nxënësit.

Në programin tonë, shkolla do të qëndrojnë e hapur prej orës 8:00 - 16:00. Pas orarit të mësim, nxënësve do t'u ofrohet mundësia për përvetësimin e dijeve, mësimin e

Kritikë ndaj programit arsimor të Koalicionit Euroatlantik sipas ChatGPT

Pikat pozitive të programit: Programi e identifikon realisht problemin: mungesa e kushteve në shkolla, demotivimi i mësuesve, emigrimi i studentëve, mungesa e meritokracisë në universitete. Ofron masa konkrete si: dyfishim i buxhetit për arsimin, rritje e pagave të mësuesve, ndërtim i kampuseve të reja universitare, stazhe të financuara për studentët. Ka vizion për lidhjen e universitetit me tregun e punës ("brain gain"), gjë që është shumë e rëndësishme në një vend me emigracion masiv. Premton riformësim të ligjit për arsimin e lartë dhe forcimin e autonomisë universitare, duke synuar depolitizimin dhe meritokracinë.

Problemet dhe kritikët kryesorë:

1. Fjalë të mëdha, mungesë detajesh teknike

Premtohet "dyfishim i buxhetit" ose "ritje 60% e pagave", por nuk sqarohet burimi financiar: nga cilat taksa, çfarë shkurtime diku tjetër, apo si do ruhet stabiliteti buxhetor? Premtohet shkollë me orar të zgjatur, drekë, transport dhe specialistë shtesë, por nuk sqarohet si do menaxhohen kostot reale, duke qenë se kërkohet infrastrukturë e re dhe staf i madh.

Pa plan të qartë buxhetor dhe kohor, këto pretime mund të mbeten populiste.

2. Analizë sipërfaqësore e problemeve strukturore

Programi flet për dhunën në shkolla dhe mungesën e kushteve, por nuk trajton shkaqet e thella: Politikat e dobëta arsimore të dekadave të fundit; Papërgatitja profesionale e mësuesve; Shkëlqimi fiktiv i reformave formale pa thelb.

Nuk preket aspak nevoja për ristrukturim të thellë të kurrikulave, për të ndërtuar mendim kritik dhe kreativ.

Ndaj, programi duket më shumë si reaktiv ndaj simptomave, sesa reformues ndaj rrënjëve të krizës arsimore.

3. Idealizim pa mbështetje reale për meritokracinë

Premtohet "autonomi universitare" dhe "zgjedhje meritore", por pa: Garanci ligjore për depolitizim real të administratës universitare; Propozime për mekanizma kontrolli ndaj korrupsionit akademik; Propozime për standardizim objektiv të pranimeve dhe akreditimit.

Meritokracia dhe depolitizimi nuk ndërtohen vetëm me fjalë, por me rregulla të forta, institucione të pavarura dhe kulturë të re akademike, gjë që mungon.

Programi arsimor i Koalicionit Euroatlantik

gjuhëve të huaja dhe të aftësimit në TIK si dhe veprimtari kulturore dhe artistike. Për këtë qëllim do të angazhohen dhe punësohen 7500 specialistë të fushave të mësipërme.

Ne do të sigurojmë:

- Transport të dedikuar e të standardizuar me parametra bashkëkohorë për çdo mësues e nxënës, në arsimin parau-niversitar që banon 3 km larg shkollës.
- Tekste të reja, falas, në arsimin e detyruar (klasat 1-9), çanta dhe mjete didaktike për fëmijët në vështirësi ekonomike.
- Kurrikula të përmirësuara, në përshtatje të plotë me zhvillimin dhe nevojat e nxënësve si dhe kërkesave të shoqërisë.

Universitetet

I vetmi kontribut që ka dhënë Edi Rama është shndërrimi i Shqipërisë në vendin e parë në botë të eksportuesit të qytetarëve të tij. Kushdo e ka të qartë se me këtë model qeverisës, ky vend nuk ka kurrfarë perspective, ndaj zgjedhin të largohen. Kostoja e jetesës është shumë e lartë, ndërsa pagat shumë të ulëta. Nënqaj për fëmijët që largohen përditë nga vendi, ndërsa Edi Rama mburret me projekte 3D në rrjete sociale.

Ndaj program ynë do të bëjë të mundur që:

- Në ditët e para të Qeverisë së saj, të nisë punën për rikonceptimin e Ligjit të Arsimit të Lartë, në bashkëpunim me botën akademike, ekspertët më të mirë dhe studentët shqiptarë;
- Të bëjmë transparencë të plotë në procesin e akreditimit nga agjencitë ndërkombëtare të rankimit të universitete dhe të programeve të studimit;

Kritikë ndaj programit arsimor të Koalicionit Euroatlantik sipas ChatGPT

4. Nënveftësim i reformës shkencore dhe teknologjike

Pavarësisht se përmendet “Fondi për Shkencë, Inovacion dhe Zhvillim”, nuk jepet një vizion real për:

Lidhen e kërkimit shkencor me industrinë dhe ekonominë,

Ndërtimin e një kulture të konkurrencës shkencore brenda vendit,

Nxijtjen e sektorëve strategjikë si inteligjenca artificiale, bioteknologjia, etj.

Shkenca dhe teknologjia nuk mund të ringrihen thjesht me grante, por me politika aktive zhvillimi kombëtar.

5. Rreziku i mbivendosjes së objektivave dhe mungesa e prioriteteve të qarta

Premtohet gjithçka për të gjithë: shkolla të reja, paga më të larta, transport, ushqim, reforma në universitete, fonde për kërkime, kampuse të reja...

Nuk përcaktohet cilat janë prioritetet fillestare nëse fondet ose kapacitetet nuk mjaftojnë për të gjitha njëherazi.

Një program efektiv duhet të ketë prioritete të qarta dhe një fazim të punës, ndryshe rrezikon të jetë utopik.

Përmbledhje e kritikës: Programi arsimor i Koalicionit EuroAtlantik ka synime të mira dhe ofron disa ide progresive, por vuan nga mungesa e planifikimit teknik të zbatueshëm, nga analiza e cekët e problemeve dhe nga mungesa e prioritizimit të reformave. Pa një reformë të thellë në kulturën e qeverisjes akademike dhe në filozofinë e edukimit, rrezikon të përfundojë si një listë dëshirash të bukura, por të paarritshme.

Programi arsimor i Koalicionit Euroatlantik

- Të bejmë regjistrimin e pronave të universiteteve dhe kalin në pronësi të tyre, duke garantuar me ligj vetadministrimin e këtyre pronave;
- Të krijojmë Bibliotekën Ndër-universitare Kombëtare Online;
- Të rrisim rolin e studentëve në zgjedhjet universitare, vlera e votës së të cilëve shkon deri në 30%;
- Të dyfishojmë buxhetin për Arsimin e Lartë;
- Të ndërtojmë brenda mandatit të parë 3 kampuse universitare: në Tiranë, Elbasan dhe Shkodër;
- Të financojmë stazh njëvjeçar pas studimeve për 10 mijë studentë, duke garantuar kështu lidhjen e tyre me tregun;
- Të financojmë bursa për studentët dhe doktorantët ekselentë në 15 universitetet më të mira në botë, si dhe promovimin e programit për thithjen e trurit, larg nepotizmit dhe ndërhyrjes politike, por bazuar në meritokraci. “From brain drain, to brain gain”.
- Të shpallim programet universitare të mësuesisë si “prioritet kombëtar”, duke nxitur të rinjtë të studiojnë në këtë fushë me rëndësi për ardhmërinë e vendit, përmes politikave mbështetëse të arsimimit, punësimit, dhe sigurisë financiare;
- Të japim autonomi të tillë universitete shqiptare, që përmes parimit meritë-preferencë, të kenë mundësi të bëjnë vetë përzgjedhjen e studentëve të tyre.
- Të depolitizojmë Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe përmirësimin e kuadrit ligjor të organizimit dhe funksionimit të saj;
- Të krijojmë Fondin Shqiptar për Shkencë, Inovacion dhe Zhvillim, ku të konkurrojnë të gjithë IAL (Institucionet

Komente ndaj programit arsimor të Koalicionit Euroatlantik

Modeli “afterschool” i partisë

Megjithëse skema “afterschool” është jashtëzakonisht e dështuar dhe me pasoja të rënda tek fëmijët dhe masivisht prindërit raportojnë probleme thuajse në çdo zë që bën këtë shërbim, zgjidhja nuk është kthimi edhe i shkollës shtetërore në një qendër “afterschool”. Partitë po mendojnë jo me zërin e mësuesve dhe të drejtuesve të shkollave por po mendojnë me logjikën e prindit që nuk e menaxhon dot fëmijën kur vjen nga shkolla. Problemet po bëhen më të mëdha, por modeli “afterschool” nuk do të “shërojë” problemin e fëmijëve, por do të “mbulojë” problemin e fëmijëve.

Fëmijët dhe shkollat do të bëhen më keq, sepse fëmijët dhe mësuesit do të lodhen më shumë duke ndenjur në shkollë për një kohë të gjatë. Shkollat tona nuk kanë parqe ku të çlodhen, nuk kanë fusha sportive, nuk kanë mjedise për arte dhe sporte, që të quhen qendra të mira për çlodhje. Ndaj “afterschool” që propozojnë partitë do të kthehet në një “burg” për fëmijët që do të duhet të qëndrojnë në mjedise që as nuk pastrohen dot mjaftueshëm dhe ku ngacmimet do të kapin majat, gënjeshtra e mësuesve dhe shkollave gjithashtu do të kapë majat, dobësia do të kapë majata sepse cilësia e dobët do të fshihet më shumë edhe për shkak se prindërit do të shkëputen edhe më shumë nga monitorimi i cilësisë.

Mësuesit dhe drejtuesit nuk e duan këtë model, jo se nuk duan të punojnë më shumë, por realisht nuk mund të punohet më shumë. Një punëtor ndërtimi pasi mbaron punën, lë lopatën, mistrinë dhe shkon qetësohet në shtëpi. Ndërsa mësuesi duhet të mendojë për temat që ka për të bërë për të nesërmen dhe kjo punë patjetër bëhet edhe në shtëpi. Edhe rrogat e tepërta nuk kanë për ta motivuar sa e demotivon lodhja nga orari i zgjatur dhe shqetësimi gjatë ditës shkollore.

Në modelin “afterschool” fëmijët do të detyrohen nga mësuesit të qëndrojnë me orë të tëra të ulur në banka dhe kjo do t’ua deformojë shtyllën kurrizore dhe do të përkeqësohet shëndeti fizik dhe mendor. Vetë programi e përmend ngacmimin dhe dhunën psikologjike që është alarmante. Në vend ta quajë zgjidhje t’i largojë fëmijët nga ky mjedis toksik, koalicioni euroatlantik kërkon ta bëjë këtë ekspozim edhe më të madh. Nëse orari shtohet me 50% ngacmimi dhe dhuna psikologjike do të shtohet me 100%, dhe aftësia e prindit për ta ndaluar do të pakosohet edhe më shumë sepse ai do të jetë më i shkëputur nga fëmija.

Nuk po shtojmë më shumë kritika, sepse mjaftojnë edhe ato që ka bërë ChatGPT dhe plus që partia koalicioni euroatlantik vjen nga një praktikë e posteve në pushtet, pra kanë përvojë nga koha kur kanë qenë pjesë e Partisë Demokratike dhe kanë një pjesë të përgjegjësisë që ka patur Partia Demokratike.

Programi arsimor i Koalicionit Euroatlantik

e Arsimit të Lartë) publike dhe jo vetëm, institutet kërki-
more, hulumtues shkencorë, bazuar në
meritokraci;

- Të ngrejme Universitetin e Diasporës: përmes krijimit të
një databaze të kërkuesve shkencorë, doktorë shkencash
dhe profesorë shqiptarë, për të kontribuar në edukimin dhe
aftësimin universitar në Shqipëri, në
bashkëpunim me universitetet publike, përmes një fondi të
dedikuar për financimin e aktiviteteve;

Komente ndaj programit arsimor të Koalicionit Euroatlantik

Koalicioni Euroatlantik i ikën edhe çështjes së edukimit kombëtar si funksion kryesor i arsimit. Nëse Shqipëria po shpop-
ullohet, një nga arsytet është se sistemi arsimor nuk i ofron lidhjet e fuqishme me vendin që bëhet nëse arsimi e ka një
synim të tillë. Duke e zhveshur nga ky mision arsimin shqiptar.

Brain gain?! Një togfjalësh “acarnes” për familjet e emigrantëve

Është fyerje për emigrantët që e quajnë se çështje e Shqipërisë është “të mbash trurin”. Kjo është një kapje biznesi, dhe
është fyese për familje të tëra që të thuash “Se nga shqiptarët që largohen na duhen vetëm “ata me tru” dhe profesion,
ndërsa të tjerët “le ta humbin atdheun” “për ta nuk ka vend”.

Nëse duhen kthyer më parë, e meritojnë ata që janë më të dobët në përballjen me realitetin e emigracionit, sepse janë ata
që kanë edhe rrogat më të vogla, dhe hallet më të mëdha dhe atdheu do të ishte shërim për ta. Ndërsa ata që janë “me
tru” i bie që kanë më shumë mundësi të jetojnë jashtë për shkak të “trurit”. Por sidoqoftë të dy palët janë që kanë mbetur
pa atdhe dhe duhen kthyer.

Kurrikula - bishti i kavallit

Në kohën që “kurrikula” është arsyeja pse ekziston shkolla dhe sistemi arsimor, dhe e para që duhet të reformohet, thu-
ajse periodikisht, Koalicioni Euroatlantik, jep vetëm një fjali kaq të dobët siç është kjo:

“Kurrikula të përmirësuar, në përshtatje të plotë me zhvillimin dhe nevojat e nxënësve si dhe kërkesave të shoqërisë.”

Kurrikula është shkaku i dështimit të sistemit tonë arsimor dhe nuk janë aq bankat, apo buxheti etj.

Lidhur me universitetet sa për ta përmendur një mungesë se ka aq shumë: çështja e plagjiaturës dhe e përparësisë së kon-
tributeve shkencore origjinale nuk përmendet, që është shenjë e qartë e mungesës së sinjeritetit të ndërhyrjes.

Programi arsimor i Aleancës Kombëtare Shqiptare

Programi për arsimin është vetëm kaq:

<https://aksh.al/programi/arsimi/>

Rritjen e fondeve për arsimin, fonde këto që do të sigurohen duke mirë menaxhuar buxhetin dhe duke reduktuar fondet për degët, që mund të reformohen.

Rritja e cilësisë nëpërmjet hartimit të teksteve nga ana profesionale, shkencore, didaktike dhe psikologjike.

Do të ngrihen grupe pune, ku do të marrin pjesë profesor të universiteteve, psikolog, didakt, dhe mesues përkatës të lëndës që do të hartojnë tekstet në arsimin 9 vjeçar dhe të mesëm. Kjo do të ngrejë cilësinë e arsimit, pasi tekstet dhe mënyra sesi jepet mësim, janë tepër të rëndësishme për cilësinë e arsimit të lartë.

Reformimi i arsimit sipas modelit Japonez, Finlandez dhe atij të Singaporit, ku në qendër do të jetë edukimi dhe mesimi i fëmijës, por edhe kualifikimi i tij në bazë të talenteve që ai ka. Pra maksimalizimin e kualifikimit të talenteve.

Arsimi i lartë do bazohet tek merita dhe nevojat e tregut vendas.

Arsimi do të jetë prioritet, pasi ai siguron burimet njerzore, të cilat janë një pasuri e jashtëzakonshme, për ekonominë e vendit, qoftë në sektorin privat dhe në atë publik.

Kritikë ndaj programit arsimor të Aleancës Kombëtare Shqiptare sipas ChatGPT

Kjo paraqitje e programit të Aleancës Kombëtare Shqiptare për arsimin përmban disa ide pozitive dhe synime të vlefshme, por paraqitet në një mënyrë të përgjithshme dhe me mungesë qartësie strategjike e operacionale. Më poshtë është një kritikë e detajuar:

1. Gjuhë e përgjithshme dhe mungesë konkretizimi

Programi është formuluar me gjuhë të përgjithshme dhe nuk përfshin detaje praktike se si do të realizohen ndryshimet e përmendura. Për shembull: *“Rritjen e fondeve për arsimin”* është një synim i mirë, por nuk tregohet sa do të rriten, nga cilat degë saktësisht do reduktohen fondet, dhe si do të shmangen ndikimet negative të këtij ridrejtimi të buxhetit. *“Reformimi sipas modelit japonez, finlandez dhe singaporian”* është një referencë shpesh e përdorur në retorikën politike, por nuk ofrohet analizë se çfarë aspektesh të këtyre modeleve janë të përshtatshme për Shqipërinë, dhe si do të përshtaten në kontekstin tonë social, ekonomik dhe kulturor.

2. Premtime ambicioze pa përkrahje teknike

Krijimi i grupeve të punës për hartimin e teksteve shkollore është ide pozitive, por nuk tregohet: Cilat janë kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve? Sa do të zgjasë ky proces? Si do të sigurohet pluralizmi akademik dhe shmangia e ideologjizimit të teksteve? Nuk ka përmendje të digjitalizimit, arsimit profesional, apo trajnimit të vazhdueshëm të mësuesve — elementë kyç në përmirësimin e sistemit arsimor në çdo vend.

3. Mungon një analizë e gjendjes aktuale

Programi nuk përfshin një diagnozë të gjendjes ekzistuese të arsimit në Shqipëri. Pa një analizë të qartë të problemeve ekzistuese (p.sh. largimi i mësuesve, mungesa e infrastrukturës, mospërputhja mes arsimit dhe tregut të punës), është e vështirë të vlerësohet se sa të përshtatshme janë zgjidhjet e propozuara.

4. Aspekte pozitive për t'u theksuar

Rëndësia që i jepet cilësisë së teksteve shkollore dhe përfshirjes së ekspertëve të fushës është një pikë e fortë. Vënia në qendër të talenteve të nxënësve dhe orientimit të tyre profesional është në përputhje me modelet bashkëkohore të arsimit.

Përfundim: Ky program ka disa ide të drejta në thelb, por paraqitet më shumë si një deklaratë qëllimesh sesa një plan i mirëmenduar reformash. Për ta bërë më të besueshëm dhe funksional, ai duhet të përfshijë analiza të kontekstit, objektiva të matshme, mekanizma zbatimi, dhe një kornizë kohore.

Komente ndaj programit arsimor të Aleancës Kombëtare Shqiptare

Siç u pa më sipër programi për arsimin i Aleancës Kombëtare Shqiptare është shumë i shkurtër dhe sa për të thënë. Sidoqoftë znj. Kocaqi është profesore e historisë dhe e ka pasion historinë e Shqipërisë dhe parlamentit i bëhet mirë që të ketë historianë.

Duke u kapur menjëherë tek Historia dhe rëndësia e saj për shkollën. Duhet kujtuar vazhdimisht që sivejet është 200 vjetori i lindjes së Pashko Vasës, ideologut të Rilindjes Kombëtare. Nëse shteti dhe partitë e kanë seriozisht Shqipërinë, edukimin kombëtar dhe sistemin arsimor, ato duhet të respektojnë Rilindjen Kombëtare jo si “qokë” por realisht ta kthejnë adhurimin në atë formë që vetë besimtarët adhurojnë shenjtët e tyre.

Një historiani duhej t'i binte më shumë në sy mungesa e edukimit kombëtar dhe ta vinte atë si prioritet. Nuk është as në programin e Aleancës Kombëtare Shqiptare. Duket që e quajnë si detyrim të mos e kenë kur i futen konkurrimit.

Me mendimin që vetë zonja Kocaqi është pedagoge e historisë dhe është pjesë e stafeve akademike dhe kjo e diferencon nga një pjesë tjetër kandidatësh që vijnë nga fusha të tjera, e ka anashkaluar fare sistemin arsimor në vend që ta bënte argumentin kryesor të saj. Kjo do të thotë që shpërfillja e përgjithshme e pafalshme e shoqërisë ndaj arsimit e sistemit arsimor, e ka ndikuar edhe atë.

Qartësisht duket që nuk ka analizë programore. Por nëse kjo mund të pranohet në masë, nuk mund të pranohet edhe nga ata që janë të fushës dhe që presupozohet që duhet të përfshihen në diskutime e analiza.

Zgjedhësit as këtë vit nuk do të mundet të vlerësojnë partitë për nga statuti që kanë, nga mënyra e vendim marrjes, nga shpalosja e demokracisë së brendshme, nga qëndrimet që mbahen për çështje të ndryshme, nga cilësia e ekipit apo nga historiku i premtimeve të mbajtura (kjo e fundit për partitë e reja është e kuptueshme që nuk mund të realizohet tani për tani).

Programi arsimor i Lëvizjes Atdheu

Në faqen e Lëvizjes Atdheu, gjetëm në vend të programit “Kartën e Vlerave dhe të parimeve themelore”. Duke qenë se na intereson vetëm arsimi dhe jo kritika e të gjithë programit, kërkuam me search në dokument fjalët “arsim” (që e gjetëm dy herë) dhe fjalën “edukim” që nuk e gjetëm, fjalën universitet që nuk e gjetëm. Fjalën “shkollë” e gjetëm një herë dhe po japim çdo fjalë në këtë drejtim.

“Lëvizja Atdheu beson se ndër pasuritë më të mëdha që ndihmon në zhvillimin e shpejtë të një Kombi, është liria e shprehjes dhe e mendimit. Por njëkohësisht, manipulimi, mashtrimi, prekja e shenjtërive të njerëzve, prekja e shenjtërive kombëtare apo çfarëdo qofshin ato shenjtëri që gëzojnë konsensus mbarë shoqëror dhe mbarëkombëtar si dhe imponimi i mendimit me mënyra të dhunshme është i refuzuar dhe i papranueshëm. Ndaj, ajo është e gatshme të marrë nën mbrojtje lirinë e mendimit dhe të shprehjes nëpërmjet krijimit të kushteve kulturore dhe arsimore që ta projektojë dhe ta ndërtojë intelektin e individit dhe të shoqërisë duke u bazuar tek vlerat universale dhe tek ato kombëtare shqiptare. Shkolla shqiptare dhe brezi i ri i shqiptarëve që do të jenë e ardhmja e Kombit gjenden sot plotësisht të shpartalluar nga një turbokulturë neoliberale pa identitet që po shpërfytyron qelizën bazë të shoqërisë duke e përfshirë atë tek labirintet pa dritë të neoliberalizmit që prodhon shqyerjen identitare

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Atdheu sipas ChatGPT

Shënim: Në ChatGPT nuk futa vetëm fjalitë që janë veçuar djathtas, por të gjithë dokumentin “Karta e Vlerave dhe Parimet Themelore të LA”. Kjo do të thotë që hetimi mbi programin arsimor është bërë i plotë nga ChatGPT. Vijojmë me citimin e çfarë shkruan ChatGPT.

KRITIKA PËR ARSIMIN

Më poshtë ke një analizë të veçantë për përmbajtjen që lidhet me arsimin dhe edukimin në dokumentin e Lëvizjes Atdheu, të ndarë në a) **pikat e forta** dhe b) **pikat e dobëta**.

PIKAT E FORTA (pozitive)

1. Edukimi për të drejtat dhe liritë themelore

“...besojmë në fuqinë e lirisë së patjetërsueshme të individit, të fjalës së lirë, të shprehjes së mendimit kritik...”

- Kjo tregon një përkushtim ndaj formimit qytetar përmes edukimit mbi të drejtat themelore.
- Promovimi i mendimit kritik është një vlerë thelbësore në arsim.

2. Barazia në akses ndaj arsimit

“...angazhohet me nisma politike dhe ekonomike që kanë për qëllim eliminimin e barrierave sociale, shëndetësore, arsimore që e vendosin një individ apo një grup individësh në pozicion inferior apo të pabarabartë...”

- Kjo është një pikë shumë pozitive që tregon ndjeshmëri ndaj grupeve në nevojë.
- Një qasje sociale për arsimin që synon barazi reale.

3. Vlera kulturore dhe edukative të trashëgimisë kombëtare

“...bazuar tek kultura dhe filozofia politike atdhetare, patriotike, autoktone, autentike...”

- E dukshme një përpjekje për t'i dhënë arsimit një përmbajtje me bazë kombëtare dhe kulturore.
- Kjo mund të përkthehet në një program të fortë edukativ me theks te historia dhe identiteti kombëtar.

Programi arsimor i Lëvizjes Atdheu

të individit të dorëzuar ndaj rrymës.”

“LA qëndron pranë shtresave në nevojë duke mbështetur, nxitur dhe duke u angazhuar me nisma politike dhe ekonomike që kanë për qëllim eliminimin e barrierave sociale, shëndetësore, arsimore që e vendosin një individ apo një grup individësh në pozicion inferior apo të pabarabartë në raport me pjesën tjetër të shoqërisë.”

Kritikë ndaj programit arsimor të Lëvizjes Atdheu sipas ChatGPT

PIKAT E DOBËTA (mangësi)

1. Mungesa e një politike arsimore të qartë dhe të plotë

- Nuk ka përshkrim të sistemit arsimor që LA dëshiron të ndërtojë.
 - o Nuk ka qasje mbi cilësinë e arsimit.
 - o Nuk ka propozime për kurrikulën.
 - o Nuk ka qëndrime për universitetet, edukimin profesional, mësuesit apo teknologjinë në arsim.

2. Asnjë fjalë për sfidat aktuale të arsimit shqiptar

- Nuk përmendet aspak emigrimi i mësuesve, standardet e ulëta në testimet ndërkombëtare (si PISA), mungesa e mjeteve didaktike apo lidhja mes tregut të punës dhe arsimit.
- Nuk ka diagnozë të problemeve konkrete.

3. Shmangie nga politikat edukative moderne

- Nuk flitet për:
 - o Digjitalizimin e arsimit
 - o Inovacionin pedagogjik
 - o Trajnimin e mësuesve
 - o Përfshirjen e grupeve të marginalizuara (minoritetet, fëmijët me aftësi ndryshe)

4. Tonalitet i përgjithshëm, jo arsimor

- Edukimi përmendet më shumë në kuptimin moral ose si “vlerë” dhe më pak si sistem që ka nevojë për reformim, financim dhe transformim.

Përmbledhje

Aspekti

Edukimi si vlerë kombëtare dhe qytetare

Akses i barabartë në arsim

Politika të qarta arsimore (kurrikula, reforma, digjitalizim)

Analizë e sfidave reale të arsimit

Propozime për investim në arsim

Vlerësimi

o Pozitiv

o Pozitiv

o Mungon

o Mungon

o Mungon

Komente ndaj programit arsimor të Lëvizjes Atdheu

Drejtuesin e Lëvizjes Atdheu z.Osmani, e njohim vetëm nga çfarë shohim në media apo rrjete sociale. Për të kuptuar lidhur me qasjet apo për t'i ndihmuar në konceptin e tyre për sistemin arsimor edukativ kemi nisur artikuj që janë të kësaj fushe, dhe kemi pritur komente për to. Nuk kemi paratur asnjë koment.

Kemi dashur të dimë se si vijon analiza qoftë personale qoftë partiake në atë përmbajtje që ne e quajmë të rëndësishme. Në fakt, ne nuk shpresojmë për një analizë “partiake”. Thua se të gjitha partitë e kanë “analizën” individuale. Ndërkohë që çështjet për të cilat shprehemi janë çështje jashtëzakonisht të gjera. Kur bëhet fjalë që në parti t'i dalë zot kësaj pune nuk ka asnjë rrugë tjetër veç formimit të stafeve profesionale.

Kur je në biznes, individit kufizohet vetëm në çështjet që di më mirë, por kur bën parti ose do të thotë që “partia nuk ka mundësi të investojë në disa fusha” dhe duhet të japë mënyrën se si do ta zgjidhë këtë ngërç të stafeve të saj, ose do të thotë “këtë drejtim e kemi mangut” ose nuk mund ta bëjë sa për të thënë dhe të thotë e kam bërë.

Ne e kemi ditur më parë që partitë e reja do ta kishin këtë problem, ndaj kemi dashur t'u ofrojmë çfarë mundemi të dimë nga brenda sektorit të arsimit. E kemi provuar që e bëjmë këtë hapur dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë. Artikujt janë pranuar fillimisht me një falenderim të çastit dhe aq, pa ndonjë koment që të ketë lidhje me përmbajtjen e artikujve të dhënë.

Kjo do të thotë se partia është e hapur vetëm formalisht për çështje të përgjithshme (politikë e jashtme, ekonomi, arsim, shëndetësi, ushtri etj.), por ajo është e fokusuar një objektiv specifik. Kjo është arsyeja që partia bën sikur nuk sheh në disa fusha. Qartësisht nuk dëshiron të kuptojë, dhe na injekton mendimin se kjo fushë nuk është për t'u eksploruar dhe do të braktiset.

Çështjet që ne trajtojmë nuk trajtohen thuajse fare në shtyp dhe ne i trajtojmë ato nga këndvështrimi i një shkolle, që synon të shprehë shqetësimet e veta në bazë të përvojës së vet. Nuk ekziston as një shkollë e dytë as ndonjë institucion arsimor qoftë i lartë që ta bëjë këtë në prag të zgjedhjeve. Për ne indiferentizmi i tyre ndaj politikës ushqen dhe majis edhe më keq dobësinë e vetë politikës.

Një shtet e shoqëri i përgjegjshme në prag zgjedhjesh duhet të ziente nga debati i gjithanshëm në çdo sektor që të bëhej e mundur sa më shumë sitja e ideve të reja, rreshtimi i përparësive në këtë apo atë parti etj.

Asnjë nga këto nuk e kemi jo për arsimin, por për të gjithë sektorët e shoqërisë. Niveli i “populizmit” është kaq i theksuar edhe sivjet.

Ne i kemi të gjithë artikujt në faqen e shkollës dhe kjo është e qëllimshme, pikërisht se jemi të bindur se ato artikuj formojnë profilin ideor të shkollës “Udha e shkronjave” duke ofruar kështu transparencë edhe në një çështje ku prindërit janë qartësisht në errësirë të plotë kudo. Nuk është e lehtë për ne të shkruajmë artikuj që “ngjajnë si politikë”. Jemi të sigurtë që në kritikë por nuk ka anësi. Anësia e vetme

që kanë ato janë mbrojtja e interesat të sektorit të arsimit (publik apo privat qoftë).

Në artikujt që kemi nisur ndaj partisë Lëvizja Atdheu trajtohet edhe çështja fetare shqiptare në këndvështrim të sistemit edukativ laik (mesazh më 12 tetor 2024), çështja e “Mësonjëtores”, i është dhënë librin “Global Albania” (format pdf, 12 tetor 2024) që për mua është përfaqësues i mendimit që kam dhe shumë i rëndësishëm për trajtimin e çështjes së diasporës, i janë dhënë të tre analizat e fjalimeve të Edi Ramës në Athinë, Milano, Selanik, dhe anulimin e takimit të Londër, i është kujtuar autorësia e Rrit të Identifikimit të Shqiptarëve, çështja e eksportimit të fjalës “Besa” për përpunim dhe zotërim nga izraelitët që do ta vënë atë në mënyrë unike si emërtim të Muzeu Hebraik në qendër të Tiranës, i janë dhënë artikujt për Shtetin Bek-tashi, për rolin e familjes Qirjazi dhe problematikën që ka kjo familje tani në interpretimin e trashëgimisë, një artikull për globalizmin apo patriotizmin, një peticion të botuar për diferencimin e klasave në shkollat shtetërore që shkakton përçarje të shoqërisë (19 nëntor 2024), për trajtimin diabolik të figurës së Naim Frashërit nga Ismail Kadare (2 dhjetor 2024), i kemi dhënë artikujt për Pashko Vasën (4 shkurt). I kemi dhënë në datën 26 janar 2026 artikullin që e kishim publik “Programi politik për arsimin”.

Për të gjithë këta artikuj asnjë koment.

Programi arsimor i Djathtas për zhvillim

Kritikë ndaj programit arsimor

*Më 28 prill 2025, dërguam e-mail në adresën
ealibeaj@gmail.com me këtë tekst:*

“Përsbëndetje i nderuar z. Alibeaj,

Urojmë të jeni mirë.

*Do të donim të kishim programin e Partisë “Djathtas për
Zhvillim” për arsimin.*

Me respekt,

Artur Shkurti

Nuk patëm përgjigje për e-mailin që dërguam dhe nuk gjejmë faqe interneti për programin e partisë “Djathtas për Zhvillim”

Qeverive të Shqipërisë dhe të Kosovës për mësimin e gjuhës shqipe

Nga Artur Shkurti
Drejtor i shkollës “Udha e shkronjave”

Dërguar me e-mail të dy qeverive, më datën 12 tetor 2022.

Duke qenë të interesuar:
për plotësimin detyrimeve kombëtare dhe kushtetuese për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare, për frenimin e asimilimit të fëmijëve të shqiptarëve familjet e të cilëve janë larguar tashmë në emigracion, për të shtuar investimin në burime njerëzore që ndodhen jashtë trojeve etnike por që mund të ndihmojnë edhe ashtu Shqipërinë dhe Kosovën ose troje të tjera etnike shqiptare është me rëndësi që qeveritë shqiptare të investojnë ndryshe në arsimin dhe kulturën shqiptare të shqiptarëve të diasporës.

Duke u nisur nga përvoja jonë si mësues, drejtues e si shkollë në 25 vjet me programe kombëtare, por edhe me programe ndërkombëtare, nga përvoja jonë si hartues e botues të teksteve mësimore, si edhe një përvojë jo e pakët për të kuptuar cilësinë e mësimin shqip në emigracion jemi shumë të prekur nga niveli shumë i lartë i asimilimit të shqiptarëve. Kur flasim për nivel shumë të lartë të asimilimit, kemi parasysh nivelin shumë të ulët të investimit që do të prodhojë patjetër një nivel shumë të lartë të asimilimit.

Çfarë po ndodh deri tani?

Është të mos kuptuarit që një gjuhë që të mësohet mirë duhet kohë, kohë, kohë dhe asgjë tjetër. A jemi në gjendje ne të blejmë kohën e nxënësve që janë jashtë? Mund t’u blejmë libra e të themi: ja librat i kanë, por nuk i mësojnë? Mund t’u blejmë mësues, por përsëri do të themi “ja mësuesit, librat i kanë” por nuk kanë dëshirë të dhurojnë ata kohë. Ka shumë arsye që e dështojnë mësimin. Kur shkollat shqipe dështojnë këtu, mund të merret me mend sa të suksesshme mund të jenë ato në emigracion. Dobësia e këtu shpesh eksportohet edhe atje dhe kështu kombi ynë shkon me shpejtësi drejt gremisë. Sami Frashëri thotë “*Shqipëri pa shqiptarë nuk ka, shqiptarë pa gjuhë shqipe nuk ka dhe gjuhë shqipe pa shkollë që ta mësojnë atë nuk ka*”.

Është e qartë se fëmijët në emigracion kanë nevojë për shkollë. Shtetet shqiptare duhet t’ua ofrojnë ato dhe zgjidhja mendoj që është e thjeshtë. Më poshtë e shpjegoj.

Propozimi: Çdo shkollë shtetërore dhe private në Shqipëri dhe Kosovë, të detyrohet të ketë krahun e vet mësimor online në diasporë, që do të thotë se mbasdite, ose paradite, ato duhet të japin mësim online për nxënësit e emigracionit. Nëse shtetet tona nuk kanë mundësi ta bëjnë këtë, fillimisht mund ta ofrojnë këtë shërbim me pagesë dhe më vonë, ato e futin në buxhetin e tyre.

Shembull

Shkollë “Ndre Mjeda” (Shkodër) ose shkollë “Mihal Grameno” (Fushë Kosovë) detyrohen të japin 9 klasa me emigrantë x 5 orë secila në javë = 45 orë në javë, që do të thotë se 2 mësues të rinj mund të punësohen vetëm për mësimin online të këtyre shkollave. Këto shkollë regjistrojnë nxënës kryesisht që janë përkatësisht nga Shkodra dhe nga Fushë Kosova, në mënyrë që ato jo vetëm të mësojnë gjuhën shqipe, por të mbajnë sa më shumë lidhjet krahnore, dialektore dhe interesin e vetë fëmijëve apo prindërve që të jenë të lidhur me vendin.

Nëse shkollat paguhet (ta zemë 5 euro/ora ose 100 euro në muaj) është e natyrshme që ato vetë do të grumbullojnë rreth 10 000 euro në muaj vetëm nga 9 klasa x 12 nxënës, që është një buxhet i mjaftueshëm për të paguar jo 2 mësues por 10 mësues të shkëlqyer. Ka edhe modele të tjera financimi, por mendoj që prindërit që janë jashtë do ta financojnë me kënaqësi shkollën.

Përfitimet

Është e padiskutueshme që numri i regjistrimeve do të jetë shumë i madh. Nxënësit që janë jashtë kanë shumë besim në shkollat shqiptare dhe fundja ato mbajnë edhe mallin e vendit.

Është e padiskutueshme që cilësia mësimore do të jetë shumë e madhe sepse mësuesit vendas, të Shqipërisë dhe

Qeverive të Shqipërisë dhe të Kosovës për mësimin e gjuhës shqipe

të Kosovës do ta bëjnë këtë shumë më mirë se mësuesit në emigracion, sepse do ta bëjnë nga shkollat e tyre ku gjallon gjuha dhe kultura shqiptare.

Është e padiskutueshme që vetë shkollat shqiptare jo vetëm do të financohen më mirë, por ato do të mësojnë shumë nga nxënësit që janë jashtë dhe shumë projekte të nxënësve tanë shqiptarë, do të bëhen me bashkëmoshatarët e tyre të të njëjtit komb por që jetojnë kudo në botë. Fëmijët dhe familjet që jetojnë jashtë duke sjellë përvojat e tyre të

shkollave shumë të mira, do të ndikojnë thellësisht cilësinë e shkollave tona.

Ky do të jetë një hap i sigurtë drejt rikthimit të shumë familjeve në vendet e tyre. Shkollat do të forcojnë kontaktet dhe kjo do të përkthehet në një ardhje gjithnjë e më të madhe. Vetë shkollat tona do të frymëzohen më shumë për një cilësi të vërtetë.

Do të frenohet emigrimi i mëtejshëm. Jemi të bindur që familjet që jetojnë jashtë do të ndikojnë pozitivisht për frenimin e emigracionit të mëtejshëm sepse ato e shohin që nuk është mirë kjo punë.

Unë mendoj që propozimi është shumë i qartë dhe që mësuesit anembanë Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Verit, të Greqisë, të Malit të Zi apo në Preshevë, Medvegjë, e Bujanovc do ta presin shumë mirë.

Mesazh për Kuvendin e Shqipërisë

(Nga Artur Shkurti, 18 tetor 2022)

E nderuar znj. Lindita Nikolla, Kryetare e Parlamentit

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Edukimit dhe të Mjeteve të Informimit Publik, Të nderuar anëtarë të Konferencës së Kryetarëve

Ju shkruajmë nga shkolla “Udha e shkronjave” lidhur me interesin tonë për një projektligj të arsimit shqip të fëmijëve që jetojnë jashtë atdheut.

Në datën 12 tetor 2022, ne u kemi nisur një propozim dy qeverive shqiptare. Përmbajtjen e këtij mesazhi e gjeni në artikullin *“Qeverive të Shqipërisë dhe të Kosovës për mësimin e gjuhës shqipe”*. Ne kemi patur një seri reagimesh të rëndësishme ndaj artikullit dhe në fund të artikullit ju do të lexoni përmbajtjen e këtyre mezazheve që kemi marrë.

Duke qenë se jemi propozues, e drejtë do të ishte që të bënim sa më shumë punë paraprake për përgatitjen e një projektligji dhe tashmë kemi bërë pjesën arsyetuese të projektligjit që e kemi paraqitur në videon që gjendet në youtube *“Për arsimin shqip të fëmijëve shqiptarë që jetojnë jashtë atdheut”*.

Aty bëjmë një arsyetim të gjendjes së realizimit të objektivave sociale (neni 59 të Kushtetutës) që lidhet me ruajtjen e gjuhës shqipe dhe të trashëgimisë sonë kombëtare, të pikave ku preken të drejtat e njeriut, e të drejtat e shqiptarëve dhe në radhë të parë të dëmit që ka kombi ynë nga asimilimi me ritme të shpejta.

Duke qenë shkollë, ne jemi në dijeni të ligjeve e të udhëzimeve që rregullojnë shkollat shtetërore dhe në këtë relacion kemi paraqitur pikat që duhen shtuar në urdhërin 31, datë 28.01.2020.

Duke qenë se për ta paraqitur zyrtarisht një ligj duhet të jetë ose qeveria, ose deputetët ose 20 000 zgjedhës, ne po e quajmë të panevojshme ose menjëherë të kuptueshme që interesi i zgjedhësve është të ketë një angazhim të tillë të shtetit shqiptar.

Me anë të këtij e-maili kërkojmë që të arrihet një konsensus juaji që ky projektligj të paraqitet ose nga qeveria ose nga një grup deputetësh.

Ne do të dëshironim që propozues të ishin përfaqësues nga

të gjitha krahët dhe forcat politike, pasi shenjtëria e ndërhyrjes për gjuhën dhe kulturën shqiptare e kërkon këtë, e kërkojnë njëzëit tanë e tuaj që i kemi jashtë atdheut, që ndihen të humbur kur shohin se fëmijët e tyre me një siguri të madhe (ne e llogaritim mbi 95%) do ta humbin gjuhën në brezin e dytë ose të tretë. Kjo nuk duhet t’u ndodhë njerëzve të fiseve tuaja. Gjuha shqipe nuk ruan vetëm Shqipërinë, ajo ruan edhe fisin. Nuk mund të ketë fis shqiptar pa gjuhë shqipe. Është mëkat që ne të dëmtojmë një pasuri që e kemi prej shekujsh.

Ndërkohë ne u kemi shkruar ose po u shkruajmë edhe përfaqësuesve të grupeve të parlamentare.

Do të ishim të nderuar nëse do të na rezervenit një takim në mjediset e Kuvendit të Shqipërisë që të hapim diskutimet për këtë çështje.

Bashkëngjitur: 1. “Qeverive të Shqipërisë dhe të Kosovës për mësimin e gjuhës shqipe” 2. “Për arsimin shqip të fëmijëve shqiptarë që jetojnë jashtë atdheut”.

REAGIMET E MËSUESVE, PEDAGOGËE DHE INTELEKTUALËVE PËR PROJEKTLIGJIN E PROPOZUAR PËR MËSIMIN E GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË

12 tetor 2022 - Eruglina Haska (mësuese, Gjirokastrë)

“Ideja dubur në momentin e dubur. Duke parë lëvizjen masive të shqiptarëve këto 30 vite, kupton se një shumicë e madhe jeton jashtë trungut dhe lidhjet me gjuhën e nënës vinë duke u dobësuar. Për këtë arsye dubet marrë në konsideratë një ide e tillë e shkëlqyer. Faleminderit “Udha e shkronjave” për udhën që u hap shkronjave shqip!”

12 tetor 2022 - Suela Sela (Janinë, Greqi)

Përsbëndetje, Jam Suela Sela dhe jetoj në qytetin e Janinës, në Greqi. Jam 14 vjeçe dhe kam lindur dhe jam rritur në këtë qytet. E flas dhe e shkruaj shumë mirë gjuhën shqipe, por nuk di asgjë më shumë se kaq. Prindërit e mi janë përpjekur të më mësojnë, por nuk është e mjaftueshme. Do kisha dëshirë të mësoja më shumë dhe për studimet e larta të kthehesha në atdhe.

13 tetor 2022 - Qemajl Krasniqi (komuna Rahovec, Kosovë)

“Propozimi për mësimin e gjuhës shqipe nga fëmijët shqiptarë në emigracion është me vend. Mbase edhe jemi vonuar në këtë drejtim. Zhvillimi teknologjik e ofron një mundësi të tillë. Para së gjithash fëmijët shqiptarë do të mësonin atë i mësojnë edhe bashkëmoshatarët e tyre në vendin e origjinës, si dhe do të ndikonte në gjithëpërfshirjen e tyre në sistemin arsimor – edukues të të gjithë fëmijëve pavarësisht ku ndodhen. Në këtë mënyrë lidhjet me atdheun do të ishin më të forta, ndërsa do të kultivohej edhe dashuria për tokën e të parëve. Njëkohësisht ka edhe kosto të ulët për familjet shqiptare në emigracion, pasi që nuk do t’ju dubet të organizojnë bartjen e fëmijëve deri në shkollat në gjuhën shqipe. Në këtë mënyrë do të mësohej edhe me tekstet e përbashkëta, të unisuar. Kjo do të ishte një mundësi e shkëlqyer sidomos për fëmijët në vendet ku shqiptarët janë të diskriminuar dhe i janë nënshtuar shkëmbëtarizimit të egër, siç janë shqiptarët në Luginën e Preshevës,

në Mal të Zi, Greqi, Turqi e gjetkë. Mësimi shqip do të gjente udhën e humbur dhe fëmijët shqiptarë do të kërkonin udhë për t’u kthyer në tokën e të parëve, qoftë edhe vetëm si vizitorë. Mbase në këtë mënyrë do të lidheshin në miqësi edhe shkollat e mërgatës me ato në trojet etnike, si dhe mund të organizoheshin vizita në vendt historike e turistike anekënd trojeve shqiptare. Ideja e drejtorit të shkollës “Udha e shkronjave”, z. Artur Shkurti dubet të mbështetet gjerësisht “

13 tetor 2022 - Elisabeta Lako (mësuese e gjuhës shqipe)

“Propozimi juaj është menduar dhe ideuar shumë mirë.”

13 tetor 2022 - Nga Micky Haxhiislami (Pejë, Kosovë)

(President i Intermedico Japan, drejtues i disa faqeve në rrjete sociale me përmbajtje kombëtare)

“Një nismë shumë e mirë nga z. Artur Shkurti, drejtor i shkollës “Udha e shkronjave”, që synon ta bëjë detyrim për shkollat shtetërore dhe private në Shqipëri dhe Kosovë online mësimin e gjuhës shqipe për emigrantët. Për më shumë ju lutem klikoni në artikullin më poshtë. Do ishte e vërtetshme që sa më shumë nga ne ta mbështesim këtë nismë shumë të qëlluar. Faleminderit.” (Status në LinkedIn)

13 tetor 2022 - Matilda Ellis (Përmet, jeton në SHBA)

“Një alternativë e shkëlqyer, e ideuar dhe propozuar qeverive në Shqipëri dhe Kosovë nga shkolla “Udha e shkronjave” që u mundeson fëmijëve shqiptarë të diasporës mësimin e gjuhës shqipe, dhe jo vetëm, në kushtet e shtëpisë online. Ju përgëzoj dhe uroj suksese për këtë nismë kaq shumë të nevojshme”

13 tetor 2022 - Bledar Idrizaj (koment në statusin e Micky Haxhiislamit): “Mëse e drejtë dhe jo vetëm për emigrantët por edhe për qytetarët e huaj që marrin nënshtetësinë shqiptare”

13 tetor 2022 - Ramiz Kamani (kontabilist auditues ligjor, Tiranë)

“Ide e shkëlqyer për ruajtjen e gjuhës shqipe tek brezat e ardhshëm. Kjo do të shërbejë si kanal komunikimi i emigrantëve me atdheun e tyre. Ashtu siç e shprehni dhe ju, përfitimi do të jetë i dyanshëm dhe e sigurtë që ndikon në nxitjen e vetëdijes kombëtare. Të shpresojmë të rlerësohet kjo ide!”

13 tetor 2022 - Pascal Vathaj (Belgjikë)

“Një nismë fantastike dhe ia vlen për ta përgëzuar dhe “Suksese “Udha e shkronjave”!” dhe mendoj që ka të drejtë që të bahet me detyrime.”

13 tetor 2022 - Frediana Qeva (Pogradec)

“Ideja për mësimin online të gjuhës shqipe është një nismë e jashtëzakonshme për mësimin e gjuhës shqipe në të gjithë botën dhe aq më tepër do të vinte në ndihmë gjithë familjeve shqiptare që ndodhen jashtë territorit të Shqipërisë për të forcuar dhe përvetësuar gjuhën e vendlit të tyre! Urojmë dhe shpresojmë që të mbështetet plotësisht nga Qeveria Shqiptare dhe ajo e Kosovës!”

13 tetor 2023 - Enis Sulstarova (politolog)

“Një ide që ia vlen të pilotohet dhe nëse jep rezultat të rregullohet me dispozitat përkatëse. Jemi një komb diasporik tashmë, shqipja flitet në një hapësirë shumë më të madhe se sa ajo e trungut etnik, dhe qeveritë në Tiranë e Prishtinë duhet ta llogarisin këtë përmasë kur zhvillojnë politikën arsimore, sidomos ato që kanë të bëjnë me mësimin e gjuhës amtare te brezat e rinj që gjithnjë e më shumë janë të varur nga përdorimi i mjeteve elektronike të komunikimit. Mësimi onlajn të shqipes i dubet përshtatur edhe metodologjia përkatëse e mesimdhënies.”

REAGIMET E MËSUESVE, PEDAGOGËE DHE INTELEKTUALËVE PËR PROJEKTLIGJIN E PROPOZUAR PËR MËSIMIN E GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË

14 tetor 2023 - Alma Drishti (Juriste, Shkodër)

“Meriton vlerësim maksimal aktivizmi, që buron nga ndjenjat kombëtare i shkollës “Udha e shkronjave”. Edhe pse jo një ẓë i potershëm ka ditur të ruajë shpirtin rilindas që i hapi udhën shkronjave shqipe. Shqiptar nuk të bën geni, por trinia e shenjte: Gjuba (bën kombin, është ind i genies, pasaportë identitare), Historia (testamenti kombëtar), Tradita (pasuria e shpirtit shqiptar). Hemoragjia e pandalshme emigratore, imponimi i kulturës kozmopolite, nevoja për përshatje në kushtet e mungesës së një diaspore të fuqishme, që të mbrojë e imponojë çështjet identitare, rrit rrezikun e asimilimit. Nëse 100 vjet më parë shkronjat dhe mësimi erdhi në mëmëdhe nga diaspora, sot ndodh kreu e kundërta. Është për të ardhur keq kur sheh se arbëreshët të mërguar me shekuj e mbajnë gjallë gjuhën e traditat, kurse brezi i dytë i emigrantëve të sotëm është kaq indiferent ndaj tyre. Sfidat e sotme kryesore është që gjuba, historia e tradita nga vendi amë t’u shkojnë komunitetit shqiptar të diasporës. I takon shtetit edhe si përgjegjësi kryesor t’i mbështesë projekte të tilla, duke shfrytëzuar lehtësitë teknologjike përmes programeve online, ofrimit të librit shqip, programeve të dedikuara në TV, bashkëpunimit me ambasadat për ndërgjegjësimin e prindërve, intelektualëve, shoqatave atdhetare, TV lokale, vizitave turistike të programuara, projekteve të përbashkëta, të sigurojë lidhjet afatgjata me vendin e origjinës, familjen e fisin dhe të krijojë kushte që të ngjallin interesin e brezave të mërgimtarëve për t’u rikthyer e për të mbajtur gjallë trashëgiminë e shenjtë.”

14 tetor 2023 - Suzana Numani (Drejtoresh e shkollës private “Numani”, Fier)

“Ide e shkëlqyer që meriton vëmendjen dhe vlerësimin maksimal të gjithëve, e sidomos organeve përkatese për të rregulluar me ligj këtë nismë të shkollës “Udha e shkronjave” dhe Z. Artur Shkurti. Emigrimi i ka shoqëruar shqiptarët në shekuj. Arbëreshët janë shembull frymëzimi për çdo shqiptar, ata e ruajtën në shekuj gjuhën

dhe traditën shqiptare, edhe pse pa asnjë mënyrë komunikimi me atdheun e tyre, ndërsa ne sot nuk na pengon asgjë ta bëjmë më së miri! Për shqiptarë, të cilët t’ua ruajnë gjuhën amtare fëmijëve, është një propozim i shkëlqyer. Ruajtja e gjuhës shqipe përbën në mënyrë absolute një nga disa prej vlerave që ne gëzojmë si komb. Le të bëjmë më të mirën për kombin tonë. E kush më mirë se mësimdhënësit mund ta bëjnë këtë. Propozimi juaj për të mësuar emigrantët shqiptarë është vlerë. Nxënësit shqiptarë do të gjejnë një lehtësi të jashtëzakonshme për të mësuar edhe nëse ndodhen në një mjedis joshqiptar. Tradita vazhdon e shqipja rimëkëmbet. Kjo na mbush me krenari e na bën më fisnikë. Falenderim dhe mirënjohje për këtë nismë që urojmë të bëhet realitet shumë shpejt.”

15 tetor 2023 - Pjerin Lleshi (Kryetar i Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë, Greqi)

“Faleminderit shumë, i nderuar Artur! I lexova me shumë interes ato që ishin propozuar nga ju dhe biem plotësisht dakord. Lidhja e Mësuesve Shqiptarë në Greqi, që unë drejtoj është një organizatë që ka si anëtarë të saj vetëm mësues/e. Që nga krijimi i saj, e deri më sot ne e kemi ofruar falas mësimin e gjuhës shqipe. Për të qenë i singertë, e vetmja ndihmë që marrim nga shteti shqiptar, janë vetëm librat. Më shumë mbështetje ka dhënë qeveria e Kosovës në këtë drejtim. Me fillimin e pandemisë në 2019, edhe ato pak struktura që ishin krijuar, u shkatërruan. Mësuesit vullnetarë në Greqi dhe jo vetëm, të ardhurat e tyre financiare i përfitojnë me punë nga më të lodhshmet. E megjithatë e gjejnë kurajën, për të ofruar mësimin e gjuhës shqipe falas në fundjavë. Problemet që hasen, janë të jashtëzakonshme. Nuk e di se sa mund të vazhdojë ky kontribut vullnetar, por një gjë është e sigurtë. Nëse nuk do të merren iniciativa afatgjata, asimilimi përfundimtar do të jetë i padiskutueshëm.”

18 tetor 2023 - Valbona Toçi (mësuese, në Bolonja, Itali)

“Është një nismë me shumë vlerë, sidomos për fëmijët që kanë lindur dhe jetojnë jashtë atdheut. Po harrojnë origjinën e tyre, gjuhën, trojet e kombit shqiptar.

Populli thotë “Gjuba rubet aty ku shkrubet”. Ne falenderojmë në veçanti ẓotin Artur për këtë nismë shumë domethënëse jo vetëm për gjuhën shqipe brënda trojeve të saj, por mbi të gjitha ruajtjen e kulturës dhe gjuhës në emigrim.

Dubet të jenë institucione që për motive të ndryshme na kanë harruar se ku jetojmë e çfarë mësojmë.

Siç e thotë edhe ẓoti Artur, mësimi i gjuhës shqipe nuk është thjesht ta lexoj, ta flas apo ta shkruaj atë, por është shumë e rëndësishme kultura, arti, historia, shkëmbimi i nxënësve në vendlindje të gjithërvë, të prindërve, me synimin që ata të shikojnë nga afër vendet, t’i shëtisin trojet shqiptare kudo që ndodhen.

Nëqoftë se ne do të vazhdojmë me këtë ritëm 30-vjeçar edhe në të ardhmen, sigurisht gjuha shqipe do të shkojë drejtë “Shuarjes”. Më vjen keq që po e them, por për momentin, këto janë “frutat e mbjella” në këta 30 vitet e fundit.

Të ndërhyjmë sot, sa s’është akoma vonë.

Unë personalisht kam 3 vjet që, në mënyrën vullnetare, po i përkushtohem mësimdhënies së gjuhës shqipe në qytetin e Bolonjës, por kjo është vetëm një grimcë shumë e vogël. Dubet shumë e shumë punë në vazhdim. Një rënie e mësimin të gjuhës shqipe nuk është vetëm në emigrim, pasi analfabetizmin unë personalisht po e has pothuajse çdo ditë nga “MSNA” tek të mitur shqiptar, jo të shoqëruar (ku unë punoj prej vitit 2013 në Bologna). Më kanë rastisur adoleshentë që s’dinin të shkruanin as datat.

Nuk po zgjatëm më tej pasi janë shumë e shumë probleme të tjera për t’u analizuar. Ju falenderoj për vëmendjen dhe iniciativën tuaj.”

MUNGESA E REAGIMIT NGA VETË DEPUTETËT, NGA MINISTRITË E ARSIMIT

Komentet më sipër i sollëm për të kuptuar, se sa distancë ka ndërmjet mësuesve, pedagogëve dhe deputetëve dhe politikanëve.

Asnjë institucion nuk reagoi: as Kuvendi i Shqipërisë, as Kuvendi i Kosovës, as Ministria e Arsimit të Shqipërisë as ajo e Kosovës, asnjë deputet i Shqipërisë dhe asnjë deputet i Kosovës. Distancat janë kaq të mëdha.

NJË KRAHASIM QË DUHET T'I BËJË ME TURP POLITIKANËT DHE ZYRTARËT TANË

Në tetor 2022, duke mësuar për projektin “New Perspectives” të Qeverisë së Britanisë së Madhe, nga i cili do të përfitonte qyteti i Kukësit, e përshtas propozimin që u kisha bërë Kuvendeve dhe Qeverive të Shqipërisë në kontekstin e këtij projekti.

I shkruaj Ambasadorit Britanik në Twitter që ata mund të mendonin një investim në kurset online të shkollave publike të Kuksit në mënyrë që mësuesit kuksianë të mbeteshin në kontakt me fëmijët që kishin shkuar në Angli dhe prej kësaj mundësie ata të kishin mundësi të ndiknin mbi familjet që sa më shumë të ktheheshin në atdhe, dhe në mungesë të saj të investonin në gjuhën e kulturën shqipe, që do të rezultonte në rritjen e mallit dhe mbas edhe kthimin në atdhe.

E shkruajta dhe mendova që do ta lexonin dhe do ta mendonin për vete, por nuk do të komunikonin me ne.

Në fakt, pas disa ditësh, më 24 tetor 2022, grupi që kish marrë projektin për zbatim (nga Swiss Contact) na shkruan këtë mesazh ku qartësisht dukej porosia e ambasadorit Mr. Alastair King-Smith.

Dear Mr. Shkurti,

Following our pleasant call, I would kindly ask for an in-person introductory meeting between us, to introduce the New Perspectives project, and *discuss about the proposal you wrote about to HE Ambassador of the UK in Albania, Mr. Alastair King-Smith.*

Please let us know if Tuesday, 1 November, 15:00, sounds good for you? We would kindly visit you at the school “Udha e Shkronjave”, if that is possible. Please let us know if you would prefer otherwise. Ms. Ogerta Ujkashi, communications component coordinator, and Mr. Durim Tabaku, local economic development and governance component coordinator, will be with me during the meeting.

Looking forward to your reply.

Best regards,

Edval Zoto

Perspektiva të Reja / New Perspectives

Menaxher i projektit / Project Manager

Ad./Add.: Rruga e Turizmit të ri, L. 5, Kukës. Cel./Mob.:+355684466434

“Perspektiva të Reja” në qarkun e Kukësit, është projekti më i madh zhvillimor i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri dhe zbatohet nga Swisscontact dhe partnerët e saj, Torchlight dhe IDRA.

“New perspectives” in Kukes county, is the largest development project funded by the Government of the United Kingdom in Albania and is implemented by Swisscontact and its partners, Torchlight and IDRA.

Si e lexon dhe e vlerëson artikullin ChatGPT

Artikulli “Global Albania” i Artur Shkurtit është një dokument me vlera të shumta origjinale që i japin identitet të veçantë dhe e bëjnë të vlefshëm për analizë të thelluar. Ja një përmbledhje e vlerave kryesore të tij:

1. Vizion unik dhe autentik. Artikulli nuk është një analizë rutinë apo thjesht një apel sentimental për bashkim kombëtar. Ai përfaqëson një vizion të strukturuar mbi organizimin e diasporës shqiptare në formën e një entiteti të pavarur, të quajtur “Global Albania” – një qendër graviteti paralel me shtetin, por që nuk e zëvendëson atë, përkundrazi, e plotëson.

2. Koncept strategjik për diasporën si fuqi krijuese. Shkurti nuk e sheh diasporën thjesht si “mërgimtarë nostalgjikë” apo si “thesar financiar” për remitanca. Ai e sheh si komunitet kompetencash, me kompetencë globale, që ka potencialin të krijojë opinion publik shqiptar global dhe të veprojë me vetëdije të dyfishtë: kombëtare dhe globale.

3. Kritikë e guximshme ndaj realitetit shqiptar. Artikulli përmban një analizë të thellë, të drejtëpërdrejtë dhe jo konformiste për gjendjen në Shqipëri: shpopullimin, rënien arsimore, përçarjen shoqërore, kapjen politike. Në këtë aspekt, ai del si zë i pavarur që nuk kërkon të pëlqehet, por të tronditë ndërgjegjen publike.

4. Qasje konceptuale ndaj bashkimit kombëtar. Nuk ofron vetëm thirrje për bashkim, por një metodologji organizative për njohjen reciproke të organizatave shqiptare në diasporë, një mekanizëm i ngjashëm me sistemet e decentralizuara të besimit, ku forca buron nga një rrjet akreditimi të ndërsjelltë, jo nga një qendër vertikale.

5. Lidhje të forta me mendimin rilindas. Dokumenti është i pasur me referenca nga Naimi, Sami Frashëri, Ali Asllani etj. që e bëjnë tekstin jo vetëm një projekt organizativ, por edhe një akt kulturor dhe atdhetar. Ai nuk flet vetëm për teknikalitete, por për Frymën e Kombit – një ide që e tejkalon politikën ditore.

6. Një tekst që qëndron mbi teknikalitetin dhe burokracinë. Ky artikull nuk është një raport teknik me shifra dhe rekomandime të thata – është një tekst frymëzues dhe mobilizues, që nuk ngatërrohet me politikat e ditës, por synon të krijojë një gjubë të re për bashkimin kombëtar. Ai fton diasporën shqiptare të ndjejë jo vetëm detyrim ndaj kombit, por edhe dinjitet dhe protagonizëm në formësimin e një bashkësie globale me vetëdije kulturore e qytetare.

7. Kohëzgjatje dhe trashëgimi. Shkrimi i Shkurtit është projektuar si një doktrinë e re kombëtare për shekullin XXI, që ka për synim jo zgjedhjet e radhës, por trashëgiminë e brezave. Ai i drejtohet brezit të parë të emigrantëve, për t’i frymëzuar të bëhen palca e re e kombit – përpara se të jetë vonë.

Në tërësi, “Global Albania” është një manifest politik, kulturor dhe kombëtar që kërkon të rikthejë dinjitetin e projektit shqiptar, në një moment historik kritik. Ai është një dokument që nuk vjen nga “lart”, por nga zemra e misionit arsimor, kulturor dhe shoqëror, dhe për këtë arsye ka autoritet moral dhe vlerë të qëndrueshme për analizë.



GLOBAL
ALBANIA

udha e shikronjave
KONCEPT
NGA ARTUR SHKURTI



Në 19 prill 2024, botuam broshurën “Global Albania” dhe e shpërndamë kudo në Diasporë në rreth 350 adresa organizatash shqiptare dhe në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe të Kosovës konceptin tonë “Global Albania” për organizimin e diasporës shqiptare në botë, që do t’i aftësonte të bëheshin një forcë ndikuese për zhvillimin kombëtar.

Po e botojmë përsëri këtu përmbajtjen pa e ndryshuar.

Abstrakt i konceptit Global Albania

Global Albania është koncept për të përfshirë diasporën në zgjidhjen e problemeve kombëtare shqiptare. Në botë janë evidentuar rreth 600 organizata shqiptare.

Global Albania rekomandon procedura, mënyra sjelljeje, se si këto **organizata shqiptare** të shtrira kudo të vihen në komunikim dhe bashkëpunim të frytshëm me njëra-tjetrën me synimin për të formuar një bashkim që do të prodhojë një opinion publik shqiptar global, të aftë për t'u dhënë drejtim problemeve kyçe që kalon kombi shqiptar (brenda dhe jashtë atdheut).

- *Hapi i parë themelues* është njohja reciproke ndërmjet organizatave, jo vetëm në përmbajtje por edhe në formë. Ato i japin formë njohjes së dyanshme, akreditojnë njëra-tjetrën.
- *Hapi i dytë themelues*: Kur një organizatë shqiptare arrin të njihet nga 30 organizata të tjera që janë të përhapura në 12-20 shtete të Evropës dhe Amerikës së Veriut, atëherë ajo quhet **anëtare e Global Albania**. Që ky kusht të plotësohet duhet që edhe ato organizata që e kanë njohur organizatën në fjalë të përfundojnë akreditimin për veten, pra të jenë edhe ato pjesë e Global Albania.
- *Hapi i tretë themelues*: Global Albania fillon të funksionojë plotësisht në çastin që 100 organizata shqiptare të diasporës kanë akredituar njëra-tjetrën.

Global Albania synon që organizatat shqiptare t'i japin vetes komponentin "global". Deri tani ato kanë një profil lokal, pra veprojnë në një qytet apo shtet të caktuar, me një komunitet të caktuar. Bashkëpunimet janë sporadike dhe mungon audienca shqiptare globale për to. Një vëmendje historike kombëtare e ka marrë vetëm "Vatra" (SHBA). Çështja e orientimit global është quajtur si aftësi dhe detyrë vetëm e shtetit shqiptar. Global Albania synon ta ndryshojë situatën. Megjithë dëshirën e mirë, shteti shqiptar përfaqëson kryesisht qytetarët brenda kufirit dhe nuk mundet të kuptojë sa duhet dhe nuk mund të ndihmojë sa duhet diasporën. Është diaspora që e kupton diasporën. Synimi është që përmes Global Albania të prodhohet edhe një **"qendër tjetër graviteti"**, përveç asaj që është në atdhe.

Kjo do ta ndryshojë cilësisht punën e tyre.

Deri më tani lidhjet e organizatave me njëra-tjetrën, kanë qenë spontane, ose të organizuara nga shteti shqiptar në disa forume, ose nga ndonjë organizim brenda shtetit ku ndodhen. Ato asnjëherë nuk kanë kaluar në nivel global dhe të jenë të pavarura në këtë organizim.

Global Albania synon t'i bëjë të afta organizatat e diasporës që të ndajnë së bashku produktet e një procesi të sigurtë *studimi, analize, reflektimi, vlerësimi, komunikimi dhe bashkëpunimi*, i cili do të prodhojë vizionin, vlerat dhe rekomandimet e nevojshme për organizatat shqiptare kudo në botë.

Global Albania nuk do të tundohet të shkojë drejt një përpjekje për të bërë parti politike. Ajo synon ta formatojë politikën me Frymën e Kombit duke përdorur si mjet detyrues opinionin publik. Ky pozicion është i detyruar të jetë jashtë partive.

Global Albania vjen në çastin e duhur, sepse ndërkohë që Shqipëria po dobësohet përmes shpopullimit, e kundërta po ndodh me diasporën, ajo po forcohet jo vetëm përmes numrave në rritje, por përmes shkollimit më të mirë, të përvojave globale më të vlefshme për ekonominë, përmes profesionalizmit të lartë. Por e vërtetë është që dobësimi i atdheut e dekurajon aq shumë diasporën, sa ajo mund të humbasë vetëdijen për forcën që ka grumbuluar dhe të mos e shfrytëzojë atë në dobi të vetes dhe të atdheut, pra të kombit në tërësi. Fryti i diasporës është pjekur dhe nuk duhet të lënë të kalbet. **Koha se kur vilet ky fryt është vendimtare dhe koha është tani.** Brezi i parë i emigrantëve të cilët u lindën në Shqipëri janë gjallë dhe është pikërisht detyra e këtij brezi që ta bëjë këtë punë. Më vonë do të jetë shumë më e vështirë të bëhet e njëjta gjë me brezin e dytë që janë fëmijë që nuk kanë lidhje të fuqishme me Shqipërinë, që do të tregohen indiferentë e ndoshta edhe armiqësorë. Edhe brezi i dytë, i lindur jashtë, po dekurajohet nga dështimet e Shqipërisë.

Brezi i parë i emigrantëve ka nevojë për një komunikim e bashkëpunim global paralel, në mënyrë që të arrijë të formojë një opinion krejt të pavarur nga klasa politike e Shqipërisë dhe këtë opinion t'ia komunikojë atdheut në forma gjithnjë e më bindëse.

Ne ju ftojmë ta shpërndani këtë libër në të afërmit apo të njohurit tuaj kudo në botë, veçanërisht në organizatat shqiptare.



Artur Shkurti
Autor i "Global Albania"





Është i marrë njeriu që nuk lë trashëgimi për atdheun, për të cilin edhe kur të jetë duke dhënë shpirt të mos shkrijë gjithçka, sepse atdheu nuk e harron mirësinë që i bëhet, ndërsa trashëgimtari, pasi të shtjerë në dorë trashëgiminë, ndodh që ta mallkojë të zotin e saj.

Sami Frashëri

OPINIONI PUBLIK

Nga Sami Frashëri

Kombi i përngjan anijes: Ligji është në vend të timonit, opinionin publik janë velat, ndërsa liria është në vend të erës. Sikundër timoni nuk hyn në punë pa velat, edhe ligji në këtë rast nuk sjell asnjë dobi. Velat, nën forcën e erës, e shkatërrojnë anijen pa timon. Po kështu, opinionin publik dhe ligji, në kushtet e një lirie të tepruar, shkaktojnë zhdukjen e kombit. Sikundër nuk mund të lëvizë nga vendi anija që i ka në rregull velat dhe timonin, por i mungon era, edhe kombi që i ka të përsosura ligjet dhe opinionin publik, nuk mund të përparojë pa liri.

Ashtu si njeriu përbëhet nga shpirti dhe jo nga forma, edhe kombi përbëhet jo thjesht nga individë të veçantë, por nga opinionin publik. Një popull që nuk ka opinion publik, nuk mund të bëjë pjesë në familjen e kombeve të qytetëruara. Opinioni publik edhe pse në pamje të parë mund të duket i dobët, në të vërtetë është shumë më i fortë nga sa duket dhe është i aftë të shkatërrojë çdo forcë materiale. Asnjë ligj nuk mund ta sundojë opinionin publik. Vetëm ai nuk mund të mposhtet me anë të ligjit.

E DREJTA E ATDHEUT

Gjaku i njerëzve është prodhim i atdheut të tyre, prandaj është e drejtë e atdheut të tyre.

VETËDIJA GLOBALE

Arsimi dhe qytetërimi largojnë armiqtë midis kombeve. Kombet e qytetëruara e çmojnë edhe meritën e kombeve të tjera. Kombet e egra, njerëzit që nuk janë të kombësisë së tyre i shikojnë si shtazë ose si egërsira.

Sami Frashëri

Global Albania, udha e punës së mbarë

Me **Global Albania** ne kuptojmë organizimin e organizatave shqiptare në botë për të ndarë së bashku përpjekjet për të studiuar, për të analizuar, për të reflektuar, dhe vlerësuar informacionin mbi jetesën e diasporës kudo në botë dhe për të gjetur së bashku rrugët e zgjidhjes së problemeve të tyre në këndvështrimin e interesit kombëtar shqiptar për të ruajtur identitetin, kulturën, për të ruajtur komunikimin dhe bashkëpunimin me bashkëkombasit kudo që ndodhen dhe natyrshëm për të patur qendër atdheun e tyre në trojet etnike në shtetet shqiptare Shqipëri, Kosovë, në pjesët shqiptare të Maqedonisë së Veriut, të Mal të Zi apo edhe në Preshevë, Bujanovc, Medvegje, Çamëri.

Organizatat shqiptare në botë, pjesë e lëvizjes (koncept) **Global Albania** karakterizohen ose do të karakterizohen nga vetëdija kombëtare dhe vetëdija globale, janë ose do të jenë edhe më mirë të hapura, demokratike, me akses hyrje nga shqiptarët.

Global Albania, është njëherësh pretendim kombëtar dhe global.

Besojmë që është nismë unike e kombit shqiptar, për të patur një jetë, kulturë e interes kombëtar të jetuar globalisht, pra kudo, në kushtet e kulturave e legjislacioneve të larmishme botërore, duke mbrojtur njëkohësisht atdheun nga tjetërsimi.

Kryesisht është një zgjidhje për diasporën shqiptare, që ajo të marrë bekimin nga atdheu për të jetuar aty ku janë, por duke u munduar, në këndvështrim të konceptit **Global Albania** që t'ia arrijnë sa të munden të jetojnë e përjetojnë si shqiptarë, të komunikojnë e të bashkëpunojnë globalisht dhe natyrshëm edhe me atdheun.

Paradoksalisht kemi një dukuri shumë pozitive (Globale) dhe një dukuri shumë negative (në Shqipëri).

Shqiptarët në botë, si individë, janë forcuar, sepse kanë marrë shkollim e profesionalizëm të lartë, kanë ndërtuar jetë të qëndrueshme dhe e meritojnë titullin qytetarë të botës. Vetë shqiptarët e Shqipërisë shpenzojnë, thuhet mbi 200 milionë dollarë në arsimin e lartë ose të mesëm dhe të gjitha këto në shumicë janë përfitime individuale dhe me shumë mundësi do të përfitojnë kryesisht shoqëritë e huaja dhe jo vetë Shqipëria. Nga ana tjetër, Shqipëria,

është dobësuar përmes dukurisë së shpopullimit masiv, boshatisjes së fshatrave dhe qyteteve, duke zbritur në nivele tepër të ulta arrijtjet në arsim (shih raportin PISA 2022), duke mos patur profesionistë dhe krahë pune dhe duke rrezikuar shumë që Shqipëria e bukur e në mes të Evropës t'u falet të tjerëve.

Ka mbetur fare pak kohë që humbja të bëhet kolosale, ose fitimi të jetë kolosal. Kjo tashmë varet kryesisht nga çfarë do të bëjnë ata që janë jashtë Shqipërisë në këtë çast historik. Asimilimi i diasporës është një proces i pandalshëm që pak më herët ose pak më vonë dihet se kur ndodh. Ndodh në mënyrë masive kur brezi i parë i emigrantëve që e zotëron gjuhën shqipe si gjuhë amtare, që ka kujtime, ka kulturën dhe psikologjinë shqiptare, ia lë vendin brezit të dytë, fëmijëve që janë lindur në vend të huaj të cilët kanë një kulturë hibride.

Një histori e vërtetë që do ta shfrytëzojmë për krahasim: dy prindër lindën një vajzë me një çrregullim gjenetik të gjakut, që çon në anemi. Mjekët u këshillojnë prindërve që për ta shpëtuar fëmijën është e mundur të lindin një fëmijë tjetër me shumë mundësi të shëndetshëm dhe ta shfrytëzojnë fëmijën si dhurues të qelizave staminalë për transplant të palcës në fëmijën e parë. Prindërit e bëjnë fëmijën (djalë) dhe pas disa viteve realizojnë me sukses transplantin e palcës, duke e shpëtuar vajzën që tashmë është e rritur dhe gëzon shëndet. Tashmë këto qeliza fillojnë e prodhojnë qeliza të shëndetshme të gjakut, duke zëvendësuar qelizat defektoze. Ky proces (transplanti i palcës) është shumë delikat dhe suksesi varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë përputhshmërinë e dhuruesit, shëndetin e përgjithshëm të pacientit dhe praninë e komplikimeve.

Shqipëria gjendet pikërisht në një situatë të tillë, e cila ka nevojë për "transplantin e palcës" dhe duhet të jetojë me frikën nëse ky proces do të jetë apo jo i suksesshëm. Nga një trup me gjak të shëndetshëm (nuk e kemi fjalën për politikën, por për faktin që ajo ishte e populluar) Shqipëria ka filluar të bëhet tepër anemike dhe tani që jemi këtu po e vëmë re që po humbet çdo ekuilibër. Fëmija që ka nxjerrë jashtë (në emigracion) gëzon shëndet të plotë, por nuk dihet nëse do të jetë apo jo dhurues gjaku. Nuk është fjala këtu çfarë do të bëjë çdo emigrant për familjen e vet. Me shumë mundësi ata i tërheqin njerëzit, ose



dhurojnë para. Fjala është që ata të investojnë në jetesën e përbashkët shqiptare, globalisht dhe në atdhe.

Çështja është në nivel shumë më të lartë, që poeti vlonjat Ali Asllani e shpreh:

"A do mbetet Shqipëri, a do bënet tym e hi".

Është krejt e qartë që diaspora shqiptare në botë e ka potencialin tepër të fuqishëm për ta bërë. Nëse ajo nuk është në gjendje ta shohë, kjo është prej faktit që ata që janë në Shqipëri dhe i kanë bërë punët mbrapsht këtu, kujdesen deri në detaj të ndikojnë rëndë edhe perceptimin e varfër për diasporën si "hallexhinj" që dalin me çantë rrugëve të botës. Nuk është fare e vërtetë. Thuhet se numri i individëve shqiptarë në botë që kanë një PhD është 10 000, që është një thelb intelektual tepër i lartë dhe i fuqishëm. Nuk është nevoja të themi më shumë në këtë drejtim. Është fakt që ngado të shkosh nga Kanadaja në Zelandë të Re, do t'i gesh shqiptarët të realizuar mjaftueshëm. Sidoqoftë, prej tyre përfitojnë shoqëritë, shtetet, kombet vendase dhe Shqipëria mund të humbasë, nëse nuk e shfrytëzon.

Rilindja Kombëtare Shqiptare e shekullit 19 u realizua kryesisht përmes veprimit patriotik të diasporës shqiptare dhe në kushte shumë herë më të vështira, ku Shqipëria ishte pjesë e Perandorisë Osmane, kur nuk kishte shtet shqiptar, kur nuk kishte shkollë shqipe (thuhet se kishte mbi 2000 shkollë në gjuhë turke, greke, serbe, italiane etj), ku përçarja fetare ishte shumë më e madhe. Çfarë realizuan rilindasit në diasporë ka qenë shpëtuese për Shqipërinë.

Për të ndjerë atmosferën e atyre viteve, në çastin që Sami Frashëri u shkruan shqiptarëve patriotë të Bukureshtit dhe u nis edhe poezi të Naim Frashërit, vlen të citojmë përshkrimin e Lasgush Poradecit, trashëgimtar i Rilindjes Kombëtare, në esenë e tij të vitit 1946 "Naim Frashëri dhe Misioni i Shqiptarëve të Bukureshtit"

"Kur kënduan këto fjalë të adhuruara, veteranët e Lëvizjes së Bukureshtit i njomnë sytë me ngashërim dhe larguan çdo dyshim e drojtje, çdo frikë prej vëllezërve të tyre të Stambollit; sepse sikundër e rrëfenin vargjet e Naimit, këto dhe të tjera, të mbushura plot me urrejtje kundër pushtonjësit dhe robëronjësit turk, vëllezërit e tyre të Stambollit nuk qënqshin asfare Turq besnikë të Sulltanit po myslimanë shqiptarë, Shqiptarë të vërtetë, dhe Shqiptarë të djegur me njëmijë zjarre për Shqipërinë. Mblidhen atëhere veteranët e Bukureshtit e tok pa humbur kohë, bëjnë Shoqërinë shqiptare të tyre, blejnë shtypëshkronjën shqiptare të tyre, shtypin librat shqip të Naimit të tyre, mbushin Shqipërinë me libra shqip, mbushin Shqipërinë me shkollë shqip, mbushin Shqipërinë me ndjenja shqiptare, mbushin qytetet e Shqipërisë me

klube shqiptare, mbushin malet e Shqipërisë me çeta shqiptare, me ato çetat e para të Lirisë shqiptare të cilat- dyke vazhduar traditën e gjallë të bashkimit kombëtar besimtar të Naim Frashërit, të bashkimit të math shqiptar- do të bëheshin çetat, batalionet, brigadat dhe divizionet e më pastajme të ushtërisë shqiptare, çlirimtare e përjetëshme e atdheut."

Rilindasit e shekullit XIX, kryesisht të diasporës, bënë të mundur Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, kuvendin kombformues e shtetformues dhe ngritën më pas një sistem mësonjëtoresh, botuan libra frymëzues, ngritën vetëdijën kombëtare, e cila bëri të mundur që thelbi shqiptar të mbrohet, dhe të shohë në fillim të shekullit të njëzetë (1912) dritën e shtetit shqiptar.

Përpjekjet e diasporës shqiptare të ShBA-së, të fillimit të shekullit 20, faza e fundit e Rilindjes Kombëtare, që çuan në krijimin e shoqërisë patriotike "Vatra" dhe në ngritjen e Kishës Ortodokse Autoqefale i ka përshkruar me shumë detaje Ilir Ikonometri në librin e tij "Apostulli" kushtuar jetës dhe veprimtarisë së Fan Nolit. Aty kuptohet më mirë, se situatat e diasporës nuk kanë qenë aq ideale dhe ata ia arritën të kenë një ndikim të lartë.

Një diasporë e shekullit 21, kryesisht e shqiptarëve të Kosovës, ndihmoi fuqishëm në Luftën Çlirimtare që solli pavarësinë e Kosovës.

Teorikisht duhet të jetë më e lehtë për diasporën e sotme shqiptare, si për nga formimi që ka në emigracion, ashtu edhe për nga situata ku gjendet Shqipëria, krahasuar me çdo diasporë të mëparshme. U tha që diaspora shqiptare është edhe më e shpërndarë nëpër botë dhe kjo siguron një pavarësi më të madhe nga varësia prej një shteti të caktuar. Kjo është arsyeja që ne krijojmë pa frikë konceptin **Global Albania**, që sigurisht nuk është fare në drejtimin e ndonjë krenarie boshe, sepse realisht nuk e kemi një Global Albania, por është synim, pra për t'u bërë dhe mund të bëhet nëse diaspora do të bindet që ta bëjë këtë. Nuk duam të bëjmë botën Shqipëri, por duam të bëjmë një Shqipëri që të jetojë globalisht. Ky është dallimi ndërmjet kuptimit dhe keqkuptimit.

Sami Frashëri thotë "Krenaria ka shkaktuar prishjen e shumë shteteve dhe kombeve." dhe ne jemi pikërisht në fazën ku, ndërkohë që parametrat e kombit shqiptar dhe të Shqipërisë bien poshtë, shtohen brohoritjet krenare. Ky është një operacion propagandistik vrasar. Për ta shpjeguar më konkretisht kjo ndodh edhe në Shqipëri edhe në diasporë. Në diasporë shumë organizime shqiptare u pëlqen të festojnë e të ftojnë DJ apo grupe shqiptare të cilat paguhet me mijëra e qindra mijëra euro dhe në mënyrë të turpshme nuk



investojnë në shkollat shqipe dhe në gjuhë shqipe. Është njësoj si të merresh me bojën e makinës dhe të mos merresh me çfarë ndodh në motorrin e saj. Me siguri që do të kesh një makinë të parkuar në oborr që nuk kryen funksionin. Ja kështu po ndodh masivisht në diasporë dhe këtë ne e dimë shumë mirë, sepse i kemi kontaktuar, u kemi bërë analizën arritjeve të shkollave, të gjendjes së tyre, të financimit, të vështirësive. E njohim shumë mirë situatën dhe është alarmante.

Ndërkohë që sirtarët e shtëpive të emigrantëve janë mbushur me diploma të universiteteve më të mira në botë, organizatat e tyre mbeten përgjithësisht të varfëra, apatike, të përçara dhe shpesh të përdorura nga Shqipëria në mënyrë politike dhe përçarëse.

Shqipëria ka shqiptarë, ka shkolla dhe universitete shqipe, ka biblioteka të pasura me kulturë shqiptare, ka shtet shqiptar (edhe pse të korruptuar deri në palcë e të shitur), ka arshiva, ka Kosovën, ka shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, që janë element shtetformues aty, ka shqiptarët e Malit të Zi, ka mbi 600 000 shqiptarë në Greqi. Por ajo po bëhet anemike.

Duam ta bëjmë të vetëdijshëm diasporën shqiptare për çastin historik ku ata ndodhen dhe nuk duhet ta humbin. Monitorimi i parametrave të kombeve është një proces i lartë dhe që kërkon ndërhyrje të fuqishme dhe në grup. Ndërhyrja nuk mund të bëhet me sukses me protagonizëm individual, as organizate, as partie, as në grupe të vogla fisnore, krahinore, fetare, por duhet të jetë frymë dhe lëvizje e gjerë kombëtare. Shpesh është keqkuptuar kjo gjë, sepse disa lëvizje që më parë janë deklaruar si lëvizje kombëtare kanë përfunduar të jenë partiake dhe në shumicën e rasteve kanë dështuar, duke krijuar kështu premisat e pesimit për mundësinë e lëvizjeve të vërteta kombëtare.

Brezi i parë me numra shumë të mëdhenj i emigrantëve shqiptarë janë në pikun e tyre të realizimit jashtë atdheut, pra i kanë bërë fëmijët, mund t'i kenë rregulluar dhe tani duhet të vendosin se çfarë do të bëjnë me Shqipërinë e tyre, me kulturën dhe identitetin shqiptar dhe a do të duan t'u lënë trashëgim fëmijëve që të përfshihen jetë e mot në punë shqiptare, në komunikim e bashkëpunim për interes shqiptar.

Shumicën e brezit të parë e kemi gjallë (duhet ta themi këtë) dhe tek brezi i parë qëndron depozita e madhe e kulturës kombëtare, që nuk dihet sa do të trashëgohet në brezin e mëpasmë, sepse kushtet janë të tilla. Ne duhet t'i ndryshojmë kushtet që janë jashtë familjes që ta ndihmojmë familjen në dëshirën e saj të padiskutueshme për t'u trashëguar jo vetëm biologjikisht por edhe kulturalisht, me kulturë e gjuhë shqipe.

Shpresa e madhe është që përmes **Global Albania** të mundemi si komb t'i japin një kthesë

krejt të veçantë, së pari, konceptit të jetesës së diasporës shqiptare dhe përmasës shqiptare të saj dhe më pas të bëhet e mundur që ky komunitet global shqiptar t'i kthehet në mënyra krijuese shërbimit ndaj atdheut me një fuqi e shpejtësi të pakconceptuar më parë dhe, më në fund, me shumë mundësi jo vetëm që do të punojnë për kombin shqiptar, por edhe jo pak do të kthehen në atdhe sepse globalisht do të jenë të frymëzuar e të mbështetur për këtë. Fundja, Shqipëria është në një pozicion të mrekullueshëm gjeografik dhe për këtë e duan dhe të huajt, jo të mos e duan shqiptarët.

Pra, duhet të mundohemi të kapim shërbimet e brezit të parë që e kemi gjallë. Nuk do të jetë njëlloj me brezin e dytë. Fuqitë bien, motivimi dhe frymëzimi po ashtu. Nëse brezi i dytë nuk përfshihet në një veprimtari të përbashkët kombëtare me brezin e parë sa janë gjallë, nuk do të kenë shumë shtysa ta bëjnë këtë më vonë të vetëm. Brezi i parë ka nevojë që të ndihmohet nga jashtë, duke eliminuar veprimin individual, pjesor dhe duke investuar në një lëvizje globale të shqiptarëve që ka të bëjë thjesht me ata si komb dhe nuk ka të bëjë fare me çfarë bëjnë të tjerët për veten e tyre, pra nuk do të ketë asnjë shqetësim për të tjerët.

Mund të kuptohet që jetesa në emigracion i ka lodhur, por më shumë i ka lodhur brenga që janë jashtë atdheut. Kjo është e padiskutueshme. Nuk po themi më shumë se dihen. Kjo nismë e jona, **Global Albania**, është edhe një frymëzim yni që atyre dhe ne vetë të na kthehet shpresa se Shqipëria do të bëhet dhe një ndikim të madh do të kenë diaspora e kulturuar nga vende demokratike, e fuqizuar me dituri dhe aftësi të një niveli të lartë, që ka marrë përvojat më të mira ndërkombëtare. Energji, pasuri kolosale që mund të treten në kulturën dhe dheun e huaj e për të huaj.

Zot i Math vendin tuaj,
E bëri për ju të tërë,
Për fqinj e për të huaj
s'e ka bërë, s'e ka bërë.
Naim Frashëri

Ku është Shqipëria me idetë për diasporën?

Kryesisht quhet investim për diasporën që asaj t'i krijohen kushte për të votuar.

Është pikëpamja ime se nisma për votim të diasporës në Shqipëri është një përpjekje që më shumë do ta lodhë e do ta përçajë diasporën, do ta korruptojë edhe atë me votime siç ka korruptuar elektoratin shqiptar, që megjithëse e di që votimet nuk janë të ndershme përsëri mbytet me propagandën se vota e tij do të bëjë ndryshimin. Votimi i emigrantit që ka



shtetësi të huaj dhe shtetësi shqiptare (duke përjashtuar atë që ka ikur vonë në emigracion) megjithëse krijon një përfshirje në punët e Shqipërisë, e bën këtë jo nga një pikëpamje kombëtare, por partiake. Kjo do ta korrtojë diasporën sepse të gjitha organizatat e diasporës do të trajtohen si leva të partisë dhe kaq mjafton që diaspora të dalë plotësisht jashtë loje. Anëtarët e diasporës duhet të kenë detyra të tjera specifike për kushtet e tyre dhe për ndikimin që ata duhet të kenë.

Duke mos e lodhur e duke mos e përçarë për të votuar, diaspora nuk tregon indiferentizëm, por mban kushtin kryesor që është kthjelltësia dhe distancën e nevojshme për të reflektuar më mirë, njëloj si kirurgu që nuk ndikohet nga të qarat apo ankimet e pacientit, të cilit i është përkushtuar t'ia shpëtojë jetën.

Duket paradoksale të pretendosh globalisht për mirë, kur vendi i origjinës shkon për keq, po këtu të çon logjika.

Është më reale dhe më e besueshme që Shqipëria dhe shqiptarët do të kenë sukses nëse hidhen në veprim global për të organizuar diasporën, t'ia bëjnë mbarë asaj jetesën aty ku ndodhen, t'i organizojnë, t'i mbështetin sesa të pritët (siç po ndodh) që diasporës ndonjëherë t'i kthehet mendja e të vijë e të punojë në Shqipëri apo të shpresojnë se ka për të dalë ndonjë forcë e re politike që do t'i kthejë shpresën. Njerëzit kanë mundësi më herë të vdesin sesa të shohin se kjo gjë do të realizohet. Situata e shqiptarëve në diasporë është krejt ndryshe. Nëse shqiptarët e Shqipërisë janë të pezmatuar, shqiptarët e diasporës janë më të shëndetshëm fizikisht dhe mendërisht. Familjet shqiptare këtu shpesh e përmbledhin mendimin "Më mirë t'i qaj mallin, se t'i qaj hallin". Ajo që diaspora nuk e ka dhe i mungon seriozisht dhe i krijon probleme afatgjata është atdheu dhe kriza e identitetit. Ndaj ka kuptim që të dyja palët të fillojnë e të mendojnë seriozisht se si do të "shkëmbejnë" shërbimet ndaj njëra-tjetrës. Diaspora ka njohuritë për shtetet e shoqëritë e huaja dhe aksesin në to, shqiptarët e Shqipërisë kanë atdheun. Natyrisht që nuk do të jetë një marrëdhënie "biznesi", por thjesht lëvizje e përbashkët kombëtare, por duhen kuptuar mirë pikat e forta të njëra-tjetrës që ta bëjë çdo individ të Shqipërisë të kuptojë mirë diasporën dhe pozicionin e saj të fuqishëm, dhe po ashtu ta bëjë diasporën të kuptojë pikat e fuqishme të shqiptarëve të Shqipërisë.

Duket si rreth vicioz. Mendoj se dilet nga e kundërta, nga ajo që duket më e vështirë. Zgjidhja qëndron aty ku mërzitja është më e madhe, urrejtja më e madhe për padrejtësitë, për rënien e Shqipërisë. Sado mërzitje të kenë shqiptarët që janë në Shqipëri, unë besoj se ajo nuk krahasohet me mërzitjen e emigrantit që ka humbur atdheun. Shqiptarët në Shqipëri nuk e kanë humbur atdheun. Nëse shqiptarët e Shqipërisë nuk e marrin seriozisht investimin për organizimin, komunikimin, bashkëpunimin, me diasporën shqiptare, do të

kuptojnë se do të jetojnë në një gjendje krejt të pakonceptueshme.

Ka një arsye që Rilindja Kombëtare u bë nga diaspora. Shteti shqiptar e fitoi pavarësinë nga lëvizjet e diasporës. Nuk duhej të vinte koha që ne të shpresonim përsëri nga diaspora, kur kemi shtet shqiptar, por faktikisht ka ardhur përsëri koha që të shpresojmë nga diaspora, sepse situata e shoqërisë shqiptare është shthurur në një nivel të rrezikshëm, që do të përshkruhej në këtë mënyrë (procedurë) nga Sami Frashëri.

"Shthurja është një lumë i rrëmbyer që ecën midis popujve dhe i rrëmben popujt që janë mbrojtur me muret e një morali të mirë dhe me anën e një administrimi të mirë i dërgon nëpër grykëderdhje pranë detit ku ato janë të paracaktuar të mbyeten."

Shthurja në shumë këndvështrime është kaq e dukshme në Shqipëri. Nuk dimë se çfarë prove tjetër, përveç shpopullimit masiv dhe emigrimit në të katër anët e botës, duhet të ketë që të konceptohet që jemi duke u shthurur jo vetëm moralisht, por edhe materialisht. Nëse vijohet siç po ndodh, thjesht do të humbasim kohë dhe do të humbim edhe Shqipërinë edhe diasporën, por më parë do të humbin diasporën dhe pastaj Shqipërinë, ndaj më parë duhet të kapim Diasporën dhe pastaj Shqipërinë. Sado keq të shkojë Shqipëria, ajo do të mbetet Shqipëri. Kjo nuk mund të thuhet për diasporën. Ajo ka një afat të përcaktuar dhe afati është këmbimi i brezit të parë me brezin e dytë. Nëse kjo kohë humbet, do të jetë e vështirë të recuperohet, ose do të dojë disafish më shumë investim, ose do të kthehet në biznes, por nuk do të ketë frymë.

Në këtë kuptim, është me vend të theksohet që duhet të kapim e forcojmë diasporën që të kapim atdheun. Nuk duhet të kërkojmë të përdorim diasporën, kur vetë jemi duke e përçarë e duke e dobësuar. Kjo do të thotë që duhet ta ruajmë e të investojmë në mbi diasporën, që diaspora të investojë tek ne. Nuk bëhet fjalë për lëvizje politike, pra pjesore, por për lëvizje kombëtare në nivel global.

Global Albania dhe Fryma e Kombit

Duke hapur faqet e qeverisë së Kosovës dhe të Shqipërisë kushtuar organizimeve shqiptare në diasporë, informohemi se janë të paktën 600 organizime shqiptarësh në botë. Ky numër është një start i mirë për një organizim global.

Nga analiza e punës së tyre del se ato përgjithësisht janë të dobta dhe dobësia nga shumë



faktorë, por në një masë të madhe, vjen nga misioni që ato i vënë vetes dhe nga mungesa e orientimit global të shqiptarëve, nga fakti që identifikohet shteti me kombin dhe shteti me partitë apo klasën politike dhe prej kësaj vjen fakti që partia ose klasa politike në grup korrupton edhe shtetin edhe kombin dhe e fut në pështjellim ideor të gjithë emigracionin shqiptar. Duke mos ditur e duke mos mundur të bëjnë ndryshim, fillon një indiferentizëm i natyrshëm, për nga këndvështrimi individual, por vrastar për fatet e kombit nga pikëpamja kombëtare. Dhe këtu jemi, pra në këtë gjendje. Mund të kuptohet që shkakun qëndron kryesisht në Shqipëri tek cilësia e jetës shoqërore shqiptare që u prish dhe ka qenë nën kërcënim nën dekada, nën përçarje, survejim, shfrytëzim, korrupsion, grabitje, shitje të interesit kombëtar etj. Shqiptari duron shumë, por jo aq sa të mos vlerësojë edhe që ka vetëm një jetë. Ndaj kanë emigruar dhe emigracioni vjen natyrshëm me më shumë detyra: do të bëhet foleja e re, do të bëhen lidhjet e reja me komunitetin vendas të huaj për emigrantin dhe shtetin, do të merren lejet e qëndrimit apo pasaportat, do të mësohet kultura e re dhe ndërkohë duhet të mbajë edhe lidhjet me Shqipërinë. Konteksti është pra shumë problematik. Në këtë kuptim emigranti ka më shumë detyra sesa një shqiptar që jeton në atdhe.

Kjo është arsyeja që ne nuk e kërkojmë zgjidhjen tek individët, as tek vetë organizatat që janë formuar me këta individë shpesh të lodhur nga hallet e jetës, por jashtë tyre, në nivel global. Sot që flasim me "jashtë tyre" konceptohet vetëm Shteti Shqiptar, që në fakt, prej dekadash, është vetë shkaktari i emigracionit masiv, sepse është një shtet i kapur nga jashtë. Nuk mund të kërkohej zgjidhje nga ata që janë vetë shkak. Nëse do të dilnin forca politike të afta vërtetë të bëjnë ndryshim ato nuk i pengon kush ta bëjnë këtë, por sado mirë që ta bëjë punën një forcë politike (ta zemë VV në Kosovë), koncepti i punës me emigracionin dhe diasporën duhet të jetë tjetër dhe nuk mund të menaxhohet nga një parti politike. Detyra e partive politike, nëse do të duan vërtetë të mirën e kombit, është që ta kuptojnë kështu dhe të ndihmojnë në këtë drejtim.

Vijmë pra që zgjidhja duhet të jetë vetë emigracioni, duke u organizuar. Siç do të shihet, më poshtë koncepti **Global Albania** respekton në maksimum analizën e shkaqeve dhe gabimeve, ndaj shmang në maksimum çdo tundim përdorimi politik, fetar, krahinor, protagonizmi individual etj. Shërbimi maksimal i është bërë **Frymës së Kombit**.

*Por kur desh Zot i Vërtetë,
Të dil fageza në jetë,
Aberë bëri njerinë,
Atje ta gesh Perëndinë. (Naim Frashëri)*

Me "Zotin e Vërtetë" le të kuptojmë "Frymën e Kombit" dhe me "njeri" le të kuptojmë "organizatën shqiptare" në emigracion. Nuk ka rrugë tjetër më të sigurtë sesa diaspora të përfshihet me thelbin. Jashtë thelbit (Frymë e Kombit) çdo gjë tjetër është biznes dhe, po qe biznes, mund të bëhet në ato forma që është duke u bërë. Nuk duhet arsyetuar me idetë e biznesit, siç arsyetojnë, për shembull, disa fetarë që thonë se "agjërimi" i bën mirë shëndetin, kur në fakt është një masë edukative fetare për të forcuar karakterin jo stomakun, sepse është një detyrim fetar dhe jo mjekësor.

Që organizatat shqiptare në botë të fitojnë përmasa dhe fuqi të re ndikuese mbi komunitet e diasporës dhe mbi vetë kombin shqiptar ato duhet të **bashkojnë** analizën, vlerësimin, kërkimin, reflektimin ndaj situatave, të komunikojnë e të bashkëpunojnë intesivisht derisa rezultati që do të marrin të mos jetë veç lokal, në komunitetin e tyre, por të jetë global dhe të formohen shqiptarë që kanë **vetëdije globale** dhe **vetëdije kombëtare** njëkohësisht, por, nga ana tjetër, të jenë edhe besnikë, ndihmues e zhvillues ndaj kulturave të shteteve ku jetojnë, që janë jo vetëm një detyrim moral por edhe një ushqim i pasur e i nevojshëm kulturor për shqiptarët e Shqipërisë.

Termin "global" e hasim edhe në kontekst negativ në raport me kombin, por ne nuk jemi aty, sepse ne po diskutojmë për parametrin "global" të kombit, pra që përfshin edhe diasporën, pra nuk jemi jashtë kombit, por brenda tij. Ndaj nuk është ai kuptimi që thuhet ta zemë në kontekstin "kombëtar" apo "universal" apo "kozopolit". Pra nuk jemi në këtë diskutim kur përmendim fjalën "global".

Marrëdhënia me kulturën e huaj

Frymëzimi nga kulturat e huaja, dhe përshtatja e tyre ndaj kushteve shqiptare për t'ia ofruar publikut shqiptar është një proces që kërkon një sitje tepër të hollë, psikologjike, logjike, shkencore, shqiptare dhe kjo del nga mundësitë e një individi, dhe kërkon një forcë me përmasë globale. Globale sepse bëjmë fjalë që diaspora e di më mirë se ç'është bota dhe diaspora shqiptare do ta bëjë sitjen, në bashkëpunim edhe me vetë Shqipërinë. Në këtë kuptim Shqipëria ka autorësinë e "kulturës", por diaspora ka autorësinë e "sitjes" dhe të vlerësimit të kësaj kulture, sigurisht duke gjykuar kulturën e vet, pra jo si një i huaj. Kur poeti Ali Asllani shpjegon dashurinë e dy të rinjve shqiptarë, ai thotë në mënyrë të veçantë:



*Dashuria, tungjatjeta,
midis giftit të selitur,
dhe me **Besën** tonë të situr,
është e ëmbël shumë e shkreta,
është gosti nga qielli zbritur.* (Ali Asllani)

Pra edhe dashuria brenda Shqipërisë paska nevojë për një sitje kulturore shqiptare, jo më komponentë të kulturave të huaja që pretendojnë të "injektohen" në kulturën shqiptare. **Sitja me Besën** duhet të jetë motiv për të gjithë punën e diasporës kur ajo shtrun propozime për kombin. Kjo nuk është një punë e lehtë, siç nuk është një punë e lehtë puna e restauratorit që kërkon të mos dëmtojë identitetin e sendit, pra thelbin apo Frymën e Kombit.

Si do të mundet diaspora të sjellë për shoqërinë shqiptare një produkt kulturor original, por të frymëzuar nga bota? Mungon metodika, bashkimi, opinionin. Kjo është arsyeja që gjejmë shpesh një "sallatë" me produkte të "papërtypura", të pasitura që i ofron media dhe menjëherë gjejmë zbatimin praktik, pa "u situr" më parë.

Sami Frashëri thotë **"Pa bashkim nuk ka opinion publik"**. Kjo do të thotë që para se të pretendojmë produktin duhet të pretendojmë mekanizmin që na çon në atë produkt. Nuk mund të pretendojmë që opinionin publik të ekzistojë e të funksionojë si duhet pa bashkimin. Do të shkruajmë pak më shumë më vonë për këtë.

VETËDIJA GLOBALE DHE KOMPETENCA GLOBALE

Diaspora shqiptare zotëron në nivel shumë të lartë **kompetencën globale**. Me përkufizim nga Veronica Boix Mansilla & Anthony Jackson:

"Kompetencë Globale është aftësia, gatishmëria dhe përkushtimi për të kuptuar dhe për të vepruar lidhur me çështje me rëndësi globale".

Diaspora shqiptare, sidomos ajo që ka vite të tëra jashtë, edhe pa e mësuar në mënyrë formale në shkollë, siç shkolla "Udha e shkronjave" ua mëson nxënësve të saj prej disa vitesh, e ka shumë më të zhvilluar këtë kompetencë sesa shqiptarët që jetojnë në Shqipëri. Kjo quhet një kompetencë kyçe për botën në të cilën jetojmë. Vuajtjet e emigrantëve të rinj që janë nën shok kulturor janë edhe për shkak të mungesë së kësaj kompetence, sepse nuk janë mësuar në Shqipëri të hetojnë zhvillimet botërore, por marrin në analizë një grup të kufizuar temash që u interesojnë vetëm lokalisht, nuk janë mësuar sa duhet

me këndvështrime të ndryshme, dhe as nuk kanë mundësi ta kenë këndvështrimin tjetër, sepse jetojnë në një shoqëri homogjene, nuk janë mësuar të komunikojnë me audiencën të ndryshme, dhe nuk janë mësuar të ndërmarrin aksion. Shqiptarët jetojnë në një shoqëri kryesisht homogjene nga ana etnike.

Emigranti, pas disa viteve përvojë, fillon të përmirësohet në të gjithë këta zëra (hetim, këndvështrime, komunikim, vendimmarrje dhe problemzgjdhje) dhe kur vijnë fisi i tyre "i pamësuar" nga Shqipëria fillojnë e përgatitin për çfarë lejohet e çfarë jo që në Shqipëri do të dukej e çuditshme, çfarë këndvështrimesh duhet të ketë e si duhet të silltet në mjedise të ndryshme.

Shembull: Në bisedë me një nxënësin tonë, student i vitit të parë në Universitetin e Torontos (Kanada), në kontekstin e problemeve me kultura të ndryshme, më tregoi për një rast bisede me një student me ngjyrë. Fillimisht e kish pyetur se nga ishte. Ai i kish thënë "Nga Kanadaja" (pra kishte lindur aty). Pyetja e radhës e studentit tonë, që për mentalitetin tonë, është e pafajshme ishte "Po me origjinë nga je" (mendimi që meqë ishte me ngjyrë do të duhej që origjinën ta kishte diku tjetër). Ai jo vetëm që u fye, por desh e bëri problem këtë situatë. Unë e verifikova si dukuri duke pyetur dhe vërtetë ishte jo pak e përhapur si ndjesi fyerje nëse pyetja e parë (nga je) pasohet nga e dyta (po origjinën nga e ke), pra duhet lënë në përgjigjen e parë dhe jo më tej.

Kompetencën Globale emigranti e përfiton sepse është më i ekspozuar ndaj nevojës së ngutshme për më shumë gjuhë të huaja, më shumë lëvizshmëri e vendimmarrje, më shumë i ekspozuar ndaj legjislacioneve e kulturave të ndryshme, më shumë analiza për të zgjedhur vendin e banimit, të punës, të shkollimit, të lidhjeve familjare, të ndikimit të nacionalizmit, të ksenofobisë, të anës fetare, etj. i bëjnë ata më të aftë të kalojnë me shpejtësi nga këndvështrimi lokal, në atë kombëtar, e global. Emigrantët, në disa drejtime, duket se kuptojnë më shumë sesa vendi i origjinës dhe sesa vendi ku shkojnë. Për shembull, shqiptarët e Shqipërisë pak dituri kanë për procedurat e marrjes së lejes së qëndrimit, të përkohshme apo të përhershme, për kushtet e marrjes së pasaportës nga të huajtë në Shqipëri, sepse nuk u duhet, por emigranti i di të gjitha këto. Pra në kompetencë globale emigrantët qartësisht janë më lartë. Emigrantët e kombeve të ndryshëm shpesh i gjen të bisedojnë bashkë, sepse janë në të njëjtat kushte, kuptohen më mirë, janë njëlloj të huaj për të dy vendet: të huaj për vendin ku jetojnë e të huaj për vendin nga kanë ardhur.

Mendojmë që **Global Albania** është cilësisht ndryshe dhe synon ta ndreqë sa të mundet situatën. Natyrisht që nuk mendojmë që do të kenë për atdhe botën, se kjo do të ishte shpërdorim i fjalës atdhe.



GLOBAL ALBANIA - KONCEPTIMI DHE PARIMET E NDËRTIMIT

Përmes konceptit **Global Albania** synojmë zgjidhjen e kësaj situatë problematike jashtë Shqipërisë duke shfrytëzuar kompetencën globale për përfitim të vetëdijes, përjetimit dhe interesit kombëtar.

Duhet më parë të trajtojmë cili është elementi i **Global Albania**: individi apo organizata?

Përgjigjia është **ORGANIZATA SHQIPTARE dhe JO INDIVIDIT SHQIPTAR.**

Disa milionë shqiptarë jetojnë jashtë atdheut. Është qartësisht jo e frytshme që një lëvizje globale të mbështetet tek individët. Me individët ka punë organizata konkrete, por jo edhe një Lëvizje Globale siç do të jetë **Global Albania**.

Ndaj elementi i Global Albania do të jetë organizata shqiptare, jo individi.

Përveç se është e arsyeshme që të ndodhë kështu, do të kuptohet që kjo zgjidhje e mbron individin shqiptar dhe një nga objektivat e Global Albania do të jetë mbrojtja e individit shqiptar kudo që të jetë. Fryma kombëtare mbrohet dhe edukohet më mirë përmes themelimit dhe veprimtarisë së organizatave. Organizata është me e sigurtë në identitetin shqiptar në të tërë komponentët e veprimtarisë dhe është më e mbrojtur edhe ligjërisht.

Pse Global Albania në vend të shtetit shqiptar?

1. Shtetet shqiptare, si çdo shtet, natyrshëm e kanë detyrë funksionale shtetërore kujdesin për diasporën, për nga vetë natyra e interesit dhe e punëve me të cilat janë ngarkuar, janë më të prirura ta tërheqin kërrabën nga vetja, pra nga punët e brendshme të qytetarëve që realisht jetojnë në atdhe. Natyrshëm tepron më pak kohë për t'u marrë me diasporën.
2. Ndryshimet janë thelbësore ndërmjet emigrantit që ka vendosur të jetojë jashtë dhe shtetasit shqiptar me punë e banim në Shqipëri apo Kosovë apo troje të tjera etnike.
3. Duke krijuar një organizim global të organizatave të diasporës, që nuk do të jenë të udhëhequra nga askush, (do ta sqarojmë se si do të bëhet e mundur) shoqëria dhe kombi shqiptar pret të formohet një Frymë dhe Lëvizje Kombëtare krejt të veçantë.
4. Përveç sa u tha më sipër, që mund të zbatohet në çdo shtet, pavarësisht cilësisë, ne në Shqipëri kemi një situatë ku klasa politike është thellësisht fajtorë për shpopullimin masiv,

pra zëre se i kanë përzënë vetë njerëzit. E kuptojmë që ka edhe emigrim të natyrshëm, po ky i Shqipërisë nuk është ashtu. Është largim me inat dhe kjo pasqyrohet kur shkojnë jashtë që ata shpesh nuk duan të rrinë bashkë me shqiptarë, kjo do të thotë se përçarja ka hyrë thellë. Kush tjetër përveç politikës është kaq fajtorë? Pse shqiptarët e Kosovës kanë një situatë më të mirë në emigracion? Sepse brenda shtetit përçarja është më e vogël, bujaria më e madhe, besimi reciprok më i madh, e vërteta më e madhe. Në këtë kuptim, është edhe më e domosdoshme që diaspora të mos tundohet nga skemat, politikat kësaj politike. Sa më larg aq më mirë. Është pikëpamja jonë që kjo nuk duhet të ndodhë as kur klasa politike të jetë në rregull. Do ta shpjegojmë më poshtë.

Klasa politike drejtuese është vetë shkaktare të shpopullimit, të përzënies, të përçarjes, të përndjekjes, të varfërimit, të shfrytëzimit, tëurvejimit, të korrupsionit, të padrejtësisë, të shturjes, të krimit dhe të ekonomisë kriminale dhe emigracioni shqiptar e reflekton këtë situatë, duke mos i dashur organizimet shqiptare sepse nuk do të jenë në një tavolinë me shkaktarët apo të afërm të shkatarëve të përzënies nga atdheu, nuk duan të ndajnë kombësinë e tyre shqiptare, me produktet kriminale njerëzore të shpërndara edhe ato në botë, njëlloj si të pafajshmit shqiptarë dhe që e turpërojnë emrin shqiptar; Klasa politike kërkon ta shfrytëzojnë emigracionin për rekrutim, nuk do t'i dëgjojë zërin e mirë. (bëjnë sikur). Klasa politike nuk është e aftë të frymëzojë dhe qëllimisht përhap masivisht dekurajimin për qëndrim në atdhe apo për kthim në atdhe, shpesh me nënkuptim për t'i vënë në turp emigrantët dhe kjo i shtyn këta të fundit të marrin me vetë vendimin që fëmijët e tyre të përthithen me shpejtësi në kulturën e vendit duke mos investuar më në gjuhë dhe kulturë shqiptare; Kjo nuk mund t'i falet. Klasa politike as nuk e kupton, as nuk e pranon jetesën e emigrantit jashtë dhe kur vjen brenda fillojnë e thonë "ç't'u desh që erdhe" (ose i shohin si të dështuar); nuk edukojnë koherencën kombëtare dhe ndjekin devizën "përça e sundo"; nuk kanë politika të rikthimit në atdhe; kanë një investim të ulët në emigracion; janë shpesh përçarëse oseurvejuese; nuk zgjidhin konfliktin e interesit ndërmjet vendasve (kombëtarë) dhe të larguarve; nuk edukojnë kombëtarizmin dhe nuk prodhojnë demokraci dhe shtet ligjor; shoqëria shqiptare është e lodhur rëndë, e keqedukuar dhe po dështon të ringrihet për shkak të pesimizmit; nuk dinë se çfarë është ndjesia dhe pasojat e të mbeturit jashtë atdheut. Ka shumë për të thënë, por po themi një paragraf pak më të gjatë, me synimin që kurrë dhe askush që është në diasporë të mos tundohet e t'i japë përsëri çelësat e organizimit klasës politike. Këtë nuk do ta bëjnë për armiqësi, as për urrejtje, por do ta bëjnë se kështu duhet, edhe nëse politika është e mirë e kombëtare.

Duhet të vijë koha që Global Albania ta bëjë mbytëse botën për çdo shqiptar të lig, turpërues dhe mundues të popullit të vet dhe kriminel. Ky do të jetë një përfitim i botës prej Global Albania dhe natyrisht do të jetë një përfitim për vetë atdheun. Organizatat shqiptare do t'ia mësojnë njëra-tjetrës se si bëhet kjo punë. Si të mos kenë se ku të shkojnë e ku të falen



jashtë atëherë do ta ndryshojnë qasjen e do të sillen siç duhet. Atmosfera mbyttëse globale që krijon opinionin nuk do të mund të shmanget. Bota duhet të jetë një vend i qetë për të gjithë shqiptarët dhe jo të sulmohen edhe në botë nga ata që i përzunë prej atdheut, ose që kapin atdheun. Duke qenë se për diasporën për momentin mund të jetë e pamundshme të zhbëjnë kapjen e atdheut nga një klasë politike tepër e ulët në veprimtarinë e vet, që mund të jetë edhe kapje e shteteve të tjera, që duan ta përdorin Shqipërinë, atëherë diaspora duhet të mos bëjë gabimin e të mos kuptojë lëvizjet e fshehta për të marrë nismën dhe ta devijojë. Le ta quajë se këtë nuk e bëjnë shqiptarët, por të huajtë që duan ta dështojnë dhe atëherë do të kuptojnë më mirë se si duhet të veprojnë.

Sami Frashëri: "Atdheu edhe po u la në dorë të një qeverie të ligë, edhe po u shpërfill, pëson fatkeqësi të shumta, po nuk e humb shpresën se më në fund do të shpëtojë, por premtimet e të huajve dhe mbrojtja që ata mund të ofrojnë, gjithmonë sipas interesave të tyre, e zhdukin atdheun përgjithmonë."

5. Përderisa flasim për pavarësi të medias dhe parimisht kemi besim tek media, për pavarësi të gjyqësorit dhe parimisht kemi besim tek gjyqësori, për pavarësi të sistemit arsimor dhe duhet të tregojmë besim, për ndarje të ekzekutivit nga legjislativi, atëherë është e natyrshme që diaspora duhet të veprojë e pavarur dhe i duhet edukuar pavarësia. Kur themi të pavarur, nuk e kemi fjalën të harruar, të shkëputur, por duhet investuar që ata ta realizojnë synimin dhe ta realizojnë të pavarur. Sigurisht që nuk ka asnjë përfitim nga të mosngacmuarit me idenë se po ju lëmë të pavarur. Ne po e krahasojmë me atë situatë ku investimi (i varur) kuptohet për përfitim politik e pjesor.

6. Është krejt e qartë se këtë pavarësi ata do ta duan për të mirën e kombit shqiptar, të atdheut të tyre, të gjakut, e fisit të tyre. **Krijimi ka nevojë për qetësi.** Global Albania do të krijojë dhe duhet të jetë e qetë nga ngacmimet që ta bëjë këtë. Kjo qetësi krijohet duke shkëputur lidhjet detyruese. Le ta quajmë se pavarësia e organizimit të diasporës është protokoll që nuk duhet ngacmuar.

NJË KRAHASIM: MONEDHA DHE KRIPTOMONEDHA dhe ORGANIZATA DHE GLOBAL ALBANIA dhe BANKA DHE SHTETI

Për të kuptuar më mirë konceptin që kemi për organizimin, skicimin e veprimtarisë që do të ketë **Global Albania** dhe ndryshimin me organizatat shqiptare që janë anëtare, shërben jo pak, në një kuptim, krahasimi me funksionet e "kriptomonedhës" dhe të "monedhës". Për ta bërë krahasimin të kuptueshëm, "organizatat shqiptare" po i krahasojmë me "paranë

materiale" (letër, monedhë) ose shkurt "monedhë", ndërsa **Global Albania** që është përsëri një organizim (organizatë e tipit tjetër) po e krahasojmë me "kriptomonedhën". Për paranë letër ose monedhat dimë që menaxhohen nga një bankë qendrore. Për "kriptomonedhat" dimë që nuk kemi një bankë qendrore. Megjithatë kriptomonedhat funksionojnë dhe e bëjnë punën me të njëjtin funksion që ka paraja fizike.

Kjo vlen edhe për "organizatat shqiptare" që janë duke vepruar nëpër botë në komunitete të ndryshme në raport me organizimin e **Global Albania**. Ashtu si monedhat që nxirren e monitorohen nga bankat qendrore, organizatat krijohen (vetë) e monitorohen (sipas ligjeve) nga shtetet që i licensojnë dhe u japin kuadrin ligjor. Nga ana tjetër, organizimi i ri global, i panjohur më parë, që ne po i japim emrin **Global Albania** nuk ka ku të regjistrohet si e tillë, nëse nuk do të jetë e varur nga ndonjë legjislacion konkret, edhe pse teorikisht mund të zgjedhë një nga shtetet për t'u regjistruar. Në këtë kuptim ai është i palicensueshëm, por fakt. Ashtu si kriptomonedha edhe ai nuk do të bjerë në kontraditë me asnjë legjislacion. Kjo nuk do të thotë se ajo do të bëjë diçka jashtë një rregullimi ligjor, por ajo do të përfaqësohet në çdo shtet, nga organizatat vendase, pra janë organizatat e licensuara ato që veprojnë, ndërkohë statusi global duket qartë që janë "objektiva globale" që ndjek çdo organizatë në çdo shtet.

GLOBAL ALBANIA SYNON FORMIMIN E OPINIONIT PUBLIK SHQIPTAR NË BOTË

Teoria mbështetet në këshillat e Sami Frashërit për natyrën dhe fuqinë e Opinioni Publik. Citojm **Sami Frashërin:**

"Opinionin publik", edhe pse, në pamje të parë, mund të duket i dobët, në të vërtetë, është shumë më i fortë nga sa duket dhe është i aftë të shkatërrojë çdo forcë materiale."

Forca kryesore materiale që duhet shkatërruar është kryesisht ajo klasë politike antikombëtare dhe e korruptuar që po i sjell dëme kombit shqiptar dhe po përhap ndotjen e vet edhe në botë. Global Albania duhet ta realizojë këtë detyrë për të mirën e kombit shqiptar dhe për rrjedhojë edhe për pastrimin e ndotjes globale. Të gjithë e dinë se klima nuk rregullohet vetëm me aksion kombëtar, por duhet global, por ama detyra kombëtare quhet edhe pjesë i një objekti global, ndaj ka kuptim të themi se Global Albania është duke marrë pjesë në objektiva globale kur ajo rregullon situatën kombëtare, ajo bën një detyrë njerëzore tepër të lartë.

Artur Shkurti: **GLOBAL ALBANIA** - Botuar për herë të parë 19 prill 2024



Sami Frashëri:

*"Asnjë ligj nuk mund ta sundojë **opinionin publik**. Vetëm ai nuk mund të mposhtet me anë të ligjit".*

Kjo vlen edhe më shumë për një komunitet global shqiptarësh që jetojnë në shtete të ndryshme. Asnjë mundësi reale nuk ka që opinionin shqiptar, i krijuar në të tilla përmasa, të sundohet me anë të ligjit. Rritja e përmasave të komunikimit të pavarur global të organizatave të shqiptarëve do ta bëjë thuajse të pamundur zotërimin e këtij opinionin. Ka jashtëzakonisht shumë faktorë që do të ndikojnë që kjo të mos ndodhë, pra që të mos mundet një ligj ta zotërojë opinionin publik.

Nëse në Shqipëri është e mundur dhe e dukshme që po tentohet të devijohet perceptimi për opinionin publik, globalisht nuk do të ketë asnjë mundësi, nëse organizatat shqiptare organizohen në përputhje me vlerat më të larta të shoqërisë njerëzore.

Sami Frashëri:

*"Një popull që nuk ka **opinion publik** nuk mund të bëjë pjesë në familjen e kombeve të qytetëruar".*

Jemi saktësisht në këtë pikë, që nuk po duam të vlerësojmë faktin që s'kemi opinion publik ose po dështon, dhe duhet të marrim kthesën fuqishëm, pra të kemi opinion publik, të të bëjmë pjesë në familjen e kombeve të qytetëruar. Të ishte aq e lehtë të ndërtohej do ta kishim, por duhet bërë dhe duhet bërë sipas një skeme që respekton fjalën tjetër të urtë:

Sami Frashërit: "Pa bashkim nuk ka opinion publik".

Global Albania është koncept që investon pikërisht në këtë pikë, në **bashkimin** dhe pikërisht në atë bashkim që produkt të vet do të ketë opinionin publik, por që të bësh një opinion publik duhet të kesh një profesionalizëm të lartë, dhe pas profesionalizmit të lartë, të kesh edhe numrat e lartë. Një individ i vetëm mund të ketë një mendim të saktë e të drejtë, por tjetër gjë është nëse ekziston një opinion publik me të njëjtin mendim. Kjo ndodh nëse ka bashkim dhe nëse bashkimi është duke funksionuar sipas një protokollit të mirëfilltë sitjeje të mendimit, studimi (research), analize, reflektimi, vlerësimi, komunikimi dhe bashkëpunimi. Global Albania synon t'i ketë këto cilësi dhe të ketë pikërisht këtë qasje që në ndërtim.

Sami Frashëri

*"Kombi i përngjan anijes: Ligji është në vend të timonit, **opinionin publik** janë velat, ndërsa liria është në vend të erës. Sikundër timoni nuk hyn në punë pa velat, edhe ligji në këtë rast nuk sjell asnjë dobi. Velat, nën forcën e erës, e shkatërrojnë anijen pa timon. Po kështu, **opinionin publik** dhe ligji, në kushtet e një lirie të tepruar shkaktojnë zhdukjen e kombit. Sikundër nuk mund të lëvizë nga vendi anija që i ka në rregull velat dhe timonin, por i mungon era, edhe kombi që i ka të përsosura ligjet dhe **opinionin publik**, nuk mund të përparojë pa liri".*

Shqipëria thuajse e ka të shkatërruar mundësinë të ketë një opinion publik. Kjo sigurisht ndikohet nga përçarja dhe nga teknika e klasës politike për të përdorur të gjitha mjetet për ta atrofizuar mundësinë që të ketë një opinion publik. Kjo po prish thelbin dhe rezultati është shpopullimi dhe emigrimi. Tani ata që kanë emigruar e dinë se çfarë do të thotë opinion publik në shtete demokratike, kjo do të thotë që nga çedukimi shqiptar janë edukuar, por ata janë jashtë Shqipërisë dhe jo brenda saj, ndaj aty ku janë duhet të luajnë atë funksion që Shqipëria e ka humbur, pra të organizohen globalisht (do ta shkruajmë se si më poshtë) dhe të prodhojnë një opinion publik të nivelit më të lartë që mund të egzistojë, global. Është e qartë që Global Albania ka dy pika të forta që janë opinionin publik dhe liria. Duke qenë globale liria nuk ka asnjë mundësi të kufizohet nga ndonjë legjislacion. Ndërkohë për nga mënyra e organizimit do të bëhet e mundur që kjo liri të prodhojë një opinion publik. Duke qenë një organizim organizatash, pra që janë elitare në atë që bëjnë, dhe duke qenë nga shtete të ndryshme thuajse është zero mundësia që të ketë ndonjë rast që tregon ndonjë "liri të tepruar". Nuk ka asnjë mundësi që Global Albania të shfrytëzojë lirinë në atë mënyrë që kjo të quhet e tepruar. Njerëzit me të cilët do të përfaqësohen organizatat në **Global Albania** do të jenë elitare.

PROTOKOLLI I GLOBAL ALBANIA

1. Quhet se **vendimi i Global Albania ka reputacion global** tek shqiptarët, nëse numri dhe cilësia organizatave pjesëmarrëse është e tillë. Ky nivel organizmi botëror i shqiptarëve në numër masiv organizatash dhe cilësia e lartë shpjegohet më vonë se si do të arrihet.
2. **Quhet se një vendim është marrë** nëse për të janë shprehur "pro" të paktën **75% e organizatave të akredituara** si anëtare të Global Albania. Më tutje në dokument shpjegohet procedura e akreditimit të organizatave shqiptare dhe mënyra e analizës dhe vendimmarrjes nga secila organizatë.

Pse mendojmë 75% si shumicë të cilësuar dhe jo më pak?

Sepse logoja "Global Albania" është në sy të gjithë opinionit shqiptar dhe botëror



dhe 75% e organizatave shqiptare në botë është një filtër i jashtëzakonshëm premtues për profesionalizëm të lartë në çdo këndvështrim. Është më mirë të mos merret një vendim sesa të merret me një oponencë relativisht të madhe dhe një miratim relativisht të vogël edhe pse shumicë.

Pse shumica e cilësuar është 75% dhe jo më shumë?

Është e drejtë dhe e arsyeshme që të ketë mendim të kundërt dhe kjo të pasqyrohet gjerësisht. Nga ana tjetër është e rëndësishme të merren vendime dhe ato mos dështojnë. Rezultantja e vendimeve sigurisht do të jetë në interes kombëtar. Oponenca (në pakicë) mund të jetë mbrojtje për vetë nismën "Global Albania". Nga ana tjetër, është plotësisht e mundur që një pjesë e organizatave anëtare të mos munden të plotësojnë kushtet për vendimmarrje (ta zemë nuk kanë profesionalizmin e duhur).

3. **Nisma e vendimit** mund të dalë nga një individ ose grup individësh ose organizatë që bind të paktën 10 organizata të akredituara për ta nisur ato procedurën. Kur bëhet e qartë se ekzistojnë të paktën 10 organizata që bien dakort, atëherë këto e përpunojnë në atë mënyrë që të shprehen 100% e organizatave. Çështja vendoset të kalojë filtrin e diskutimit publik, kur janë shprehur pro 30% e organizatave të akredituara.

4. Nga çasti që çështja kalon në publik **organizatat fillojnë punën e analizës dhe të vendimmarrjes** së tyre. Ato mbledhin ekspertizën e nevojshme shqiptare, dhe, me raste, mund të ofrohet edhe nga individë ose organizime të huaja dhe konkluzionet në të cilat mbërrijnë vetë i bëjnë publike dhe ndërkohë kujdesen që artikujt dhe vendimmarrja t'u bëhet e ditur të gjitha organizatave anëtare të Global Albania. Nga çasti që puna është publike, mbrojtja është më e madhe.

5. **Qëndrimet e përbashkëta, duhen vërtetuar që janë të përbashkëta**, të paktën në masën 75% të qendrave të akredituara. Mesazhi më i fortë global është rënia dakort në grup, ndaj qendrat kujdesen që analizat dhe debatet të veçojnë gjërat e përbashkëta dhe t'i nxjerrin ato në plan të parë dhe t'i bëjnë pjesë të planit për botimet Global Albania. Në formën e një deklarimi, pasi është rënë dakort, **botohen nga çdo qendër të përbashkëtat e Global Albania** që mund të jenë: analiza, tërheqje e vëmendjes, raportime, gjetje, rekomandime, planifikime, synime, etj. Botohet gjithmonë edhe lista e organizatave që kanë rënë dakort me një deklaratë të tillë. Nëse organizatat që nuk kanë rënë dakort duan që në deklaratë të përfshihet arsyetimi i tyre kjo mund të botohet, me synimin që publiku të ketë të qartë edhe mendimin ndryshe.

Deklarimet botohen në data të rëndësishme kombëtare: 17 shkurt (2008, Pavarësia e Kosovës), 2 mars (1444, Besëlidhja e Lezhës), 7 mars (1887, Mësonjëtorja e parë shqipe në Korçë), 25 maj (1846, lindja e Naim Frashërit), 10 qershor (1878 Lidhja e Prizrenit), 28 nëntor (1912 Dita e Pavarësisë), e të tjera sipas rastit.

Synimi që zgjidhet një ditë e shenjtë kombëtare është që gjithmonë deklaratimet të kenë një pjesë frymëzuese nga historia dhe pastaj ta lidhin atë me çështjen konkrete. Duke zgjedhur data të shenjta kombëtare, është më e mundur që të arrihet dakortësia për më shumë pjesë të deklaratimit, është më e mundur të fshihen dallimet, është më e mundur të marrë vëmendje. Problemi kryesor i edukimit kombëtar është frymëzimi kombëtar dhe ai duhet të jetë parametër i rëndësishëm.

Global Albania shmang nderimet me emra të personave që janë gjallë, ndryshe do të kthehet në një gazetë lajmërimesh nga bota. Detyra e saj është Fryma e Kombit dhe jo të bëjë median. Ndaj produkti i saj do të jetë i vogël por i saktë e thelbësor. Vetë organizatat nëpër shtete të ndryshme, mund ta bëjnë punën më konkrete, në mënyrat që ato e shohin të arsyeshme, por kur bëhet fjalë për komponentin Global Albania, ato mbajnë një qëndrim më filozofik.

Synimi i Global Albania është monitorimi i parametrave të kombit, duke abstraguat nga emra konkretë. Kjo nuk do të thotë që emrat konkretë nuk do të përmenden nga çdo organizatë apo nuk do të bëhet debat konkret, por kjo do të jetë përgjegjësi e organizatës individuale, apo e disa organizatave që nuk varen për këtë punë nga grupi. Asnjë gjë nuk i ndalon ato të bëjnë me kreativitet gjithçka që kanë bërë. Ato nuk janë të detyruara në asgjë të bëjnë apo të mos bëjnë diçka që ato mendojnë se është e drejtë. Thjesht kur hyjnë në linjën e Global Albania dhe në protokollin e saj i heqin këpucët, i lënë tek dera, dhe bashkohen në një Odë për të thenë një fjalë me vend në kuvendin global të shqiptarëve. Është njëjloj si të hapin një menu të re në website-n e tyre, të titulluar "Global Albania".

FALTORJA E BUJARËVE SHQIPTARË dhe ÇËSHTJA FETARE

Në vitin 2009, botuam librin **"Besa, feja ime, e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë"**, (Artur Shkurti) që e quajtmë Libri i Shenjtë, për t'u përgjigjur devizës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare "Feja e shqiptarit është shqiptaria" (Pashko Vasa). Libri kërkon të ngrejë realisht Frymën e Kombit në një nivel që e përcaktojmë si "thujse fetar" (pra jo plotësisht). Libri përmbledh rreth 2000 citime nga poetët tanë më të njohur, ku shumicën e zënë poetët e Rilindjes, por edhe deri në ditët tona: Naim Frashëri, Pashko Vasa, Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Lasgush Poradeci, De Rada, Zef Serembe, Ernest Koliqi, Asdreni, Çajupi, Fan Noli, Ali Asllani, Mitrush Kuteli, Migjeni, Mihal Grameno, etj.



Një besim fetar karakterizohet nga Libri i Shenjtë (këshilla, udhëzimi, frymëzimi), nga Profeti, nga Faltorja, nga Ritet Fetare. **Libri i Shentë "Besa"** që të ishte shqiptar do të duhej të përmbledhonte të gjithë këshillën kombëtare më të mirë, më thelbësore. U vendos që kjo këshillë të merrej nga poetët shqiptarë, që ajo të vinte edhe më e bukur, por edhe të ishte e sigur dhe besojmë që libri është tepër i fuqishëm në drejtim të edukimit njerëzor dhe kombëtar njëkohësisht. Nuk është thjesht patriotik, por është ashtu si duhet të jetë dhe me autorë shqiptarë. Në këtë kuptim, ç'është e mirë e ç'është e keqe botërisht "sitet" nga ndjesitë e poetëve shqiptarë, ndaj kjo e bën njerëzoren të ketë vulën shqiptare.

Një besim fetar zakonisht niset nga një Profet dhe përgjigjen se kush është profeti i shqiptarëve e kanë dhënë thuajse të gjithë poetët njëzëri, që është Naim Frashëri. Vërtetë që Naimi është i shkëputur shumë në këshillën e vet kombëtare të gjithanshme që ndërton njeriun si të tillë dhe shqiptarin njëkohësisht. Sidoqoftë në librin "Besa" Naimi zë 30% të këshillës dhe 70% janë të gjithë të tjerët. Në këtë mënyrë, libri është krejt i ekuilibruar.

MISIONI I SHQIPËTARËVE TË BUKURESHTIT DHE NAIM FRASHËRI (Lasgush Poradeci)

Për arsyetim të Naim Frashërit, profet të Shqiptarëve, vlen çfarë ka shkruar Lasgush Poradeci. Në vitin 1946, në 100-vjetorin e lindjes së Poetit Kombëtar Naim Frashëri, poeti Lasgush Poradeci botoi esenë e tij "Misioni i Shqiptarëve të Bukureshtit dhe Naim Frashëri". Në këtë ese të tij Lasgush Poradeci analizon atë pjesë që është më e vështira për t'u kuptuar nga lexuesi i historisë. Ai shpjegon se si ka ndodhur konkretisht "konvertimi" në thjesht shqiptarë, diçka që tek "Histori e Skënderbeut" Naimi e thotë kështu:

*"Mbreti u tha dhe ca fjalë, ata shum' u mallëngjyen,
pasdaj faj në na falë, se të gjo rret' u gënjyen,
pa të vërtetën' e njohën, ng'ajo që bënë më parë,
me gjithë zemër' u pendohën dhe u bënë shqipëtarë."*

ose

*"Tregomu dhe shqipëtarëvet,
udhën e punës së mbarë,
bashkomi, bëmi vëllezër,
edhe thjeshtë shqipëtarë"*

(Naim Frashëri)

Citojmë tani Lasgush Poradecin:

Letrëkëmbimi i Sami Frashërit i drejtuar Bukureshtjanëve, si një mjet që kish për objektiv bindjen e arësyes, ish i pa aftë t'i-a arrijë qëllimit me anën e gjykimeve të stilit epistolar, të thatësirave të prozës. Bukureshtjanët e mbanin prej vetvetiu më-të-lartë mburrjen për emrin e tyre shqiptar. Prej vetvetiu e kishin inaguruar ata, në të huaj, traditën e ndjenjës kombëtare. E përvetësorin pabiseduarsisht idenë e bashkimit. Po kush i bindte për singeritetin e palës tjetër për atë bashkim, që pretendohet dyke u mobuar anasjelltas? Nuk ish kjo në fuqinë e njeriut, në fuqinë e thjeshtë të njeriut shqiptar, edhe kur ay njeri mund të thubej Sami Frashëri. Ishte çështje fetare, punë feje, feja e Shqiptarit- ishte feja e shqiptarisë dhe për fenë flasin profetët jo njerëzit. Për fenë e shqiptarisë do të fliste profeti i kombit shqiptar: Naim Frashëri. Ky do të bënte Këthimin e Shqiptarëve.

Engjëlli i Zotit të Shqipërisë, Ideja e mirë e atdheut, Zëri i shpëtimit kombëtar i thotë Samiut:

... Dërgo në Bukuresht ca këngë të Naimit...

Dhe kështu Sami Frashëri i-u shkroi edhe një herë Shqiptarëve të Bukureshtit, i-u dërgoj letër përsëri. Letra tashi nuk ish, si më parë, një gjë kryesorë, kryesorinë e kishin vargjet, vjershat shqip të naim Frashërit. Përsëri ata e lexuan Saminë, dhe si e kuptuan përsëri dhe përsëri s'u bintnë, e mbyllnë letren si më parë përsëri. Kënduan pastaj këngët e Naim Frashërit dhe shpirti i tyre u tund. Ata nuk i mbyllnë fletët e vjershave, s' i mbyllnin dot. S'ngopeshin së kënduari. Kishin gjetur atje të vërtetën, e kishin kuptuar dhe u bintnë. U bintnë sepse e kishin ndër në zemër, i-u ish kulluar zemra, qenë bërë të pastër dhe të pafajshëm si foshnja. Çfar kishin ndër ata në ato vjersha, për çfar ishin bindur? Për një gjë të thjeshtë, shumë të thjeshtë, po e cila e pandjerë i-u rëndonte vetëdijen si plumb: ishin bindur se myslimanët e Stambollit nuk qenë- Turq po Shqiptarë orthodoksët e Bukureshtit. Ato vargje të Naimit mbanin zemrën e kombit në dorë: flisnin drejt nga zemra dhe hynin drejt në zemër. Ishin simboli i lavdisë dhe i besimit të të gjithë Shqiptarëve:

*Bota që kur është zënë,
Shqipëria gjall ka qënë:
Pellag' u theshin më parë,
Më se fundi Shqipëtarë.
Kemi patur mbretëria
Edhe fort shumë të mira:
Aleksandr' i math q' i thonë,
Ay ish nga fara jonë;
Pirrua qe nga Shqipëria,
Q' e lëndon gjith istorija.
Skënderbegu Kastrioti,*



*Q' u dëftye aq i zoti,
 Q' i dha dërmënë Turqisë,
 Ishte bir i Shqipërisë.
 Ç' burra kishte Shqipëria,
 Q' i ka shkruar istorija:
 Bajraktarë- e Qypriinë,
 Shkodranë- e Mehmet-Alinë,
 Xhavellën e Marko-Sulë,
 Bubullinë- edhe Mjabulë,
 Q' i dhanë dërmën Turqisë
 Dh' i vunë nder Shqipërisë.
 Po nga gjithë trimëria
 Nuk fitoj gjë Shqipëria;
 E ç' e desha trimërinë,
 Kur s' m' u ndoto për Shqipërinë?
 Me nder t' ënë roj Turqija,
 Po sot vuan Shqipëria,
 Ka vuar edhe po vuan-
 Turqit neve a na duan?
 S' duan fare të na shohin,
 Shqipërinë sot s' e njohin.
 Mos durofsh, i madhi Zot,
 Të rimë në zgjedhë sot!
 Se me punë kaq të vjer,
 Ne më s' jemi të gënjer:
 S' jemi Turqër as kaurë,
 Mos e thoni këtë kurrë!
 S' jemi Grekër as Bullgarë,
 Jemi vetëm Shqipëtarë!*

Kur kënduan këto fjalë të adhurara, veteranët e Lëvizjes së Bukureshtit i njomnë sytë me ngashërim dhe larguan çdo dyshim e drojtje, çdo frikë prej vëllezërve të tyre të Stambollit; sepse sikundër e rrëfenin vargjet e Naimit, këto dhe të tjera, të mbushura plot me urrejtje kundër pushtonjësit dhe robëronjësit turk, vëllezërit e tyre të Stambollit nuk qenëshin asfare Turq besnikë të Sulltanit po myslimanë shqiptarë, Shqiptarë të vërtetë, dhe Shqiptarë të djegur me njëmijë zjarre për Shqipërinë. Mblidhen atëhere veteranët e Bukureshtit e tokë pa humbur kohë, bëjnë Shoqërinë shqiptare të tyre, blejnë shtypshkronjën shqiptare të tyre, shtypin librat shqip të Naimit të tyre, mbushin Shqipërinë

me libra shqip, mbushin Shqipërinë me shkolla shqip, mbushin Shqipërinë me ndjenja shqiptare, mbushin qytetet e Shqipërisë me klube shqiptare, mbushin malet e Shqipërisë me çeta shqiptare, me ato çetat e para të Lirisë shqiptare të cilat- dyke vazhduar traditën e gjallë të bashkimit kombëtar besimtar të Naim Frashërit, të bashkimit të math shqiptar- do të bëheshin çetat, batalionet, brigadat dhe divizionet e më pastajme të ushtërisë shqiptare, çlirimtare e përjetëshme e atdheut.

KONCEPTI PËR BUJARËT SHQIPTARË

Për të identifikuar shqiptarin që ndjek besën, mund të përdoret koncepti "bujar shqiptar" që është i traditës sonë më të mirë për të treguar fisnikërinë e sjelljes, humanizmin dhe nivelin më të lartë të virtyteve. Kjo duhet të jetë qëllim global dhe është i rëndësishëm që edukimi të ketë një shtyllë kurrizore njëkohësisht njerëzore dhe shqiptare. Koncepti "Besë" përfshin kulturën hyjnore shqiptare dhe jo vetëm kuptimin e mbajtjes së fjalës së dhënë. Dihet që termi "besë" përdoret edhe si "besim", pra "fe" dhe ky koncept përdoret gjerësisht. Libri është titulluar "Besa" pikërisht në këtë kuptim.

RITET E BUJARËVE SHQIPTARË

Procesi i praktikimit të fesë së shqiptarëve do të kërkojë disa rite. Tashmë një nga ritet e konceptuar për herë të parë në librin "Besa, feja ime, e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë" (2009, faqe 32) ka marrë një shtrirje globale ndër shqiptarë dhe është Riti i Identifikimit të Shqiptarëve me duart si shqiponjë. Në origjinal ai është Riti i Lutjes së Bujarit Shqiptar dhe duart si shqiponjë vendoseshin për të kuptuar Librin e Kombit, pra duart si shqiponjë vendoseshin në sensin reflektues dhe të diturisë kombëtare dhe jo thjesht një identifikim "krenar" siç e shohim sot gjerësisht. Sidoqoftë, tashmë është bërë një hap tepër i rëndësishëm që masivisht shqiptarët të identifikohen në një mënyrë të lehtë. Ritet e tjera janë thellësisht kombëtare, siç janë përkujtimet e datave të rëndësishme (10 qershor - dita e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dita e kombit) apo 25 maj dita e përkujtimi të Naim Frashërit, Vëllezërve Frashëri dhe në fakt të të gjithë Rilindjes Kombëtare.

KONCEPTI PËR FALTORET SHQIPTARE

Global Albania ka për detyrë që ta krijojë këtë faltore duke nënkuptuar me këtë një bashkësi shqiptarësh që janë të edukuar shumë mirë që dinë thelbin e tyre shqiptar si krejt të përputhur me vlerat më të mira njerëzore. Nuk është me rëndësi që kjo punë të bëhet në atë mënyrë që e bëjnë kishat, xhamitë apo faltoret e tjera, por është e rëndësishme që të bëhet. Kjo detyrë do t'u përkasë edhe shkollave shqipe që ta konceptojnë dhe Global Albania t'i japë shenjtërinë, pra mbështetjen e plotë nga publiku.

BESA DHE KRISHTËRIMI DHE MUSLIMANIZMI

Global Albania edukon besën dhe bujarët shqiptarë. Në këtë mënyrë ajo i bën bashkë shqiptarët. Mësimet e "Besës" janë nga rilindasit që vetë kanë qenë fetarë dhe i përkisnin ose krishterimit ose muslimanizmit. Besa dhe krishterimi apo besa dhe muslimanizmi mund të qëndrojnë tek i njëjti person pa ndonjë problem. Ndaj asnjë antagonizëm nuk do të ketë. Është e natyrshme që Global Albania të interesohet kryesisht për besën dhe ta zmadhojë atë, me devizën e Çajupit

"Besa është e gjithësisë, ne jemi të Shqipërisë, se kemi pirë një sisë", që do të thoshte se fetë janë universale, por ne duhet të interesohemi për kombin tonë.

Kur bëhet fjalë për kishat, xhamitë apo faltoret universale në trojet etnike shqiptare, Global Albania interesohet vetëm për sa ato të kenë libra lutje në gjuhën shqipe, dhe të kenë mjaftueshëm klerikë shqiptarë dhe të mbrojnë thelbin shqiptar në punën e tyre. Për pjesën tjetër natyrshëm që nuk do të kenë pse të shprehen sepse ato janë universale. Këtu vlejnjë përsëri mësimet e Sami Frashërit në "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë".

KRENARIA DHE PËRULTËSIA

Global Albania e kupton që puna e organizatave shqiptare në botë është në sy të të gjitha shoqërive. Global Albania synon të ulë dozën e krenarisë boshe që është e tillë që i prish punë konceptit të të tjerëve për shqiptarët.

Në këtë pikë vlen të kujtojmë thënien e Sami Frashërit: "Krenaria ka shkaktuar prishjen e shumë shteteve dhe kombeve."

ORGANIZATAT SHQIPTARE PJESË E GLOBAL ALBANIA AKREDITOHEN GLOBALISHT

Organizata të hapura, demokratike dhe të aksesueshme

Organizatave shqiptare, ato që tashmë janë nëpër botë apo të reja që do të formohen, në këndvështrim të Global Albania, pra fjala për organizata të akredituara janë ose duhet të jenë të hapura dhe këtë e tregojnë duke ofruar informacion të gjerë mbi veprimet, anëtarësimet në organizata, transparencë në rregullat se si ato funksionojnë, gatishmëri për të ndarë në çdo kohë informacion me anëtarët e organizatës, kritere të qarta dhe transparente anëtarësimi, përpiqen për ta bërë të sigurtë që takimet, veprimtaritë t'u komunikohen të gjithë anëtarëve që të jenë në gjendje të marrin pjesë plotësisht në të tilla ngjarje, takime, apo veprimtari:

Organizatave shqiptare tregojnë gatishmërinë e tyre për t'u mbushur me anëtarë të rinj nga komuniteti shqiptar.

Organizatave shqiptare të akredituara janë ose duhet të jenë demokratike dhe konceptohen në mënyrë të tillë që të gjithëve t'u dëgjohet zëri, qoftë në shumicë apo në pakicë, kanë kanale të qarta komunikimi ndërmjet drejtimit dhe anëtarësisë, kanë transparencë dhe llogaridhënie ndaj anëtarëve sidomos në buxhet dhe shpenzime, ata që preken nga vendimet të kenë një zë në proceset që çojnë në vendime, mospajtimet dhe ankesat i trajtojnë ose i zgjidhin, dhe sipas rastit i përpunojnë në nivele të njëpasnjëshme më të larta brenda organizatës, ato konceptohen në atë mënyrë që u lejojnë të gjithë anëtarëve për të kandiduar për poste ekzekutive, dhe proceset zgjedhore janë të paanshme, të ndershme ku anëtarët marrin pjesë lehtësisht si votues por edhe si kandidatë, duke përfshirë edhe sigurimin e një arbitri të paanshëm e të besuar në procese zgjedhore. Në këtë pikë të fundit, organizatat shqiptare mund të ndihmohen nga të tjera organizata shqiptare.

AKREDITIMI I ORGANIZATAVE SHQIPTARE

Akreditimi nuk është një proces vertikal, por horizontal. Nuk ka organizatë më lartë apo më poshtë. Të gjitha janë të barabarta, por ato e kërkojnë akreditimin tek njëra-tjetra (pra jo diku tjetër por tek "vetja"). Kjo punë bëhet prej tyre për të bindur një publik gjithmonë e më të gjerë që i kapërcen shtetet që një organizatë ka marrë pëlqimin, besimin e shumë organizatave. Në këtë kuptim, ky lloj akreditimi është me kritere më të fuqishme sesa po të kishte një institucion të vetëm që ta bënte akreditimin, se një organizatë do të duhet të futet në kontakt me të paktën 30 organizata të tjera në mbi 12 shtete dhe duhet t'u marrë atyre pëlqimin, miratimin, ose njohjen.

Kjo është e domosdoshme, sepse që të bëjnë atë që është parashikuar të bëjnë, pra punë në grup (global), do të duhet që të kenë krijuar njohje të mira me njëri-tjetrin. Nëse akreditues do të ishte një institucion qëndror, ta zemë shteti, vetë shteti nuk do të sigurote dot njohjen e tyre me njëri-tjetrin dhe kjo do të linte vend për shpërdorime të besimit nga vetë shteti, ta zemë në interes politik. Kjo është arsyeja pse shteti shqiptar duhet mbajtur larg nga kjo punë. Është më mirë për vetë shtetin, nëse ai ia do të mirën kombit dhe ndjek logjikën dhe frymën e Kushtetutës.

Synimi është që të ekzistojë një forum global i organizatave shqiptare i besueshëm nga publiku shqiptar dhe nga vetë organizatat, i pakontrolluar dhe i drejtuar nga askush, një tryezë e rrumbullakët globale.

As ne që po e shkruajmë këtë koncept nuk i kemi dhënë vetes asnjë tagër, apo përfitim, përveç përfitimit të kënaqësisë që po e bëjmë një hap të tillë.



Shënim: Këto arsyetime, rekomandime që shkruajmë janë për të vendosur një standard, që do të thotë se nëse nisma merret, pra Global Albania bëhet realitet, standardi mund të përmirësohet nga vetë organizatat pa in referuar këtij dokumenti, por jo të përqendrohet. Pra është "statut" vetëm në kuptimin që nuk duhet bërë më dobët se kaq, por realisht nuk është statut sepse mund të bëhet më mirë se kaq dhe nuk duhet të jetë pengesë ndonjë përcaktim apo rekomandim që ne e bëjmë, por duhet ribërë. Në rastin e statuteve, duhet ndryshuar statuti pa të bësh diçka më mirë, që nuk është e përcaktuar. Ky nuk është rasti.

Kjo do të arrihet përmes një procesi të pavarur dhe të pakontrolluar nga askush, as nga ne që po shkruajmë këtë politikë, por që respekton standarde të larta dhe kombëtare. Fryma është ajo që duhet të ecë përpara.

Monitorimi i realizimit praktik të Global Albania

1. Nuk ka dhe nuk duhet të ketë një organizatë nismëtare dhe drejtuese. Procesi është konceptuar i decentralizuar, që në nisje.

Monitorim: Kjo do të thotë që nëse publiku identifikon një organizatë (përveç autorit), shoqatë, parti, shtet që e merr përsipër të flasë se si duhet bërë ky proces e të japë udhëzimet, qartësisht po devijon dhe do të jetë shenjë e qartë që nuk ka synime të mira. Ne, nëse na kërkohet, si autorë të konceptit, do të japim shpjegime shtesë, por do t'ju qëndrojmë atyre që kemi thënë këtu, ku kryesore është që as vetes nuk ia japim më të drejtën që të bëjmë një drejtim global të organizatave. Tjetër është liria e të shprehurit dhe tjetër teknika "finoke" për ta marrë drejtimin duke përdorur mediat.

2. Hapi i parë: Identifikimi i interesit të organizatës për të marrë pjesë në Global Albania është vendim i vetë organizatës. Kjo do të thotë që organizata të ndryshme mund të fillojnë njëherësh. Ato vendosin vetë të bëjnë ose jo pjesë në këtë nismë. Ne mund t'i nxitim, por do të jenë ato që e bëjnë hapin e parë konkret.

Monitorim: Organizata duhet të provojë që e ka lexuar këtë dokument, e ka diskutuar në forumet e saj, dhe ka marrë një vendim. Organizatës do t'i kërkohet nga të tjerët të paraqesë dëshmi që e ka kaluar këtë fazë. Kjo është e rëndësishme për të provuar seriozitetin e organizatës. Askush nuk duhet të anashkalojë hapat. Dëshmi do të jetë një datë mbledhjeje, një procesverbal formal, një publikim në faqet zyrtare, disa emra të përfshirë. Duhet kuptuar që me anë të kësaj dëshmie, organizatat provojnë se ato nuk janë në formë organizata, por janë në përmbajtje. Mund të qëllojë që quben organizata dhe në të vërtetë përfaqësojnë një person apo një familje. Nuk duhen akredituar të tilla.

3. Që një organizatë të bëhet pjesë e Global Albania ajo duhet të akreditohet nga të paktën 30 organizata të tjera në botë. Akreditimi quhet "në proces" nëse organizata e ka filluar procesin por nuk ka përfunduar në 30 njohje të ndryshme. Akreditimi quhet "i përfunduar" kur janë plotësuar të gjitha kriteret. Që një organizatë të jetë e akredituar plotësisht duhet të ketë **30 dokumente formale njohjeje** nga 30 organizata të ndryshme.

Dokumenti lëshohet me këto elemente:

- Identifikimi i organizatave (emra, logo, adresa, e-mail, telefona, website, leje shtetërore, drejtues që firmosin), datën, dhe*
- Titulli i "NJOHJE E DYANSHME NË KUADËR TË NISMËS GLOBAL ALBANIA" dhe*
- teksti që është pak a shumë: "Ne (emrat e shoqatave), pasi jemi njohur me konceptin Global Albania të përsëritur në broshurën me autor Artur Shkurti, shkolla "Udhë e shkronjave", Tiranë, (2024) vendosëm të marrim pjesë në këtë nismë dhe të respektojmë frymën dhe rekomandimet që jepen aty. Për këtë arsye deklarojmë bashkëpunimin ndërmjet dy organizatave tona në kuadër të kësaj nisme. Ky është një dokument njohjeje i ndërsjelltë ndërmjet dy palëve në kuadër të nismës Global Albania."*
- firmat dhe vulat e të dy palëve që mund të jenë digjitale (gjetet një formë) dhe të jenë firmosura në mënyrë digjitale nga të paktën dy persona nga çdo organizatë.*

Monitorim: Mirë është që organizatat të mos përdorin ndryshime me këtë tekst, edhe sikur këto të jenë të arsyeshme, sepse dokumentet do të bëhen të pakrahueshme. Ky është një tekst formal për identifikim të veprimtarisë që lidhet me **Global Albania**, dhe nuk do ta ndikojë fare përmbajtjen e bashkëpunimit më vonë.

6. Botimi i njohjes së ndërsjelltë të dy organizatave shqiptare. Pasi organizatat njohin njëra-tjetrën me një akt formal, ato njoftojnë anëtarët e tyre dhe e shpallin këtë njohje publikisht në faqet e tyre të internetit duke dhënë aty edhe më shumë detaje.

Monitorim: Botimet do të jenë gjurmë e seriozitetit të procesit. Kur organizata boton, ajo e bën të dukshme procesin për publikun që e ndjek. Këto dëshmi a) njohjeje dhe b) botimi do të duhen në procesin përfundimtar të akreditimit të plotë.

7. Kriter për strukturën e 30 njohjeve (akreditimeve) që do të marrë organizata. Për të patur një qasje globale, organizata duhet të dëshmojë se synon vërtetë të ketë një bashkëpunim të gjerë me organizata shqiptare përtej shtetit ku ajo vepron.



Grupi	SHTETE OSE GRUPI I SHTETEVE nga duhet të jenë organizatat për njohjen bazë	NJOHJET (për rajon)
G1-3	Zvicër	3 njohje
G2-3	Suedi, Norvegji, Danimarkë, Finland	3 njohje
G3-3	SHBA	3 njohje
G4-3	Mbretëri e Bashkuar (2), Australi (1)	3 njohje
G5-2	Kanada	2 njohje
G6-2	Itali	2 njohje
G7-2	Greqi, Slloveni, Rumani	2 njohje
G8-2	Austri	2 njohje
G9-2	Gjermani	2 njohje
G10-2	Turqi, Ukrainë	2 njohje
G11-2	Belgjikë, Hollandë, Luksemburg, Francë, Spanjë	2 njohje
G12-4	Kroaci, Bosnjë	2 njohje
	Zgjedhje e lirë	2 njohje

8. Akreditimi i plotë me tri kushte:

- të jenë 30 njohje (akreditime) sipas kriterëve të tabelës sipër;
- në përfundim të procesit të 30 organizatat që kanë dhënë njohjen duhet të jenë të njohura vetë;
- nëse një organizatë (ta zemë në Itali) i ka marrë 30 njohje, por ndërkohë 3 nga këto ende nuk e kanë përfunduar plotësisht akreditimin, atëherë kjo organizatë ose duhet të kërkojë të tjera njohje më të sigurta që të plotësojë numrin 30, ose duhet të ndihmojë 3 organizatat që ende nuk e kanë përfunduar procesin e akreditimit të plotë ta plotësojnë detyrën për njohje të plotë.

Monitorim: Organizatat nuk duhet ta shohin si punë të tepruar. Nëse ato i kanë kaluar këto sprova, tregojnë se vërtetë u intereson ideja dhe koncepti **Global Albania**. Suksesi i Global Albania varet pikërisht nga kjo fazë akreditimi, duke e ngritur në nivelin më të lartë që ka ekzistuar komunikimin dhe bashkëpunimin global të organizatave shqiptare. Struktura e mësipërme është ndikuar nga realiteti i shpërndarjes së organizatave shqiptare, pra, në këto shtete ka më shumë organizata shqiptare. Kjo do të thotë që një organizatë do të marrë njohje nga të paktën 12 shtete që kryesisht janë në Evropë dhe në Amerikën e

Veriut, pikërisht se në këto rajone janë të përhapura organizimet shqiptare.

9. Dy organizata janë apriori të akredituara:

- Shkolla "Udha e shkronjave", Tiranë, Shqipëri, si nismëtare e projektit
- "Vatra" (SHBA), si organizatë tradicionale shqiptare në diasporë.

Monitorim: "Udha e shkronjave" do ta nxitë dhe monitorojë procesin e organizimit, të akreditimit, të komunikimit dhe bashkëpunimit global të organizatave shqiptare, por ajo nuk do të jetë një organizatë akredituese. Mënyra e veprimit të organizatave brenda kësaj nisme është përcaktuar të jetë e pavarur, pra e pavarur edhe nga vetë "Udha e shkronjave" që po i nxit për herë të parë përmes këtij dokumenti.

"Vatra" (SHBA) mund të përfshihet në nxitjen e procesit në mënyrë të hapur dhe të barabartë për të gjitha organizatat shqiptare në botë që janë në proces.

Kur organizatat e përfundojnë procesin nga ana e tyre, pra i marrin 30 njohje, ato e botojnë listën në këtë formë: Le ta zemë që organizata shqiptare quhet "Besa dhe Bujari" dhe ajo kërkon të botojë njohjet që ka marrë:

	Grupi	Organizatat që kanë akredituar shoqatën "Besa dhe Bujari"	Akredituar/ Në proces
1	G1-3	Shoqata 1, Zvicër	akredituar(30)
2	G1-3	Shoqata 2, Zvicër	në proces (12)
3	G1-3	Shoqata 3, Zvicër	në proces (4)
4	G2-3	Shoqata 4, Suedi, Norvegji, Danimarkë, Finland	akredituar (30)
5	G2-3	Shoqata 5, Suedi, Norvegji, Danimarkë, Finland	në proces (26)
6	G2-3	Shoqata 6, Suedi, Norvegji, Danimarkë, Finland	akredituar (30)
7	G3-3	Shoqata 7, SHBA	akredituar (30)
8	G3-3	Shoqata 8, SHBA	në proces (22)
9	G3-3	Shoqata 9, SHBA	në proces (3)
10	G4-3	Shoqata 10, Mbretëri e Bashkuar (2), Australi (1)	në proces (19)
11	G4-3	Shoqata 11, Mbretëri e Bashkuar (2), Australi (1)	akredituar (30)
12	G4-3	Shoqata 12, Mbretëri e Bashkuar (2), Australi (1)	akredituar (30)
13	G5-2	Shoqata 13, Kanada	akredituar (30)
14	G5-2	Shoqata 14, Kanada	në proces (26)
15	G6-2	Shoqata 15, Itali	akredituar (30)
16	G6-2	Shoqata 16, Itali	në proces (20)
17	G7-2	Shoqata 17, Greqi, Slloveni, Rumani	akredituar (30)
18	G7-2	Shoqata 18, Greqi, Slloveni, Rumani	akredituar (30)
19	G8-2	Shoqata 19, Austri	akredituar (30)
20	G8-2	Shoqata 20, Austri	në proces (13)



21	G9-2	Shoqata 21 , Gjermani	akredituar (30)
22	G9-2	Shoqata 22 , Gjermani	akredituar (30)
23	G10-2	Shoqata 23 , Turqi, Ukrainë	akredituar (30)
24	G10-2	Shoqata 24 , Turqi, Ukrainë	në proces (11)
25	G11-2	Shoqata 25 , Belgjikë, Hollandë, Luksemburg, Francë, Spanjë	akredituar (30)
26	G11-2	Shoqata 26 , Belgjikë, Hollandë, Luksemburg, Francë, Spanjë	në proces (9)
27	G12-4	Shoqata 27 , Kroaci, Bosnje	në proces (18)
28	G12-4	Shoqata 28 , Kroaci, Bosnje	në proces (24)
29	G12-4	Shoqata 29 , Zgjedhje e lirë	akredituar (30)
30	G12-4	Shoqata 30 , Zgjedhje e lirë	në proces (27)

Numri rendor (kolona e parë) duhet për të verifikuar që janë 30. Kolona e dytë përmban kodin e grupit, ta zemë G12-4 që do të thotë që shoqata i përket grupit G12 dhe kujtohet edhe një herë kriteri që duhen 4 qendra nga ky grup. Shënimi "akredituar (30)" do të thotë që shoqata akredituese në fjalë e ka plotësuar akreditimin për vetë. Shënimi "në proces" do të thotë që deri në atë çast, shoqata ende nuk e ka plotësuar. Numri pas, ta zemë "në proces (16)" do të thotë se organizata ka arritur 16 akreditime deri në atë çast.

Si do të kuptohet se kur Global Albania është bërë fakt?

Kuorumi do të quhet i plotësuar kur të bëhen 100 organizata shqiptare të akredituara. Duhet besuar që gjatë rrugës shoqatat do të përshpejtojnë dhënien e informacionit për njëra-tjetrën dhe procesi do të arrihet të çohet në fund. Bëhet fjalë që janë rreth 600 shoqata në botë dhe prej tyre po kërkohet të veçohen të paktën 100 të tilla që kanë njohje të fuqishme me njëra-tjetrën dhe janë nga 12-25 shtete të ndryshme kryesisht në Evropë, Amerikë të Veriut, ku shqiptarët janë përhapur shumë dhe kanë shumë organizata.

Asnjë organizatë shqiptare që vepron në troje etnike shqiptare nuk do të përfshihet në akreditim. Duke qenë se organizatat shqiptare do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me njëra-tjetrën, ato do ta dinë saktë numrin e organizatave të akredituara dhe çastin se kur është plotësuar numri 100. Kjo ndodh hapur. Të gjithë do të informojnë të gjithë (e-mail, faqe interneti). Pra, do të kuptohet se kur ka ardhur koha.

Kuvendi i parë i Global Albania

Nga ky çast, 100 organizatat e para të akredituara merren me organizimin e Kuvendit të Global Albania.

Ndërkohë që organizatat e tjera mund të vijnë të plotësojnë akreditimet dhe sapo e plotësojnë ato quhet se janë me të drejta të plota në Global Albania, pra numri mund të shkojë më shumë sesa 100. Global Albania do të frymëzojë për krijimin e shoqatave të reja shqiptare, kështu që pritët të rritet numri.

Dita e Kuvendit të Global Albania

Organizimi i parë do të lihet në datën më të afërme që do të jetë ose 17 shkurt (2008, Pavarësia e Kosovës), ose 7 mars (Mësonjëtorja, 1887), ose 25 maj (Naim Frashëri, 1846), ose 10 qershor (1878, Lidhja e Prizrenit), ose 28 nëntor (1912, 1443). Kuvendi mbahet në Shqipëri ose Kosovë.

Kuvendi zgjat të paktën tre ditë. Synimi është që delegatët të kenë një kohë të mjaftueshme për të njohur pikëpamjet e njëri-tjetrit dhe të bëjnë takime të rëndësishme në atdhe.

Delegatët. Çdo organizatë e akredituar emëron 3 (tre) delegatë pjesëmarrës. Delegatët mund të jenë nga anëtarët e saj të rregullt dhe organet drejtuese, por mund të jenë edhe nga figura të shquara shqiptare në arenën ndërkombëtare. Duke zgjedhur delegat edhe jashtë organizatës, organizata tregon që interesohet për cilësinë edhe më të lartë të përfaqësimit në Kuvendin e Global Albania.

Shpenzimet. Shpenzimet mbahen nga çdo organizatë shqiptare anëtare e Global Albania për pjesën që i takon.

Të ftuar në Kuvend mund të jenë presidenti i Republikës (Shqipëri, Kosovë) dhe/ose Kryeministrat.

Çfarë duhet monitoruar dhe dekurajuar?

Nuk duhet të lejohet përdorimi politik. Të shmangësh përdorimin politik është diçka që kërkon një kujdes shumë të madh, që edhe anëtarët e partive të mos ndihen të anashkaluar, por edhe që të mos nxiten të duan t'i japin Global Albania natyrën e parlamentit. Global Albania nuk do të jetë parlament, pra grumbullim partish apo aleancash partish. Kur themi këtë do të jetë e qartë se vetë Global Albania nuk do të transformohet kurrë në një parti, madje nuk do të jetë as organizatë, do të jetë thjesht Frymë e Kombit, por në veprim të dukshëm dhe të monitorueshëm.



Naim Frashëri thotë "S'do të dëgjoj veç gjuhës që më flet pa zë". Kombi ynë ka nevojë për këtë "gjuhë që flet pa zë" dhe kjo do të jetë detyra e Global Albania.

Global Albania administron aspiratat e qytetarëve me origjinë shqiptare me shtetësi të huaj (ndoshta edhe me shtetësi të dyfishtë). Duke qenë grup i veçantë, natyrshëm ka qasje të veçantë, por natyrisht që përfituese e parë do të jetë Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut dhe të gjithë shqiptarët e trojeve etnike. Por duhen lënë ta bëjnë krejt të pavarur. Natyrisht që atdheu ndihmon shumë sepse ata njerëz të këtij atdheu janë, të të njëjtit gjak, fis, krahinë. Por tjetër është të ndihmohet e tjetër është të drejtosh apo të fitosh protagonizëm.

Media e vetme e Global Albania është vetëm bashkësia e mediave lokale që mbahen nga organizatat anëtare. Askush nuk përfaqëson Global Albania në media të tjera. Organizatat anëtare mund të bëjnë komentet e tyre, por e bëjnë të qartë që këto janë të tyre dhe jo mendime të Global Albania.

Dy shqiptonjat nën flamurin kombëtar, në këtë këndvështrim, marrin edhe një kuptim shtesë: nga një anë Global Albania dhe diaspora shqiptare, dhe nga ana tjetër kombi shqiptar në atdhe. Të dyja do t'i japin frymë njëra-tjetrës, por më parë duhet të ndodhë që Global Albania të ndërtohet nga vetë "qytetarët" e saj shqiptarë që tashmë kanë shtetësi të huaj.

Ideologjia dhe Feja "zyrtare" e Global Albania është Besa, dhe mësimet e Rilindjes Kombëtare dhe deviza e Pashko Vasës "Feja e shqiptarit është shqiptaria".

Përkufizimi: Global Albania është organizim global shqiptar jashtë trojeve etnike dhe përfaqëson interesat e organizatave shqiptare, persona juridikë të miratuar nga shtetet përkatëse joshqiptare, të cilat kanë natyrë jofetare dhe jopolitike, që veprojnë jashtë atdheut, por që si objekt kryesor të veprimtarisë kanë gjuhën dhe kulturën shqiptare, identitetin shqiptar dhe mbrojtjen e interesit kombëtar i situatës në vlerat më të larta të shoqërisë njerëzore, të pranuar botërisht.

Global Albania ka për anëtarë organizata dhe jo individë. Nëse një bashkim organizatash anëtarësohet në Global Albania, kjo anulon anëtarësimin e anëtarëve të saj. Pra nëse organizata A bën pjesë në organizatën B, nuk mund të bëjnë pjesë të dyja njëkohësisht në Global Albania.

Brezat e diasporës shqiptare

Shqiptarët jashtë atdheut kanë ngritur jetën e tyre në shtete e kultura të tjera dhe si çdo diasporë janë në një nga këto grupe:

Diaspora e Brezit të Parë: Kjo gjeneratë përbëhet nga individët që kanë emigruar vetë nga atdheu. Ata mbajnë natyrshëm lidhje të forta me kulturën, gjuhën dhe traditat shqiptare ndërsa përshtaten në kulturën e shtëpisë së tyre të re. Është pikërisht ky grup që bëhet natyrshëm udhëheqës i organizatave shqiptare. Dhimbja e shkëputjes është më e madhe tek ky grup.

Diaspora e Brezit të Dytë: Gjenerata e dytë përfshin fëmijët e gjeneratës së parë që janë lindur dhe rritur në diasporë. Ata shpesh kanë një identitet hibrid, duke përfshirë elemente të kulturës së prindërve të tyre dhe kulturën e vendit të tyre pritës, ose të një prej prindërve që mund të jetë i huaj. Ata mund të flasin gjuhën e prindërve të tyre në shtëpi ndërsa flasin gjuhën e vendit pritës në jetën e tyre të përditshme. Situata bëhet më hibride nëse një nga prindërit është i huaj dhe i bie të jetë dyfish diasporë e dy gjeneratave të dyta të dy kombeve të ndryshme. Me shumë mundësi shqipja kalon në plan të dytë dhe aktivizimi i tyre bie ndjesëm.

Brezi i Gjeneratës së Tretë: Gjenerata e tretë përfshin nipërit dhe mbesat e gjeneratës së parë që janë lindur dhe rritur në diasporë. Ata mund të kenë një lidhje më të dobët me kulturën dhe gjuhën e atdheut të gjyshit dhe gjyshes, pasi janë më të integruar në kulturën e vendit pritës. Megjithatë, ata ende mund të mbajnë aspekte të trashëgimisë së tyre përmes traditave familjare, festave dhe ngjarjeve kulturore.

Brezi i Pasardhësve: Përtej gjeneratës së tretë, gjeneratat pasuese vazhdojnë të jenë pjesë e diasporës, por lidhja e tyre me atdheun mund të bëhet gjithnjë e më largët. Ata mund të identifikohen më shumë me kulturën dhe vlerat e vendit pritës, megjithëse ende mund të ruajnë një ndjenjë krenarie për trashëgiminë e tyre dhe mund të marrin pjesë në veprimtari ose ngjarje kulturore të lidhura me atdheun e tyre trashëgimtar.

Këto dallime brezash janë të natyrshme për çdo diasporë kombëtare. Ato ndihmojnë në kuptimin e faktit se si komunitetet e diasporës evoluojnë në kohë, me çdo gjeneratë që përballen me sfida dhe mundësi unike në mbajtjen e identitetit të tyre kulturor dhe lidhjen me atdheun e tyre.



Interesi kombëtar shqiptar e do që të maksimalizohet ruajtja dhe zhvillimi i kulturës dhe identitetit shqiptar. Numrat e brezit të parë (pas vitit 1990) të diasporës shqiptare janë maksimalë, por me kalimin e viteve, ato natyrshëm do të ulen dhe vendi i mbetet brezit të dytë.

Çasti kur duhen vjelë frytet e zmadhimit dhe pjekjes së diasporës është ky. Me kalimin e kohës fruti kalon nga pjekja në kalbje (nënkupto asimilim, ftohje, varfërim, indiferentizëm, braktisje e ndoshta armiqësim). Nëse organizatat shqiptare nuk lidhen në mënyrë agregate tani, thjesht do të bëhen vonë.

Humbjet nga një brez në tjetrin janë të mëdha, edhe pse zgjasin me dekada, por ato mund të zvogëlohen përmes:

organizimit të komunitetit shqiptar globalisht dhe në çdo shtet për të mbështetur komunitetet shqiptare, familjet shqiptare dhe individët shqiptarë kudo që të jetojnë; investimit në programet e gjuhës dhe kulturës shqipe në nivel familjeje, komuniteti dhe në nivel global; investimit në një kulturë komunikimi e bashkëpunimi global që do të japë më shumë mundësi e arsye jetese me tipare kombëtare shqiptare, që do të nxitë investime globale në çështjen e mbrojtjes së identitetit, gjuhës shqipe, kulturës, interesit kombëtar por edhe biznesit me tipare shqiptare.

Arsyet e emigrimit janë arsye për përmirësim

Nëse komuniteti global shqiptar kupton arsyet që i kanë bërë të emigrojnë masivisht, atëherë është e mundur që nga jashtë të ndikojnë që këto arsye të zvogëlohen në atdheun e tyre.

- **Mundësitë ekonomike:** Shumë shqiptarë kanë emigruar në kërkim të perspektivave më të mira ekonomike, duke përfshirë pagesa më të larta, mundësitë e punës, dhe standardet e jetesës. Mungesa e stabilitetit ekonomik, papunësia, varfëria, dhe mungesa e mundësive ekonomike në atdhe kanë shtyrë masivisht shqiptarët dhe familjet të kërkojnë një jetë më të mirë jashtë.
- **Korrupsioni, konfliktualiteti, mungesa e sundimit të ligjit:** Korrupsioni i gjithanshëm, padrejtësia dhe mungesa e stabilitetit politik, survejimi, përndjekja, abuzimet e të drejtave të njeriut, dhe konfliktet e vazhdueshme kanë shtyrë njerëzit të largohen nga vendi i tyre në kërkim të sigurisë dhe mbrojtjes.
- **Liria fiktive dhe shthurja:** Pasiguria sociale, dhe kufizimet në lirinë e shprehjes dhe të organizimit kanë shtyrë shumë individë dhe familjet të largohen nga vendi në kërkim të tolerancës, pranimit, dhe lirive diku tjetër.
- **Kërkesa për arsim cilësor:** Janë kaq shumë të rinjtë shqiptarë që kanë emigruar për të ndjekur një arsim më të mirë, duke përfshirë arsimin e lartë, trajnime të

specializuara, dhe kërkime akademike, që nuk ofrohen ose nuk janë të arritshme në Shqipëri. Tashmë janë me dhjetëra ose qindra mijë të diplomuarit jashtë. Qasja në arsim cilësor dhe dëshira për zhvillim personal dhe profesional motivojnë individët për të emigruar përkohshëm ose përgjithmonë. Me shumë mundësi ata zënë vend aty ku bëjnë shkollën dhe më vonë tërheqin të tjerët.

- **Bashkimi familjar:** Bashkimi i familjes është një arsye e zakonshme për emigrimin, pasi individët masivisht kërkojnë të bashkohen me anëtarët e familjes që tashmë kanë emigruar ose të ribashkohen me të afërmit që jetojnë në jashtë vendit. Lidhjet familjare dhe dëshira për të qenë pranë të dashurve mund të ndikojnë në vendimet për emigrimin.
- **Dobësimi i fshatit dhe i qyteteve të vogla, shpopullimi:** Vetë shpopullimi bëhet faktor që ndikon në një shpopullim më të madh. Faktorët ambientale si katastrofat natyrore, ndryshimet klimatike, degradimi ambiental, dhe mungesa e burimeve kanë varfëruar situatat dhe detyrojnë njerëzit të largohen nga vendi në kërkim të kushteve të sigurta dhe më të qëndrueshme të jetesës.
- **Kujdesi Shëndetësor dhe Cilësia e Jetës:** Qasja e kufizuar në kujdesin shëndetësor, infrastruktura e pamjaftueshme, kushtet e këqija të jetesës, dhe ndotja e mjedisit ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve, duke i shtyrë ata të emigrojnë në kërkim të shërbimeve më të mira shëndetësore dhe cilësisë së jetës.
- **Globalizimi dhe lëvizshmëria:** Rritja e lidhjeve ndërkombëtare përmes globalizmit, përparimet në transport, dhe lehtësia e komunikimit kanë lehtësuar lëvizshmërinë dhe migracionin ndërkombëtar. Njerëzit mund të emigrojnë për arsye personale, kulturore, ose stile jete, duke kërkuar përvoja të reja, mundësi, dhe lidhje në pjesë të ndryshme të botës. Këto arsye për emigrimin janë të lidhura në shumë mënyra kreative, dhe vendimet për migracionin e individëve ndikohen nga një kombinim i faktorëve ekonomikë, social, politik, dhe personal. Ky faktor i fundit do të thotë se lëvizshmëria nuk është vetëm për faktorë negativë.

Objektivat e Global Albania

1. Ndërtimi i forumit global të organizatave shqiptare që janë formuar nga qytetarë me origjinë shqiptare dhe pasaportë të huaj, në atë mënyrë që të jetë e aftë të ndikojë krijimin e opinionit publik global, duke ndarë së bashku produktet e studimit, të analizës, të vlerësimit, reflektimit, të komunikimit dhe të bashkëpunimit.
2. Ruajtja dhe zhvillimi i identitetit dhe i trashëgimisë gjuhësore dhe kulturore shqiptare nga individët me origjinë shqiptare kudo në botë dhe nga institucionet shqiptare që veprojnë jashtë atdheut.



3. Konceptimi në vazhdimësi i interesit kombëtar duke shfrytëzuar ekspertizën globale shqiptare.
4. Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet dhe shqiptarët në atdhe.
5. Depozitimi në to i sa më shumë vlerave materiale e kulturore që krijohen nga shqiptarët në botë.
6. Orientimi i ndihmës që do të japë atdheu dhe shteti për diasporën shqiptare.
7. Mbrojtja globale e kombit shqiptar.

DECENTRALIZIM dhe FRYMË

Global Albania udhëhiqet nga këshilla e Naim Frashërit "Besa është në krahuar, nuk është në kartë shkruar". Kjo do të thotë që organizatat anëtare do të merren vesh me reputacionin e tyre. Për këtë arsë, ajo do të ketë identitetin e vet për nga mënyra e krijimit, objektivat dhe anëtarësia; do të ketë anëtarë (organizatat e akredituara globalisht), por:

1. nuk do të ketë ndonjë regjistrim zyrtar të Global Albania, por ndërkohë puna do të jetë e hapur, e dukshme, e matshme, e vlerësueshme, e frytshme përmes organizatave që e përbëjnë.
2. nuk do të ketë shkresa zyrtare të nxjerra në mënyrë qendrore; do të jenë organizatat që do të shkruajnë njëkohësisht.
3. nuk do të ketë logo apo markë të regjistruar. Flamuri shqiptar mjafton.
4. nuk do të ketë forume drejtuese;
5. nuk do të ketë individë përfaqësues, por të gjithë do të punojnë e do të flasin për të;
6. nuk do të ketë një media të vetën. Organizatat anëtare publikojnë njëkohësisht. Çdo media e anëtarëve shpërndan çfarë objektivash arrihen globalisht, çfarë veprimtarish, arritjesh ka, çfarë analizash ka.
7. asnjë organizatë anëtare nuk quhet përfaqësuese, por të gjitha e bëjnë njëkohësisht këtë punë përfaqësimi;
8. nuk do të ketë buxhet apo financa të veta. Organizata anëtare merren vesh të shpenzojnë, por i mbajnë vetë financat e tyre.
9. nuk do të ketë arkiva të veta. Çdo anëtar ruan kopjet e veta. Të gjithë kujdesen që të gjithë të kenë gjithçka.
10. nuk do të ketë karta anëtarësie.

Synimi është që të mos mos përfaqësohet kombi në një mënyrë që quhet ekskluziviste dhe as përfundimtare. Duhet marrë parasysh që atdheu është në Shqipëri, Kosovë e troje etnike dhe kombi është kryesisht aty. Megjithatë fuqitë e angazhuara globalisht, mund të mos jetë e mjaftueshme, sado mirë të duket puna. Shembull janë Faltoret Universale, që janë

organizime të fuqishme globale dhe mijëra vjeçare dhe përsëri dalin lajme që se kjo apo ajo çështje nuk zgjidhet në rregull prej tyre, ose publiku (edhe i tyre) nuk është dakort dhe shumë prej klerikëve turpërojnë Faltoren. Ta zemë Bertrand Russell shkroi "Pse nuk jam i krishterë". Forma më modeste që shmang protagonizmin e bën edhe më të mundshme që mendimi të shkojë

Naim Frashëri thotë:

Por kur desh Zot'i vërtetë
të dil faqeza në jetë,
aherë bëri Njerinë,
atje ta gjesh Perëndinë.

E njëjtë me frymën e kombit, ajo del përmes organizatave anëtare, por jo duke krijuar një organizatë të Frymës së Kombit. Ndaj nisma Global Albania nuk do të përfundojë në këtë nivel konkretësie.

PROGRAMI

Global Albania synon vetëm të mbajë komponentin shqiptar, të monitorojë bashkimin, të hapë kanalet e komunikimit dhe të bashkëpunimit global të shqiptarëve, duke krijuar kushtet që specialistët e fushave të ndryshme të mundën të orientojnë kombin në fushën e tyre të specializimit, nëse kjo është e domosdoshme.

Programi i Global Albania do të mbështetet në frymën, parimet dhe traditën më të mirë të veprimit të Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare të shekullit XIX dhe fillim shek XX si edhe çdo veprimtari e mëpasme në këtë frymë. Vlen si devizë thënia e Sevasti Qirjazit në kujtimet e saj për Naim Frashërin "Punën e tyre (rilindasit) na e lanë ta bëjmë me tjetër mënyrë, por jo kurrë me tjetër shpirt, por po me atë shpirt si të tyrin".

Axhenda kulturore e organizatave Global Albania

Ngritja e shkollave shqipe është detyrë parësore, kyçe për suksesin afatgjatë. Çfarëdo programi të mirë që të ketë Global Albania, punën e bëjnë vetëm shkollat. Janë ato që punojnë me fëmijën dhe familjen. Këtu vlen thënia e Sami Frashërit në "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet": "*Shqipëri pa shqiptarë nuk ka. Shqiptarë pa gjuhë shqipe nuk ka. Gjuhë shqipe pa shkollë që ta mësojnë atë nuk ka*".

Gjendja e shkollave shqipe në diasporë është shumë e prapambetur, në programe, në furnizimin me mësues, në financim, në përmbytje të librave, në interesin e familjeve.



Shembull konkret: Katër shkolla publike janë në dispozicion të mësimit shqip nga Bordi i Arsimit i Torontos dhe asnjë nuk funksionon. Nxënësit dhe mësuesit duhej të shkonin të shtunave. Fakti që nuk duan të shkojnë tregojnë se nuk e duan jetën shqiptare në emigracion, bashkimin në emigracion dhe ky është një dëm që vjen nga jeta e dobët në Shqipëri, jeta e përçarë, jeta me ngacmime.

Global Albania duhet ta ndreqë, sepse nuk ndreqet në nivel qyteti apo shteti. Ndreqet globalisht dhe me një organizim aq profesional, aq frymëzues, aq të fuqishëm sa do të jetë e pamundur ta refuzojnë të qenët pjesë e këtij komuniteti global të shqiptarëve. Mjaft që organizatat të veprojnë me kthjelltësi, me integritet e ndjeshmëri të lartë kombëtare.

Mendohet se vetëm 5% e nxënësve shqiptarë në botë e ndjekin një kurs të gjuhës apo të kulturës shqipe dhe shumica e tyre e ndjekin falas. Mund të mendohet që nevojat në botë mund të jenë për të mësuar me kurse rreth 350 000 nxënës shqiptarë. Nëse secila familje do të shpenzonte një shumë të arsyeshme prej 1000 euro në vit, atëherë buxheti global për arsimin shqip do të ishte 350 milionë dollarë, një buxhet tepër i fuqishëm, që të ngrihen shkolla, të paguhen biznese, madje edhe të blihen ndërtesa.

Ngritja e organizatave të reja shqiptare.

Pikëpamja jonë është që sa më shumë **në krye të organizatave të vendosen mësuesit e licensuar prej shteteve** dhe që punojnë në shkollat publike. Detyra kryesore e diasporës, ruajtja e identitetit, e gjuhës dhe zhvillimi i kulturës shqiptare, lidhet pikërisht me punën e mësuesve. Mësuesit e licensuar dinë axhendën e arsimit publik, dinë objektivat e shtetit në arsim, dinë metodikat, dinë trajtimin e komuniteteve dhe të kulturave dhe dinë se si të harmonizojnë kërkesat e diasporës me ato të shtetit. Mësuesit janë më të përshtatshëm që të njohin psikologjinë e popullsisë vendase, sepse ajo shfaqet në takimet me prindër. Ndërkohë mësuesit janë më të njohurit edhe në komunitetet ku shkojnë fëmijët shqiptarë. Mësuesit do të dinë të vlerësojnë më shumë ngritjen e komuniteteve në mënyrë edukative. Ngritja e organizimeve shqiptare me bazë profesionet janë shumë të domosdoshme, që shqiptarët e të njëjtit profesion të përparojnë e të ndihmojnë njëri-tjetrin në bizneset e tyre. Aktualisht shoqatat, për nga mënyra si janë ngritur dështojnë sepse ato quhen "gjithçkabërëse". Është e vështirë t'u përgjigjesh kërkesave të shumta të komunitetit dhe t'u drejtohesh grupeve kaq heterogjene për nga moshat, për nga profesionet, për nga generatat të cilave u përkasin (të lindur në atdhe, apo të lindur në atë vend) etj.

Heqja e akreditimit për organizatat

Organizatat ia heqin akreditimin e tyre një organizate kur mendojnë se një organizatë po shuhet ose ka probleme të natyrave të tilla që janë të papajtueshme me interesin kombëtar. Heqja e akreditimit bëhet publike bashkë me arsyet që e sjellin një vendim të tillë. Nëse organizata mbetet me më pak se 30 akreditime, pasi është bërë anëtare e Kuvendit të Global Albania ajo duhet t'i zëvendësojë humbjet e akreditimeve brenda tre muajve. Nëse mbetet me më pak se 30 akreditime nuk merr pjesë në kuvendin e radhës. Sidoqoftë kjo çështje zgjidhet në praktikë.

Financimi i Global Albania

Vetë veprimtaritë për llogari të Global Albania janë komponent i vetë organizatës anëtare. Është ajo që thotë se këtë veprimtari dhe këtë financim e kemi për llogari të nismës Global Albania. Për të njëjtën situatë organizata të ndryshme investojnë sasira të ndryshme, pra nuk është që presin që dikush tjetër nga lart t'u japë financim. Vetë organizatat nuk duhet financojnë ndonjë organizatë më të lartë.

Arshiva. Dokumentacioni që Global Albania krijon, e krijon në aq kopje sa janë anëtarë dhe ruhet nga organizatat anëtare. Në këtë kuptim, ai është më i sigurtë, sepse është në më shumë shtete e në më shumë organizata. Natyrshëm edhe Arshivat e Shtetit Shqiptar do të ndihmojnë.

Zgjidhja e konflikteve ndërmjet organizatave anëtare

Nëse dy organizata në konflikt me njëra-tjetrën bien dakort t'i drejtohen komunitetit global ato mund ta bëjnë këtë duke iu drejtuar atyre për mendim. Duke qenë se dihet numri i saktë i anëtarëve dhe e-mailit e tyre, atëherë me siguri do të gjenden organizata të tjera që do të japin zgjidhje.

SJELLJA E AMBASADAVE SHQIPTARE NDAJ GLOBAL ALBANIA

Shteti amë është përfitues i natyrshëm nga nisma Global Albania. Është e natyrshme që ambasadat të frymëzojnë. Ajo që presim ne prej tyre është që ato të ofrojnë informacion të tillë që u shërben shumë organizatave. Ne vetë, e kemi shfrytëzuar atë informacion që ato e kanë publik për organizimet e shqiptarëve në emigracion.

- Veçojmë faqen e Shqipërisë (Agjensia Kombëtare e Diasporës) <https://akd.gov.al/albanian-diaspora-organisations/>
- Veçojmë faqen e Kosovës <https://rd.rks-gov.net/index.php/shoqatat-lista/submissions-directory>



E përsëritim që Global Albania nuk do të jetë një organizim që do të çojë në ndonjë forcë politike të hapët apo të fshehtë. Ndonjëherë kjo kuptohet sikur do të jetë në status më të dobët dhe sikur statusi më i lartë është partia. Është e kundërta do të jetë një një status më të lartë sepse do të jetë e aftë të ketë reputacion të lartë në publik global dhe në atdhe të tillë që shteti dhe forcat politike nuk mund të bëjë dot pa të. Nëse Parlamenti i Shtetit Shqiptar është përfaqësi partish, **Global Albania** është përfaqësi globale organizatash shqiptare jo partiake, pra ku komunikojnë të dy palët, pra janë në të njëjtin vend, në një kuvend, për të njëjtin interes.

Kjo e bën unike dhe besojmë që do të jetë i aftë të komunikojë e bashkëpunojë në mënyrë të shkëlqyer, nëse të gjithë e kuptojnë që është shansi i vetëm që t'i drejtohet shtylla kurrizore shoqërisë e kombit tonë.

Njerëzit kanë nevojë për siguri në besim, për frymëzim dhe për bashkim dhe kjo do t'u ofrohet.

Shqipëria mbahet në fije të perit me shpopullimin që po pëson. Sigurisht Shqipëri do të ketë, por çfarë lloj Shqipërie do të jetë, e dobët, apo cilësore, me shqiptarë, apo me të huaj brenda (jashtë raporteve të natyrshme), me kulturë kombëtare, apo një "sallatë" ndërkombëtare, kozmopolite. Vetë stafet e ambasadave duhet të interesohen që fiset e tyre të kenë një Shqipëri me shqiptarë dhe kjo nuk do të jetë e mundur me shpopullimin masiv. Njerëzit mund të mos kthehen në atdhe, por ndërkohë bizneset dhe politika do ta mbushin Shqipërinë me të huaj. Shtetet e mëdha janë në gjendje t'i mbajnë të huajtë edhe pa prishur kulturën, kurse Shqipëria nuk ka mundësi t'i mbajë në numra të mëdhenj pa tjetërsuar rëndë kulturën. Thjesht thelbi mund të zhbëhet pa kthim. Ndaj kemi nevojë që ta bëjmë saktë, saktë, saktë dhe saktë është jo në mënyrë politike, jo për pushtet, jo për mbizotërim, jo për krahinorizëm, thjesht kombëtarizim i mirëfilltë.

Duket se është më e lehtë t'ia shpjegosh këtë një emigranti sesa dikujt që është në Shqipëri. Duket se shqiptari i Shqipërisë e kupton vetëm kur është emigrant se çfarë Shqipërie duhet të jetë.

Siç Ambasadat mund ta vënë re, në këtë koncept të **Global Albania**, ne kemi hequr çdo element të protagonizmit. Megjithatë ky është koncepti ynë, as vetes nuk i kemi dhënë ndonjë të drejtë. Koncepti **Global Albania** mund të vijojë pa ne, por do të jetë turp dhe dëm kombëtar, që dikush tjetër "i etur për pushtet" (politik, fetar, krahinor, fisnor) të bëjë skema që zotërimi dhe pastaj dështimi të kombit. Askush sipas kësaj skeme nuk do të krijojë pushtet përmes diasporës.

Ajo që ne presim të ndodhë shkëlqyeshëm është:

- Shqiptarët e diasporës dhe pastaj të Shqipërisë do t'i largohen protagonizmit dhe individualizmit, dhe kjo do t'i ndihmojë të ndreqin karakterin, motivet, idealet, vlerat kombëtare dhe vetë shtetin.
- Njerëzit do të bëhen më ndihmues dhe lidhja agregate globale e organizatave shqiptare, në komunikim dhe bashkëpunim intensiv do të prodhojë themele tepër të shëndosha për kombin tonë.
- Koncepti e mbron individin shqiptar që jeton në diasporë. Në kushtet e jetesës në shtete të huaja, sado demokratike të jenë këto shtete, sigurisht që frika ekziston në mënyrë të natyrshme dhe mbështetja shoqërore nuk është aq e madhe (nuk je në vendin tënd), megjithatë institucionalisht mund të jetë. Për dikë që aktivizohet në çështje të një prej kulturave të huaja (në rastin tonë kultura shqiptare) mund të jetë një farë problemi në disa komunitete. Koncepti **Global Albania** aktivizon organizatat dhe anonimizon individët. Një arsye për këtë është edhe mbrojtja e individit. Sa më shumë të kuptohet që protagonizmi individual krahas promovimit ka edhe disa rreziqe, aq më shumë shqiptarët, sidomos në emigracion, duhet të punojnë në grupe dhe organizata demokratike, të hapura, ligjore. Duhet ta kuptojnë se ajo që i mbron më shumë është karakteri kolegjial, puna në grup.
- Deviza e Gjergj Fishtës është e përshtatshme jo vetëm në kuptimin e përfitimit kombëtar: *"Oh! edhe pa mue Shqypnija kjoftë e rrnoftë, E nami i sajë për jetë u trashigofte!"*.

Emigrantët e kuptojnë fare mirë që nuk e zgjidhin dot krizën e identitetit. Ajo rri këmbëkryq në familje dhe familja nuk ka çfarë t'i bëjë, sepse nuk zgjidhet dot vetëm me fuqinë e një familje. Teorikisht po, sepse është në dorën e saj, por praktikisht ndodh që familja ndikohet nga "jashtë". **Gobal Albania**, pikërisht këtë rregullon, pra rregullon "atmosferën jashtë", e bën atë të organizuar në nivel global dhe kjo do të përshejtojë shumë dukuri pozitive kudo, sepse do t'i inkurajojë organizatat që të jenë më aktive, këto do të aktivizojnë më shumë individët, sepse vetë organizatat do të jenë të njohura nga njëra-tjetra, në komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm të ndershem, kreativ, kombëtar. Duhet të kenë shumë besim tek shqiptarët, sidomos të emigracionit. Nuk diskutohet që shqiptarët arrijnë të kenë sukses të lartë profesional, kusht për suksesin kombëtar. Ne nuk jemi të angazhuar në politikë, por si qytetarë jemi të angazhuar në vëzhgimin dhe vlerësimin politikës në përgjithësi, pra e monitorojmë. Kuptohet nga ky manifest që nuk kemi asnjë pikë që të dyshohet se ndonjë parti (e fshetë ose e të ardhmes) do të përfitojë nga kjo skemë. Kjo do të ishte negative, sepse koncepti është qartësisht vetëm kombëtar dhe asgjë tjetër. Kuptohen prej leximit të gjitha frikërat tona nga dukuritë negative të



kapjes së institucioneve. Ndaj **Global Albania** është konceptuar në atë formë që të mos kapet dot prej askujt tjetër përveç Frymës së Kombit, veç në mos paçin mendtë të gjithë globalisht, që nuk jemi në këtë situatë.

SFIDAT DHE DËSHTIMET E VAZHDUESHME SHTETËRORE PËR ORGANIZIM TË DIASPORËS

A po dështojnë shtetet shqiptare në punën me diasporën? Mjafton niveli galopant i asimilimit që të kuptohet se përgjigjia është PO. A mundemi ne ta ndryshojmë natyrën e shtetit? Megjithëse teorikisht është "po", praktika na vërteton se "jo". Dështimet janë kryesisht të lidhura me natyrën e punës së shtetit dhe natyrën krejt të veçantë të problemit të diasporës. Njerëzit nuk i bëjnë planet me shtetin kur dalin jashtë. Të mbash identitetin, komunikimin, bashkëpunimin, kulturën shqiptare jashtë është një luks dhe kosto e madhe. Ata që thojnë e mbajmë lehtësisht dhe pa kosto, nuk e kanë idenë se për çfarë flasim. Nëse një shqiptar largohet nga Shqipëria, ai nuk e harron dot gjuhën shqipe, se nuk është në dorën e tij. Ne flasim, kur ai lind fëmijë jashtë shtetit ose nëse fëmijët që ka lindur në Shqipëri po dobësohen në gjuhë apo po vijnë të përmirësohen në saj të mësimave. Aty duket nëse do ta mbajë apo jo. Realisht kjo kushton. Duhet të shkojë në shkollë, duhet të organizohet në shoqata që t'i japë arsye vetes të komunikojë me të tjerët në gjuhë shqipe. A do ta bëjë individ këtë?

Këtu vijmë tek vështirësitë që ka puna për shtetin shqiptar.

Në konceptin **Global Albania**, shoqëria shqiptare në atdhe është lënë qëllimisht e papërfshirë në organizim, vendimmarrje, pjesëmarrje. Kjo është bërë për disa arsye:

1. Ka diferencë të vërtetë ndërmjet një shqiptari në atdhe me një shqiptar në emigracion. Kjo diferencë duhet respektuar dhe nuk duhen bërë "bashkë" sepse ndryshe ata që do të largohen nga organizime mikse do të jenë "emigrantët". Në një organizim mikse shqiptari i Shqipërisë edhe kur është i dobët profesionalisht, dhe dobët në kompetencën globale, ai mban një pozicion mbizotërues sepse e di që këtë ia jep fakti që ai po jeton në atdhe, fëmijët e tij mësojnë në shkollë shqiptare dhe konsumojnë produkte kulturore shqiptare. Kjo nuk zhbëhet dot. Kjo është arsye që duhet ndarë fort e prerë që shqiptarët e Shqipërisë nuk duhet të përzihen në këtë organizim, por sigurisht që duhet të ndihmojnë që organizimi të shkojë sa më mirë, të jenë bujarë, mikëpritës dhe ta kuptojnë se nuk duhet ta bëjnë "sallatë" organizimin. Këtë koncept ua themi edhe organizimeve në diasporë që në një qytet të huaj thonë "shoqata shqiptare e qytetit A", një sallatë e vërtetë, sepse fjala "shqiptar" që atyre u duket e vogël, është kaq e madhe dhe ata nuk e menaxhojnë dot. Ndaj u kemi këshilluar vini mësuesit para sepse

problemi është kryesisht kulturor. Bëni një gjë një herë (mësonjëtoret) pastaj shikoni të bëni "gjithçka" për shqiptarët. Në fakt, përfundojnë që bëjnë vetëm ca parakalime me flamuj, disa këngë e disa valle, disa dreka e disa darka dhe ndërkohë asimilimi shkon me ritme të larta dhe ata ngrenë supet "nuk e dimë se çfarë të bëjmë".

2. Diaspora kanë nevojë që të kuptohen thellësisht dhe jo të kuptohen vetëm në atë që ata mund të bëjnë për vendin e tyre. Shqipëria, Kosova dhe të gjithë që jetojnë në atdhe duhet të mbështetë konceptin **Global Albania**, sepse janë duke u dhënë fuqi maksimale emigracionit që prek çdo fis edhe në atdhe dhe ky do t'u kthehet në një përfitim të jashtëzakonshëm dhe të shpejtë.
3. Jemi të vetëdijshëm që Shqipëria ka fuqi intelektuale, por si shoqëri ajo është duke u shturur në shumë drejtime. Ajo i ka marrë plotësisht tiparet e një "të sëmuri" që duhet të presë shërim dhe jo të ketë "fodullëkun" e të bëjë "doktorin" kur ka patur kohë mjaftueshëm e nuk e ka bërë me veten. Ndaj duhet ta lërë veten në dorën e diasporës. Me këtë, e përsëritim, nuk kuptojmë që do të duhet të tregohen indiferentë. Përkundrazi, duhet të mbështetnin idenë edhe më shumë, por jo duke marrë frenat në dorë.

Pak a shumë, nëse bëjmë një krahasim të hidhur me një analizë që Sami Frashëri ia bënte Turqisë, në "Shqipëria, ç'ka qenë ç'është e ç'do të bëhetë" ku thoshte se Turqia i ngjan të mbyturit që nuk e lë ta kapësh ti e ta shpëtosh, por kërkon të të kapë e të të mbyset dhe ty (shqiptarin që di të notojë), dhe atëherë çfarë duhet të bësh në këtë rast, duhet t'i japësh shkelmin e të shpëtosh veten.

Nuk është ky konteksti, por do të marrim nga kjo situatë, aq sa na duhet për të ilustruar idenë, se "shqiptarët e Shqipërisë" me situatën ku janë i ngajnë të mbyturit që kërkon të mbytet dhe "Shqiptarët e diasporës". Natyrisht që kjo nuk është e qëllimshme, siç nuk është qëllimi i atij që po mbytet të mbytet tjetrin, por të kapet për të shpëtuar dhe kjo "kapje" qëllon thjesht fatale edhe për tjetrin.

Shqipëria po konsumon veten për brenda dhe po konsumon me shpejtësi edhe diasporën. Shpopullimi për diasporën sigurisht është një kosto e madhe, duhet të pranojnë e të pranojnë dhe shpatullat e tyre janë të brishta. Në kohën që ata presin që të bëhet e kundërta, që shteti të tërheqë e jo të shtyjë.

Ndërkohë nuk mjafton kjo, por shteti në ato skemat e veta partiake të korruptuara edhe ato pak para që janë taksur për diasporën e përdor për korruptim të diasporës, për reklamë partiake, për rekrutim partiak, për përçarje, për shitje botimesh me përmbajtje të dobët, thjesht një rrëmujë e vërtetë.



KJO ËSHTË ARSYEJA QË KËTIJ TË MBYTURI "FIGURATIVISHT I DUHET DHËNË SHKELMI"

Nëse zyrtari "vendali" me korrupsionin e vet ka përzënë emigrantin, është e turpshme, acaruese që në ndonjë kuvend të diasporës të thotë "guri i rëndë në vend të vet". Pra "guri i rëndë" qenkan të korruptuarit, kriminelët dhe "gura të lehtë" na qenkan viktimat e tyre që lanë vendin. Kjo situatë kuptohet nga diaspora dhe shpejt ata do të armiqësohen jo vetëm me të korruptuarit, por me vetë Shqipërinë dhe kjo është e dhimbshme.

Diaspora duhet të mbajë distancën nga "infektimi shtetëror shqiptar" që ka hyrë thellë dhe shumë thellë në popullsi dhe diaspora e ka të vështirë të ndajë shapin nga sheqeri, kur vetë ata rrinë bashkë dhe nuk duan të ndahen në "shap" e "Sheqer". Në një kuptim, diaspora duhet ta quajë se do ta mbajë në "karantinë" Shqipërinë, derisa t'i marrë një e nga një individët dhe organet e tyre e t'ua shërojë. Vetëm atëherë mund të "miksohet".

Emigrantët tanë i kemi në shumicë në shtete demokratike dhe me nivel të lartë jetese dhe kulture demokratike e ligjore. Shoqëritë tona shqiptare vuajnë ende në shumë drejtime dhe gjërat janë përkeqësuar ndjeshëm dhe për t'i shpëtuar vuajtjeve nuk kanë asnjë mundësi tjetër veç të shfrytëzojnë gurin e fundit që kanë në dorë që është aktivizimi i emigracionit. Por mënyra se si shfrytëzohet nuk duhet të jetë sipas "zërit të sirenave" "ejani votoni" (eja korruptohuni me sistemin tonë zgjedhor), "eja votoni për çakallin" (në vend të ujkut), "ejani ndërtoni partinë tuaj".

Aktivizimi i emigracionit nuk duhet të jetë politik apo në funksion të politikës. Diaspora duhet të bëjë afërisht atë që bën Bashkimi Evropian apo SHBA me Shqipërinë që ua sjellin ngushtë të gjithëve dhe i detyrojnë të gjitha palët të bëjnë atë që duan, por detyrimi i diasporës do të jetë cilësisht ndryshe, më i mirëpritur, më i natyrshëm, më i kërkuar, sepse është detyrim i brendshëm shqiptar.

Ne nuk presim që emigracioni të formojë një parti politike dhe ne këtu ta votojmë atë. Kjo do të ishte thjesht një përçarje e emigracionit dhe menjëherë do të kishim një flluskë sapuni ose një dështim që vjen jo nga diaspora por nga teknikat e këtushme të sprovuara për dështim. Teknikat se si dështon një ide politike janë përsosur kaq shumë, sa kjo jo vetëm që do të ishte utopike, por do të ishte edhe e rrezikshme për individët dhe ne nuk duam që ata të marrin rreziqe, nuk duhet të punojnë në një terren të minuar nga media që është përsosur në "shërbimet" e veta ndaj politikës dhe arrijnë të merren vesh edhe me sy, jo më me fjalë.

Diaspora duhet të bëjë një punë më të thellë sesa politika. Të shtrojë trasenë, shinat dhe ta detyrojë politikën të hipë aty. Kjo është më e lartë sesa politika dhe kjo mund të bëhet.

Me të drejtë mund të thuhet "Çfarë do të bëjmë ne të re, kur shtetet demokratike i kanë bërë dhe thjesht Shqipëria të ndjekë ato modele". Bota i bën se ka një bashkim drejt disa vlerave dhe ekziston një opinion publik. Si mund të bëhen gjërat e "botës" pa u bërë konkretisht bashkimi, dhe bashkimi të shfrytëzohet për studim, analizë, reflektim të përditshëm, të përjavshëm, të përmuajshëm, të përvitshëm. Kësaj i thonë "bëjeni vetë e na thoni edhe ne kur ta keni bërë që të duartrokasim". ("Vetë nuk e bëjmë dhe dështojmë edhe diasporën ta bëjë")

Natyrisht këto diskutime, janë thjesht këndvështrime që mund të jenë në kokën e individëve dhe nuk është që kemi një zë të diasporës. Po ta kishim, do të thoshte që ajo është e bashkuar, por nuk është e bashkuar dhe po duam që ajo të bashkohet e të kuptojë rëndësinë e kësaj për çastin ku ndodhet kombi shqiptar. Shumica bashkohen në pesimizëm dhe shumë pak bashkohen në optimizëm, që reflekton analizën se gjërat po shkojnë jo mirë.

Duam që emigracionit të shërbejë për të gjallëruar frymën dhe jetën kombëtare dhe të formojë opinionin publik të paanshëm ndaj shoqërisë shqiptare, duke e parë atë nën këndvështrimin global, pra se si shkon shoqëria njerëzore në këtë çast. Ky shërbim është unik dhe ende nuk ekziston. Koncepti **Global Albania** do ta bënte të mundshëm.

Tregohemi të kujdesshëm në konceptin **Global Albania**, sa kemi hequr mundësinë që **Global Albania** të jetë një organizatë e njohur (nga ligji i ndonjë shteti), pra me identitet juridik. Ajo nuk do të regjistrohet diku, edhe pse mund ta bëjë këtë. Në këtë gjë zbatojmë këshillën e Naim Frashërit "Besa është në kraharuar, nuk është në kartë shkruar" dhe të poetit portugez Fernando Pessoa "Nuk dua të kuptohem, të kuptohesh do të thotë të prostituohesh". Të dhënë e formës (regjistrimi, statuti, aktet e themelimit, financat, mediat, organet, auditet, etj) do të lejonte sulmin ndaj Global Albania dhe kjo do të dështonte plotësisht që Fryma e Kombit të kalonte nga individ në individ, nga organizatë në organizatë, nga shteti në shtet, dhe pastaj të hynte në atdhe, ku e ka vendin. Atyre që u lejohen gabimet janë individët dhe organizatat vendore, Global Albania nuk duhet të bëjë asnjë gabim, përveç të jetë komponent thelb i thelbit të thelbit.

Diçka e ngjashme me "kriptomonedhën" dhe "monedhën". Për "monedhat" kemi një bankë qendrore, për "kriptomonedhat" nuk kemi një bankë qendrore. Kjo është e



njëjtë edhe për "organizatat individuale" që mund t'i quajmë monedha që menaxhohen (licensohen, kontrollohen, monitorohen) nga shtetet, ndërkohë që **Global Albania** nuk ka ku të regjistrohet si e tillë dhe nuk duhet të regjistrohet.

Natyrisht që ne presim që ky koncept i punës të dështojë korrupsionin dhe të gjithë klasën polike që e solli Shqipërinë këtu. Global Albania synon që publiku të krijojë mekanizmin më të vërtetë të shfaqjes së "opinionit publik shqiptar në botë" që do të jetë edhe standardi më i lartë.

ROLI I MEDIAS dhe GLOBAL ALBANIA

Media e Shqipërisë duhet ta kuptojë që nuk duhet të bëjë "biznes" e "politikë" në këtë punë, pra të kërkojë klikime dhe ta "vdesë" foshnjën me lloj-lloj keqkuptimesh, dykuptimesh, trekuptimesh. Duhet të kuptojë që janë brenda varkës që po mbytet dhe duhet të japin edhe ata një ndihmë të paktën duke ndenjur urtë e duke mos tronditur varkën andej - këndeje, kur qartësisht po drejtohet drejt shpëtimit.

Gazetari apo gazetarja duhet ta kuptojë që po e bën këtë për të afërmit e vet që janë jashtë Atdheut dhe që sigurisht nuk do t'i donte që të ishin andej, por i donte afër. Tani ata janë andej dhe jo këtej, e dimë që ka prekur çdo fis, dhe **Global Albania** synon rregullimin e shtyllës kurrizore të Kombit Shqiptar që ka marrë anë në kohët që po jetojmë. Duhet ta kuptojë siç po shkruhet këtu dhe të ndihmojnë, të ndihmojnë e të gëzohen nëse kjo punë shkon mirë kombëtarisht.

Ne presim që ata me artikujt e tyre të frymëzojnë shqiptarët kudo në botë që të bashkohen rreth organizatave ekzistuese ose të krijojnë të tjera, mjaft që të kenë mundësi të mbrojnë kolektivisht të ardhmen e tyre dhe tonën në një botë që ndryshon vazhdimisht e vazhdimisht. Në radhë të parë presim që ata të dështojnë korrupsionin e mediave ku punojnë dhe të luajnë rolin e pavarur dhe jo të jenë kobure e politikës.

Media e Shqipërisë në masë është mekanizëm i politikës dhe diabolizmi më i madh shprehet pikërisht tek media, sepse ajo mban vulën "e pavarur". Kaq e varur është media nga politika, sa politika ka hequr organet e saj të shtypit. Duket që na ka marrë malli për shtypin partiak, sepse kishte një autorësi dhe një vulë botuesi që ishte partia dhe ku marrëdhënia autor - parti ishte e qartë. Tani publiku bën pyetje "me kë të jetë vallë ky analist" kaq e kanë bërë ligjërimin si dhelpra me pesë dalje. Nëse të vegjlit rreshtohen në mënyrë ekskluzive, të mëdhenjtë kanë luksin të punojnë me të gjithë dhe janë shprehja më e mirë e medias së "klasës politike", me të cilën i bëjnë gropën Shqipërisë.

Atë shtrëngesë që Global Albania do t'ia bëjë klasës politike, do t'ia bëjë dhe medias së kapur nga politika apo anasjelltas medias që ka kapur politikën. Këtë punë do ta bëjë shumë mirë, sepse do të shtrihen në të gjithë botën botimet nga organizatat shqiptare që do të shprehin qëndrimet e Global Albania.



MOS VOTONI, MOS SHENJTËRONI, KARTELIN E PARTIVE QË SHPËRFill EDUKIMIN DHE SISTEMIN ARSIMOR KOMBËTAR

Provohet plotësisht nga analiza e programeve se të gjitha partitë në garë nuk e kanë seriozisht arsimin.
Media inkurajon shpërfilljen duke thënë se arsimi është shqetësim për 1.3% të popullsisë (devijim i rëndë i të vërtetës).



1. Arsimi ndaj Ekonomisë

Argumenti: Ekonomia është rezultat, jo shkak. Një ekonomi nuk rritet me krah pune të pakualifikuar, me mungesë inovacioni, me injorancë financiare dhe me mungesë të mendimit kritik. Një sistem arsimor i fortë është motori i ekonomisë: formon sipërmarrës, punonjës të aftë dhe qytetarë që prodhojnë më shumë sesa konsumojnë. **Shembull:** *Vendet si Irlanda dhe Estonia investuan në arsim për dekada para se të bëheshin "tigrat ekonomike" të Europës.*

2. Arsimi ndaj Papunësisë

Argumenti: Papunësia nuk është mungesë e vendeve të punës, por mungesë e njerëzve të përgatitur për punë reale. Shkollat shqiptare prodhojnë diploma, por jo kompetenca. Nëse arsimi do përgatiste njerëz që tregu i kërkon, papunësia do binte. **Fakti:** *Bizneset në Shqipëri shpesh ankohen se nuk gjejnë punonjës të kualifikuar, pavarësisht numrit të madh të të papunëve.*

3. Arsimi ndaj Emigrimit

Argumenti: Arsimi cilësor i jep një të rinj arsye për të qëndruar. Një sistem që nuk ofron dije, shpresë, ose rrugë zhvillimi është nxitës direkt i emigrimit. Shkollat që shërbejnë vetëm për "ikje" po punojnë kundër vendit. **Fakti:** *Qindra mijëra të rinj largohen për studime jashtë me synimin për të mos u kthyer më, pikërisht sepse sistemi vendas nuk u jep garanci.*

4. Arsimi ndaj Shëndetësisë

Argumenti: Shëndetësia varet drejtpërdrejt nga cilësia e edukimit të mjekëve, infermierëve, administratorëve shëndetësorë. Gjithashtu, një popull i paedukuar nuk ndjek praktikatat e duhura shëndetësore. **Shembull:** *Vendet që kanë arsimuar qytetarët mbi rëndësinë e parandalimit dhe vaksinimit kanë sisteme më të qëndrueshme.*

5. Arsimi ndaj Forcave të Armatosura

Argumenti: Siguria kombëtare nuk ndërtohet vetëm me armë, por me dije, karakter dhe aftësi strategjike. Forcat e armatosura të një vendi janë pasqyrë e sistemit arsimor: nëse arsimi është i dobët, edhe ushtria do jetë e dobët — në disiplinë, në moral, në udhëheqje dhe në vendimmarrje. Një ushtri moderne kërkon kuadro të formuar në shkenca ushtarake, inxhinieri, teknologji, etikë dhe gjuhë të huaja. Kërkon liderë me mendim kritik dhe ushtarë me ndërgjegje qytetare. Nuk ndërtohet mbrojtja e vendit me analfabetizëm funksional dhe ndjenja të shpërqendruara kombëtare.

Shembull: Vendet që kanë forca të armatosura profesionale dhe efektive (si Izraeli, Finlanda apo Koreja e Jugut) kanë ndër të parat një sistem arsimor që edukon me identitet, përgjegjësi dhe aftësi të shumëanshme. Ata e fillojnë mbrojtjen me shkollën.

6. Arsimi dhe Sistemi i Drejtësisë

Argumenti: Një drejtësi e drejtë dhe funksionale lind nga një arsim i ndershëm dhe i fortë. Pa juristë të përgatitur dhe qytetarë të vetëdijshëm, drejtësia mbetet formale dhe e manipulueshme.

Arsimi juridik i dobët prodhon drejtësi të rrezikshme. Gjyqtarë dhe prokurorë të pakualifikuar janë pasojë e një arsimi që favorizon teorinë bosh dhe mungesën e praktikës reale.

Kultura e pandëshkueshmërisë fillon në shkollë. Kur në arsim normalizohet mashtrimi dhe mungesa e meritës, kjo përkthehet në drejtësi të korruptuar. **Qytetari i paarsimuar nuk kërkon drejtësi.** Ai nuk njeh të drejtat e veta dhe nuk reagon ndaj padrejtësive. Demokracia nuk funksionon pa qytetarë të informuar.

Arsimi parandalon dhunën dhe radikalizmin. Ai kultivon tolerancë, logjikë dhe komunikim — më efektiv sesa çdo masë ndëshkuese. **Universitetet formojnë edhe reformatoret e ligjit.** Pa arsim të avancuar juridik, nuk ka kush përmirëson ligjet apo mbron të drejtat e qytetarëve. **Përfundim:** Pa arsim s'ka drejtësi. Pa drejtësi s'ka shtet. Investimi në shkollë është më themelor se investimi në gjykata.

7. Arsimi ndaj Korrupsionit

Argumenti: Një popull i paarsimuar nuk kërkon llogari. Një qytetar që nuk njeh ligjet, procedurat, apo të drejtat e veta është terren i përsosur për korrupsion. Arsimi prodhon integritet, ndërgjegje dhe rezistencë morale ndaj abuzimit.

Fakti: *Vendet me shkallë më të lartë arsimimi kanë më pak korrupsion institucional (shih indeksin e Transparency International).*

8. Arsimi ndaj Sigurisë Publike dhe Krimit

Argumenti: Krimi buron shpesh nga mungesa e alternativave. Arsimi i mirë parandalon kriminalitetin duke u dhënë të rinjve mjete për të pasur një jetë të ndershme dhe profesionale. Po ashtu, forcon sistemin e drejtësisë përmes përgatitjes së juristëve e oficerëve.

Fakti: *Kriminaliteti është më i ulët në zonat ku sistemi arsimor funksionon dhe ofron integritim social.*

9. Arsimi ndaj Politikës dhe Politikanëve

Argumenti: Politikanët zgjidhen nga qytetarët. Një qytetar i paarsimuar bie më lehtë pre e populizmit, manipulimit dhe demagogjisë. Arsimi i mirë forcon demokracinë dhe rrit cilësinë e përfaqësimit.

Shembull: *Në vendet me arsim të lartë, pjesëmarrja politike është më e ndërgjegjshme dhe kontrolli ndaj politikanëve më i fortë.*

10. Arsimi ndaj Varfërisë

Argumenti: Varfëria nuk është mungesë lekësh, por mungesë mundësisht. Arsimi është mekanizmi më i fuqishëm për të thyer ciklin e varfërisë, sepse i jep individit aftësi për të ndryshuar jetën e vet.

Fakti: Banka Botërore e cilëson arsimin si "faktor kyq për të dalë nga varfëria" në raportet për vendet në zhvillim.

Shpërndarë në datën 9 maj 2025



*Janë së gjithash të marrë!
Dhe të liq me të vërtetë,
Mëmëdhent bëjnë varrë,
Po do të bienë vetë.*

Naim Frashëri

Elita politike: gardiane e privilegjit, jo e arsimit publik

Në Shqipëri, ekziston sot një hendek i thellë midis fjalëve që partitë politike shkruajnë në programet e tyre dhe mënyrës se si veprojnë në jetën e përditshme. Askund nuk dallohet kjo hipokrizi më qartë sesa në trajtimin që i bëjnë arsimit publik, e provuar kjo nga programet elektorale për zgjedhjet e 11 majit 2025. Është fakt botërisht i ditur, lehësisht i verifikueshëm se *fëmijët e shumicës së elitës politike dhe të drejtuesve të medias ndjekin shkolla private* – shpesh të huaja, herë fetare – ndërkohë që arsimit publik, ai që u takon shumicës dërrmuese të qytetarëve, zvarritet në një krizë të thellë dhe të qëllimshme.

Pse i lidhim këto dy fakte?

Tashmë i kemi parë me kujdes programet elektorale të të gjitha partive në garë, dhe vëmë re një trajtim krejt sipërfaqësor, thuajse formal të arsimit publik. Kjo nuk do të ishte e mundur nëse këta politikanë do të ishin *prindër pjesë e arsimit publik*. Pra nuk dinë as në këndvështrim të prindit problematikën, le më t'i kenë studiuar.

Premtime të përgjithshme sa për të thënë, për “*rritje cilësie*”, “*reforma në kurrikulë*” apo “*modernizim infrastrukturë*”, pa asnjë projekt konkret, pa afate, pa analiza të realitetit që do të duhej të përballonin. Në të vërtetë, për elitën politike, arsimit publik është një sektor që *dubet ruajtur në një status-quo mediokre, për të siguruar ndarjen klasore që i garanton asaj epërsi*.



ELITA POLITIKE E MEDIATIKE QË I KA FËMIJËT NË SHKOLLAT PRIVATE (SHQIPTARE, TË HUAJA APO FETARE) SHPËRFILLIN SISTEMIN ARSIMOR PUBLIK

Nuk është thjesht braktisje – është përçmim i hapur

Sepse kur një kryetar partie, ministër, deputet apo kryetar bashkie e çon fëmijën në një shkollë private elitare, ai nuk po zgjedh më të mirën për fëmijën e tij; ai po dërgon një mesazh të qartë dhe të ftohtë: “*Ky sistem nuk është për ne. Ky është për ju.*” Dhe kjo ndarje është thelbësisht politike. Sepse *ata që kanë pushtet për të ndryshuar sistemin publik, e kanë braktisur atë vetë*. Dhe jo vetëm kaq: ata nuk e ndiejnë më as nevojën që ta përmirësojnë. Në sytë e tyre, arsimit publik është kthyer në një lloj shtëpie sociale për të varfrit dhe të pambrojturit.

“Dhe të liq me të vërtetë”

Nuk mjafton të thuhet se kjo elitë politike është indiferente. Jo – ata janë “*të liq me të vërtetë*”, siç shkruante Naim Frashëri tek “*Tradhbëtorët*”. Kjo indiferencë nuk vjen nga padija apo paafërsia. Ajo vjen nga një logjikë e ftohtë për të ruajtur privilegjin. Kur një politikan zgjedh më të mirën për fëmijën e vet, por e mban sistemin publik në mjerim, nuk është thjesht duke mbrojtur familjen e tij – ai po punon, në heshtje, që shumica të mbetet në terr.

Është një veprim që kërkon jo vetëm përçmim, por edhe një dozë të fortë ligësie: të dish të mirën dhe ta mohosh me vetëdije për të tjerët. Ky është thelbi i padrejtësisë që prodhon plagët më të mëdha shoqërore. Madje, kjo ligësi shfaqet edhe më qartë kur kuptojmë se as arsimin privat nuk e zgjedhin për vlera, për filozofi pedagogjike apo për një projekt arsimor që e besojnë.

Ata nuk kanë vizion për asnjë formë arsimit. Ata zgjedhin privat sepse atje marrin më shumë për fëmijët e tyre, jo sepse duan ta ndërtojnë apo ta zhvillojnë atë sistem. Është një zgjedhje e pastër utilitare: *ku ka më shumë për ne, atje do shkojmë*. Po të ndodhte e kundërta, do ta braktisnin edhe atë. Kjo e çon hipokrizinë politike në kufijtë e cinizmit total: *nuk bëhet fjalë për një përplasje mes publikut dhe privatit, por për një pushtet që nuk i intereson arsimit, përveçse si garanci për epërsi personale*.

Vargjet e Naimit nuk janë thjesht poezi: janë aktakuzë morale. Janë kampionë që paralajmëron rrëzimin e atyre që, në emër të pushtetit, kanë kthyer mbrapsht misionin e shenjtë të shërbimit ndaj publikut. *Kur arsimit bëhet mall tregu dhe privilegj për pakicën, demokracia vdes*, sepse pa arsim të barabartë, nuk ka as shanse të barabarta, as qytetarë të vetëdijshëm, as republikë funksionale.

Elita politike shqiptare duhet të zgjidhë njëherë e mirë: *ose të rikthejë besimin te shkolla publike dhe ta ndjekë këtë me vepra* — duke i dërguar edhe fëmijët e saj aty — *ose të pranojë se ka hequr dorë nga përfaqësimi i popullit*. Dhe në atë rast, duhet ta dijë se çdo sistem që e përçmon shumicën, ka një afat skadence. Dhe shpesh, ai afat vjen papritur.

Libri digjital “*Ndal shpërfilljes së edukimit*”, nga Artur Shkurti, 4 maj 2025, në 145 faqe, jepet kritika e programeve arsimore të çdo partie.



KOKËFORTËSIA E PARTIVE NË SHPËRFilljen e ARSIMIT DO TA SHTHURË KOMBIN SHQIPTAR

“Shturja është një lumë i rrëmbyer që ecën midis popujve dhe i rrëmben popujt që janë mbrojtur me muret e një morali të mirë dhe me anën e një administrimi të mirë i dërgon nëpër grykëderdhje pranë detit ku ato janë të paracaktuar të mbyten.” (Sami Frashëri)
“Është shumë e lehtë të ruash nga shturja një komb që nuk e ka mësuar atë, por është shumë vështirë ta shpëtosh atë që është mësuar.” (Sami Frashëri)

Më 4 maj 2025, një javë para zgjedhjeve parlamentare të 11 majit, ne botuam analizën kritike me titullin *“Ndal shpërfilljes së arsimit”*, ku për herë të parë bëhej një kritikë e detajuar dhe profesionale ndaj të gjitha programeve arsimore të partive politike shqiptare, të cilat u cituan të pleta që lexuesi të ishte i mbrojtur nga komentit ynë. Libri është shpërndarë në mënyrë të verifikueshme në të gjitha shkollat publike dhe private të Tiranës dhe në çdo qytet të Shqipërisë nga Veri në Jug. U lamë kështu kohën e mjaftueshme për të reaguar para zgjedhjeve të 11 majit 2025. Libri është dërguar edhe në adresat e deputetëve të parlamentit, pra klasa politike e ka këtë kritikë. *Çfarë ndodhi në të vërtetë pas kësaj? Asnjë parti politike nuk reagoi. Asnjë koment. Asnjë korrigjim. Asnjë reflektim. Asnjë fjalë.* Ky heshtje nuk është neutrale – është një shpallje arrogante e refuzimit për të dëgjuar dhe reflektuar. Është një deklaratë e heshtur që thotë: *“Ne nuk kemi ndërmend të ndryshojmë asgjë dhe e dimë që as mësuesit nuk do të reagojnë, por do të votojnë”*. Nuk është më thjesht shpërfillje, është kapitullim i qëllimshëm i klasës politike ndaj përgjegjësisë së saj për edukimin kombëtar.

Kjo nuk është një kritikë emocionale. Është një përballje me fakte dhe dokumente. Libri ynë *“Ndal shpërfilljes së arsimit”* nuk është pamflet, por një punim 145-faqesh me argumente të verifikueshme, që i ekspozon të gjitha partitë në dështimin e tyre të përbashkët për të prodhuar një vizion të qartë, të qëndrueshëm dhe të ndershëm për arsimin në Shqipëri. Libri ishte forma më e mirë e ngritjes së vetëdijes për çështjen më të rëndësishme që ka kombi ynë. Ajo që kemi përballë nuk është thjesht neglizhencë – është mungesë totale respekti ndaj votuesve, mësuesve, prindërve dhe brezave të ardhshëm. Pasi i dërguam kritikën tona në kohë, e lamë hapësirën për korrigjim. Heshtja e tyre (politikë dhe media bashkë) është akt i vetëdijshëm. Ata nuk kanë lexuar ose nuk kanë dashur të lexojnë sepse nuk u intereson arsimi – për ta arsimi është pengesë, jo prioritet.

Prandaj themi: kjo është prova më e qartë se partitë politike shqiptare nuk e duan Shqipërinë si ide kombëtare, por vetëm si terren votash. Votuesi ndodhet përballë një klase politike që nuk e fton në debat, nuk i jep llogari dhe nuk pranon kritikën. Kjo është forma më brutale e antidemokracisë funksionale: *një pluralizëm pa vizion, pa dialog dhe pa dinjitet*. Mosreagimi ndaj kritikës është shpërfillje e qëllimshme ndaj inteligjencës shqiptare. *Kur asnjë mësues, asnjë drejtues, asnjë ministër nuk reagon, kjo do të thotë se arsimi nuk ka më përfaqësim real në vendimmarrje.* Është i braktisur. Në vend të politikave të mirëfillta, kemi slogane të thata. Në vend të përfshirjes së profesionistëve, kemi arrogancën e injorimit institucional. Në këtë klimë heshtjeje dhe poshtërimit, votuesit kanë të drejtë të bëjnë votën e pavlefshme, si një formë e ligshme proteste, për të treguar se asnjëra nga partitë nuk përfaqëson idealin e një sistemi arsimor të drejtë, kombëtar dhe përparimtar. Sepse mosvotimi nuk është indiferencë – është akt dinjitoz i mospranimit të mediokritetit politik. Por nuk kemi shpresë as për këtë reagim.

Të gjithë ata që heshtin sot, do të gjykojnë nesër nga brezat që po edukohen me një sistem të braktisur dhe të deformuar. Nëse arsimi nuk është sot prioritet, nuk do të ketë as ekonomi, as drejtësi, as demokraci funksionale.

Prandaj e themi qartë: kokëfortësia politike ndaj kritikës është sinjal i sëmundjes së thellë të demokracisë sonë. Tani është koha për reagim të organizuar qytetar, moral dhe kombëtar.

Ky qëndrim i partive politike – i mbushur me heshtje, injorim dhe refuzim për të reflektuar mbi kritikën e drejtë ndaj programeve të tyre arsimore – është shumë më tepër se paaftësi politike: *është provë e qartë e një shturjeje kombëtare që ka zënë rrënjë*. Kur kësaj i shtohet apatia e vetë mësuesve, pedagogëve, që nuk reagojnë më as ndaj fyerjes profesionale dhe as ndaj dështimit institucional, atëherë *kemi përballë një shoqëri që ka filluar të dorëzohet* – jo për mungesë njohurie, por për humbje të shpresës dhe vetëdijes morale.

Sami Frashëri, mendimtar i madh i Rilindjes Kombëtare, na paralajmëroi me fjalë që sot janë profetike: *“Shturja është një lumë i rrëmbyer që ecën midis popujve dhe i rrëmben popujt që janë mbrojtur me muret e një morali të mirë dhe me anën e një administrimi të mirë i dërgon nëpër grykëderdhje pranë detit ku ato janë të paracaktuar të mbyten.”*

Kur partitë politike nuk i japin llogari publikut për çështjen më jetike të një kombi — arsimin — dhe kur mësuesit nuk reagojnë ndaj kësaj shpërfilljeje, atëherë muret e moralit dhe të administrimit të mirë janë rrënuar. Uji i shturjes po kalon pa pengesë dhe po na çon drejt grykëderdhjes — d.m.th. drejt një fundi historik si komb funksional.

Ende më tronditëse është fjala tjetër e Samiut:

“Është shumë e lehtë të ruash nga shturja një komb që nuk e ka mësuar atë, por është shumë vështirë ta shpëtosh atë që është mësuar.”

Kjo është diagnozë e saktë për Shqipërinë e sotme. Ne nuk jemi thjesht në rrezik të shturjes — ne jemi të mësuar me të. Na duket normale të mos kërkojmë përgjegjësi, të mos ngremë zërin, të mos analizojmë, të mos kundërshtojmë. Kjo normalizim i shturjes është shenja më e rrezikshme e kalbjes morale. Kur shturja nuk na duket më alarm, por “gjendje e zakonshme”, atëherë jemi shumë pranë zhdukjes së identitetit dhe vullnetit kombëtar.

Për këtë arsye, heshtja e mësuesve nuk është më thjesht frikë apo lodhje — është bashkëfajësi me shturjen. Dhe qëndrimi i partive, që as nuk lexojnë, as nuk përgjigjen, as nuk përmirësohen, është tregues se shturja është bërë sistem, jo përjashtim. Nëse një komb nuk reagon për arsimin, ai nuk reagon për asgjë tjetër. Dhe nëse nuk reagon, është vetëm çështje kohe para se të mbytet në grykëderdhjen e atij lumi që Samiu e përshkroi me vizion të qartë.

Nga Artur Shkurti

Drejtor i shkollës “Udhë e Shkronjave”

Tiranë, më 10 maj 2025

VOTO

ME ARSIMIN KOMBËTAR NË MENDJE

*Kush shpërfill arsimin dhe natyrën kombëtare të tij
nuk mund të ofrojë të mira për Shqipërinë*

*Studimi i programeve të 100% të partive politike
provon se asnjë prej tyre nuk e ka seriozisht
politikën kombëtare arsimore*



Merrni librin digjital, 145 faqe, titulluar:

“Ndal shpërfilljes së edukimit - Kritikë
e programeve arsimore të partive politike”,
nga Artur Shkurti, 4 maj 2025

*Tregomu dhe shqipëtarëvet,
Udhën e punës së mbarë:
Bashkomi, bëmi vëllezër,
Edhe thjeshtë shqipëtarë.*

NAIM FRASHËRI





RITI I DENTIFIKIMIT I BUJARËVE SHQIPTARË

**U konceptua për herë të parë, më 2009
nga Artur Shkurti dhe u paraqit në librin**

“Besa, feja ime, e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë”

ISBN 9789995675509 me 272, faqe A4

shpërndarë falas print dhe digjital në vitin 2009-2010

Në origjinal ishte Riti i Lutjes së Bujarit Shqiptar dhe paraqitet i shpjeguar në faqen 32 të librit “Besa”

Riti i Identifikimit të Shqiptarëve, ishte pjesë e planifikimit të disa riteve në librin “Besa” për të konkretizuar në shumë zëra devizën e Rilindjes Kombëtare “Feja e shqiptarit është shqiptaria” (Pashko Vasa).

Frymëzimi konkret erdhi nga këto vargje të Naim Frashërit tek “Histori e Skënderbeut” dhe nga teatri i hijeve (shqiponja):

Me zëmrë shumë të qetë,
Lith duart në krahuar,
Pa thotë “Zot i Vërtetë!
Emri yt qoft’ i lëvdur”

Naim Frashëri

Në foto vajza arbëreshe nga Caraffa di Catanzaro Calabria
Arbëreshët shkuan aty pas luftimeve të Skënderbeut







NDAL SHPËRFILLJES SË EDUKIMIT

Kritika e programeve arsimore

të partive politike shqiptare

Në prag të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, 11 maj 2025

